



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar auditimi financiar dhe përputhshmërie në**  
**Bashkinë Fushë Arrëz**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË**  
**PËRPUTHSHMËRISË**  
**NË**  
**BASHKINË FUSHË ARRËZ**

**Janar 2023**

<b>Nr.</b>	<b>PËRMBAJTJA</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	
I.1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	<b>4-10</b>
I.2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
I.3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	
II.1.	Objekti i auditimit	<b>10-15</b>
II.2.	Qëllimi i auditimit	
II.3.	Identifikimi i çështjes	
II.4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
II.5.	Përgjegjësitë e audituesve	
II.6.	Kriteret e vlerësimit	
II.7.	Standardet e auditimit	
II.8.	Metodat e auditimit	
II.9.	Dokumentimi i auditimit	
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI AUDITIMIT</b>	<b>15-152</b>
III.1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	15-16
<b>III.2.</b>	<b>Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit</b>	16-152
III.2.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	16-18
III.2.1.1	Mbi auditimin e brendshëm	18-23
III.2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	23-52
III.2.3	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2021	52-65
III.2.4	Mbi planifikimin dhe zbatimin e procedurave të prokurimit publik	65-122
III.2.5	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit	122-123
III.2.6	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV)	123-124
III.2.7	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	124-128
III.2.8	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	129-141
<b>IV.</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	<b>141-152</b>
<b>V.</b>	<b>ANEKSE</b>	<b>153-167</b>

## Shkurtime

<b>AAJM</b>	Aktive Afatgjata Jo Materiale
<b>AAM</b>	Aktive Afatgjata Materiale
<b>AK</b>	Autoritet Kontraktor
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
<b>ASHK</b>	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
<b>AKBN</b>	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
<b>BOE</b>	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
<b>DRT</b>	Drejtoria Rajonale Tatimore
<b>DSHP</b>	Drejtoria e Shërbimit Pyjor
<b>ERE</b>	Enti Rregullator i Energjisë
<b>FZHR</b>	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
<b>GMS</b>	Grupi i Menaxhimit Strategjik
<b>INTOSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit
<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>KVO</b>	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
<b>LPP</b>	Ligji i Prokurimit Publik
<b>MFK</b>	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
<b>MAB</b>	Manuali i Auditimit të Brendshëm
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues
<b>NJA</b>	Njësi Administrative
<b>NJAB</b>	Njësia e Auditimit të Brendshëm
<b>NJP</b>	Njësia e Prokurimit
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues
<b>OE</b>	Operator Ekonomik
<b>PF</b>	Pasqyrat Financiare
<b>QKB</b>	Qendra Kombëtare e Biznesit
<b>SHA</b>	Shoqëri Aksionare
<b>SHPK</b>	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
<b>SKK</b>	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
<b>STTV</b>	Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>TNI</b>	Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë
<b>QKB</b>	Qendra Kombëtare e Biznesit
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak
<b>ZK</b>	Zonë Kadastrale

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **I.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Fushë Arrëz, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, planifikimit, realizimit të prokurimeve dhe zbatimit të kontratave të lidhura për punë publike, planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, si dhe aktivitetin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit. Gjithashtu pjesë e këtij auditimi ishte edhe trajtimi i ankesave të subjekteve “K.LI” dhe “O” Sh.P.K.

Gjatë periudhës së auditimit nga data 05.10.2022 deri në datën 25.11.2022 u krye auditimi, i cili kishte objekt: “Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë të Bashkisë Fushë Arrëz” dhe mbuloi periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021, si dhe auditim përputhshmërie për periudhën 01.01.2019-31.12.2020 (auditimi i procedurave të prokurimit publik)

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 10 akt-konstatime dhe 4 akt-verifikime. Mbi aktet e mbajtura nga grupi i auditimit, nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur.

-Për projekt raportin e auditimit nga subjekti i audituar me shkresën nr.858/8 prot., datë 11.01.2023, janë paraqitur observacione, të cilat janë trajtuar rast pas rasti në çështjet përkatëse.

-Nga subjekti i audituar u paraqit kërkesë për kryerjen e takimit të ballafaqimit në ambjentet e KLSH-së, i cili u realizua më datë 18.01.2023.

**Në mënyrë të përmbledhur, në përfundim rezultoi se nga auditimi i procedurave të prokurimit, u konstatua se në:**

-16 raste në dokumentet standarde të tenderit, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e kriterëve për kualifikim (si kërkesa për certifikatat e standardizimit, numrin e punonjësve, të makinerive, kategorive të licencave të zbatimit të punimeve etj), si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjestim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

-16 raste OE janë shpallur fitues në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, si dhe nga KVO nuk është bërë anulimi i procedurës së prokurimit.

-5 raste nga NJP nuk është argumentuar dhe dokumentuar përlllogaritja e fondit limit, duke shkaktuar përdorim pa eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën 3,139,712 lekë.

-Veç sa më sipër, u konstatua se kërkesat për karburant nga sektorë të ndryshëm në Bashkinë Fushë Arrëz, nuk argumentohen në mënyrë të plotë dhe të saktë. Gjithashtu për mjete të ndryshme nuk është përcaktuar norma e konsumit të karburantit, si p.sh., mjetet e sektorit të zjarrëfikses.

### **Gjithashtu nga auditimi i:**

-Veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme, rezulton se në Bashkinë Fushë Arrëz nuk është krijuar Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit. Për periudhën objekt auditimi, nuk ka asnjë evidencë nga punonjës të bashkisë për veprimtari që mbulojnë fushën e inspektimit dhe kontrollit të territorit.

-Të dhënave të siguruara nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me leje minerare sipas regjistrit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se përgjatë periudhës 2020-2021, në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz, kanë ushtruar aktivitet në sektorin e kërkimit, zbulimit,

prodhimit të minerareve 10 subjekte me sipërfaqe 11.475 km<sup>2</sup>, për të cilat NSHP Bashkia Fushë Arrëz nuk administron dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj)<sup>1</sup>.

-Debitorëve të Bashkisë Fushë Arrëz, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh në vlerën 18,441,055 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz dhe vlera 1,059,385 lekë është krijuar brenda vitit 2021. Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Fushë Arrëz, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, është mjaftuar vetëm me njoftimin e subjekteve debitore dhe nuk ka kryer asnjë procedurë tjetër, për të vërtetuar nëse këto subjekte operojnë ose jo.

-Dokumentacionit të subjekteve të liçencuara për ushtrim aktivitetit si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve, u konstatua se në Bashkinë Fushë Arrëz në fund të vitit ushtrimor 2021, ushtrojnë aktivitetin 4 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 3 subjekte nuk janë pajisur me autorizim 5 vjeçar, të cilët nuk kanë paguar detyrimet në vlerë 3,000,000 lekë, vlerë që konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz.

-Kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Fushë Arrëz me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe Sektori Juridik, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifikim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Fushë Arrëz, përlllogaritje e gabuar e tarifave, mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e qirave, etj), veprime dhe moveprime të cilat kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz në vlerën 53,839 mijë lekë.

-Raportimit të transaksioneve dhe ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2021, ka rezultuar kontabilizimi jo i saktë dhe i drejtë për:

Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm” është pasqyruar më pak për vlerën 14,083,752 lekë;

Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është pasqyruar më shumë për vlerën 6,016,237 lekë;

Llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, është pasqyruar më pak për vlerën 122,100,000 lekë.

Llogaria nr.231 “Investime në proçes”, është pasqyruar më shumë për vlerën 197,608,607 lekë;

Llogaria nr.202 “Studime dhe kërkime” është pasqyruar më shumë për vlerën 3,594,080 lekë;

Llogaria nr.210 “Toka, Troje, Terrene” është pasqyruar më pak për vlerën 741,960 lekë.

## **I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon.**

<b>Gjetja</b>	<b>Përmbledhje e Gjetjes</b>	<b>Faqe nr.</b>	<b>Rëndësia</b>	<b>Rekomandimi</b>
1	Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2021 për punë publike mallra dhe shërbime, u konstatua se në 16 raste, në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e kriterëve për kualifikim (si kërkesa për certifikatat e standardizimit, numrin e punonjësve, të makinerive, kategorive të licencave të zbatimit të punimeve etj), si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjestim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.	65-122	E Lartë	Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e përcaktimit të kriterëve të kualifikimit në kundërshtim me kuadrin rregullator, si dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës. Njësia e Prokurimit Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet. -Njësia e Prokurimit në Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa që në vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në procedurat e prokurimit për blerjen e mallrave me natyrë lëndë djegëse për

<sup>1</sup> Pasqyruar në Kapitullin “Aneksë” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
				ngrohje dhe transport, të përcaktohet distanca e favorshme e magazinimit të lëndës djegëse, si dhe e stacionit të shitjes së karburantit, me qëllim plotësimin e nevojave të institucionit në kohë dhe me cilësi.
2	Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2021, u konstatua se në 16 raste OE janë shpallur fitues në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, si dhe nga KVO nuk është bërë anulimi i procedurës së prokurimit.	65-122	E Lartë	Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.
3	Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2021, u konstatua se Bashkia Fushë Arrëz ka prokuruar blerjen e mallit “lëndë djegëse dru zjarri” për ngrohje në institucionet publike. Grupi i auditimit gjatë auditimit të procedurës së mësipërme, duke pasur në konsideratë burimet natyrore (florën) të disponueshme në territorin administrativ të Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe sipërfaqet pyjore dhe kullimore, vlerësoi se Bashkia Fushë Arrëz ka mundësinë, që lëndën djegëse dru zjarri ta siguroj nëpërmjet prerjeve në fondin e saj pyjor dhe jo ta blejë, duke siguruar në këtë mënyrë kursimin e fondeve publike, në vlerën 3,139,712 lekë. -Veç sa më sipër, u konstatua se kërkesat për karburant nga sektorë të ndryshëm në Bashkinë Fushë Arrëz, nuk argumentohen në mënyrë të plotë dhe të saktë. Gjithashtu për mjete të ndryshme nuk është përcaktuar norma e konsumit të karburantit, si p.sh., mjetet e sektorit të zjarrëfikses.	65-122	E Lartë	Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të marrë masat e nevojshme, që të prokurojë shërbimin e prerjes së lëndës djegëse lloji “Dru zjarri” për ngrohje, dhe jo blerjen e tij, me qëllim eliminimin e përdorimit të fondeve publike pa eficiencë dhe ekonomicitet. -Gjithashtu në bashkëpunim me sektorin e financës, të marrë masa për ngritjen e komisionit, me qëllim përcaktimin e normës së konsumit të karburantit për mjetet e sektorit të zjarrëfikses, si dhe argumentimin e plotë dhe të saktë të sasisë për karburant nga sektorët përkatës.
4	Nga auditimi për veprimtarinë e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtime të paligjshme, rezultoi se në Bashkinë Fushë Arrëz nuk është krijuar Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit. Për periudhën objekt auditimi, nuk ka asnjë evidencë nga punonjës të bashkisë për veprimtari që mbulojnë fushën e inspektimit dhe kontrollit të territorit.	122-123	E Lartë	Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtime pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.
5	Nga të dhënat e siguruar nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me leje minerare sipas regjistrit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezultoi se përgjatë periudhës 2020-2021, në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz, kanë ushtruar aktivitet në sektorin e kërkimit, zbulimit, prodhimit të minerareve 10 subjekte me sipërfaqe 11.475 km <sup>2</sup> , për të cilat NSHP Bashkia Fushë Arrëz nuk	23-52	E Lartë	Drejtoria e shërbimit Pyjor t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore të mbetura. -Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohej Agjencisë

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	administron dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj) <sup>2</sup> .			Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.
6	Nga auditimi i debitorëve të Bashkisë Fushë Arrëz, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh në vlerën 18,441,055 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz dhe vlera 1,059,385 lekë është krijuar brenda vitit 2021. Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Fushë Arrëz, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, është mjaftuar vetëm me njoftimin e subjekteve debitorë dhe nuk ka kryer asnjë procedurë tjetër, për të vërtetuar nëse këto subjekte operojnë ose jo.	23-52	E Lartë	Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Fushë Arrëz, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën 18,441,055 lekë, si më poshtë vijon: a- T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare. b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme). c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhrer bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, si dhe të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilat nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.
7	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se në Bashkinë Fushë Arrëz në fund të vitit ushtrimor 2021, ushtrojnë aktivitetin 4 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 3 subjekte nuk janë pajisur me autorizim 5 vjeçar, të cilët nuk kanë paguar detyrimet në vlerë 3,000,000 lekë, vlerë që konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz.	23-52	E Lartë	Drejtoria e Shërbimeve në bashkëpunim me Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative në të gjitha shkallët e gjyqimit, për arkëtimin e tarifës së pataksuar prej 3,000,000 lekë ndaj 3 subjekteve, sipas listës së subjekteve në Kapitullin “Anekse-Aneksi nr.2” të raportit përfundimtar të auditimit.
8	Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Fushë Arrëz me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe Sektori Juridik, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifikim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Fushë Arrëz, përllogaritje e gabuar e tarifave, mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e qirave, etj), veprime dhe moveprime të cilat kanë	23-52	E Lartë	Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të analizojë sitatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 53,839 mijë lekë, ndaj subjekteve si më poshtë vijon: V.A – 300,000 lekë; E & P – 1,228,716 lekë; A 2014 – 15,479,198 lekë; NSE – 24,401,188 lekë; A – 4,017,138 lekë; Q 1 – 2,361,810 lekë;

<sup>2</sup> Pasqyruar në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.3” të projekt raportit të auditimit.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz në vlerën 53,839 mijë lekë. Gjithashtu është konstatuar se në 1 rast është lidhur kontratë qiraje në tejkalim të kompetencës ligjore që përcakton kuadri rregullator i fushës, respektivisht "Amendimi i kontratë së qirasë nr.2718 prot, datë 07.11.2017 me qiramarrësin shoqëria "A 2014" Sh.P.K përfaqësuar nga administratori z.A.Gj, duke rritur sipërfaqen sipas nenit 4 të kontratës, në kundërshtim me procedurat ligjore.			O – 6,051,394 lekë. Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Sektori Juridik, në kushtet e konstatimit të mungesës së kompetencës lëndore për procesin e zhvillimit të procedurës dhe lidhjes së kontratës, të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për shpalljen absolutisht të pavlefshme të Amendimit të kontratës së qirasë nr.2718 prot, datë 07.11.2017 me qiramarrësin shoqëria "A 2014" Sh.P.K.
9	Nga auditimi i llogarisë nr.468 "Debitorë të ndryshëm", u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Fushë Arrëz për arkëtim ndaj të tretëve, është pasqyruar më pak për vlerën 14,083,752 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, për vlerën prej: -13,686,443 lekë detyrimi i subjektit NSE, për kontratën e qirasë. -397,309 lekë kamatë-vonesa për kategorinë biznes.	52-56	E Lartë	Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 "Debitorë të ndryshëm" me kundërparti llogarinë nr. 470 "Të ardhura për t'u marrë".

### I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit.

#### Opinionin mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Fushë Arrëz për vitin ushtrimor 2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705, dhe ISSAI 1200<sup>3</sup>, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, **shprehim një opinion të modifikuar**<sup>4</sup> për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Fushë Arrëz, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, të cilat janë të shprehura në bazën për opinionin e modifikuar.

#### Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Fushë Arrëz, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISSAI 1700.7).

<sup>3</sup> Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit. Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

<sup>4</sup> Audituesi duhet të modifikojë opinionin në rastet kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.



Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 4,336 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve, si dhe faktin se disa llogari në pasqyrat financiare nuk paraqesin vlerën e tyre reale, si vijon:

-Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm” është pasqyruar më pak për vlerën 14,083,752 lekë;  
-Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është pasqyruar më shumë për vlerën 6,016,237 lekë;

-Llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, është pasqyruar më pak për vlerën 122,100,000 lekë.

-Llogaria nr.231 “Investime në proçes”, është pasqyruar më shumë për vlerën 197,608,607 lekë;

-Llogaria nr.202 “Studime dhe kërkime” është pasqyruar më shumë për vlerën 3,594,080 lekë;

-Llogaria nr.210 “Toka, Troje, Terrene” është pasqyruar më pak për vlerën 741,960 lekë.

### **Opinion i auditimit mbi përputhshmërinë për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2021**

Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2021, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkinë Fushë Arrëz, bazuar në analizën e riskut, janë konstatuar disa anomali në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me kriterë të plotësuar, që janë baza për dhënien e një opinionit të kualifikuar .

### **Për drejtimin e Bashkisë Fushë Arrëz**

Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nën ligjore (kriteret e vlerësimit), për procedurat e prokurimit publik të zhvilluara gjatë periudhës nga data 01.01.2019 - 30.12.2021, në Bashkinë Fushë Arrëz.

Auditimi, ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin kryerjen e procedurave të prokurimit, si dhe çdo dokument të ndodhur në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE). Në auditimin e prokurimeve me fonde publike, ne u mbështetëm në analizë risku, duke vlerësuar paraprakisht funksionimin e menaxhimit financiar dhe sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi, etj.

### **Opinion i kualifikuar:**

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Fushë Arrëz, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë.

### **Baza për opinionin e kualifikuar:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e Raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Fushë Arrëz, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e përputhshmërisë, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 400 & ISSAI 4000).

Përshkrimi i çështjeve:

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se është konstatuar përdorim i fondeve publike jo në përputhje me parimet e efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomicitetit, për:

-5 raste në procedurat e prokurimit publik në vlerën 3,139 mijë lekë;

-53,839 mijë lekë të ardhura të munguara nga marrëdhëniet kontraktore me subjektet që kanë shfrytëzuar fondin pyjor/kullësor.

-18,441 mijë lekë për 129 subjekte, të cilët nuk kanë likuaduar detyrimet për taksat dhe tarifata vendore;

-3,000 mijë lekë për 4 subjekte, të cilët nuk kanë paguar detyrimin për licencimin e ushtrimit të aktivitetit në tregtimin e karburantit;

Sa më sipër, shkeljet dhe mangësitë e evidentuara përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura (ISSAI 400 & ISSAI 4000). Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar.

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Fushë Arrëz.**

Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Fushë Arrëz, Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator të fushës.

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifata vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbytur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 885/1 datë 03.10.2022 prot., i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Fushë Arrëz nga data 05.10.2022 deri në datën 25.11.2022, u krye “*Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë*”, i cili mbuloi periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021, si dhe auditim përputhshmërie për periudhën 01.01.2019-31.12.2020 (auditimi i procedurave të prokurimit publik), nga grupi i auditimit me përbërje:

- 1.K.K., Auditues, Përgjegjës Grupi.
- 2.H.I., Auditues, Anëtar.
- 3.Sh.H., Auditues, Anëtar.
- 4.A.D., Auditues, Anëtar.
- 5.E.Rr., Auditues, Anëtar.

### **II.1. Objektivi i auditimit**

-Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin

2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

-Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbime e investimeve, planifikimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit.

## **II.2. Qëllimi i auditimit**

-Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

-Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara, miratimin e lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit, si dhe kontrollin e territorit për ndërtimin e objekteve pajisur me leje zhvillimi dhe ndërtimi, ose deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, për periudhën objekt auditimi.

-Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

## **II.3. Identifikimi i çështjes**

Projekt Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Fushat të cilat u audituan janë si vijon:

1. Aktiviteti i Njësisë së Auditit të Brendshëm;
2. Implementimi dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
3. Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit;
4. Raportimi financiar;
5. Planifikimi, realizimi i prokurimeve dhe zbatimi i kontratave të lidhura për punë publike për periudhën 01.01.2019-31.12.2021;
6. Aktiviteti i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit;
7. Ankesat e subjekteve “K.LL” dhe “O” Sh.P.K.

## **II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Niveli drejtues i Bashkisë Fushë Arrëz (Kryetari i bashkisë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Përgjegjësi i Sektorit të Financës, në rolin e Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontrolleve të brendshme të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keq-raportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

Gjithashtu Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, Drejtorët e drejtorive dhe Përgjegjësit e sektorëve pranë Bashkisë Fushë Arrëz kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

## **II.5.Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim, pra nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe rezultatet financiare të njësisë ekonomike janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi (ISSAI 1200.3). Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së arsyeshme. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozonë që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë. Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keqraportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. (ISSAI 1200.7) Raporton rastet e mospërputhshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë, dhe/ose Raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

## **II.6.Kriteret e vlerësimit**

Standardet dhe kuadri ligjor që shërbeu si kriter për vlerësimin e aktivitetit të subjektit të audituar, është si më poshtë vijon:

Standardet dhe kuadri ligjor që shërbeu si kriter për vlerësimin e aktivitetit të subjektit të audituar, është si më poshtë vijon:

### **Lloji i dokumentit:**

### **Detajet e bazës ligjore dhe rregullatore.**

### **Standardet e auditimit:**

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;  
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);  
Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;

### **Ligje:**

Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;  
Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;  
Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”;

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”

Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

Ligji nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;

**VKM:**

Ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;  
Ligji nr.9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;  
Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;  
Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;  
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar;  
VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;  
VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar;  
VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar;  
VKM nr.736, datë 1.7.2009 për disa ndryshime në VKM nr.808, datë 4.12.2003 të këshillit të ministrave “Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”;  
VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, të ndryshuar;  
VKM nr.438, datë 8.6.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”, i ndryshuar;  
VKM nr. 165, datë 2.3.2016 “Për grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;

**Udhëzime:**

Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, i ndryshuar;  
Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;  
Udhëzimi i MFE nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;  
Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;  
Udhëzimi i MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJVQ-ve”;  
Udhëzimi i MFE nr.10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, etj;  
Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”;  
Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;  
Rregullore mbi organizimin e funksionimit të Bashkisë, etj.

**Rregullore:**

## **II.7.Standardet e auditimit**

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 100, 200, 400, Manualit të Auditimit të Financiar dhe të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar.

## **II.8.Metodat e auditimit**

1. Kontrolli aritmetik.
2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.
3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.
4. Kontrolli i vlerësimeve.
5. Konfirmimi nga të tretët.
6. Kontrolli sipas një treguesi.
7. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe MFK.

## **II.9.Dokumentimi i auditimit**

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve 13 gjithësej dhe akt-verifikimeve 1 gjithësej, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili do të jetë edhe materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

### **▪ Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

### **▪ Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

### **▪ Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

### **III.PËSHKRIMI AUDITIMIT**

#### **III.1.Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.**

Bashkia është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

Auditimi në subjektin “Bashkia Fushë Arrëz”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës (*materiale por jo të përhapura*), si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi, në fushën e prokurimeve, lejeve të ndërtimit etj.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

#### **Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik.**

Zona Gjeografike: Bashkia Fushë Arrëz i përket Qarkut Shkodër, kufizohet në veri me Bashkinë Tropojë, në perëndim me Bashkinë Vau i Dejës dhe jug-perëndim me Bashkitë Pukë dhe Mirditë. Në lindje kufizohet me Bashkinë Kukës. Qendra e kësaj bashkie është qyteti Fushë-Arrëz. Përbëhet nga 5 Njësi Administrative si vijon: NJA Fushë Arrës; NJA Fierzë; NJA Blerim; NJA Qafë Mali dhe NJA Iballë.

#### **Administrata e Bashkisë Fushë Arrëz dhe strukturat në varësi të saj, përbëhen nga:**

-Këshilli Bashkiak (1 punonjës), Sekretari i Këshillit (1);  
-Kryetari 1, Zv.Kryetari 2, Drejtori 2 (Drejtoria e Shërbimeve Publike (26), Drejtoria e Shërbimit pyjor (20), Sektorë 11 (Auditimi i Brendshëm (3), Njësia për koordinimin e integritimit Evropian (1), Zyra One Stop Shop (1), Policia Bashkiake (3), Burimet Njerezore (2), Sektori Juridik (2), Financa (4), Çështjet Sociale (3), Planifikim Territori (3), Menaxhimi i mbetjeve (11), Shërbimet Publike (15), Taksat dhe Tarifat (2), Njësitë Administrative 4 (Njësia Administrative Qafë-Mali (7), Njësia Administrative Blerim (7), Njësia Administrative Fierze (9) Njësia Administrative Iballë (10), Zyra e Gjendjes Civile (3).

#### **Funksionet kryesore të Bashkisë Fushë Arrëz kryhen në fushën e:**

Infrastrukturës dhe shërbimeve publike.

Shërbimeve sociale.

Kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese.

Mbrojtjes së mjedisit.

Bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike.

Zhvillimit ekonomik vendor.

Sigurisë publike.

## **Financat**

Bashkia Fushë Arrëz ka të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

- a) krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
- b) vendos taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) harton, miraton dhe zbaton buxhetin e tyre;
- ç) mban llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofron informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

-Për vitin 2021 nga Bashkia Fushë Arrëz janë shpenzuar gjithësej 270,352 mijë lekë, nga të cilat:

- 14,558 mijë lekë për investime;
- 129,470 mijë lekë për paga;
- 46,082 mijë lekë për mallra të ndryshëm;
- 101,679 mijë lekë për transfera në ndihmë ekonomike për familje në nevoj, invalidë etj.

-Për vitin 2021 Bashkia Fushë Arrëz nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ka arkëtuar gjithësej 15,035 mijë lekë.

## **III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.**

### **III.2.1. Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditin i Brendshëm.**

Në zbatim të nënplikës 1.1 të programit të auditimit: “Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetësori i Vetëvlerësimit dhe a është dërguar në Ministrinë e Financave.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Fushë Arrëz, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i Kontrollit”, “Menaxhimi i Riskut”, “Aktivitetet e Kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për



*Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

**Titulli i gjetjes:** Funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit<sup>5</sup>.

**Situata:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, është pjesërisht efektiv, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

**“Mjedisi i kontrollit”**

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.
- Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të kontrollit të brendshëm.
- Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.
- Në rregulloren e brendshme, por edhe me urdhër të titullarit, nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të bashkisë.
- Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.
- Nuk është miratuar Kodi i Etikës, por rregullat mbi etikën përshkruhen në rregulloren e brendshme, neni 13, Kreu III.
- Nuk dokumentohet procedura e ndjekur për komunikimin dhe njohjen e stafit të Bashkisë Fushë Arrëz për ndryshimet ligjore të ndodhura në fusha të ndryshme.
- Për vitin 2021 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit.
- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.
- Në Bashkinë Fushë Arrëz nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.
- Për vitin 2021 nuk dokumentohet ngritja dhe funksionimi i GMS.

**“Menaxhimi i Riskut”**

- Nuk janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut.
- Nuk është krijuar regjistri i riskut dhe nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut.
- Nuk ka raportim të riskut operacional, për shkak të strukturave të pa plotësuara.
- Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues pranë Bashkisë Fushë Arrëz.

**“Aktivitetet e Kontrollit”**

- Bashkia Fushë Arrëz nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm.
- Në Bashkinë Fushë Arrëz, mbajtja e kontabilitetit bëhet me programin EXCEL dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.
- Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.
- Në Bashkinë Fushë Arrëz nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

**“Informimi dhe komunikimi”**

<sup>5</sup> Trajtuar më hollësisht në Kapitullin “Aneksë” – “Aneksi nr.1” të raportit përfundimtar të auditimit.

-Sipas komunikimit me personat përkatës në Bashkinë Fushë Arrëz dhe verifikimit të grupit të auditimit, faqja e bashkisë është jashtë funksionit, pra nuk sigurohet transparenca e institucionit dhe e drejta për informim.

-Për vitin 2021 nga Bashkia Fushë Arrëz (për vendimmarrje për dhënien e pasurive të paluajtshme me qira, buxhetin) nuk janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit.

#### **“Monitorimi”**

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore nuk lidhet me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

*Sa më sipër mbajnë përgjegjësi F.T, Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, D.L, përgjegjësi i sektorit të financës, E.E, Inspektore e zyrës së financës, në rolin e koordinatorit të riskut, S.Gj, përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe L.N, përgjegjëse e sektorit juridik.*

**Kriteri:** Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;

Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Risk i shtuar për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

**Rëndësia:** E Mesme.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit të risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

**Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit Juridik në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit të Burimeve Njerëzore të kryejë ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.

**Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre, si dhe hartimin e hartës së proceseve të punës në Bashkinë Fushë Arrëz.

### **III.2.1.1. Mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.**

Në zbatim të pikave 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njesisë AB të Bashkisë Fushë Arrëz;
2. Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2021;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmoizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përshërshme të subjekteve të audituara;
6. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

### **Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.**

Në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, është krijuar njësi e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm. Ky sektor përgjatë vitit 2021,

është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të VKB nr.48, datë 23.12.2020 dhe Urdhrit nr.371, datë 17.12.2020, dhe ka pasur 3 punonjës përkatësisht, përgjegjësi dhe 2 specialist. Përgjatë vitit 2021, drejtuesi i Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Fushë Arrëz, është zj.P.P.

#### Struktura e njesisë AB për vitin 2021

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në pune	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme
<b>Për vitin 2021</b>								
1	P.P	Përgjegjëse	2021 – larguar 2022	I larte	18 vite	7 muaj	Jo	3 ditë
2	L.Ç	Specialiste	Maj 2019	I larte	3 vite	6 muaj	Jo	3 ditë
3	E.P	Specialiste	Shkurt 2021	I larte	10 vite	3 muaj	Jo	3 ditë

Burimi: NJAB Fushë Arrëz, raportimi në MFE, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

#### **Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2021.**

Përgjatë vitit 2021, nga sektori i auditit të brendshëm, janë kryer gjithësej 3 auditime, ndarë si më poshtë vijon:

**Viti 2021**, plani vjetor i auditimeve i miratuar është përcjellë në MFE me shkresën nr.911 prot., datë 19.04.2021, sipas të cilit janë planifikuar për t'u kryer 4 auditime dhe janë realizuar 3, pasqyruar si më poshtë:

Nr	Planifikuar	Nr	Subjekte të audituara nga NJAB	Nr	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Të përfunduar	Në proces
					Përputhsh	Perform	Financ	IT	Kombin		
1	Spektori i Arshivës-Protokollit	1	Spektori i Arshivës-Protokollit	1	1						
2	Spektori i Bordit të Ujitjes-Kullimit	1	Spektori i Bordit të Ujitjes-Kullimit	1	1						
3	Spektori i Shërbimeve Publike	1	Spektori i Shërbimeve Publike	1	1						
4	Spektori i Rrugëve rurale	1									
		<b>4</b>	<b>Totali</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	

Burimi: NJAB Fushë Arrëz, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për aktivitetin e vitit 2021 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm me shkresën nr.504 prot., datë 15.02.2022.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2021, rezulton se janë dhënë 48 rekomandime gjithësej, nga të cilat janë pranuar 48 prej tyre. Nga rekomandimet e pranuar janë në proces zbatimi 48 prej tyre. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithësej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithësej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	Viti 2021	10	2	0	8	0	0	0	0
	<b>TOTALI</b>	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>8</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Burimi: NJAB Fushë Arrëz, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Karta e auditimit të brendshëm është miratuar me urdhrin nr.67, datë 16.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz.

**Titulli i Gjetjes:** Mbi krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik në Bashkinë Fushë Arrëz, përgjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2021.

**Situata:** Nuk është hartuar plani strategjik i auditimit të brendshëm për periudhën 2021-2023.

-Plani vjetor i auditimeve për vitin 2021 nuk është hartuar nga drejtuesi i sektorit të auditimit të brendshëm, por nga specialistët e sektorit.

-Audituesit pranë këtij sektori nuk janë të pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm.

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njesisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Nuk administrohet shkresa e ndryshimit të planit vjetor të auditimeve e miratuar nga titullari i institucionit dhe përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

-Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2021 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së përcaktuar në shkronjën “ç” të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, “Për Auditin e Brendshëm Publik”, pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve. Gjithashtu raporti vjetor i aktivitetit, kreu IV.3 “Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre” nuk përmban plotësisht informacion sipas përcaktimit të bërë në formatin standard nr.5 “Struktura e raportit vjetor të njësive të auditimit të brendshëm” në manualin e auditimit të brendshëm.

-Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësive vendore në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

-Në auditimet e kryera për vitin 2021, konstatohet se Sektori Auditit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

-Nuk janë kryer auditime të teknologjisë së informacionit.

-Nuk ka gjetur zbatim Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”, lidhur me strukturën e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimeve të kryera në vitin 2021, si dhe dhënien e opinionit në përfundim të auditimit.

-Për vitin 2021, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete me risk të lartë që kryen Bashkia Fushë Arrëz, si Sektori i Financës, Sektori Juridik, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, prokurimet e realizuara nga Bashkia Fushë Arrëz, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm “Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit”.

-Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të identifikuar, mbajnë përgjegjësi: Z. F.T, Kryetar i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Zj. P.P, Përgjegjës i Sektorit të NJAB.

**Kriteri:** Shkronja “ç” në nenin 6, shkronja “ç” pika 2 në nenin 11, nenin 12, nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”; Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar;

-Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”;

-Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

**Ndikimi/Efekti:** Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni. Nuk pasqyron aktivitetin e drejtorive me risk të lartë si Financa, Taksat apo Prokurimet.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator të fushës.

**Rëndësia:** E Mesme.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, Përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe përgjegjësi i sektorit të auditit të brendshëm, të marrë masa për:

-Certifikimin e audituesve të brendshëm të punësuar pranë NJAB Fushë Arrëz;

-Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

**Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësive vendore në arritjen e objektivave.

### **III.2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të vitit 2021.**

**2.1.** Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2021;

**2.2.** Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

**2.3.** Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

**2.4.** Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MFE, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

**2.5.** Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

#### **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet:**

**2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2021;**

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2021-2023, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallë e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavaneve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Me Urdhrin nr.69, datë 17.02.2021, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024.

Planifikimi i programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me nr. 32 , datë 27.08.2020.

Miratimi i tavaneve të buxhetit afatmesëm 2021-2023 Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 50, datë 23.12.2020 konfirmuar me shkresën nr. 51/1 datë 21.01.2021, jashtë afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 50, datë 23.12.2020, “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Fushë Arrëz për vitet 2021-2023”, jo më vonë se 31 Janar, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2021 kanë vlerën 29,427,000 lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 79,240,000 lekë, transfertat specifike ka vlerën 79,171,000 lekë. Në total të ardhurat kanë vlerën 187,838,000 lekë.

Gjatë vitit 2021, janë bërë ndryshime vendime të këshillit bashkiak që kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2020). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB nr. 22, datë 21.05.2021 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Fushë Arrëz për miratimin e buxhetit për fondeve të trashëguara nga viti 2020, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 58,771,000 lekë.

*Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2021 sipas tabelave në vijim:*

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2020	Faza e I PBA 2021	Faza e II PBA 2021	Projekt Buxhet 2021
600	Paga	109,331	121,316	121,316	121,161
601	Sigurime Shoqërore	18,241	20,289	20,289	20,014
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	27,473	33,219	33,219	37,049
603	Subvencione		150	150	
604	Transferta	1,447	373	373	100
605	Transferta Korente të Huaja				
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	100,547	95,648	95,648	
609	Kontigjence rezerve		3,031	3,031	7,514

<b>I</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>257,039</b>	<b>274,026</b>	<b>274,026</b>	<b>187,838</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	7,757			
231	Kapitale të Trupëzuara	68,082			
	<b>Shp. Kapitale me financim te brendshem</b>				
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>				
<b>II</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>75,839</b>			
<b>III</b>	<b>Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti</b>				
	<b>I+II +III Totali I Shpenzimeve</b>	<b>332,878</b>	<b>274,026</b>	<b>274,026</b>	<b>187,838</b>

Burimi: Drejtoria e financës

Në formë table paraqitet planifikimi bazë i buxhetit për vitin 2021 dhe ndryshimet në tabelën vijuese:

Njesia		Bashkia Fushë Arrëz viti 2021						
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)	% e realizimit
		Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	PBA Plan Viti 2021	Buxheti Vjeter Plan Fillestar Viti 2021	Buxheti Vjeter Plan i Rishikuar Viti 2021	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	
600	Paga	109,331	121,316	121,161	134,860	111,265	23,595	83%
601	Sigurime Shoqërore	18,241	20,289	20,014	22,602	18,278	4,324	81%
600+601	Paga +Sigurime	127,572	141,605	141,175	157,462	129,543	27,919	82%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	27,473	33,219	37,049	38,278	29,365	8,913	77%
603	Subvencione		150				0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	1,447	373	100	100	100	0	100%
605	Transferta Korente të Huaja						0	0
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	100,547	95,648		94,053	92,554	1,499	98%
609	Transferta		3,031	9,514	9,514	4,231	5,283	44%
602-609	Shpenzime operative	129,467	132,421	46,663	141,945	126,250	15,695	89%
	Shpenzime Korrente	257,039	257,039	274,026	187,838	299,407	255,793	71,533
230	Kapitale të Patrupëzuara				200	192	8	96%
231	Kapitale të Trupëzuara				26,267	14,367	11,900	55%
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>26,467</b>	<b>14,559</b>	<b>11,908</b>	<b>55%</b>
<b>Totali</b>	<b>(korrente + kapitale)</b>	<b>257,039</b>	<b>257,039</b>	<b>274,026</b>	<b>187,838</b>	<b>325,874</b>	<b>270,352</b>	<b>83%</b>

Burimi: Drejtoria e financës

Në mënyrë të detajuar lista e investimeve të reja parashikuar në buxhetin vjetor të vitit 2021 nga të ardhurat e veta dhe granti paraqitet më hollësisht në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.2” të projekt raportit të auditimit.

**2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.**

-Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2021-2023 me planin buxhetor 2021, paraqitet në tabelën e më poshtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emertimi	Plan përfundimtar 2021	Sipas PBA 2021-2023	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakkush e spec)	155,332	139,475	15,857
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	46,297	36,773	9,524
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant I pakushtez)	26,467		
4	Investime nga FZSH			
	<b>Total I planit fillestar</b>	<b>228,096</b>	<b>176,248</b>	<b>25,381</b>
	<b>Shtesat nga Pushteti Qendror</b>			
5	Investime grant i kushtëzuar			0
6	Shpenzime për pagat (600+601)	2,130	2,130	0
7	Shpenzime (602.604.609)	95,648	95,648	0
	<i>Grant i kushtëzuar (230-231)</i>			0
	<b>Gjithsej</b>	<b>325,874</b>	<b>274,026</b>	<b>25,381</b>

Burimi: Nga përpunimi i të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti

**Nga auditimi konstatohet se ndryshimet midis planit buxhetor vjetor 2021 dhe planit vjetor 2021 në PBA vijnë si rezultat i shtesës së rritjes së pagës së edukatoreve me VKM nr. 1149, datë 24.12.2020 “Për ndryshime të vendimit nr. 175, datë. 08.03.2017 dhe pagës minimale në shkalle vendi, me VKM nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkalle vendi”.**  
-Transferta e pakushtezuar dhe ajo sektoriale nuk ka qenë e planifikuar në nivel të barabarte në

PBA me ate që është transferuar në plan buxhet të vitit 2021. Investimet dhe shpenzimet operative nga projektet nuk rregjistrohen nga dega e Thesarit. Plani i investimeve për vitin buxhetor rregjistrohet në thesar me kod projekti nga ministria e financave në momentin kur janë kryer procedurat e rregjistrimit të kerkese blerjes në Degen e Thesarit Pukë.

Plani përfundimtar i buxhetit ka diferenca prej 51,848 mijë lekë nga plani në PBA për shkak se në planin përfundimtar janë pasqyruar rritja e grantit të pakushtëzuar 25,381 mijë lekë për llogarit e sipërcituar sipas tabelës

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit.

Gjatë viteve janë kryer ndryshime në buxhet (shitesa/ paksime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018”Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” pika 100 germa “b” dhe “c” ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shitesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

Tabela e ndryshimeve në buxhet paraqitet në vijim:

Në 000 lekë

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr/ datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull			
					SHTESA art.	shuma	PAKSIME art.	shuma
Viti 2021	Nr.20 dt.23/12/2020	187,838	Nr.22, 21.05.2021	16,411	600+601,Paga dhe sigurime.			157,462
				15,893	602- 609 ShP. te tjera			62,680
				26,467	230+231 (Investime)			26,467

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

Shënim: Ndryshimet e tjera buxhetesh për Bashkinë Fushë Arrëz për vitin 2021 vetëm brenda grupit të shpenzimeve (brenda Programit 1110 dhe nuk ka qene nevoja për vendim këshilli)

Bashkiak kjo në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018”Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” pika 100 germa “b” dhe “c” ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, Pra është bërë vetëm me Shtesë nga ana Kryetarit për Degën e Thesarit Fushë Arrëz.

### 2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2021, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Fushë Arrëz, për vitin 2021. Në lekë										
Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Burimi i financimit të shpenzimit						
				Nga të ardhurat e veta	% e realizimit nga të	Nga Granti Qeveritar				
						Nga transferata e pakushtëzuar	Nga transferata e kushtëzuar specifike	Nga transferata e kushtëzuar për	Nga transferata e kushtëzuar për investimet	
Paga 600	129,470,072	110,971,902	85.71	720,620	1	49,462,345	58,236,917	2,552,020	129,470,072	
Sigurime shoqërore 601	22,075,894	18,278,465	82.80	1,785,732	10	6,254,047	9,985,983	252,703	22,075,894	
ShP. Operat 602+ F. Rezervë	46,082,091	29,365,446	63.72	8,918,497	30	11,329,065	9,017,884	100,000	46,082,091	
Subvencion Ujësjetllësi, etj. 603										
K. Q Emergj Civile 604	100,000	100,000	100.00	100,000	100				100,000	
Nd/Ekonom invalid 606	101,679,248	97,077,561	95.47			4,230,790	292,548	92,554,223	101,679,248	
Mjete ne ruajtje 466										
Investime 230-231	26,467,000	14,558,840	55.01	10,213,440	70	4,345,400			26,467,000	
<b>Totali</b>	<b>325,874,305</b>	<b>270,352,214</b>	<b>82.96</b>	<b>21,738,289</b>	<b>8</b>	<b>75,621,647</b>	<b>77,533,332</b>	<b>95,458,946</b>	<b>325,874,305</b>	

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

Konstatohet se plani i buxhetit i gjeneruar nga thesari ka vlerën **343,900 mijë lekë** e cila nuk përputhet me vlerën e planit të buxhetit të miratuar nga këshilli bashkiak që ka vlerën **325,874 mijë lekë**, ose **18,026 mijë lekë** më pak se plani buxheti i gjeneruar nga thesari.

Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transferata e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën **325,874 mijë lekë**, ndërsa realizimi **270,352 mijë lekë**, ose në masën 82.96%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën **129,470 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **110,971 mijë lekë**, ose në masën 85.71%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 82.8%.

Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën **46,082 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **29,365 mijë lekë**, ose në masën 63.7%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën **26,467 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **14,558 mijë lekë**, ose në masën 55 %.

**Titulli gjetjes:** Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli.

#### **Situata:**

Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 me të ardhurat e veta (pa transfertën e palushtëzuar) të Bashkisë Fushë Arrëz ka diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën **325,874 mijë lekë**, ndërsa realizimi **270,352 mijë lekë**, ose në masën 83%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën **26,467 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **14,558 mijë lekë**, ose në masën 55 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i



mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Fushë Arrëz në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe ngarkojnë me përgjegjësi kryetarin e Bashkisë Fushë Arrëz z. F.T, si dhe z. D.L, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.

Gjithashtu edhe gjatë vitit 2021 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2021.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

*“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.*

**Kriteri:** Pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”

**Shkaku:** Lidhja e kontratave në fund të vitit, si dhe për vlerën e plotë të projektit dhe jo për nivelin e fondeve të buxhetuara për vitin përkatës.

**Efekti:** Mos realizim i investimeve të planifikuara.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë, Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Buxhetit, si dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korrigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

#### **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë.**

Konstatohet se për vitin 2021 vlerat e llogaritura për këtë qëllim janë Kontigjencë 1,000,000 lekë, Rezerve 1,000,000 lekë dhe Emergjencë 7,514,000 lekë, mënyrën e llogaritjes të kësaj vlere, bazën ligjore për këtë; Fondi i emergjencës është llogaritur në vlerën 4% të buxhetit të vitit 2021 (Në mbështetje të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”) Vlera e përdorur në fakt, për çfarë janë përdorur këto fonde nga Bashkia Fushë Arrëz; Fondit rezerve dhe ai i kontigjencës nuk janë përdorur gjatë vitit 2021, ndërsa fondi i emergjencës është përdorur 5,427,843lekë për raste emergjente nga fatkeqësi natyrore duke ngelur e pa përdorur nga fondi i emergjencës vlera 2,086,157 lekë

#### **2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizimit të të ardhurave<sup>6</sup>.**

#### **Në mënyrë të përmbledhur detyrimet e prapambetura detyrimet e prapambetura për viti 2021 paraqitet si vijon:**

*Në lekë*

Emerimi i detyrimit të prapambetur	Deyrimi i prapambetur progresiv deri në datën e miratimit të buxhetit vjetor 2021	Planifikimi për likuidim në planin e buxhetit 2021 i vlerës së detyrimit të prapambetur	Pagesa në fakt gjatë vitit 2021 e detyrimit të prapambetur të planifikuar në planin e buxhetit	VKB nr.50 datë 23.12.2020

<sup>6</sup> Trajtuar më hollësisht në Kapitullin “Aneksë” – “Aneksi nr.2” të raportit përfundimtar të auditimit.

Detyrime të p. per vend.gjyqesore	8,017,270	8,017,270	2,633,423	8,017,270
D.P.per sherbime				
D.P.per mirembajtje				
D.P.per investime	2,856,626			
D.P.per investime nga Ministrite e Linjes (specifiko FZHR etj...)				
D.P per mallra				
D.P.te tjera				
<b>Totali</b>	<b>10,873,896</b>	<b>8,017,270</b>	<b>2,633,423</b>	<b>8,017,270</b>

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

Vlera e raportuar nga Bashkia Fushë Arrëz në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2021 është **8,778,833 lekë**, konfirmuar me shkresën nr. 354 datë 31.02.2022 drguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore, e cila kuadron me detyrimet e paraqitura në pasqyrat financiare dërguar degës së Thesarit Fushë Arrëz me shkresën 828 datë 24.03.2022 të konfirmuara.

Stoku i detyrimit të mbetur rakordon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
<b>I</b>	<b>Borxhe (a+b)</b>	<b>0</b>		
<b>a</b>	<b>Hua sfatgjatë</b>	<b>0</b>		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
<b>b</b>	<b>Hua afatshkurtër</b>	<b>0</b>		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
<b>II</b>	<b>Detyrime (a+b+c)</b>	<b>8,778,833</b>		<b>3.56%</b>
<b>a</b>	<b>Shpenzime korrente</b>	<b>0</b>		
a,1	Mallra dhe shërbime			
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
<b>b</b>	<b>Shenzime kapitale</b>	<b>0</b>		
b,1	Insitucione buxhetore			
b,2	Subjekte private			
<b>c</b>	<b>Vendime gjyqësore</b>	<b>8,778,833</b>		
c,1	Marrëdhënie pune	3,813,562		
c,2	Mallra dhe shërbime	2,108,645		
c,3	Investime	2,856,626		
c,4	Të tjera			
			<b>246,609,000</b>	
<b>III</b>	<b>Totali (I+II)</b>	<b>8,778,833</b>	<b>246,609,000</b>	<b>3.56%</b>

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

### Vështirësia Financiare

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e konstatuara në fund të vitit 2021 paraqitën në vlerën **8,778** mijë lekë (të akumuluar) dhe fondet e miratuara për shpenzime të këtij viti janë në vlerën **246,609** mijë lekë. Kjo situatë tregon se Bashkia Fushë Arrëz nuk mund të konsiderohet në vështirësi financiare në fund të vitit ushtrimor 2021, pasi vlera e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta është **3.56 %**, pra nën nivelin prej 25 % të

shpenzimeve vjetore të miratuara, sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

**Titulli i gjetjes:** Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura dhe raportimi i tij në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë si dhe marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur faonde në dispozicion.

**Situata:** Bashkia Fushë Arrëz në datën 01.01.2021 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 10,873 mijë lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2021 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti vlera 8,017 mijë lekë, nga e cila është likuiduar vlera 2,633 mijë lekë, ose 32.8% e vlerës së planifikuar. Pra, në datën 31.12.2021 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2021), është ulur me 2,095 mijë lekë, ose në masën prej 19.2%. Rezulton se gjatë vitit 2021 Bashkia Fushë Arrëz ka parashikuar investime të reja nga të ardhurat e veta në vlerën 12,781,000 lekë dhe ka realizuar 10,239,840 lekë dhe nga transfertat e pakushtëzuar 13,686,000 lekë dhe ka realizuar 4,319,000 lekë. Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91<sup>7</sup>.

Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2021, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z. F.T, si dhe z. D.L, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.

**Kriteri:** Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

**Efekti:** Mospasqyrimi real i stokut të detyrimeve të prapambetura.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkaku të krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

*Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore “Mbi pagesat e vendimet gjyqësore për dëmshpërblim page punonjësit e larguar nga puna”.*

*Në lekë*

<i>Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2021</i>	<i>Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2021</i>	<i>Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2021</i>	<i>Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2021</i>	<i>Pagesa në lekë të kryera gjatë vitit 2021</i>	<i>Detyrimi në lekë më 31.12.2021</i>
4	3,475,202	2	538,360	200,000	3,813,562

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

**Titulli i gjetjes:** Efektet negative në buxhet si rezultat i likuidimit të vendimeve gjyqësore.

<sup>7</sup> Trajtuar më hollësisht në Kapitullin “Aneks” – “Aneksi nr.2” të raportit përfundimtar të auditimit.

**Situata:** Konstatohet se nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Fushë Arrëz për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën **200,000 lekë**, për 3 raste, *të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona*. Nga praktikat e mësipërme të likuidimit u përzgjedhën për auditim mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit financiar dhe ligjor, 6 prej tyre rezulton se ka mbetur pa u likuiduar vlera **3,813,562 lekë**<sup>8</sup>. Gjithashtu konstatohet se në 3 raste për likuidimit e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullari i institucionit, por nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

**Kriteri:** Nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës.

**Efekti:** Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

## **2.2.6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor<sup>9</sup>.**

### **➤ Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.**

Për vitin 2021 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 48, datë 23.12.2022, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Fushë Arrëz dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2021”, ku përfshihet edhe struktura e taksave dhe tarifave vendore, e cila sipas strukturës është e përbëre nga sektorë dhe në total ka 5 punonjës nga të cilët 3 punonjës sipas njësive administrative dhe 2 punonjës të sektorit të taksave ku 1 përgjegjës Sektori sektori i taksave dhe tarifave vendore, 1 specialist i, 3 specialist taksash në njësit administrative. Në mënyrë të detajuar struktura organizative e sektorit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021 paraqitet si në aneksin nr. 1 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

**Titulli gjetjes:** Mangësitë e konstatuara në plotësimin e strukturës për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

**Situata:** Konstatohet se: Struktura e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Fushë Arrëz ka probleme dhe nuk është në funksion të realizimit të të ardhurave, edhe pse është krijuar Sektori i Masave Shtrenguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Fushë Arrëz, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të paarkëtuara

<sup>8</sup> Trajtuar më hollësisht në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.2” të raportit përfundimtar të auditimit.

<sup>9</sup> Observacionet janë trajtuar në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.

(debitor), në vlerën **18,441 mijë lekë**, kjo nisur nga fakti se kanë natyra të ndryshme pune dhe se arkëtimi i debitorëve është procedurë më vetë dhe afate të përcaktuara si dhe janë evidentuar lëvizje të shpeshta të stafit si dhe mangësi në plotësimin e strukturës organizative me specialit respektivisht; Specialist IT për përdorimin e programit kompjuterik çka sjell mos evidentimin e subjekteve, mos llogaritjen e detyrimit fiskale për këto mos deklarime si dhe mos arkëtimin e të ardhurave. kjo për mungesë stafi, në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me shkresën nr. 737 prot datë 07.02.2018. Veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin Autorizues si dhe Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

-Nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, nuk është bërë miradministrimi i informacionit tatimor, të subjekteve tatimpagues të biznesit të vogël edhe të biznesit të madh, për të gjitha detyrimet tatimore dhe nuk janë vendosur në dosjen e çdo taksa paguesi, nuk është bërë përditësimi i të dhënave dhe nuk është plotësuar dokumentacioni, ku të regjistroheshin të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit. Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Neni 29 Dosja e detyrimeve tatimore, pika 1, citohet : “Administrata tatimore krijon dhe përditëson dosjen e detyrimeve tatimore, ku regjistrohen të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit”.

-Nga Sektori i taksave dhe tarifave vendore, nuk është vepruar për të kryer inventarizimin e dokumentacionit që ndodheshin në dosjet e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore ku nga auditimi u konstatuan me mangësi e konkretisht:

-të gjitha praktikant nuk shoqërohen me fletë inventari për numrin dhe llojin e dokumenteve dhe shkresave që përmban një dosje e subjektit.

-i gjithë dokumentacioni i subjektit mbahet në një dosje qysh nga krijimi i subjektit për disa vite me radhë.

-praktikat e përfunduara të viteve të mëparshëm nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim, me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” neni 24, ku përcaktohet: Arkivat e institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore kanë detyrë: a) të evidencojnë korrespondencën që dërgohet ose merret nga institucioni b) të bëjnë përpunimin arkivor, të ruajnë dhe të shërbejnë dokumentet që administrojnë, c) të dorëzojnë dokumentet në arkivat shtetërore, sipas afateve ligjore përkatësisht sipas përshkrimit në nenin 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" të këtij ligj, dhe me rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave “Për normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” kapitulli II-Rregulla për punën me dokumentet administrative në subjektet shtetërore dhe jo shtetërore, neni 21 dhe neni 27.

**Kriteri:** Në përputhje me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 29 pika 1, 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime.

**Ndikimi/Efekt:** Mungesa e stafit dhe mos përshtatja e strukturës më natyrën e menaxhimit të të ardhurave, çojnë në mos realizim të të ardhurave dhe mungesë të tyre në buxheti e Bashkisë Fushë Arrëz.

**Shkaku:** Mos njohja e kuadrit ligjor për menaxhimin e të ardhurave nga instancat drejtues Bashkia Fushë Arrëz.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore të marrë masa për të krijuar Sektorin e Masave Shtrënguese plotësimin e stafit me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave.

**Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa për përditësimin e të dhënave me dokumentacionin e nevojshëm, ku të regjistroheshin të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit.

➤ **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve.**

**Titulli i gjetjes:** *Performancë e dobët në planifikimin dhe realizimin e disa zërave të të ardhurave për periudhën objekt auditimi.*

**Situata:** Për vitin 2021, Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 47, datë 23.12.2020, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër. Nga të dhënat<sup>10</sup> për vitin 2021 sipas planit janë në vlerën 29,427 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 15,035 mijë lekë ose 51%, mos realizim në vlerën 14,392 mijë lekë, kryesisht në taksat e popullatës, si p.sh. taksa e ndërtesës, tarifa e pastrim-gjelbërimit, tarif për shfrytëzimin e lëndëve druhsoreetj, Konstatohet se:

-Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, nuk është planifikuar nuk ka një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit. Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike pra nuk ka një databazë të saktë për numrin e mjeteve të përdorura që ka Bashkia Fushë Arrëz, Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi nuk është planifikuar si burim i krijimit tatimor. Sektori i taksave dhe tarifave vendore, duke mospatur një bazë të dhënash nuk ka bërë rakordime me Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër (DRTB), Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHKK) dhe Drejtorinë e Shërbimit të Transportit (DSHTRR).

Nga auditimi, u konstatua se në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, Bashkia Fushë Arrëz nuk ka krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të saktë për familjet, ku të përcaktohet numri i familjeve dhe sasia e sipërfaqes së banimit që ka secila familje, kujt viteve i përket banesa, para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, nuk është plotësuar rregullisht njoftimi i detyrimit për çdo familje, si për taksën e ndërtesës edhe për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit.

Për detyrimet e familjarëve, u konstatua se shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Fushë Arrëz Sh.A., nuk është caktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit.

Akt rakordimet me agjentët tatimorë nuk janë mbajtur sipas formatit të përcaktuar me Udhëzim të posaçëm nga Ministria e Financave. Rakordimet janë bërë në formë proces-verbalesh, duke marrë informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve, por nuk mund të konsiderohen rakordime pasi nuk ka asnjë të dhënë statistikore në bazë të së cilës të bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime në pajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 117 “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”, ku përcaktohet se: “Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifën e mbledhura, apo i shmanget mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhura apo të shmangu.”,

Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 4, 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj... ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kreu VIII “Vlerësimi tatimor”, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, etj.

**Kriteri:** Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën

<sup>10</sup> Trajtuar më hollësisht në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.

e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë”; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 42, “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, “Raportimi financiar” nën-pika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekt:** Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave shkakton mangësi dhe probleme në likuidimin e shpenzimeve të kryera nga institucioni, si dhe është shkak kryesor për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

**Shkaku:** Mos njohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e një plani të pa realizueshëm në fakt.

➤ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore:**

**Titulli gjetjes:** Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin mbi aktivitetin e Agjentëve Tatimorë.

**Situata:** Në rregulloren e brendshme të institucionit të miratuar me shkresën nr. 06.12.2019, nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimit nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve agjentët tatimorë si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët:

1. Për Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, mblidhet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Krugor (DSHTRR)”, për llogari të Bashkisë Fushë Arrëz.

Në zbatim të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar dhe në mbështetje të gjurmës “b”, të pikës 2, në nenin 25 “Të ardhurat nga taksat e ndara” të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njësiteve përkatëse i kalojnë 25 për qind e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura. Rakordimet me DRSHTRR-në për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, nuk janë kryer.

2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, mblidhet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT) Shkodër”.

Në zbatim të ligjit nr. 181 datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32 datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël” Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore ku biznesi i tatueshëm është i vendosur, Administrata Tatimore Qëndrore, brenda datës 10 të muajit pasardhës, bën transferimin e të ardhurave nga ky tatim. Rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër për efekt të tatimit mbi fitimin e biznesit të vogël, nuk janë kryer rregullisht çdo muaj

3. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mblidhet nga Agjenti Tatimor “Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP)”.

Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e

taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo me vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria. Rakordimet me ZVRPP Shkodër, për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, nuk janë kryer.

4. Renta Minerare nga Agjentët Tatimorë “Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) dhe Drejtoria Rajonale Doganore (DRD) Shkodër”.

Në zbatim të të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar, Neni 4 “Niveli i Taksave Kombëtare”, pika 4, e cila shprehet: “Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare....5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i kalojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Renta minerare përcaktohet duke shumëzuar vlerën e përgjithshme të shitjes me shumicë të produktit me përqindjen e rentës...” të Udhëzimit nr. 26, datë 04.09.2008, dhe UMF Nr. 12, Dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, “...Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit...”. sipas shtojcën 2 të këtij ligji, niveli i Rentës Minerare varion nga 4 deri në 10%, sipas llojit të mineralit. Rakordimet me Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) dhe Drejtoria Rajonale Doganore (DRD) Shkodër, për Rentën Minerare, nuk janë kryer.

**Kriteri:** Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare”

**Ndikimi/Efekti:** Mos njohja e situatës, çon në mungesë të ardhura për Bashkinë Fushë Arrëz

**Shkaku:** Mungesa e bashkëpunimit dhe mos zbatimit të kuadrit ligjorë.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Fushë Arrëz nga taksat që mbledhen nga këta agjent. Në rast se agjentët tatimor nuk realizojnë sakt mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Fushë Arrëz të fillojë procedurat për penalizimin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

**Titulli gjetjes:** KLSH-ja konstatoj se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Fushë Arrëz, nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara (borxhi), dhe për të gjithë subjektet.

**Situata:** Sipas të dhënave për strukturën organike të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Fushë Arrëz, konstatohet se nuk ka një të ngritur një strukturë përgjegjëse për menaxhimin e borxhit (debitorëve nga taksat/ tarifave vendore).

Referuar të dhënave të paraqitura nga kjo drejtori, detyrimet për taksat e tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjare paraqitet si vijon:

➤ **Taksa e tokës:**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore për vitin 2021, u konstatua se kishte rezerva në planifikim, pasi sipas të dhënave të marra nga sektori i bujqësisë, dhe trajtimit të AMTP, mbi ndarjen e tokës bujqësore për familje dhe boniteti, evidentohet mos planifikim në vlerën **569 mijë lekë**. Në mënyrë të detajuar pritshmëria e taksës së tokës bujqësore për vitin 2021 paraqitet si vijon:

NJA.	Familje me tokë bujqësore	Sip (m <sup>2</sup> )	Kategoria	Cmimi sipas paketës	Planifikimi sipas	Likuidimi	Mosrealizim
NJA Qender	370	150 ha	Kategoria VII	700	105,000	11.500	93,500
NJA Qafe-Mali	1315	455 ha	Kategoria VII	500	230,000	16.200	213,800
NJA Iballe	1309	652ha	Kategoria VII	500	347,000	2.000	345,000
NJA Blerim	889	521 ha	Kategoria VII	500	263,000	8.000	255,000
NJA Fierze	1261	544 ha	Kategoria VII	500	286,000	4.000	282,000



Shuma		2322		1,191,000	41,700	1,107,600
-------	--	------	--	-----------	--------	-----------

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz dhe auditimet e mëparshme të KLSH-së

Sa më sipër konstatohet se referuar të dhënave nga Bashkia Fushë Arrëz nuk disponon të dhëna analitik mbi sipërfaqen e AMTP të ndara sipas ligjit 7501 “Për tokën” çka do të thotë se planifikimi i taksës së tokës nuk është real. Kështu sipas të dhënave të pasqyrës sipërfaqja gjithsej e tokës së **ndarë sipas fshatrave dhe familjeve për njësit administrative në Bashkinë Fushë Arrëz është 2322 ha** e ndarë sipas kategorive. Për këtë sasi toke të ndarë, referuar boniteti të tokës sipas fshatrave dhe çmimit për bonitet të miratuara në paketat fiskale me VKB. Planifikimi i kësaj takse për vit ushtrimor duhet të ishte në vlerën **1,107 mijë lekë** dhe jo në vlerën **569 mijë lekë** sipas aneksit të sipërcituar, në fakt nga sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Fushë Arrëz është realizuar në vlerën **41 mijë lekë**, mosrealizim në vlerën **581 mijë lekë** sipas planifikimit nga vetë bashkia dhe mosrealizim në vlerën **1,189 mijë lekë** sipas llogaritjeve të grupit të auditimit.

➤ **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifave vendore.**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh në vlerën **18,441,055 lekë**, **vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguara për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz dhe vlera 1,059,385 është krijuar brenda vitit 2021**

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet si vijon:

Njësia Administrative	Progresive deri në 31.12.2020		Krijuar brenda vitit 2021		Progresive deri në 31.12.2021	
	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë
Bisnesi i Madh	9	6,725,999	29	306,100	29	7,032,099
Bisnesi i Vogël	63	9,321,521	84	218,635	84	9,540,156
Institucionet	10	1,334,150	16	534,650	16	1,868,800
<b>Shuma</b>	<b>82</b>	<b>17,381,670</b>	<b>129</b>	<b>1,059,385</b>	<b>129</b>	<b>18,441,055</b>

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

Sa më sipër ariet në konkluzionin se nga strukturat tatimore e bashkisë Fushë Arrëz, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, konkretisht:

-Sipas të dhënave, edhe pse vazhdojnë procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 129 subjekte debitorë (fizik/juridik) në vlerën **18,441,055 lekë**, të cilët janë aktiv dhe nuk kanë paguar taksa dhe tarifa.

Sektori i Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Fushë Arrëz, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, nuk ka zhvilluar **asnjë procedurë tjetër**, për të vërtetuar nëse këto subjekte operojnë ose jo nëpërmjet bankës. Nuk është kërkuar **kallëzim penal** bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se:

“Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., ku përcaktohet se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.”

Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

**Kriteri:** Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve<sup>11</sup>.

**Ndikimi/Efekti:** Mos ndjekja e plotë e procedura për arkëtimin e detyrimeve, rrit nivelin e detyrimeve të paarkëtuara në fund të periudhave ushtrimore, si një e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë, ku në fund të vitit 2021 ka një vlerë afërsisht sa plani vjetore i të ardhurave të Bashkisë Fushë Arrëz.

**Shkaku:** Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi, si dhe mungesa e një strukturë organizative të përshtatshme.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Fushë Arrëz, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **18,441,055 lekë**, duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon:

d- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.

e- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).

f- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

g- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Fushë Arrëz, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

### **Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

- z. F.T me detyrë Kryetar i Bashkisë Fushë Arrëz sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 42 “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 2, ku përcaktohet se: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.”

- znj. A.D, me detyr ish/përgjegjëse e Sektorit Tatim-Taksa, per periudhën 18.12.2019 deri me 18.05.2021.

- z. V.P, me detyr ish/përgjegjës i Sektorit Tatim-Taksa, per periudhën 25.05.2021 e në vijim.

- z.. Gj.N me detyr Specialist i Tatim-Taksave, per periudhën 08.04.2019 deri me 05.01.2022.

- z. B.M me detyr Inspektor Tatim-Taksa, per periudhën 25.05.2021 e në vijim.

### ➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

**Titulli gjetjes:** *Lejimi i subjekteve që tregtojnë hidrokarbure me Licencë të bashkisë dhe papaguar tarifën në zbatim të VKM nr. 344, datë 19.04.2017.*

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e

<sup>11</sup> Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithëse mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjër në tre vjet.

detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Fushë Arrëz dhe Njësitë Administrative **nuk është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet.**

Nga auditimi i dosjeve të subjekteve që tregtojnë karburante në Bashkinë Fushë Arrëz për vitet 2018 -2021 paraqiten 4 subjekte si më poshtë:

NR	Emërtimi i Subjektit	Adresa	Data e fillimit të Aktivitetit	Autorizim / Licencë
1	K.O Shpk	Fushë Arrëz	4/16/2013	Është pajisur me licencë
2	L Shpk	Fushë Arrëz	11/15/2011	Nuk është pajisur me licencë
3	D Shpk	Fushë Arrëz	17/02/2009	Nuk është pajisur me licencë
4	V.T.O Shpk	Fushë Arrëz	1/23/2015	Nuk është pajisur me licencë

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se nga Bashkia Fushë Arrëz në fund të vitit ushtrimor 2021 ushtrojnë aktivitetin 4 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 3 subjekte nuk janë pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 të cilët nuk kanë paguar detyrimet në vlerë 3,000,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz, ndërsa 1 subjekte është pajisur me autorizim 1 vjeçar i cili ka paguar detyrimet në vlerë 200,000 lekë në kundërshtim me - VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pikës 1 germës "b" ku cilësohet:

II. Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë

1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njëjësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:

b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njëjësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.

9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante është 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe **2,000,000 (dy milionë) lekë, për bashkitë e tjera.**

- Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.

"9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe **1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera."**

10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 1 000 000 (një milion) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe **200 000 (dyqind mijë) lekë, për bashkitë e tjera.**

- Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.

"10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500 000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe **100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera."**

"15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.

15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi."

**-VKM nr. 344, datë 19.04.2017**, për disa ndryshime ne VKM nr. 970, pika 15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.

15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi."

**Kriteri:** Në kundërshtim me nenin 35 të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4. e VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar si dhe kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa "b" dhe pika 9 dhe 15 të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Mos ndjekja e procedurës për dhënien e Liçensë së tregtimit të karburanteve, çon në mungesë të ardhura për Bashkinë Fushë Arrëz me vlerë **3,000,000 lekë**.

**Shkaku:** Mungesa e bashkëpunimit dhe mos ndjekja e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për mos lejimin e ushtrimit të aktivitet pa dokumentacion të rregullt.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimeve në bashkëpunim me Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së pataksuar prej **3,000,000 lekë** ndajë 3 subjekteve, sipas pasqyrës Aneks nr. 3 pika 2.6 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

### Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

- z. O.Ç me detyrë ish/Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për periudhën 30.05.2017 deri me 04.01.2021.
- z. K.V, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për periudhën 05.01.2021 dhe në vijim.

### ➤ Pajisja me NUIS sekondare e Operatorëve Ekonomikë të cilët kryejnë veprimtari biznesi në Bashkinë Fushë Arrëz:

**Titulli i gjetjes:** Mos pajisja me nipt sekondar i OE të cilët janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit si dhe kanë ushtruar aktivitet në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz

**Situata:** Bazuar në dokumentet e paraqitura nga Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Investimeve rezulton se për perjudhen objekt auditimi janë lidhur 7 kontrata me OE të cilët janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit si dhe kanë ushtruar aktivitet në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz pa u pajisur me NUIS/sekondar si dhe pa u pajisur me leje infrastrukturore në kundërshtim me ligjin nr. 107/2017, datë 31.07.2014 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën vijuese:

Nr	Emertimi Projektit	Subjekti Fitues	Kosto e projektit pa TVSH	Njoftim Fillim Punimesh	Njoftim mbarim Punimesh
1	Ndertim i Godines se Njesise Administrative Blerim	N 2014	4,690,670	28.02.2022	25.08.2022
2	Rikonstruksion mure mbajtese Fushe Arrez U shpk UB 6403 kod 1550069	U shpk	11,550,008	18.11.2020	15.10.2021

3	Hapje rruge Strame Aprripe guri S AL, kod projekti 1550070, Ub 6447.fature 2200 date 11.8.2021	S AL	1,999,735	10.12.2020	10.03.2021
4	Sistemim asfaltim dhe ndriçim i rrugës auto lagjia e vjetër në Qytetin Fushë Arrëz + supervizim dhe kolaudim.	P G	3,120,976.95	20.05.2019	04.09.2019
5	Ndërtim I shpatullave te urave auto lagjia Koprat(Iballe)+fshati Micoj	N 2014	2,613,613	09.11.2021	09.12.2021
6	Ndërtim bazamente te urave auto lagje Koprat,Fshati Iballë dhe Fshati Micoj + supervizim dhe kolaudim.	D-1	3,007,100	04.07.2019	29.08.2019
7	Shtesë në pedonale dhe Lulishte në Qytetin Fushë Arrëz, + supervizim dhe kolaudim.	P G	5,789,450	16.05.2019	14.10.2019

Burimi: Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Investimeve

Gjithashtu nga auditimi i paketës fiskale për vitin 2021 miratuar me vendimin nr. 47 datë 23.12.2022 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 48/3 datë 09.02.2021 rezulton se Bashkia Fushë Arrëz nuk ka parashikuar aplikimin e taksave dhe tarifave vendore për subjektet e ndërtimit, (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Fushë Arrëz) të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike në kundërshtim me Ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar:

#### **Neni 9 Të drejtat dhe përgjegjësitë**

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

b) vendosin taksa vendore e **tarifa për shërbimet**, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

#### **Neni 35 Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore**

5. Bashkitë **krijojnë të ardhura nga tarifatat vendore** për:

a) shërbimet publike që ato ofrojnë;

#### **Neni 54 Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak**

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

f) **vendos për taksat e tarifatat vendore**, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;

-Ligji nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”

#### **Neni 3 Përkufizime**

10. “Tarifë vendore” është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik **bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur** apo të drejte të dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

#### **Neni 12 Rregulla të përbashkëta për taksat vendore**

2. Baza e taksave dhe tarifave, si dhe niveli i tyre, **çdo përjashtim apo ulje**, afati i pagesave, si dhe gjomat e kamatëvonesat e aplikueshme, **në përputhje me legjislacionin në fuqi**, botohen dhe bëhen të njohura publikisht.

#### **Neni 14 Tarifa vendore**

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore krijojnë të ardhura nga këto tarifa vendore:

b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve;

#### **Neni 18 Të ardhurat nga tarifatat e shërbimeve të tjera publike**

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore propozojnë ose miratojnë, sipas legjislacionit në fuqi, tarifa për mbledhjen dhe heqjen e mbetjeve, si dhe për furnizimin me ujë dhe kanalizimet.

2. **Niveli i tarifave të shërbimeve publike**, si rregull, synon mbulimin e kostos dhe është në përputhje me konsumin nga individët, personat fizikë ose juridikë.

-Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit regjistrimet e tjera”, i ndryshuar

#### **Neni 2 Përkufizime**

6. “Regjistrim” është regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër, përfshirë dhe çregjistrimin e subjektit nga regjistri.

#### **Neni 43 Regjistrimet e tjera të detyrueshme**

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:

d) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia;

-Ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

#### **Neni 40 Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare**

5. Mosregjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

-Udhëzimi nr.24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kreu III dispozita të përgjithshme administrative

#### **23. Komunikimi me personat e tatueshëm**

23.3.3 Komunikimi i vlerësimeve, njoftimeve, vendimeve dhe çdo akti tjetër zyrtar, nga ana e administratës tatimore, bëhet me postë elektronike ose në rrugë elektronike, nëpërmjet dërgimit të tyre në llogarinë e tatimpaguesit të hapur në sistemin elektronik të shërbimit tatimor, ose nëpërmjet dërgimit në adresën e postës elektronike (e-mail) të tatimpaguesit, kur një adresë e tillë i është njoftuar nga vetë tatimpaguesi administratës tatimore, sipas udhëzimit për pëlqimin e formës elektronike.

40. Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare

Për çdo vend tjetër të ushtrimit të aktivitetit të ndryshëm nga adresa kryesore, **personi fizik duhet të pajiset me një certifikatë me numër unik të identifikimit të tatimpaguesit të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes së re.**

40.4 Personi i tatueshëm që ushtron veprimtari në adresa (vendndodhje) të ndryshme biznesi, pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo adresë, e cila ka të njëjtin NIPT unik.

43. Ndryshimet në regjistrim 43.1

Sipas nenit 43 të ligjit, personat e tatueshëm që ushtrojnë veprimtari ekonomike e tregtare, janë të detyruar të deklarojnë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, çdo ndryshim të mëvonshëm që lidhet me emrin, adresën e selisë dhe të degëve, formën juridike, krijimin e mbylljen e degëve, ndryshimin e llojit të veprimtarisë, etj., siç përcaktohet në dispozitat ligjore për QKR. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend.

**Kriteri:** Ligjin nr. 107/2017, datë 31.07.2014 “Për planifikimin e territorit”; nenet 9; 35, 54 i ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; nenet 3, 12, 14 dhe 18 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 2 dhe 43 të ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit regjistrimet e tjera”, i ndryshuar; neni 40 i ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe Udhëzimi nr.24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Kreu III dispozita të përgjithshme administrative

**Ndikimi/Efekt:** Mos ndjekja e procedurës për 7 kontrata me OE të cilët janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit të cilët kanë ushtruar aktivitet në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz pa u pajisur me NUIS/sekondar si dhe pa u pajisur me leje infrastrukturore.

**Shkaku:** Mungesa e bashkëpunimit dhe mos ndjekja e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për mos lejimin e ushtrimit të aktivitetit pa dokumentacion të rregullt.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me sektorin e Sektorit Juridik dhe Prokurimeve dhe me Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve të marë masa që në paketën fiskale të vitit 2022 të parashikoj aplikimin e taksave dhe tarifave vendore për subjektet e ndërtimit, (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Fushë Arrëz) të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike.

## **Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

- Znj. A.D, me detyr ish/përgjegjëse e Sektorit Tatim-Taksave për periudhën 18.12.2019 deri me 18.05.2021.
- Znj. P.P me detyrë ish/përgjegjëse e sektorit juridik dhe prokurimeve.

### ➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Administrimi i taksave vendore nuk bëhet me program, nuk janë të pasqyruara regjistrat, sipas aktiviteteve, njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që kërkohen për auditim, konstatohet se informacionet që kërkohen të dhënat nuk dalin të analizuar për çdo zë tatimor që sektori i taksave dhe tarifave vendore bashkia fushë arrëz aplikon.

Referuar të dhënave të marra nga sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Fushë Arrëz, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja në fund të periudhës
Biznes i vogël	2021	84	-	9	75
Biznes i madh	2021	29	-	1	28
TOTAL		113	-	10	103

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

**Titulli i gjetjes:** Lejimi i subjekteve të biznesit të madhë që ushtrojnë aktivitet në Bashkin Fushë Arrëz, të cilat nuk janë tatuar që nga momenti i ushtrimit të aktivitetit e deri në vitin 2021.

**Situata:** Konstatohet se në vijim të shkresës suaj Nr. 4447 date 14.11.2022 "Kërkesë për informacion" ju dërgojmë listën e subjekteve që operojnë në Rrethin Pukë, Bashkia Fushë Arrëz të nxjerra nga sistemi tatimore nga (Drejtoria e Tatim Taksave) Shkodër rezulton se numri i subjekteve të regjistruara në sistem me status aktiv, që zhvillojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz, është 111 subjekte aktiv deri me 17.11.2022, nga të cilat 39 subjekte të kategorisë person juridik dhe 72 subjekte të kategorisë person fizik. Por nga dokumentacioni që u paraqit nga zyra e taksave dhe tarifave vendore, konstatohet se numri i subjekteve të regjistruara në njësinë vendore, për të cilat llogariten taksa dhe tarifa, është 103, nga të cilat 39 subjekte të kategorisë person juridik dhe 72 subjekte të kategorisë person fizik. Nga krahasimi i të dhënave për kategori e subjekteve biznesi i madhe rezulton se në bashkinë Fushë Arrëz ushtrojnë aktivitet 16 subjekte të cilat nuk janë tatuar që nga momenti i ushtrimit të aktivitetit<sup>12</sup>. Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore nuk japin shpjegime se nga vjen diferenca, vjen si rezultat i mungesës së strukturave, mos rakordimi midis drejtorive apo nga mos azhurnimeve në organet tatimore dhe QKB. Ky mos rakordim nuk jep siguri se numri i bizneseve të regjistruar në njësinë vendore për pagesën e taksave dhe tarifeve vendore është i saktë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 40, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 40 - Regjistrimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jo tregtare, pika 4- Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit shërben njëkohësisht si regjistrim në administratën tatimore

**Kriteri:** Nenin 40, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 40 - Regjistrimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jo tregtare, pika 4- Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit shërben njëkohësisht si regjistrim në administratën tatimore

**Ndikimi/Efekti:** Mos evidentimi i subjekteve të biznesit të madhë që ushtrojnë aktivitet në Bashkin Fushë Arrëz, cka ndikon negativisht në të ardhurat e Bashkisë.

**Shkaku:** Mungesa e bashkëpunimin dhe mos ndjekja e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për mos lejimin e ushtrimit të aktivitet pa dokumentacion të rregullt.

**Rëndësia:** I Lartë.

<sup>12</sup> Trajtuar më hollësisht në Kapitullin "Anekse" – "Aneksi nr.3" të raportit përfundimtar të auditimit.

**Rekomandimi:** Sektori i taksave dhe tarifave vendore, për subjektet e paregjistruara të marë masa për futjen e tyre në sistemin e deklarimit duke vendosur sanksione e llogaritur detyrimet tatimore edhe për periudhën e pa regjistruar<sup>13</sup>.

- Të verifikojnë në teren numrin e bizneseve faktik që ushtrojnë aktivitet, si dhe të bashkëpunojnë me drejtorinë rajonale Tatimore Shkodër dhe QKB për të evidentuar subjektet e mbyllura, që nuk ushtrojnë aktivitet e nuk kanë bërë deklarim për këtë qëllim. Në fund të verifikimeve dhe rakordimeve të bëhen ndryshimet e nevojshme në regjistrin e taksapaguesve privat në Bashkinë Fushë Arrëz. Çdo ndryshim të justifikohet me dokumentacion përkatës.

**Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

-znj.A.D, me detyr ish/përgjegjëse e Sektorit Tatim-Taksa per periudhën 18.12.2019 deri me 18.05.2021.

-z. V.P, me detyrë ish/përgjegjës i Sektorit Tatim-Taksa, për periudhën 25.05.2021 e në vijim.

### **Kontratat e qirave.**

Për auditimin e kontratave të qirasë lidhur ndërmjet Bashkisë Fushë Arrëz dhe subjekteve juridik/fizik, saktësinë e tarifave të aplikuara dhe arkëtimin e tyre, të cilat e shtrijnë efektin e tyre deri më datë 31.12.2021, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Ligj nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligj nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;

-Ligj nr.57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020;

-VKM nr.54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar;

-VKB për miratimin paraprak të heqjes së fondit pyjor/kullosor nga ekonomia pyjore/kullosore;

-Urdhrat e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për miratimin e heqjes së fondit pyjor/kullosor nga ekonomia pyjore/kullosore, sipas ngastrave dhe sipërfaqeve përkatëse;

-Kontratat e lidhura me subjektet juridike/fizike për përdorim të fondit pyjor/kullosor/tokës bujqësore, për ngritjen e hidrocentraleve, antenave të telefonisë celulare, linja të transmetimit të energjisë elektrike, agropylltari, kullotje, gurore etj;

-Raportet teknike për përdorimin e ekonomisë pyjore/kullosore, pranëvendosje në ekonominë pyjore të tubacioneve të HEC-eve, sipas ngastrave pyjore;

-Rregullore e brendshme e Bashkisë Fushë Arrëz.

Rezultoi se në territorin e bashkisë Fushë Arrëz ushtrojnë aktivitet 10 Shoqëri Koncesionare të cilat kanë lidhur kontrata me bashkinë ndër vite, sipas tabelës vijuese:

Nr.	Qarku	HEC-i	" Shoqëria Koncesionare	Kontratat koncesionare
1	Shkoder	K, Kryezi i Eperm	"B E" sh.p.k	2
2	Shkoder	Kaskada e hec-eve ne lumin Dardhe: D 1 dhe 2	W sha	2
3	Shkoder	K 3, 4, 5	O E	3
4	Shkoder	I, 2, S I, 2, B, L	"N S E" shpk	6
5	Shkoder	A	Hec A shpk	1
6	Shkodër	K	"A-2014"shpk	1
7	Shkodër	Fushe Arrez	"A-2014"shpk	1
8	Shkodër	B	"E & P"shpk	1
9	Shkodër	Q 1	L I Sh.a	1
10	Shkodër	Iballe	O Sh.p.k	1

Burimi: AKBN dhe Bashkia Fushë Arrëz

Sa më sipër grupi i auditimit auditoj 6 subjekte nga 10 subjektet që kanë lidhur kontratë me Bashkinë Fushë Arrëz. Në mënyre të detajuar problematikat e konstatuara janë si vijon;

**Titulli i gjetjes:** Keqadministrimi i të ardhurave nga kontratat e qiradhënies së pasurive të paluajtshme.

**Situata:** Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Fushë Arrëz me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Sektori i Taksave dhe

<sup>13</sup> Trajtuar më hollësisht në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.



Tarifave Vendore, si dhe Sektori Juridike, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Fushë Arrëz, përlllogaritje e gabuar e tarifave, mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e qirave, etj), veprime dhe moveprime të cilat kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz në vlerën 53,839,444 lekë.

Gjithashtu është konstatuar se në një raste është lidhur kontratë qiraje në tejkalim të kompetencës ligjore që përcakton kuadri rregullator i fushës, respektivisht Amendimi i kontratës së qirasë nr.2718 prot, datë 07.11.2017 konceptuar nga përgjegjësja e sektorit juridik znj. P.P dhe nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z. F.T me qiramarrësin shoqëria "A 2014" shpk përfaqësuar nga administratori z. A.GJ, duke rritur sipërfaqen sipas nenit 4 të kontratës, në kundërshtim me procedurat ligjore; VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 Për Përcaktimin e Kriteve, të Procedurës e të Mënyrës së Dhënies me Qira, Enfiteozë apo Kontrata të Tjera të Pasurisë Shtetërore konkretisht: Kreu II Procedurat e Dhënies me Qira ose Enfiteozë të Pasurisë Shtetërore. Në mënyre të detajuar problematikat e konstatuara janë si vijon;

**1. Kontrata Nr. 218 Rep; 98/3 kol datë 19.02.2015** “Për dhënien me qira të sipërfaqes prej 250 m2 ku qiradhënësi ka vendosur pajisjet e tij të transmetimit celular, pjesë e fondit pyjorë kullor publik ekonomi pyjorë, e emërtuar “Lumi i Zi” parcela me nr. 17/C e ndodhur në Zonën Kadastrale nr. 1657 numër pasurie 17-R-N-Volum 6 faqe 6, me Adresë fshati Fushë Arrëz, sipas certifikatës së pronësisë më datë 02/09/2008 e lidhur midis subjektit V A SH.A e përfaqësuar nga z. D Z M dhe Bashkisë Fushë Arrëz e përfaqësuar nga z. F.T.

Afati i kontratës është për një periudhë 6 vjeçare referuar nenit 4 të kontratës fillon nga data 26.05.2015 deri më 25.06.2021, me të drejtë rinovimi çdo vit. Vlera totale e qirasë për përdorimin e sipërfaqes është **300,000 lekë**. Lidhur me këtë kontratë qiraje, konstatohet se megjithëse kontrata ka përfunduar, personi qiramarrës nuk ka dorëzuar objektin të cilin ka vazhduar ta posedojë, gëzojë dhe disponojë, pa kryer pagesën e qirasë sipas kontratës, deri më datë 25.06.2021, e në vazhdim. Referuar nenit 815, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil”, citohet “*Qiramarrësi që është në vonesë për të kthyer sendin, detyrohet t’i japë qiradhënësit pagesën e caktuar deri në dorëzim, përveç detyrimit për të shpërblyer dëmin përkatës*”.

Sipas nenit 5 të kontratës, vlera e munguar e qirasë së padredhur për periudhën 25.06.2021 deri në periudhën 24.06.2022, paraqitet në vlerën **300,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Fushë Arrëz**

- *Sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. Gj.Gj me detyrë Drejtor i Drejtorisë së shërbimit Pyjor për periudhën 2018-2021 objekt auditimi, znj. P.P me detyrë ish/ Përgjegjëse e sektorit juridik dhe prokurimeve dhe znj A.D, me detyrë ish/përgjegjëse e Sektorit Tatim-Taksa për periudhën 18.12.2019 deri me 18.05.2021.*

## **2. HEC B. Për periudhën 2018 dhe 2021, i shtrijnë efektet 1 kontrata, si më poshtë vijon:**

-Kontratë qiraje nr.2720 prot, datë 07.11.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z.F.T dhe qiramarrësi shoqëria "E & P" shpk përfaqësuar nga administratori z. G M.

-VKB nr.53, datë 25.04.2018 “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullor për ndërtimin e HEC-it **B** nga subjekti "E & P" shpk me afat 2 vite.

-Me shkresën nr. 2572 prot, datë 17.10.2017 Bashkia Fushë Arrëz i ka dërguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Sektorit të Kadastrës dhe Shërbimit Këshillimor Raportin Tekniko-Ekonomik sipas Akt-Miratimit nr. 2505 datë 16.10.2017 përpiluar nga grupi i punës z. Z A, z. A.D dhe z. D.E konfirmuar nga Drejtori z. Gj.Gj dhe Kryetari i Bashkisë z. F.T

Afati i kontratës : 01.01.2018-01.01.2020 (2 vite).

-Vlera e kontratës viti I: 639,504 lekë, nga të cilat 614,358 lekë qira dhe 25,146 lekë lënda drusore, që paguhet vetëm në vitin e parë të kontratës;

-Vlera e kontratës II: 614,358 lekë/viti

### **I. Përlllogaritjet e Bashkisë Fushë Arrëz sipas raportit teknik:**

-Shtrirje tubacionesh 0.259 km trungishte \* 220,000 lekë/km/2-5 vite = 56,760 lekë;  
-Shtrirje tubacionesh 2.023 km cungishte \* 176,000 lekë/km/2-5 vite = 356,048 lekë;  
-Shtrirje tubacionesh 1.390 km induktive \* 145,000 lekë/km/2-5 vite = 201,550 lekë;  
Total qira = **614,358 lekë qira për sipërfaqe të dhënë në përdorim.**

### **Referuar të dhënave të paraqitura nga sektori i tatim taksave rezultoi se subjekti ka likuiduar detyrimet deri me 01.01.2020**

-Sa më sipër rezulton se tarifat e aplikuara nga grupi i punës janë në përputhje me tabelën nr.11 në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar, si dhe afatin e dhënies në përdorim përcaktuar në VKB nr.53, datë 21.06.2019.

### **II. Përlogaritjet e grupit të auditimit:**

-Nga shqyrtimi i kontratë qiraje nr.2720 prot, datë 07.11.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z.F.T dhe qiramarrësi shoqëria "E & P" shpk përfaqësuar nga administratori z. G.M.

Rezulton se periudha 01.01.2020 – 31.12.2021, ose 2 vite, është e pa mbuluar me kontratë qiraje dhe për pasojë ndaj subjektit nuk është lidhur kontratë qiraje, për të cilën mbanë përgjegjësi z.GJ.GJ, ish-Drejtori i DSHP Fushë Arrëz, pasi prej tij duhet të ishin marrë masat e nevojshme që subjekti mos të përdorte pyjor/kullosor pa kontratë qiraje.

Sa më sipër kemi:

(614,358 lekë \* 2 vite) = 1,228,716 lekë.

-Gjithsej diferencë e krijuar **1,228,716 lekë**, të cilat përbëjnë ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 154 dhe 296 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja "g" në pikën 1 në nenin 17, shkronja "c" e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja "a" e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 "Për pyjet"; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën "a" të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

- *-Sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. Gj.Gj me detyrë Drejtor i Drejtorisë së shërbimit Pyjor për periudhën 2018-2021 objekt auditimi, znj. P.P me detyrë ish/ Përgjegjëse e sektorit juridik dhe prokurimeve dhe znj A.D, me detyrë ish/përgjegjëse e Sektorit Tatim-Taksa për periudhën 18.12.2019 deri me 18.05.2021.*

### **➤ HEC A. Për periudhën 2018 dhe 2019, i shtrijnë efektet 2 kontrata, si më poshtë vijon:**

-Kontratë qiraje nr.2718 prot, datë 07.11.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z.F.T dhe qiramarrësi shoqëria "A 2014" shpk përfaqësuar nga administratori z. A.GJ.

-VKB nr.55, datë 25.04.2018 "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor për ndërtimin e HEC-it A nga subjekti "A 2014"shpk me afat 2 vite.

-Me shkresën nr. 1862 prot, datë 01.08.2017 Bashkia Fushë Arrëz i ka dërguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Sektorit të Kadastrës dhe Shërbimit Këshillimor Raportin Tekniko-Ekonomik sipas Akt-Miratimit nr. 1192 datë 22.05.2017 përpiluar nga grupi i punës z. Z.A, z. A.D dhe z. D.E konfirmuar nga Drejtori z. Gj.Gj dhe Kryetari i Bashkisë z. F.T

Afati i kontratës : 07.11.2017-06.11.2019 (2 vite).

-Vlera e kontratës viti I : 832,814 lekë, nga të cilat 751,535 lekë qira dhe 81,279 lekë lënda drusore, që paguhet vetëm në vitin e parë të kontratës;

-Vlera e kontratës II: 751,535 lekë/viti

### **I.Përlogaritjet e Bashkisë Fushë Arrëz sipas raportit teknik:**

-Shtrirje tubacionesh (kanal i deviacionit i mbyllur+tubacion i tresionit nëntokësor) 2.251 km trungishte \* 220,000 lekë/km/2-5 vite = 495,220 lekë;

-Shtrirje tubacionesh (kanal i deviacionit i mbyllur) 0,375 km djer \* 145,000 lekë/km/2-5 vite = 54,375 lekë;

-Shtrirje tubacionesh (linjë elektrike) 0,878 km trungishte \* 230,000 lekë/km/2-5 vite = 201,940 lekë;

**Total qira = 751,535 lekë qira për sipërfaqe të dhënë në përdorim.**

-Sa më sipër rezulton se tarifat e aplikuara nga grupi i punës janë në përputhje me tabelën nr.11 në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, si dhe afatin e dhënies në përdorim përcaktuar në VKB nr.55, datë 21.06.2019.

## **II.Përlllogaritjet e Bashkisë Fushë Arrëz**

-Nga shqyrtimi me kontratën nr. 1978 datë 26.07.2029 është bërë amendimi i kontratë së qirasë nr.2718 prot, datë 07.11.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z.F.T dhe qiramarrësi shoqëria "A 2014" shpk përfaqësuar nga administratori z. A.GJ, duke rritur sipërfaqen sipas nenit 4 të kontratës rezulton se

“Vlera e Kontratës që shtohet” për përdorimin e tokës bujqësore në pronësi shtet për ndërtimin e kanalit, tubacionit dhe linjën elektrike, shuma është

Tokë bujqësore: 4030 m<sup>2</sup> (0.4030ha) \* 100 lekë/ha = 403,000 lekë

Troje: 6190 m<sup>2</sup> (0.6190ha) \* 100 lekë/ha = 619,000

**Total qira = 1,022,000 lekë qira për sipërfaqe të dhënë në përdorim.**

Sa më sipër parashtrijmë se:

Amendimi i kontratë së qirasë nr.2718 prot, datë 07.11.2017 konceptuar nga përgjegjësja e sektorit juridik znj. P.P dhe nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z.F.T me qiramarrësin shoqëria "A 2014"shpk përfaqësuar nga administratori z. A.GJ, duke rritur sipërfaqen sipas nenit 4 të kontratës është bërë në kundërshtim me procedurat ligjore; VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 Për Përcaktimin e Kritereve, të Procedurës e të Mënyrës së Dhënies me Qira, Enfiteozë apo Kontrata të Tjera të Pasurisë Shtetërore konkretisht: Kreu II Procedurat e Dhënies me Qira Ose Enfiteozë të Pasurisë Shtetërore ku citohet;

*1. Institucioni shtetëror, ndërmarrja apo shoqëria shtetërore, që ka në administrim objektin që do të jepet me qira ose enfiteozë, për të gjitha rastet, përgatit dokumentacionin si më poshtë vijon: a) propozimin për dhënien me qira ose enfiteozë të objektit, i cili përmban propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri dhe afatin e dhënies me qira. Përfshijmë këtij rregulli, Ministria e Mbrojtjes mund të mos japë propozim për veprimtarinë që do të ushtrohet; b) vendimin e organit drejtues të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore (Këshilli Mbikëqyrës, Këshilli Drejtues, Bordi Drejtues etj.); c) miratimin e organit të varësisë administrative; ç) Genplanin e objektit, në 6 (gjashtë) kopje origjinale, të hartuar nga eksperti topograf i licencuar dhe të konfirmuar nga drejtuesi i institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore, ku të jenë përcaktuar qartë sipërfaqja e truallit gjithsej, sipërfaqja nën ndërtesë dhe sipërfaqja funksionale (jo nën ndërtesë); d) tarifën dysheme të detyrimit mujor për sipërfaqet nën ndërtesë, sipas përcaktimeve në këtë vendim dhe duke pasur parasysh edhe gjendjen fizike të objektit; dh) konfirmimin nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për pronësinë shtet të objektit dhe truallit, si dhe nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për vendimet që mund të ketë dhënë për njohje ose kthim prone. Në rastet kur pasuria, që jepet me qira ose enfiteozë, është në administrim të shoqërive shtetërore, nuk është e nevojshme të kërkohet 4 konfirmimi nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.*

*2. Në rastet e propozimit për dhënien me enfiteozë të objektit, përveç dokumentacionit të sipërpërmendur duhet të specifikohet edhe vlera kontabël e pasurisë, sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës.*

*3. Për pasuritë e përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 6 të kreut I të këtij vendimi, institucioni shtetëror a shoqëria shtetërore, pas përgatitjes së dokumentacionit sipas pikës 1 të këtij kreu, lidh kontratën e qirasë.*

*4. Për objektet e përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 6 të kreut I të këtij vendimi, pas përgatitjes së dokumentacionit, drejtuesi i institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo*

shoqërisë shtetërore, që ka në administrim pasurinë që do të jepet me qira ose enfiteozë, e përcjell atë në organin që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, i cili, me urdhër të titullarit të tij, fillon procedurat për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore.

5. Në urdhrin e titullarit të institucionit për dhënien me qira ose enfiteozë, me konkurrim, të pasurisë shtetërore përcaktohen: a) të dhënat për pasurinë shtetërore që jepet me qira apo enfiteozë: emërtimi, sipërfaqja, zona kadastrale, qëllimi i përdorimit, vlera dysHEME e detyrimit mujor të llogaritur sipas tarifave të këtij vendimi e afati; b) veprimtaria që mund të ushtrohet në objekt; c) pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, sipas pikave 3 ose 4 të kreut I të këtij vendimi, të cilat caktohen, rast pas rasti, nga titullari i institucionit; ç) vendi, data dhe ora, ku paraqiten dokumentet; d) përbërja e komisionit të shqyrtimit të ofertave të konkurrentëve, me tri veta, një kryetar e dy anëtarë; dh) dokumentacioni që paraqitet nga konkurrentët për konkurrim.

6. Njoftimi për publikim për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore shpallet I (një) herë në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në njoftim përcaktohen të dhënat për objektin, kategorizimin e veprimtarisë që do të ushtrohet në objekt, afati i dhënies me qira ose enfiteozë, pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, dokumentacioni që do të paraqesin konkurrentët, si dhe vendi, data dhe ora e paraqitjes së dokumentacionit. Data e konkurrimit të jetë jo më parë se 7 (shtatë) ditë kalendarike nga data e botimit të fundit.

7. Dokumentacioni për marrjen me qira, që paraqesin konkurrentët, i dorëzohet komisionit në orën e hapjes së konkurrimit dhe përmban: a) kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore; b) planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë: plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen; c) ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë; ç) certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR; d) NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore; dh) vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin. Ky dokumentacion duhet të plotësohet edhe në rastet kur objekti jepet me qira pa konkurrim.

8. Dokumentacioni për marrjen me enfiteozë, që paraqesin konkurrentët, të cilët duhet të jenë shoqëri tregtare, i dorëzohet komisionit dhe përmban: 5 a) kërkesën e subjektit për marrje me enfiteozë të pasurisë shtetërore; b) planbiznesin e hollësishëm për përmirësimin e pronës; c) përshkrimin e projektideve të investimit, të dhëna për nivelin e investimeve të parashikuara në pasuri të paluajtshme dhe në objektin në tërësi, shoqëruar me projekte, skica dhe dokumentacion tjetër paraprak, si dhe burimin e financimit të projektit; ç) ofertën për vlerën e detyrimit mujor; d) CV-në e subjektit, ku të tregohet përvoja në fushën e aktivitetit ekonomik që do të ushtrohet në pasurinë që jepet me enfiteozë, të shoqëruar me dokumentacion vërtetues; dh) certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR; e) NIPT-in e subjektit; ë) vërtetimin nga dega e tatimeve, që subjekti ka shlyer ose nuk ka detyrime tatimore; f) vërtetimin nga dega e doganës se ka zhvilluar eksport apo kontrata eksportuese efektive, në rastet kur subjektet kryejnë veprimtari eksportuese.

9. Komisioni i dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore kryen këto detyra: a) merr në dorëzim zarfet e mbyllura të konkurrentëve pjesëmarrës dhe i hap në prani të tyre, i lexon dhe u bën të njohur të dhënat kryesore të dokumenteve dhe treguesve konkurrues, për çdo ofertë të paraqitur. Kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, konkurrenti nuk kualifikohet në prani të tij; b) harton procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit, ku përshkruan pjesëmarrësit, konkurrentët e skualifikuar dhe shkakun, konkurrentët e kualifikuar dhe listën e dokumenteve të paraqitura prej tyre; c) brenda 10 (dhjetë) ditëve bën shqyrtimin e ofertave të paraqitura dhe vlerëson me pikë çdo element konkurrimi, sipas përcaktimit në urdhrin e titullarit. Subjektit, që paraqet vlerën më të lartë të propozuar, i jepen pikët maksimale të çdo elementi konkurrimi, ndërsa subjekteve të tjera pikët u llogariten në përpjesëtim të drejtë me vlerën më të lartë, të propozuar. Në përfundim, konkurruesit renditen në bazë të shumës së pikëve të përfituara; ç) paraqet brenda afatit të përcaktuar në shkronjën "c" të kësaj pike, te titullari i institucionit shtetëror, që ka të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë ose të

enfiteozës, informacion për zhvillimin e konkurrimit, së bashku me procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit dhe listën e konkurruesve, të renditur sipas pikëve të fituara.

10. Titullari i institucionit, që ka të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë ose të enfiteozës, vendos për subjektin fitues në konkurrim. Kur në konkurrim marrin pjesë më shumë se një konkurrues, njoftimi për shpalljen e fituesit vendoset në këndin e njoftimeve të institucionit përkatës.

11. Subjektet konkurruese, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e subjektit fitues, kanë të drejtën e ankimit te titullari i institucionit, i cili, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, i kthen përgjigje me shkrim ankuesit.

12. Pas përfundimit të procedurave të sipërpërmendura, fillojnë procedurat për hartimin dhe lidhjen e kontratës së qirasë ose të enfiteozës.

13. Kur subjekti fitues tërhiqet, procedurat e lidhjes së kontratës vazhdojnë me subjektin e klasifikuar në vend të dytë.

14. Para nënshkrimit të kontratës së qirasë ose të enfiteozës, qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi është i detyruar të kryejë pagesën e garancisë së kontratës, e cila është e barabartë me vlerën e tre muajve të pagesës së qirasë ose të enfiteozës. Garancia ngurtësohet deri në fund të kontratës dhe i kthehet qiramarrësit ose enfiteozëmarrësit me përfundimin e kontratës.

15. Në rastet kur prona shtetërore nuk është e regjistruar në administrim të ndonjë 6 institucioni shtetëror, shoqërie apo ndërmarrjeje shtetërore, ministria përgjegjëse për ekonominë e jep me qira sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim. Në këto raste, dokumentacioni i përcaktuar në pikën 1, të këtij kreu, përgatitet nga dega e shoqërive publike në prefekturën përkatëse

### **Sa në sipër rezulton se**

1. Bashkia Fushë Arrëz nuk administron ndonjë procedur ligjore në dosjen e kontratës e subjektit HEC A –K por kemi thjeshtë një amendament të kontratës me nr. 2718 prot., datë 07.11.2019. lidhur nga Kryetari i Bashkisë z. F.T dhe qiramarsi shoqëria "A 2014" shpk përfaqësuar nga administratori z. A.GJ.

2. VKB nr.55, datë 25.04.2018 “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullor për ndërtimin e HEC-it A nga subjekti "A 2014" shpk me afat 2 vite. Është shprehur për ngastrat në ekonomin pyjore të paraqitur nga grupi i punës sipas përcaktimeve të kontratës nr. 2718 prot., datë 07.11.2019. dhe jo për shtimin e sipërfaqes që do të sfrytësoj subjekti “A 2014” shpk sipas amendament të kontratës nr. 2718 prot., datë 07.11.2019 me numër protokollit 1978 prot datë 27.06.2019.

3. Sipërfaqet objekt taksimi janë sipërfaqe që nuk i përkasin ekonomis pyjore referuar llogaritjes së bërë sipas shkresën nr. 1978 prot datë 27.06.2019 respektivisht;

Tokë bujqësore:  $4030 \text{ m}^2$  (0.4030ha) \* 100 lekë/ha = 403,000 lekë

Troje:  $6190 \text{ m}^2$  (0.6190ha) \* 100 lekë/ha = 619,000 lekë

4. Në amendamentin e kontratës sipas shkresës nr. 1978 prot datë 27.06.2019 nuk është përcaktuar afati i dhënies me qira të sipërfaqeve të sipërcituar.

5. Çmimi i qirasë për sipërfaqen e tokës nuk është aplikuar sipas dispozitave ligjore konkretisht:

#### **Sipas përlllogaritjes së Bashkisë Fushë Arrëz**

Tokë bujqësore:  $4030 \text{ m}^2$  (0.4030ha) \* 100 lekë/ha = 403,000 lekë

Troje:  $6190 \text{ m}^2$  (0.6190ha) \* 100 lekë/ha = 619,000 lekë

#### **Sipas përlllogaritjet së grupit të auditimit:**

Tokë bujqësore:  $0.4030 \text{ ha} * 5,000 \text{ lekë/ha/vit} = 2,015 \text{ lekë/vit}$

Llogaritur sipas përcaktimeve të Vendim Nr. 373, datë 20.6.2018 “Për Përcaktimin e Kritereve, të Rregullave, Procedurave dhe Kontratës Tip për Dhënien me qira të Tokave Bujqësore në Pronësi të Shtetit. Kapitulli V pika 1.

Troje:  $6190 \text{ m}^2 * 100 \text{ lekë/m}^2/\text{muaj} = 619,000 \text{ lekë} * 12 \text{ muaj} = 7,428,000 \text{ leke/vit}$

Llogaritur sipas përcaktimeve të VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 Për Përcaktimin e Kritereve, të Procedurës e të Mënyrës së Dhënies me Qira, Enfiteozë apo Kontrata të Tjera të Pasurisë

Shtetërore konkretish: Kreu III Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me Qira ose Enfiteozë pika 2 ku citohet *“Kur jepet me qira truall i lirë, pra kur jepet me qira ose enfiteozë vetëm truall, tarifa dysheme e qirasë mujore është 100 lekë/m<sup>2</sup>”*.

**Total qira = 7,430,015 lekë qira për sipërfaqe të dhënë në përdorim.**

Sa më sipër kemi:

$(7,430,015 \text{ lekë} * 2 \text{ vite}) = 14,860,030 \text{ lekë}$ . (1 muaj 7,430,015 lekë/12) = 619,168 lekë.

-Gjithsej diferencë e krijuar **15,479,198 lekë**, të cilat përbëjnë ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 154 dhe 296 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010. VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 Për Përcaktimin e Kritereve, të Procedurës e të Mënyrës së Dhënies me Qira, Enfiteozë apo Kontrata të Tjera të Pasurisë Shtetërore konkretish: Kreu III Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me Qira ose Enfiteozë pika 2 ku citohet *“Kur jepet me qira truall i lirë, pra kur jepet me qira ose enfiteozë vetëm truall, tarifa dysheme e qirasë mujore është 100 lekë/m<sup>2</sup>”*. Vendim Nr. 373, datë 20.6.2018 “Për Përcaktimin e Kritereve, të Rregullave, Procedurave dhe Kontratës Tip për Dhënien me qira të Tokave Bujqësore në Pronësi të Shtetit. Kapitulli V pika 1.

-Sa më sipër mbajnë përgjegjësi konceptuesin e amendamentit të kontratës znj. P.P me detyrë ish/ përgjegjëse e sektorit juridik dhe prokurimeve dhe z. F.T Kryetar i Bashkisë Fushë Arrëz në cilësinë e Nëpunësit Autorisues dhe nënshkrues i kontratës.

#### **4. HEC – Iballe 1, 2, S 1, 2, Berishe, Liqeni. Për periudhën 2020 dhe 2021, i shtrijnë efektet 1 kontrata, si më poshtë vijon:**

-Kontratë qiraje nr.226 prot, datë 28.01.2020 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z.F.T dhe qiramarrësi shoqëria "NSE" shpk përfaqësuar nga administratori z. B.M.

-VKB nr.67, datë 20.06.2019 “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor për ndërtimin e HEC-it NSE nga subjekti "NSE" shpk me afat 1 vite.

-Me shkresën nr. 2141 prot, datë 11.07.2019 Bashkia Fushë Arrëz i ka dërguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Sektorit të Kadastrës dhe Shërbimit Këshillimor Raportin Tekniko-Ekonomik sipas Akt-Miratimit i përpiluar nga grupi i punës z. Z.A, z. A.D dhe z. D.E konfirmuar nga Drejtori z. Gj.Gj dhe Kryetari i Bashkisë z. F.T

Afati i kontratës : 28.01.2020-27.01.2021 (1 vite).

-Vlera e kontratës: 12,442,221 lekë, nga të cilat 12,200,594 lekë qira dhe 241,627 lekë lënda drusore, që paguhet vetëm në njëherë e parë të kontratës;

#### **I. Përlllogaritjet e Bashkisë Fushë Arrëz sipas raportit teknik:**

-Shtrirje tubacionesh 14.93975 km trungishte \* 240,000 lekë/km/1 vit = 3,585,540 lekë;

-Shtrirje tubacionesh 22.39539 km cungishte \* 190,000 lekë/km/1 vit = 4,255,124 lekë;

-Shtrirje tubacionesh 0.8644 km kullotë \* 190,000 lekë/km/1 vit = 164,236 lekë;

-Shtrirje tubacionesh 1.2563 km djer \* 160,000 lekë/km/1 vit = 201,008 lekë;

-Shtrirje tubacionesh 6.98384 km induktive \* 150,000 lekë/km/1 vit = 1,047,576 lekë;

-Linjë elektrike 10.6023 km trungishte \* 240,000 lekë/km/1 vit = 2,544,552 lekë;

-Linjë elektrike 1.1947 km cungishte \* 190,000 lekë/km/1 vit = 226,993 lekë;

-Linjë elektrike 0.6590 km kullotë \* 190,000 lekë/km/1 vit = 125,210 lekë;

-Linjë elektrike 0.3357 km induktive \* 150,000 lekë/km/1 vit = 50,355 lekë;

**Total qira = 12,442,221 lekë qira për sipërfaqe të dhënë në përdorim.**

-Sa më sipër rezulton se tarifat e aplikuara nga grupi i punës janë në përputhje me tabelën nr.11 në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, si dhe afatin e dhënies në përdorim përcaktuar në VKB nr.67, datë 20.06.2019.

## **II. Përlogaritjet e grupit të auditimit:**

-Nga shqyrtimi i kontratë qiraje nr.226 prot, datë 28.01.2020 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z.F.T dhe qiramarrësi shoqëria "NSE" shpk përfaqësuar nga administratori z. B.M.

Rezultoni se periudha 28.01.2021 – 31.12.2021, ose 11 muaj, është e pa mbuluar me kontratë qiraje dhe për pasojë ndaj subjektit nuk është lidhur kontratë qiraje, për të cilën mbanë përgjegjësi z.GJ.GJ, ish-Drejtori i DSHP Fushë Arrëz, pasi prej tij duhet të ishin marrë masat e nevojshme që subjekti mos të përdorte pyjor/kullosor pa kontratë qiraje.

Sa më sipër kemi:

Vlera e kontratës: 12,442,221 lekë, nga të cilat 12,200,594 lekë qira dhe 241,627 lekë lënda drusore, është e pa likuiduar.

$(12,200,594 \text{ lekë} * 11 \text{ muaj}) = 11,958,967 \text{ lekë}$

-Gjithësej diferencë e krijuar **24,401,188 lekë**, të cilat përbëjnë ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 154 dhe 296 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

- *-Sa më sipër mbajnë përgjegjësi z.Gj.Gj me detyrë Drejtor i Drejtorisë së shërbimit Pyjor për periudhën 2018-2021 objekt auditimi, znj. P.P me detyrë ish/ Përgjegjëse e sektorit juridik dhe prokurimeve dhe znj A.D, me detyr ish/përgjegjëse e Sektorit Tatim-Taksa për periudhën 18.12.2019 deri me 18.05.2021.*

## **5. HEC A. Për periudhën 2018 dhe 2021, i shtrijnë efektet 1 kontrata, si më poshtë vijon:**

-Kontratë qiraje nr. 1779 prot, datë 24.07.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z.F.T dhe qiramarrësi shoqëria "A" shpk.

-VKB nr.57, datë 25.04.2018 “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor për ndërtimin e HEC-it - A nga subjekti "A shpk” me afat 2 vite.

-Me shkresën nr. 1420 prot, datë 14.06.2017 Bashkia Fushë Arrëz i ka dërguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Sektorit të Kadastrës dhe Shërbimit Këshillimor Raportin Tekniko-Ekonomik sipas Akt-Miratimit nr. 1379 datë 12.06.2017 përpiluar nga grupi i punës z. Z. A, z. A.D dhe z. D.E konfirmuar nga Drejtori z. Gj.Gj dhe Kryetari i Bashkisë z. F.T Afati i kontratës : 24.07.2017-23.07.2019 (2 vite).

-Vlera e kontratës viti I: 1,948,420 lekë, nga të cilat 1,890,418 lekë qira dhe 58,000 lekë lënda drusore, që paguhet vetëm në vitin e parë të kontratës;

-Vlera e kontratës II: 1,890,418 lekë/viti

## **I. Përlogaritjet e Bashkisë Fushë Arrëz sipas raportit teknik:**

-Shtrirje tubacionesh 2.669 km shkurre \* 176,000 lekë/km/2-5 vite = 469,744 lekë;

-Linjë elektrike 5.971 km shkurre \* 184,000 lekë/km/2-5 vite = 1,089,664 lekë;

-Rrugë 1.482 km shkurre \* 35,000 lekë/km/2-5 vite = 51,870 lekë;

-Shtrirje tubacionesh 0.867 km induktive \* 145,000 lekë/km/2-5 vite = 125,715 lekë;

-Linjë elektrike 0.838 km induktive \* 150,000 lekë/km/2-5 vite = 125,700 lekë;

-Rrugë 0.749 km induktive \* 25,000 lekë/km/2-5 vite = 18,725 lekë;

**Total qira = 1,890,418 lekë qira për sipërfaqe të dhënë në përdorim.**

-Sa më sipër rezulton se tarifat e aplikuara nga grupi i punës janë në përputhje me tabelën nr.11 në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, si dhe afatin e dhënies në përdorim përcaktuar në VKB nr.57, datë 25.04.2018.

## **II.Përlogaritjet e grupit të auditimit:**

-Nga shqyrtimi i kontratë qiraje nr. 1779 prot, datë 24.07.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z.F.T dhe qiramarrësi shoqëria "A" shpk.

Rezultoni se periudha 23.07.2019 – 31.12.2021, ose 2 vite e 4 muaj është e pa mbuluar me kontratë qiraje dhe për pasojë ndaj subjektit nuk është lidhur kontratë qiraje, për të cilën mbanë përgjegjësi z.GJ.GJ, ish-Drejtori i DSHP Fushë Arrëz, pasi prej tij duhet të ishin marrë masat e nevojshme që subjekti mos të përdorte pyjor/kullosor pa kontratë qiraje.

Sa më sipër kemi:

**(1,890,418 lekë \* 2 vite e 4 muaj) = 4,017,138 lekë.**

-Gjithsej diferencë e krijuar **4,017,138 lekë**, të cilat përbëjnë ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 154 dhe 296 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

- *Sa më sipër mbajnë përgjegjësi z.Gj.Gj me detyrë Drejtor i Drejtorisë së shërbimit Pyjor për periudhën 2018-2021 objekt auditimi, znj. P.P me detyrë ish/ Përgjegjëse e sektorit juridik dhe prokurimeve dhe znj A.D, me detyrë ish/përgjegjëse e Sektorit Tatim-Taksa për periudhën 18.12.2019 deri me 18.05.2021.*

## **6. HEC Q 1. Për periudhën 2018 dhe 2021, i shtrijnë efektet 1 kontrata, si më poshtë vijon:**

-Kontratë qiraje nr.1653 prot, datë 07.07.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z.F.T dhe qiramarrësi shoqëria "L.I" shpk përfaqësuar nga administratori z. TH.S.

-Me shkresën nr. 1918 prot, datë 01.16.2017 Bashkia Fushë Arrëz i ka dërguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Sektorit të Kadastrës dhe Shërbimit Këshillimor Raportin Tekniko-Ekonomik sipas Akt-Miratimit nr. 959 datë 24.04.2017 përpiluar nga grupi i punës z. Z.A, z. A.D dhe z. D.E konfirmuar nga Drejtori z. Gj.Gj dhe Kryetari i Bashkisë z. F.T Afati i kontratës : 07.07.2017-06.07.2019 (2 vite).

-Vlera e kontratës viti I: 1,202,189 lekë, nga të cilat 1,111,440 lekë qira dhe 97,749 lekë lënda drusore, që paguhet vetëm në vitin e parë të kontratës;

-Vlera e kontratës II: 1,111,440 lekë/viti

### **I. Përlogaritjet e Bashkisë Fushë Arrëz sipas raportit teknik:**

-Shtrirje tubacionesh 2.0120 km trungishte \* 220,000 lekë/km/2-5 vite = 442,640 lekë;

-Shtrirje tubacionesh 3.8000 km cungishte \* 176,000 lekë/km/2-5 vite = 668,800 lekë;

**Total qira = 1,111,440 lekë qira për sipërfaqe të dhënë në përdorim.**



-Sa më sipër rezulton se tarifat e aplikuara nga grupi i punës janë në përputhje me tabelën nr.11 në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar,

## **II.Përlllogaritjet e grupit të auditimit:**

-Nga shqyrtimi i kontratë qiraje nr.1653 prot, datë 07.07.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z. F.T dhe qiramarrësi shoqëria "L.I" shpk përfaqësuar nga administratori z. TH.S.

Rezulton se periudha 06.07.2019 – 31.12.2021, ose 2 vite e 4 muaj është e pa mbuluar me kontratë qiraje dhe për pasojë ndaj subjektit nuk është lidhur kontratë qiraje, për të cilën mbanë përgjegjësi z.GJ.GJ, ish-Drejtori i DSHP Fushë Arrëz, pasi prej tij duhet të ishin marrë masat e nevojshme që subjekti mos të përdorte pyjor/kullosor pa kontratë qiraje.

Sa më sipër kemi:

$(1,111,440 \text{ lekë} * 2 \text{ vite e 4 muaj}) = 2,361,810 \text{ lekë.}$

-Gjithsej diferencë e krijuar **2,361,810 lekë**, të cilat përbëjnë ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 154 dhe 296 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

- *-Sa më sipër mbajnë përgjegjësi z.Gj.Gj me detyrë Drejtor i Drejtorisë së shërbimit Pyjor për periudhën 2018-2021 objekt auditimi, znj. P.P me detyrë ish/ Përgjegjëse e sektorit juridik dhe prokurimeve dhe znj A.D, me detyrë ish/përgjegjëse e Sektorit Tatim-Taksa për periudhën 18.12.2019 deri me 18.05.2021.*

## **7. HEC K 3, 4, 5. Për periudhën 2018 dhe 2021, i shtrijnë efektet 1 kontrata, si më poshtë vijon:**

-Kontratë qiraje nr.1652 prot, datë 07.07.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z.F.T dhe qiramarrësi shoqëria "O.B" shpk përfaqësuar nga administratori znj. O.B.

-VKB nr.52, datë 25.04.2018 “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor për ndërtimin e HEC-it B nga subjekti "O.B" shpk” me afat 1 vite.

-Me shkresën nr. 1066 prot, datë 05.05.2017 Bashkia Fushë Arrëz i ka dërguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Sektorit të Kadastrës dhe Shërbimit Këshillimor Raportin Tekniko-Ekonomik sipas Akt-Miratimit nr. 765 datë 04.04.2017 përpiluar nga grupi i punës z. Z.A, z. A.D dhe z. D.E konfirmuar nga Drejtori z. Gj.Gj dhe Kryetari i Bashkisë z. F.T  
Afati i kontratës : 07.07.2017-06.07.2018 (1 vit).

-Vlera e kontratës viti: 2,487,057 lekë, nga të cilat 1,936,446 lekë qira dhe 556,611 lekë lënda drusore, që paguhet vetëm në vitin e parë të kontratës; sipas dokumentacionit të vënë ne dispozicion rezulton se subjekti O.B Shpk ka likuiduar detyrimet deri me 06.07.2018.

### **I. Përlllogaritjet e Bashkisë Fushë Arrëz sipas raportit teknik:**

-Shtrirje tubacionesh 6.2466 km trungishte \* 240,000 lekë/km/1 vit = 1,499,184 lekë;

-Rrugë 6.2466 km trungishte \* 70,00 lekë/km/1 vit = 437,262 lekë;

**Total qira = 1,936,446 lekë qira për sipërfaqe të dhënë në përdorim.**

-Sa më sipër rezulton se tarifat e aplikuara nga grupi i punës janë në përputhje me tabelën nr.11 në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, si dhe afatin e dhënies në përdorim përcaktuar në VKB nr.52, datë 25.04.2018.

## **II.Përlllogaritjet e grupit të auditimit:**

-Nga shqyrtimi i kontratë qiraje nr. 1652 prot, datë 07.07.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z. F.T dhe qiramarrësi shoqëria "O.B" shpk përfaqësuar nga administratori znj. O.B.

Rezulton se periudha 06.07.2018 – 31.12.2021, ose 3 vite e 4 muaj është e pa mbuluar me kontratë qiraje dhe për pasojë ndaj subjektit nuk është lidhur kontratë qiraje, për të cilën mbanë përgjegjësi z.GJ.GJ, ish-Drejtori i DSHP Fushë Arrëz, pasi prej tij duhet të ishin marrë masat e nevojshme që subjekti mos të përdorte pyjor/kullor pa kontratë qiraje.

Sa më sipër kemi:

(1,936,446 lekë \* 3 vite e 4 muaj) = 6,051,394 lekë.

-Gjithsej diferencë e krijuar **6,051,394 lekë**, të cilat përbëjnë ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 154 dhe 296 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja "g" në pikën 1 në nenin 17, shkronja "c" e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja "a" e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 "Për pyjet"; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën "a" të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

- *-Sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. Gj.Gj me detyrë Drejtor i Drejtorisë së shërbimit Pyjor për periudhën 2018-2021 objekt auditimi, znj. P.P me detyrë ish/ Përgjegjëse e sektorit juridik dhe prokurimeve dhe znj A.D, me detyrë ish/përgjegjëse e Sektorit Tatim-Taksa për periudhën 18.12.2019 deri me 18.05.2021.*

**Kriteri:** Nenet 83, 154, 296, 663 dhe 678 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja "g" në pikën 1 në nenin 17, shkronja "c" e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja "a" e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 "Për pyjet"; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën "a" të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar; Neni 35 në Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Pika 11 në nenin 2 në Kreun I në Ligjin nr.8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010; Pikat 5 dhe 6 në Kreun I, shkronja "c" në pikën 15, pika 4 në Kreun II, si dhe shkronja "c" në pikën 1 në Kreun III në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", e ndryshuar;

**Ndikimi/efekti:** Të ardhura të munguara në vlerën 45,514,301 lekë.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës **53,839 mijë lekë**.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Sektori Juridik, në kushtet e konstatimit të mungesës së kompetencës lëndore për procesin e zhvillimit të procedurës dhe lidhjes së kontratës, të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për shpalljen absolutisht të pavlefshme të Amendimit të kontratës së qirasë nr.2718 prot, datë 07.11.2017 me qiramarrësin shoqëria "A 2014" Sh.P.K.

➤ *Subjektet që ushtrojnë aktivitet në Fond Pyjor dhe kullor të cilët janë pajisur me leje minerare.*

**Titulli i gjetjes:** Bashkia **Fushë Arrëz** nuk ka vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare (**për aktivitet shfrytëzim Bakri, Kromi etj...**) dhe leje koncesionare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë si dhe nga Ministria e Mjedisit, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi.

**Situata:** Nga të dhënat e siguruar nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me leje minerare sipas regjistrimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se përgjatë periudhës 2020-2021, në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz, kanë ushtruar aktivitet në sektorin e kërkimit, zbulimit, prodhimit të minerareve 10 subjekte me sipërfaqe 11.475 Km<sup>2</sup>, për të cilat NSHP Bashkia Fushë Arrëz nuk administron dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj), sipas aneksit nr. 5 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin kullor”, pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”

**Kriteri:** Nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin kullor”, pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”

**Impakti:** Nuk jep siguri të mjaftueshme për përmbushjen dhe zbatimin e ligjit për funksionin dhe detyrat që ka.

**Shkaku:** Nga neglizhenca dhe nga mos këmbëngulja në zbatimin e ligjit, për mos mbledhjen dhe arkëtimin e kësaj tarife.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e shërbimit Pyjor t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohej Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

**Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

1. z.Gj.Gj me detyrë ish Drejtor i Drejtorisë së shërbimit Pyjor për periudhën 2018-2021
2. znj.A.D, me detyrë ish/përgjegjëse e Sektorit Tatim-Taksa për periudhën 18.12.2019 deri me 18.05.2021.
3. z.V.P, me detyrë ish/përgjegjësi i Sektorit Tatim-Taksa, për periudhën 25.05.2021 e në vijim.

### **III.2.3. Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

Për të arritur në opinionin, nëse pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2021, konkretisht:

**Pasqyrat Financiare të vitit 2021.**

- Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2021 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:
  - Pasqyrat financiare të vitit 2021;
  - Centralizatori;
  - Ditari i Bankës;
  - Ditari i Arkës;
  - Ditari i Magazinës;
  - Ditari i Pagesave;
  - Ditari i Veprimeve të ndryshme;
  - Aktrakordimet me Degën e Thesarit Pukë;
  - Inventarët etj.

Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit ushtrimor 2021 janë hartuar dhe depozituar më datën 24.03.2022 në Degën e Thesarit Pukë.

**Dokumentimi i rezultateve të auditimit:** Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm dhe i mbështetur në testet e kontrollit dhe testet thelbësore të transaksioneve për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

**Përputhshmëria me kërkesat ligjore për Raportimin Financiar:** Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në Bashkinë Fushë Arrëz, është realizuar në mbështetje të kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara. Pasqyrat financiare janë plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe formatet e miratuara nga Ministria e Financave.

### **Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare.**

#### ▪ **Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2021 janë:**

- Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
- Pasyra e performancës financiare (F2);
- Pasqyra e flukseve monetare (F3);
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
- Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasyrat financiare (F5);

#### *Pasqyrat statistikore:*

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);

#### ▪ Gjithashtu në pasqyrat financiare është dhënë informacion mbi:

- Emrin e njësisë ekonomike raportuese, Bashkia Fushë Arrëz me NIPT K58811319A;
- Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2021-31.12.2021;
- Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
- Data e hartimit të Pasqyrave Financiare, 24.03.2022;
- Përgatitur nga z.D.L;
- Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Pukë me shkresën nr.828, datë 24.03.2022, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z. F.T.

Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Aktrakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Pukë të konfirmuara dhe nënshkruara nga NZ dhe NA i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Pukë.

**Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.**

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

b. Kontrollë të llogarive dhe dokumenteve.

Gjendja e llogarive të Pasqyrave Financiare të Bashkisë Fushë Arrëz paraqiten si më poshtë:

Llogaria	Emertimi	Ushtrimi i Mbyllur
<b>A</b>	<b>A K T I V E T</b>	<b>1,588,725,294</b>
	<b>I.Aktivët Afat shkurtër</b>	<b>387,893,290</b>
	<b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre</b>	<b>73,799,693</b>
520	Disponibilitete në Thesar	73,799,693
	<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>10,236,089</b>
32	Inventar i imet	9,772,624
35	Mallra	463,465
	<b>3.Llogari të Arketushme</b>	<b>295,078,675</b>
468	Debitore të ndryshëm	283,626,978
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	11,451,697
	<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>8,778,833</b>
473	Llogari e pritjes të mardhenieve me thesarin	8,778,833
	<b>II.Aktivët Afat gjatë</b>	<b>1,200,832,004</b>
<b>20</b>	<b>1.Aktive Afatgjatë jo materiale</b>	<b>23,960,531</b>
202	Studime dhe kërkime	23,960,531
<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjatë materiale</b>	<b>976,126,530</b>
211	Pyje, Plantacione	4,680,802
212	Ndertesë e Konstruksione	330,990,585
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	613,582,105
214	Instalime teknike, makineri e paisje	2,226,010
215	Mjete Transporti	7,055,463
218	Inventar ekonomik	17,591,565
	<b>4.Investime</b>	<b>200,744,943</b>
231	Per Aktive Afatgjatë materiale	200,744,943
<b>B</b>	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>314,778,102</b>
	<b>I.Pasivët Afat shkurtër</b>	<b>314,778,102</b>
	<b>1. Llogari të Pagushme</b>	<b>31,151,124</b>
401-408	Furnitore e llogari të lidhura me të	5,208,685
42	Detyrime ndaj personelit	12,067,315
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	396,691
435	Sigurime Shoqërore	2,246,513
436	Sigurime Shëndetsore	311,326
466	Kreditore për mjete në ruajtje	10,920,594
	<b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>283,626,978</b>
475	Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhese	283,626,978
<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	<b>1,273,947,192</b>
<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>	<b>1,273,947,192</b>
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,010,323,150
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	62,879,099
115	Nga Fondet e veta të investimeve	5,825,464
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	194,919,479
<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>1,588,725,294</b>

**1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)**

**Aktivët neto janë të barabarta me Aktivët-Pasivët = 314,778,102 lekë.**

- Aktivët 1,588,725,294 lekë
- Pasivët 314,778,102 lekë
- Aktivët neto 314,778,102 lekë

**Aktivi i Bilancit**

**Aktivët afatshkurtra**

Aktivët afatshkurtra më datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën **387,893,290 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 73,799,693 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 10,236,089 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 295,078,675 lekë dhe
- “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 8,778,833 lekë.

-Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 73,799,693 lekë, përbëhet nga: gjendja e fondeve në thesar më datë 31.12.2021 në shumën 62,879,099 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 10,920,594 lekë.

-Mjetet në ruajtje përbëhen nga ndalesat në masën 5 % të garancisë së punimeve.

-Gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar” sipas mbylljes së bilancit të vitit 2021 është në vlerën prej 73,799,693 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020 në vlerën prej 74,035,622 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” në vlerën 74,035,622 lekë dhe rubrikën VI “Teprica e Likujditeve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën 73,799,693 lekë. (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”)

#### Testimi i llogarisë nr.520

I.Të trashëguara nga viti 2020	Vlera (Lekë)
Sipas aktit të rakordimit për shumën. Nga të cilat:	
Granti i trashëguar	36,376,541
Të ardhura të trashëguara	22,395,564
Mjete në ruajtje të trashëguara (llog. 466)	15,263,517
<b>Totali</b>	<b>74,035,622</b>
<b>II.Të hyrat (Shtesat debitore) gjatë vitit 2021</b>	
Granti i vitit	84,794,726
Të ardhurat e vitit	15,034,536
Të hyra nga mjetet në ruajtje	651,777
Granti specifik	79,171,000
buxheti	97,291,700
<b>Totali</b>	<b>276,943,739</b>
<b>Totali i të ardhurave (I+II)</b>	<b>350,979,361</b>
<b>III.Lëvizjet kreditore të llogarisë 520 gjatë vitit 2021</b>	
Paga sigurime (600+601)	129,250,367
Shpenzime operative (602)	29,365,446
Transferime korente të brendshme (604)	100,000
Transferime për buxhetet familjare dhe individë (606)	97,077,561
Investime (231)	14,558,840
Të dala nga mjetet në ruajtje (466)	4,994,700
Transferime korente te brendshme + transfertat buxhetin e vet (418,470,743 +5,975,765)	1,832,754
Totali i shpenzimeve	<b>277,179,668</b>
<b>(I+II) - (III)</b>	<b>73,799,693</b>
<b>Totali</b>	

-Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Fushë Arrëz në 31.12.2021 paraqiten në vlerën 10,236,089 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 35 “Mallra” në vlerën 463,465 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Objekte inventari” në vlerën 9,772,624 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit, e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” (pasqyra F2 – performanca financiare) në shumën 1,463,885 lekë.

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Titullari i Bashkisë Fushë Arrëz ka nxjerrë Urdhrin nr.424, datë 26.11.2021.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Llogaria 4342 “Të tjera Operacione me shtetin (debitor)” paraqitet me gjendje në shumën 14,109,942 lekë në fund të vitit 2020, ndërsa në fund të vitit 2021 kjo llogari paraqitet në vlerën 11,451,697 lekë. Vlerat e mëposhtme përfaqësojnë detyrimet e muajit dhjetor të cilat likujdohen kryesisht në muajin janar të vitit 2022.

421	431	435	436	401-408		Shuma
Paga Dhjetor 21	Tatime	Sig.shoq	Sig shend	Shpenzime operative	Investime	2021
8,031,095	396,691	2,246,513	311,326	341,136		
				109,296		
				15,640		
8,031,095	396,691	2,246,513	311,326	466,072	0	11,451,697

- a. Tatim mbi pagë llogaria 6001 për vlerën 396,691 lekë.  
b. Paga dhe shtesa mbi pagë llogaria 6001 për vlerën 8,031,095 lekë.  
c. Sigurime shoqërore llogaria 6010/6011 për vlerën 2,246,513 lekë.  
d. Sigurime shëndetësore llogaria 6010/6011 për vlerën 311,326 lekë.  
e. Detyrime për shpenzime operative e mirëmbajtje për vlerën 466,072 lekë, konkretisht llogaria 6022. Tek kjo llogari është pasqyruar:  
- Pagesë për faturat e shërbimit të furnizimit me energji elektrike, për vlerën 341,136 lekë.  
- Pagesë për Ujësjet Sh.A për vlerën 109,296 lekë.  
- Pagesë për shërbime postare në shumën prej 15,640 lekë.

-Llogaria 486<sup>14</sup> “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2021 është në vlerën 8,778,833 lekë. Lëvizjet kreditore dhe debitore të kësaj llogarie pasqyrohen si më poshtë:

Llogaria 486	Viti 2021
Gjendja në fillim	10,873,896
Shtesa	538,360
Pakësime	2,633,423
Gjendja në fund	8,778,833

-Gjendja e llogarisë 202 “Studime e projekte” në fillim të vitit 2021 gjendet në vlerën 24,240,719 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 rezulton në vlerën 23,960,531 lekë.

Ndryshime në këtë llogari paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Objekti	Shtesa	Pakësime
Projekti Godina e Njesise Blerim fature nr 90 date 15.11.2021. N studio shpk ub 1550078	192,000	
Projektim I Rikonstruksion I shkolles Iballe		52,500
Projektim I Rikonstruksion I kanalit ujites Lagje Fushaxhi		322,428
Projekt "Ndertim bazamente ure auto Lagje Koprat, fshati Iballe dhe fshat Micoj		97,260
<b>Totali:</b>	<b>192,000</b>	<b>472,188</b>

Pakësimet janë projekte për investime në punë publike, për të cilat janë realizuar punimet, janë marrë në dorëzim dhe i janë shtuar objekteve përkatëse në llogaritë nr.212 dhe 213.

-Gjendja e llogarisë nr.211 “Pyje, Plantacione”, në fillim të vitit 2021 ka qenë në shumën 4,680,802 lekë, ndërsa në mbyllje të ushtrimit për vitin 2021 gjendet në të njëjtën vlerë 4,680,802 lekë, dhe përbëhet nga investime në pyje dhe arrorë.

-Gjendja e llogarisë nr.212 “Ndërtime e konstruksione” në çelje të vitit 2021 ka qenë në shumën 358,192,199 lekë (kosto historike, pra pa zbritur amortizimin). Për vitin 2021 kjo llogari gjendet në shumën 476,102,965 lekë, (kosto historike, pra pa zbritur amortizimin) siç shihet gjatë vitit 2021 kjo llogari ka pësuar ndryshime dhe konkretisht ka këto shtesa, si më poshtë:

Objekti	Shtesa
Rikonstruksion Ndertese Shkolla Mesme Qytet	68,434,067
Rikonstruksion Ndertesa Shkolla Fushe-Arrez Pjeter Arbnori	28,505,025
Rikonstruksion shkolla e bashkuar Iballe	20,971,674
<b>Totali:</b>	<b>117,910,766</b>

Vlera neto e kësaj llogarie (kosto historike + shtesa – pakësime) në fund të vitit 2021 është në vlerën 330,990,585 lekë.

-Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” në çelje të vitit 2021, ka qenë në shumën 729,063,652 lekë (kosto historike, pra pa zbritur amortizimin). Për vitin 2021 kjo

<sup>14</sup> Llogaria analitike pasqyrohet në Kapitullin “Aneksë” – “Aneksi nr.4” të raportit përfundimtar të auditimit.

Ilogari gjendet në shumën 741,055,152 lekë, (kosto historike, pra pa zbritur amortizimin) siç shihet gjatë vitit 2021 ka pësuar një rritje prej 11,991,500 lekë, përkatësisht:

Objekti	Vlera
Ndërtim bazamente Ura koprat dhe micoj	3,705,780
Kanele vaditese Njesia Fierze	3,991,806
Rikonstruksion Kanali Fushaxhi	4,293,914
<b>Totali:</b>	<b>11,991,500</b>

-Vlera neto e kësaj llogarie (kosto historike + shtesa – pakësime) në fund të vitit 2021 është në vlerën 613,582,105 lekë.

-Gjendja e llogarisë nr.219 “Amortizimi” në çelje të vitit 2021 gjendet në shumën -247,932,578 lekë, pas llogaritjes së amortizimit për aktivet që disponon Bashkia Fushë Arrëz dhe shtesat/pakësimet gjatë vitit 2021 kjo llogari gjendet në vlerën 293,827,414 lekë.

Llogaria	Gjendja ne fillim	Shtesa	Gjendja ne fund
219.21	-134,757,551	-11,214,726	-145,972,277
219.31	-95,810,383	-31,662,664	-127,473,047
219.41	-772,460	-161,930	-934,390
219.51	-7,376,147	-1,763,865	-9,140,012
219.81	-9,216,037	-1,091,651	-10,307,688

-Gjendja e llogarisë nr.231 “Investime për aktive afatgjata materiale<sup>15</sup>” në çelje të vitit 2021 gjendet në vlerën 287,303,156 lekë, gjatë vitit 2021 ka pasur shtesa në vlerën 14,366,840 lekë dhe pakësime në vlerën 100,925,053 lekë të kësaj llogarie dhe në total në fund vitit 2021 kjo llogari është vlerën 200,744,943 lekë.

### **Pasivi i Bilancit**

Shuma e llogarisë sintetike të klasës 4 “Detyrimet afatshkurtra” është e barabartë me gjendjen e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor) në aktivin e bilancit.

-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në fillim të vitit 2021 paraqitet në vlerën 3,410,092 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në shumën 5,431,343 lekë, ndryshe nga viti i kaluar kjo llogari ka një rritje pasi janë shtuar dhe detyrimet e prapambetura që vitin e kaluar ishin në llogarinë nr.467.

Emertimi i detyrimit	Shpenzime operative	Investime
Energji elektrike (OSHEE)	341,136	
Ujesjelles sha	109,296	
Poste	15,640	
J. Shpk		194,055
(Vllaznia ndërtim is ) U shpk		237,445
Pepa Group		144,624
(Vllaznia ndërtim is ) U shpk		2,280,502
Vendim gjykate per Alb prtrol		1,156,787
Vendim gjykate per D. P.		729,200
Vendim gjykate per Telekom Albania sha		222,658
<b>Totali:</b>	<b>466,072</b>	<b>4,965,271</b>

-Llogaria nr.42 “Detyrime ndaj personelit”, në mbyllje të vitit 2021 është në shumën 8,031,095 lekë, e cila përbëhet nga pagat e muajit dhjetor të vitit 2021.

-Llogaria nr.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, në mbyllje të vitit 2021 është në shumën 396,691 lekë, sipas listë-pagesave të muajit dhjetor të vitit 2021.

-Llogaria nr.435 “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” në mbyllje të vitit 2021 është në shumën 2,246,513 lekë, sipas listë-pagesave të muajit dhjetor të vitit 2021.

-Llogaria nr.436 “Sigurime shëndetësore” në mbyllje të vitit 2021 është në shumën 311,326 lekë, sipas listë-pagesave të muajit dhjetor të vitit 2021.

-Llogaria nr.466 “Kreditor për mjetet në ruajtje”, rakorduar me degën e thesarit, është analizuar analitikisht për çdo kreditor në lidhje me ngurtësimin e 5% të garancisë së punimeve të kryera për investime, në vlerën 10,920,594 lekë.

-Llogaria nr.470 “Llogari në pritje - të ardhura për tu marrë” paraqitet në vlerën 283,626,978 lekë në fund të vitit 2021 që lidhet me llogarinë e debitorëve nr.468.

<sup>15</sup> Llogaria analitike pasqyrohet në Kapitullin “Aneksë” – “Aneksi nr.4” të raportit përfundimtar të auditimit.



## Fondi i Konsoliduar

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën **1,273,947,192 lekë**. Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve me pasivet.

Nr. Llogarie	Përshkrimi	Viti 2021	Viti 2020
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	1,010,323,150	1,198,819,883
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati i Veprimtarise Ushtrimore	62,879,099	58,772,105
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve	5,825,464	5,825,464
15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime		
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	194,919,479	281,477,692
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim	0	0
109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0	0
	Te Tjera	0	0

-Pasqyra e performancës financiare dhe rezultati i ushtrimit i pasqyruar në llogarinë nr.85 për vlerën 62,879,099 lekë është e rakorduar me akt-rakordimin e mbajtur në degën e thesarit Pukë. Lëvizja e kësaj llogarie pasqyrohet si më poshtë.

Nr.	Emërtimi i veprimeve	Shuma në lekë
1	Grante të trashëguara nga 2020 (Kapitull 1)	36,376,541
2	Të ardhura të trashëguara nga 2020 (Kapitull 5)	22,395,563
3	Grant i Akorduar për vitin 2021	79,240,000
3/1	Shtesë Granti për 2021	5,554,726
4	Te ardhurat e vitit 2021	15,034,536
5	Transferta specifike për vitin 2021	79,171,000
	<b>Zbriten:</b>	
-	Shpenzimet faktike Grante (Kapitull 1)	75,621,647
-	Shpenzimet faktike Të ardhura (Kapitull 5)	21,738,289
-	Shpenzimet faktike Transferta specifike	77,533,332
	<b>Mbeten për përdorim në vitin 2022</b>	<b>62,879,099</b>

## Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale rezultoi:

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”.

**Situata:** Llogaria nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fillim të vitit 2021 është në vlerën 271,246,057 lekë dhe në fund të vitit 2021 është në vlerën 283,626,978 lekë, pra me një rritje të vlerës së debitorëve të Bashkisë Fushë Arrëz në vlerën 12,380,921 lekë.

Lëvizja e llogarisë 468			Viti 2021			
Viti	Bashkia/NJA	Përshkrimi	Gjendja 31.12.2020	Debi	Kredi	Mbetja
2011	Fushe Arrez	Tatim-taksa	3,326,420			3,326,420
2012	Fushe Arrez	Tatim-taksa	1,667,300			1,667,300
2013	Fushe Arrez	Tatim-taksa	1,910,220			1,910,220
2014	Fushe Arrez	Tatim-taksa	1,055,580			1,055,580
2015	Fushe Arrez	Tatim-taksa	1,267,850			1,267,850
2015	NJA	Te tjera	6,138,384			6,138,384
2016	Fushe Arrez	Tatim-taksa	1,035,244			1,035,244
2017	Fushe Arrez	Tatim-taksa	2,541,954			2,541,954
2017	KLSH	Ndalesa	230,425,169	2,155,259	12,984,075	241,253,985
2018	Fushe Arrez	Tatim-taksa	4,331,474	20,860		4,310,614
2019	Fushe Arrez	Tatim-taksa	3,776,613			3,776,613
2020	Fushe Arrez	Tatim-taksa	13,733,989			13,733,989
2021	Fushe Arrez	Tatim-taksa			1,571,635	1,571,635
2021	Kopeshti	Tarifa dhjetor	26,180	26,180	21,910	21,910
2021	Cerdhe	Tarifa dhjetor	9,680	9,680	15,280	15,280
			<b>271,246,057</b>	<b>2,211,979</b>	<b>14,592,900</b>	<b>283,626,978</b>

Nga verifikimi i listës analitike të debitorëve në fund të vitit 2021, konstatohet se nuk është kontabilizuar detyrimi i subjektit NSE në vlerën 13,686,443 lekë gjithësej, nga të cilat 12,442,221 lekë principal dhe 1,244,222 lekë kamatë-vonesë, sipas kontratës nr.226 prot., datë 28.01.2020 të lidhur me Bashkinë Fushë Arrëz, si dhe 397,309 lekë kamatë-vonesa për kategorinë biznes dhe institucione, të cilët nuk kanë likujtuar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore sipas afatit të përcaktuar në paketën fiskale, pasqyruar si më poshtë vijon:

Në fund të vitit 2020 (progresive)	Principal	Kamatë-vonesë		
		Shkalla	Ditë vonesë	Vlera
Biznesi i Madh	515,119	0.0006	365	112,811

Biznesi i Vogël	389,066	0.0006	365	85,205
Institucione	474,650	0.0006	365	103,948
<b>Krijuar brenda vitit 2021</b>				
Biznesi i Madh	306,100	0.0006	150	27,549
Biznesi i Vogël	218,635	0.0006	150	19,677
Institucione	534,650	0.0006	150	48,119

**Kriteri:** Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, shkronja “ë”, pika 3, neni 12;

Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c”.

**Ndikimi/Efekti:** Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë të përbërjes së debitorëve të Bashkisë Fushë Arrëz në fund të vitit 2021.

**Shkaku:** Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

**Situata:** Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Fushë Arrëz, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 10,920,594 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Pukë.

<b>Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"</b>	
Celje e vitit 2021	15,263,517
Kreditim	601,831
Debitim	4,801,279
<b>Gjendja në 31.12.2021</b>	<b>10,920,594</b>

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2021, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466<sup>16</sup>.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është mbivlerësuar për 6,016,237 lekë për vitin 2021.

**Kriteri:** Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”.

**Ndikimi/Efekti:** Llogaria nr. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

**Shkaku:** Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Financës në bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

<sup>16</sup> Llogaria 466 për garancitë që i ka kaluar afati, pasqyrohet në Kapitullin “Aneksë” – “Aneksi nr.4” të raportit përfundimtar të auditimit.

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimi e Llogarisë nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, vlera kontabël paraqitet në shumën 0 lekë.

**Situata:** Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “Ujësjellës Kanalizime Fushë Arrëz Sh.A” me NIPT K19629304M, u konstatua se Bashkia Fushë Arrëz zotëron 100% të aksioneve të kësaj shoqërie ose 122.100 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë secili, në total 122,100,000 lekë.

-Pra sa më sipër llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është nënvlerësuar me 122,100,000 lekë.

**Kriteri:** Urdhri i Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

VKM nr.660, datë 12.9.2007 “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve Njësive të Qeverisjes Vendore”.

VKM nr.63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu 3.1, pika 31, shkronja “b”, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Llogaria nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”.

**Situata:** Llogaria 215 “Mjete transporti” paraqet vlerën neto të mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Fushë Arrëz më datë 31.12.2021 në shumën 7,055,463 lekë. Llogaria analitike 215 e mjeteve të transportit me vlerë kontabël neto pasqyrohet si më poshtë:

Nr.	Emertimi	Vlera neto
1	Makine teknologjike	299,223
2	Njesia Qafe Mali	322,274
3	Njesia Fierze	556,799
4	Njesia Iballe	412,139
5	Njesia Blerim	418,400
6	Njesia Blerim	3,525
7	Fadrome (rruge rurale)	620,706
8	Zjarrfikse Mercedes Benz 2000 litershe	1,638,396
9	Furistrade Range Rover	2,016,000
10	Fouristrade Nisan	768,000

-Nga shqyrtimi llogarisë analitike të mjeteve të transportit, rezulton se kemi klasifikim të gabuar të disa makinerive në këtë llogari, si 1 makinë teknologjike dhe 1 fadromë për vlerën 919,930 lekë të cilat janë makineri dhe jo mjete transporti, si dhe duhet të klasifikohen në llogarinë 214, si dhe për këto makineri duhet të aplikohet normë tjetër amortizimi (5%).

**Kriteri:** Nomeklatura e llogarive të planit kontabël publik-instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune – llogaria 7-shifrore 2140240-Paisje dhe makineri për konstrukione (ndërtime); 2140260-Paisje pastrimi për rrugët; 2140320-Mjete dhe paisje të tjera teknike.

**Ndikimi/Efekti:** Llogaria nr. 215 “Mjete transporti”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

**Shkaku:** Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandim:** Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”.

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 202 “Studime dhe kërkime”.

**Situata:** Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llogaria nr. 202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 23,960,531 lekë në fund të vitit 2021.

Në fund të vitit 2021 sipas formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” llogaria nr.202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në vlerën 23,960,531 lekë e pa ndryshuar edhe vlera kontabël neto në fund të vitit 2021 pra 23,960,531 lekë. Përgjatë vitit 2021 në këtë llogari ka pasur lëvizje debitore dhe kreditore, si rrjedhojë e shtesave gjatë vitit në vlerën 192,000 lekë (të cilat përfaqësojnë projekte për investime në punë publike të Bashkisë Fushë Arrëz) dhe pakësime në vlerën 472,188 lekë (të cilat përfaqësojnë debitimin e kësaj llogarie për vlerën e projekteve për investime në punë publike të përfunduara dhe të vendosura në përdorim).

Nga shqyrtimi i pasqyrës së aktiviteve afatgjata F7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, rezulton se për vitin 2021 nuk është kryer amortizimi i llogarisë nr.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 3,594,080 lekë (kosto historike + shtesa – pakësime) \* 15% sipas normës 15% për aktivet afatgjata jomateriale.

-Veç sa më sipër konstatohet se në këtë llogari janë të kontabilizuara projekte për investime të kryera, të përfunduara dhe sipas rastit të marra në dorëzim nëpërmjet aktkolaudimit të përfundimtar. Këto projekte të cilat duhet të ishin kontabilizuar rast pas rasti në objektin përkatës (llogaritë e klasës 2, ndërtesa, konstruksione, rrugë etj) si pjesë e kostos totale të tij janë si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi	Vlera
1	Rikonstruksion i kanalit ujites fshati lballe	2,542,826
2	Projekt "shtese pedonale+lulishte qytet fushe arrez"	200,892
3	Projket "Sistemim, asflatim, ndricim rruge auto lagje vjeter	104,424
4	Projekt per hapje rruge auto rurale Fshat Aprripe Guri, Njesia Fierze	1,827,000
5	Projekt per rindertimin e mureve mbajtese te shesheve te pallateve ne qytetin Fushe Arrez	611,309
6	Projektim I objektit hapje rruge auto strame aprripe guri	75,692
	<b>TOTAL</b>	<b>5,362,143</b>

**Kriteri:** Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, klasa 2 “Aktivet Afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël).

**Ndikimi/Efekt:** Llogaria nr. 202 “Studime dhe Kërkime”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

**Shkaku:** Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”.

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 231 “Investime në proces”.

**Situata:** Llogaria nr.231 “Investime në proces”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën prej 200,744,943 lekë, në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën prej 287,303,156 lekë, pra pakësuar në vlerën 86,558,213 lekë, të cilat përbëjnë kontabilizime (shtesa) në llogaritë e aktiveve afatgjata materiale. Nga auditimi i llogarisë analitike, konstatohet se llogaria 231 është mbivlerësuar për vlerën 197,608,607 lekë, e cila përfaqëson shpenzime për investime të përfunduara, për të cilat është bërë kolaudimi/marrja në dorëzim e përkohëshme (pra janë të shfrytëzueshme dhe në përdorim) por të pakapitalizuara në llogaritë e klasës 2 AAGJ pasqyruar si më poshtë:

Nr	Emertimi	Vlera
1	Ndërtim Shkolla 9 vjeçare Mzi	28,626,277
2	Pyllzime me drurë frutor	407,654
3	Rikonstruksion rruga Mzi	3,871,437
4	Rikonstruksion Ujësjellsi Kash Berishë vogël	4,548,788
5	Rikonstruksion rruga Dardhe	3,641,241
6	Efiçenca e energjië në pallatin 5-katësh në bashkpronësi	5,514,070
10	Zgjerim dhe rrethim varreza Fashti Dardhe S al shpk,UB 6177	3,438,274
12	Vendosje kamera sigurie në ambiente publike dhe Institucione në varësi të Bashkise Fushe Arrez R shpk .UB 6180	2,438,688
13	Blerje Kamioni O shpk , UB6180	2,988,000
14	Rikonstruksioni ndricimit qytet S al UB6235	997,290

15	Sistemim asfaltim rruge lagje e vjeter P G UB6259	3,692,678
16	Ndertim Shkolla Fierze V N is UB 6237	29,115,000
19	Kanele vaditese Njesia Fierze . J shpk UB 6190	6,911,340
20	Ndertim palestere te shkolla mesme P G UB6267	42,149,202
21	Rikonstruksion I kanalit Iballe P G, kod projekti 18AJ935, Ub 6271	29,749,673
23	Rikonstruksion i catisë së godinës së Ish Drejtorisë pyjore, Fushë Arrëz + supervizim dhe kolaudim.	749,911
24	Rikonstruksion mure mbajtese Fushe Arrez U shpk UB 6403	9,235,356
25	Rikonstruksion Shkolla Fierze V N is, U shpk UB 6240	3,226,068
28	Supervizim + Kolaudim ne shkollat iballe,Fierze,Fushe Arrez	825,002
29	Supervizim+kolaudim per objektin Ndertim I Palestres dhe ambienteve sportive Shkolla 70 vjetori I pavartesisë	478,693
30	Ndertim palestere te shkolla mesme P G UB6268	4,710,461
31	Riparim i pjesshem i pallatit 79 A shpk, kod projekti 1550087,fature 9 date 2.11.2021 .	827,280
33	Riparim qsh arstmiliska A shpk, kod projekti 1550082. fature 8 date 2.11.2021	398,330
34	Rikonstruksion mure mbajtese Fushe Arrez U shpk Fat. 53 dt. 09.11.2021 UB 6403 kod 1550069	4,220,784
35	kolaudim Rikonstruksion mure mbajtese Fushe Arrez M studio shpk Fat. 66 dt. 16.11.2021 kod 1550075	41,474
36	Mbikqyrje Ndertim i mureve mbajtese te pallate 1550074	184,000
37	Rikonstruksione te pjesshme ne objekte sherbimi ne fshatra(mulli bloje) kod 1550088 A	998,912
38	Hapje rruge Strame Apripe guri S Al, kod projekti 1550070, Ub 6447.fature 2200 date 11.8.2021	2,399,682
39	Kolaudim Hapje rruge re auto 1550073	5,760
40	Supervizim Hapje rruge re auto	49,574
41	Sistemim asfaltim dhe ndricim i rruges auto lagjia e vjetër në Qytetin Fushë Arrëz + supervizim dhe kolaudim P G.	52,494
42	Hapje segmenti lidhes rruga auto Dardhe A shpk, kod projekti 1550083.fature 10 date 2.11.2021	401,304
43	Supervizimin e objektit “Sistemim Asfaltim Ndricim i rruges lidhese pallati Demokracia”	87,126
44	Riparim I pjesshem Ura Shpoz A shpk, kod projekti 1550090.fature 7 date 19.10.2021	178,512
45	Riparim I pjesshem rruga auto Lumardh A shpk, kod projekti 1550091.fature 6 date 19.10.2021	235,872
46	Riparim Ura pasarele Fshat Flet A shpk, kod projekti 1550089.fature 14 date 9.11.2021	150,000
47	kolaudim Shtese pedonale dhe Lulishte . kod projekti 1550045, Ub 6447 R 95 shpk fature nr. 6 date 21.8.2021	26,400
48	Shtesë në pedonale dhe Lulishte në Qytetin Fushë Arrëz, + supervizim dhe kolaudim. P G	36,000

-Situata e mësipërme sjell edhe mosllogaritjen e amortizimit për aktivet afatgjata materiale.

**Kriteri:** Klasa 2 “Aktivet afatgjata”<sup>17</sup> në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Llogaria nr. 231 “Investime në proces”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

**Shkaku:** Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr.231 “Investime në proces” dhe llogarive nr. 213/212 sipas rastit, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë së aktivitet afatgjatë dhe në kredi të llogarisë së investimeve në proces.

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.210 “Toka, troje, terrene” dhe nr.211 “Pyje Plantacione”.

**Situata:**Gjendja e llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene” në fund të vitit 2021, paraqitet në vlerën 0 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie **konstatohet se nuk janë kontabilizuar:**

a)Vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj, sipas inventarit të aktiveve afatgjata materiale, të pasqyruar në llogarinë nr.212 “Ndërtime e konstruksione”.

b)Vlerat e trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Fushë Arrëz;

c)Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit;

d)Vlera e truallit të palestrës së shkollës 70-Vjetori i Pavarsisë, sipas lejes së ndërtimit, sheshi i ndërtimit me sipërfaqe  $458 \text{ m}^2 * 1,620^{18} \text{ lekë/m}^2 = 741,960 \text{ lekë}$ .

-Sa më sipër llogaria nr.210 është nënvlerësuar me vlerën **741,960 lekë**, vlerë e matshme.

<sup>17</sup> Hyrjet e AAGJM dokumentohen: Për blerjet, ku si dokumenta shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme). Për rrjedhim, Aktivet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”.

<sup>18</sup> Përcaktuar në VKM nr.89, datë 03.0.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH”.

-Gjendja e llogarisë nr.211 “Pyje, kullota, plantacione” në fillim të vitit 2021 paraqitet në vlerën 4,680,802 lekë, e pa ndryshuar dhe në fund të vitit 2021. Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera për pyllëzime, pasqyruar si më poshtë vijon:

Nr.	Emertimi	Vlera
1	Pyllëzim me arre dhe geshtenje	1,939,683
2	Njesia Qafe Mali	1,395,968
3	Njesia Fierze	0
4	Njesia Iballe	359,292
5	Njesia Blerim	985,859

Nga analiza e kësaj llogarie **konstatohet se nuk është kontabilizuar:**

-Vlera e 394 pronave me sipërfaqe 65,287,847 m<sup>2</sup> pyje e kullota, të cilat janë regjistruar në ish-ZVRPP Pukë, të evidentuara nga zyra e pyjeve e kullotave të bashkisë. Këto prona janë regjistruar në vitet 2012-2013 nga ish bashkia Fush Arrëz dhe ish Komuna Qaf Mali.

-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i pyjeve dhe kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.

-Në llogarinë nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Fushë Arrëz, të transferuara me VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, e ndryshuar, shtojca nr.49, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Fushë Arrëz, me numër rendor nga 1 deri 4242, ilustruar për:

-Ekonominë Pyjore Lumëbardhë, me sipërfaqe 3182.43 Ha/31.824.300 m<sup>2</sup> \* 100 lekë<sup>19</sup>/m<sup>2</sup>= 3,182,430,000 lekë.

-Për llogaritë e mësipërme në Bashkinë Fushë Arrëz nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.

**Kriteri:** Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 “Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë”; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap III, pika 30, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekt:** Llogaritë nr. 210 “Toka, troje, terrene” dhe nr. 211 “Pyje Plantacione”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve.

**Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme, për:

- Kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene” nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”.

- Hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi Përgjegjësi i Sektorit të Financës z. D.L.*

<sup>19</sup> Përcaktuar në VKM nr.89, datë 03.0.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.885/8 prot., datë 11.01.2023, konkretisht nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës, për sa më poshtë:

**Pretendimi i Subjektit:**

Debia e subjektit NSE është kontabilizuar në llogarinë nr.468, sipas shkresës së përcjellë nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore.

Llogaria 466 përbëhet nga garanci të punimeve në masën 5% dhe jo më tepër se kjo masë.

Për llogarinë nr.26, VKM nr.660, datë 12.09.2007 nuk ka transferuar ujësjellës tek NJQV Fushë Arrëz.

Për llogarinë nr.215, fadroma dhe makineria teknologjike janë mjete transporti dhe prandaj janë klasifikuar në llogarinë nr.215.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

-Sa i përket observacionit për llogarinë nr.468, sqarojmë se nga verifikimi i listës analitike të debitorëve për vitin 2021, ky subjekt nuk rezulton të jetë pasqyruar në këtë listë. Edhe po të bëjmë përlllogaritjet sipas vlerës së debitorëve në dokumentin bashkëlidhur observacionit me vlerën e kontabilizuar përsëri nuk rezulton të jetë kontabilizuar vlera e mësipërme. Konkretisht në PF vlera e debitorëve është 283,626,978 lekë, në listën analitike (subjekt dhe vlerë) të sjellë nga juve, vlera e debitorëve në fund të vitit është 277,451,404 lekë (pa përfshirë ish komunat, kopshtet dhe çerdhet), të cilat po ti shtohen vlerës 277,451,404 lekë, barazohet me vlerën 283,626,978 lekë. Pra nëse në listën analitike do të ishte edhe vlera e subjektit NSE, vlera e listës analitike të debitorëve do të ishte 291,137,847 lekë.

-Sa i përket observacionit tuaj për llogarinë nr.466, sqarojmë se nuk keni kuptuar mënyrën e të shprehurit, pra kur kemi thënë mbivlerësim, nuk konstatojmë se garancia e punimeve është mbajtur më tepër se 5%. Mbajtjen e garancisë në masën 5% e kemi pasqyruar edhe vetë përgjatë materialit, por mbivlerësimi ka të bëjë se për disa garanci punimesh është përmbushur afati dhe nuk duhet të jenë të kontabilizuara në llogarinë 466. Pra nuk jemi shprehur se masa e garancisë nuk është mbajtur në rregull, por që një pjesë e këtyre garancive duhet tu kthehet subjekteve përkatëse.

-Sa i përket observacionit tuaj për llogarinë nr.26, sqarojmë se aksionet të japin të drejta pronësie, duke vijuar me përcaktimin në pikën 1 të VKM nr.660, datë 12.09.2007, “Transferimin e aksioneve të shoqërive shtetërore të ujësjellësve dhe kanalizimeve në pronësi të njësisve të qeverisjes vendore, sipas lidhjeve 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi (në lidhjet 1 dhe 2, pasqyrohen aksionet në % të cilave u janë transferuar disa ish komunave, aktualisht NJA të Bashkisë Fushë Arrëz”.

Me VKM nr.63 datë 27.1.2016, në pikën 3 dhe 4 përcaktohet “Bashkive u transferohen aksionet e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve sh.a., aktuale, në pronësi të ish-njësive të qeverisjes vendore të shkrira, sipas ndarjes së re administrative-territoriale. Bashkitë ndjekin procedurat e kalimit të aksioneve në përputhje me këtë vendim dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Në ato bashki, ku ka njësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, të cilat nuk kanë qenë të organizuara në formën e shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, bashkia, brenda datës 31 dhjetor 2016, është përgjegjëse për inventarizimin fizik, vlerësimin dhe regjistrimin e këtyre njësive të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., në pronësi të bashkisë, sipas ndarjes administrativoterritoriale”.

Në vijim të sa më sipër, parashtrojmë edhe përcaktimet e bëra në udhëzimin për përgatitjen e pasqyrave financiare

Llogaria 26 “Pjesëmarrje me kapitalin e vet” dallohet sipas llojeve të pjesëmarrjes si:

265 “Pjesëmarrje në ndërmarrjet publike jofitimprurëse”;

266 “Pjesëmarrje në institucionet financiare”;

267 “Pjesëmarrje në joint venture”;

269 “Pjesëmarrje në të tjera”.

a) Regjistrimi kontabël që lidhet me llogarinë 26 është si më poshtë:

Debitohen analizat e llogarisë 26 “Pjesëmarrje me kapitalin e vet”; dhe Kreditohen llogaritë financiare (klasa 5), për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

-Sa i përket observacionit tuaj për llogarinë 215, referojuni përcaktimeve të bëra nën 58 të Ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Urdhrit Nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, për të kuptuar se çfarë është makina teknologjike dhe fadroma.

-Për observacionin tuaj se nuk ka vlerë trualli dhe se kjo vlerë kontabilizohet në momentin që ka certifikatë pronësie, sqarojmë se vlera tokës truall, bujqësore, kullot dhe pyll, është përcaktuar me VKM nr.89, datë 03.0.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH” dhe për këtë ngrihet një grup pune, duke bërë matjen e sipërfaqes së truallit nën objekt ose jo, vlerësohet me çmimin referenc dhe pasqyrohet në kontabilitet. Sa i përket argumentit se duhet certifikatë që të bëhet kontabilizimi, sqarojmë se certifikata e pronësisë që lëshohet nga DVASHK është akt kadastral<sup>20</sup> që lëshohet për çdo pronar, pran nuk të jep pronësi, por vërteton që je pronar i një pasurie, pronësinë e të cilës e ke fituar me Ligj, VKM, vendim gjyqi, leje ndërtimi, leje legalizimi, AMTP, etj vendim kthim prone, (dokumente që të japin të drejtën e pronësisë) etj. Ju keni detyrimin që të kontabilizoni çdo pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme që keni të drejtat e pronësisë mbi ato.

### **III.2.4. Mbi planifikimin dhe zbatimin procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave për investime në punë publike.**

#### ***4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.***

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësi vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

#### ***4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.***

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operojnë në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon:*

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Fushë Arrëz (*regjistrat e parashikimit dhe realizmit*), për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2021, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

<b>Procedura 01/01/2019 - 31/12/2021</b>	<b>Nr.</b>	<b>Vl.Fond Limit</b>	<b>Vl.Kontrate</b>
<b>G.JITHESEJ</b>	<b>27</b>	<b>139,854,964</b>	<b>134,527,731</b>
-Të hapura	2	65,768,489	63,384,934
-Negocim me shpallje	1	2,439,840	2,419,950
- Kërkesë me propozim/E Hapur e Thjeshtuar	24	71,646,635	68,722,847
<b>Sipas objekteve</b>	<b>27</b>	<b>139,854,964</b>	<b>134,527,731</b>
-Objekte në fushën e investimeve	10	99,179,580	96,263,842
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	17	40,675,384	38,263,889

Burimi: Sektori i prokurimeve, përpunuar nga grupi i auditimit

<sup>20</sup> Certifikata e pronësisë është dokumenti unik i papërsëritshëm që provon titullin e pronësisë, statusin ligjor dhe kufijtë e pronës.



Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2021, janë realizuar gjithsej **27** procedura me fond limit 139,854 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 134,527 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 5,327 mijë lekë ose 3.9%, nga e cila, për **vitin 2019** janë realizuar gjithsej **12** procedura me fond limit 98,402 mijë lekë dhe vlerë kontrate 94,548 mijë lekë, për **vitin 2020** janë realizuar gjithsej **9** procedura me fond limit 27,635 mijë lekë dhe vlerë kontrate 26,601 mijë lekë dhe për **vitin 2021** janë realizuar **6** procedura me fond limit 13,817 mijë lekë dhe vlerë kontrate 13,377 mijë lekë.

Kanë marrë pjesë në procedura **66** OE/BOE dhe janë s'kualifikuar **34** OE/BOE ose 51%.

Sipas llojit të aktivitetit, konstatohet se në fushën e ndërtimit (investime), janë **10** procedura me fond limit 99,179 mijë lekë ose 71% e kontratave të lidhura dhe në të tjera janë **17** procedura me fond limit 40,675 mijë lekë.

Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **11** procedura ose 40.7% e procedurave të zhvilluara, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë 24 procedura, ose 88.8% e tyre, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuar nga AK Bashkia Fushë Arrëz janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të operatorëve të kualifikuar.

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **241** OE/BOE, nga të cilat janë s'kualifikuar **80** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **9** procedura ose 18.3 % e procedurave të zhvilluara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH'së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, përzgjedhi për auditim 19 procedura gjithësej, si vijon:

-9 procedura prokurimi për vitin 2019 me vlerë kontrate 91,638,506 lekë, ose 95% të fondit të kontratave të lidhura për vitin 2019;

-5 procedura prokurimi për vitin 2020 me vlerë kontrate 21,728,361 lekë, ose 75% të fondit të kontratave të lidhura për vitin 2020;

-5 procedura prokurimi për vitin 2021 me vlerë kontrate 16,915,794 lekë, ose 70% të fondit të kontratave të lidhura për vitin 2021.

## **Viti 2019**

1. “Blerje karburanti për nevojat e bashkisë Fushë Arrëz për vitin 2019” me fond limit 4,989,167 lekë.

2. “Ndërtim bazamente të urave Auto Lagjja Koprat, fshati Iballë dhe fshati Micoj” me fond limit 3,078,734 lekë.

3. “Shtesë në pedonale + lulishte në Qytetin Fushë Arrëz” me fond limit 5,833,253 lekë.

4. “Sistemim, Asfaltim, Ndriçim i Rrugës Auto Lagjja e Vjetër në Qytetin Fushë Arrëz” me fond limit 3,165,586 lekë.

5. “Ndërtim i Palestrës dhe Ambienteve Sportive, Shkolla 70-Vjetori i Pavarësisë” me fond limit 41,295,043 lekë.

6. “Rikonstruktion i kanalit, fshati Iballë” me fond limit 24,473,446 lekë.

7. “Blerje lënde djegëse për ngrohje në Shkolla, Kopsht, Çerdhe për vitin 2019” me fond limit 1,738,800 lekë.

8. “Rikonstruktion i kanalit ujitës, lagjja Fushaxhi” me fond limit 3,429,985 lekë.

9. “Shërbime projektimi për projekte të financuara nga Bashkia Fushë - Arrëz” me fond limit 7,034,166 lekë.

## **Viti 2020**

10. “Ndërtim i mureve mbajtës të pallateve në Qytetin Fushë-Arrëz (Faza I-rë)” me fond limit 11,666,666 lekë.
11. “Hapje rruge e re auto Strame –Aprripe Guri” me fond limit 2,083,333 lekë.
12. “Blerje lëndë djegëse për ngrohje për vitin 2020” me fond limit 1,702,980 lekë.
13. “Blerje lëndë djegëse për ngrohje për vitin 2021” me fond limit 1,634,540 lekë.
14. “Blerje pjesë këmbimi për mjetet për vitin 2020” me fond limit 1,264,166 lekë.

### **Viti 2021**

15. “Blerje karburanti për nevojat e bashkisë, Fushë-Arrëz për vitin 2020” me fond limit 5,056,666 lekë.
16. “Blerje karburanti për nevojat e bashkisë, Fushë-Arrëz për vitin 2021” me fond limit 5,056,666 lekë.
17. “Mirëmbajtje në kanale vaditëse në Njësitë Administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz” me fond limit 1,510,618 lekë.
18. “Ndërtim i shpatullave të urave auto Koprart dhe Micoj” me fond limit 2,642,916 lekë.
19. “Ndërtim i godinës së Njësisë Administrative Blerim” me fond limit 4,708,333lekë.

*Nga auditimi i procedurave të prokurimit të mësipërme u konstatuan mangësi në procedurat si më poshtë vijon<sup>21</sup>:*

### **1.Tenderi me objekt: “Blerje karburanti për nevojat e bashkisë Fushë Arrëz për vitin 2019”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburant për nevojat e bashkisë, Fushë-Arrëz për vitin 2019”</b>		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.34, datë 06.03.2019	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.34, datë 06.03.2019 1. L.Gj – Juriste	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.07, datë 11.01.2019 1. K.S – (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë me Propozim”	2. T.P – Inxhinier 3. E.M – Ekonomiste	2. F.D – (Anëtar) 3. A.D – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 4,989,167 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “K” shpk” me ofertë 4,989,167 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 18.03.2019, me afat 12 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 0 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 22.02.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë/ Shtetit Grand + Të ardhura te Bashkise	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

### **Vlerësimi i ofertës.**

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s’kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	K shpk	4,989,167	Kualifikuar dhe shpallur fitues

<sup>21</sup> Ndikimi, kriteri, shkaku dhe rekomandimi janë dhënë në fund të trajtimit të procedurave të prokurimit në mënyrë të përmbledhur, me qëllim eliminimin e përsëritjes.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Fushë - Arrëz z. F.T me nr. 7, datë 11.01.2019, është ngritur KVO e cila përbëhet nga z. K.S (kryetar), z. F.D dhe A.D (anëtar). Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, është kualifikuar 1 OE, dhe shpallur fitues OE “K” shpk me ofertë në vlerën **4,989,167 lekë** me marzh fitimi 16.5%.

*A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:*

1.OE “K” shpk, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3 të DST** e cila ndër të tjera kërkon nga OE *Autorizim për tregtim me shumicë ose pakicë të naftës të lëshuar nga Pushteti Vendor*. Ky OE ka paraqitur Autorizimin me nr. 2985 regj., datë 28.09.2015 të lëshuar nga Bashkia Durrës për pikën K në lagjen 1, Rr. Taulantia. Ky Autorizim nuk vlen për Bashkinë Fushë – Arrëz, pasi është autorizimi lëshohet për pikat konkrete të karburantit. Në këto kushte, ky OE do duhej të paraqiste vërtetimin të lëshuar nga Bashkia Fushë Arrëz, të cilin nuk e dispononte. Sa më sipër, ky OE nuk përmbush kriterin e kërkuar në DST.

## **2.Tenderi me objekt: “Ndërtim bazamente të urave Auto Lagjja Koprati, fshati Iballë dhe fshati Micoj”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim bazamenteve të urave auto lagjja Koprati fshati Iballë dhe fshati Micoj”.</b>		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.88, datë 25.03.2019	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.88, datë 25.03.2019 1. L.Gj – Juriste	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.07, datë 11.01.2019 1. K.S – (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Kërkesë me propozim	2. T.P – Inxhinier 3. E.M – Ekonomiste	2. F.D – (Anëtar) 3. A.D – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 3,078,734- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “D-1” shpk” me ofertë 3,007,100 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 17.05.2019, me afat 4 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 71,634- lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 15.04.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë/ Shtetit	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

### **Hartimi i kriterëve.**

#### **AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik ka kërkuar:**

1.Kërkesa e pikës **2.3 e DST** për makineritë dhe pajisjet, NJP ka vetëm të jenë të shënuara tek formulari i disponueshëm të konfirmuara nga drejtuesi i shoqërisë. Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se është minimaliste, por njëkohësisht mbart risk pasi kërkesa për mjete duhej të shoqërohej edhe me dokumentet e tyre, si leja e qarkullimit, akti i kolaudimit, policia e sigurimit dhe leja e transportit, kërkesa këto që japin garanci për cilësinë, sigurinë dhe mbarëvajtjen e punës objekt prokurimi.

## Vlerësimi i ofertës.

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	P.G shpk	3,017,940	Kualifikuar
2	D-1 shpk	3,007,100	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Fuzhë Arrëz z. F.T me nr. 7, datë 11.01.2019, është ngritur KVO i cili përbëhet nga z. K.S (kryetar), z. F.D dhe znj. A.D (anëtar). Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE, të cilët janë kualifikuar, dhe shpallur fitues OE “D-1” shpk me ofertë në vlerën **3,007,100 lekë** me diferencë nga fondi limit në vlerën **71,634 lekë**.

*A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:*

1.OE “D-1” shpk, nuk përmbush kriterin e pikës **IV të DST** pasi nuk disponon kategorinë NS-9 të licencës, sipas kërkesës në DST.

2.OE “D-1” shpk, nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/f të DST** për likuidimin e faturave të energjisë elektrike. Ky OE ka paraqitur vërtetimin me nr. 298 prot., datë 05.02.2019 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Shkodër, sipas të cilit ky OE ka 0 lek detyrime deri më datë 04.02.2019 pa përfshirë faturën e muajit Janar 2019. Në kushtet kur vlerësimi i ofertave është me datë 08.04.2019, ky OE rezulton debitor për muajt Janar dhe Shkurt 2019, në kundërshtim me DST.

3.OE nuk përmbush kriterin për stafin teknik si më poshtë:

a.Nuk përmbush kriterin për 1 murator pasi punonjësit H.Q, figuron në listëpagesë me kod punësimi 8112.16 – *makinist i përpunimit të gurëve*;

b.Nuk përmbush kriterin për 1 armator pasi punonjësi i deklaruar A.F, figuron në listëpagesë me kod punësimi 9312.04 – *punëtor krahu mirëmbajtje rrugësh*;

c.Nuk përmbush kriterin për 1 manovrator pasi punonjësi i deklaruar J.GJ figuron në listëpagesë me kod punësimi 9312.04 – *punëtor krahu mirëmbajtje rrugësh*;

*-Punonjësit e mësipërm të cituar me mangësi që lidhen me deklarinimin e tyre në listëpagesat e shoqërisë, bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, e cila përcakton kodet përkatëse të çdo profesioni të cilat pasqyrohen në listëpagesat përkatëse.*

### 3.Tenderi me objekt: “Shtesë në pedonale + lulishte në Qytetin Fushë Arrëz”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shtresë në pedonale + lulishte në Qytetin Fushë - Arrëz”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.87, datë 25.03.2019	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.87, datë 25.03.2019 1 L.Gj – Juriste	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.07, datë 11.01.2019 1. K.S – (Kryetar) 2. F.D – (Anëtar) 3. A.D – (Anëtar )
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Kërkesë me propozim	2. T.P – Inxhinier 3. E.M – Ekonomiste	
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 5,833,253- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE- BOE “P.G” shpk “J” shpk me ofertë 5,809,450 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 02.05.2019, me afat 5 MUAJ	7.Diferenca me fondin limit: 23,803- lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 08.04.2019	9.Burimi Financimit: Grandi i Bashkisë+ Buxheti i shtetit	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

### Hartimi i kriterëve.

Mungon hartimi dhe argumentimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

#### **AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik ka kërkuar:**

1.Kërkesa për 1 mjek është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1 ku përcaktohet se:

“Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“6.Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.

### Vlerësimi i ofertës.

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s’kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	P.G shpk & J shpk	5,809,450	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz z. F.T me nr. 7, datë 11.01.2019, është ngritur KVO i cili përbëhet nga z. K.S (kryetar), z. F.D z. A.D (anëtar). Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, i cili është kualifikuar, dhe shpallur fitues BOE “P.G” shpk & “J” shpk me ofertë në vlerën **5,809,450 lekë** me diferencë nga fondi limit në vlerën **23,883 lekë**.

-Ndërmjet operatorëve “P.G” shpk dhe “J” shpk, është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me nr. 2619 Rep., Nr. 820 Kol., datë 05.04.2019. Sipas marrëveshjes shoqëria “P.G” merr përsipër kryerjen e 60% të punimeve dhe shoqëria “J” shpk 40% të tyre sipas ndarjes në preventiv.

*A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se BOE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:*

1.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/a të DST** e cila kërkon vërtetim se ka plotësuar detyrimet vendore për taksat dhe tarifatat për vitin 2018. OE “P.G” shpk, ka kryer punime në Bashkinë Vlorë të pasqyruara në QKB për vitin 2018, ndërkohë që vërtetimi i paraqitur nga ky subjekti, është lëshuar nga Njësia Administrative Qendër Vlorë, ku përcaktohet se nuk ka detyrime ndaj kësaj njësie. Lidhur me këtë vërtetim, sqarohet se dokumenti i firmosur nga Administratorja e Njesisë, nuk është në përputhje me kompetencat që përcakton neni 64, germa (gj) “Kompetencat e Kryetarit” të ligjit me nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili përcakton se, *Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:*

*gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët;*

-Sa më sipër, është kompetencë e kryetarit të bashkisë, ose personit të autorizuar prej tij, lëshimi i dokumenteve të tilla, në rastin konkret vërtetimit për likuidimin e tarifave vendore, dhe jo njërive administrative.

-Gjithashtu, evidentohet se edhe vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Shkodër për OE “J” shpk, në të cilin përcaktohet se ky subjekt nuk ka detyrime ndaj taksave dhe tarifave vendore kundrejt kësaj bashkie për vitin 2018, është cituar se përjashtohet kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i bashkisë apo buxheti i shtetit. Ky përcaktim është në kundërshtim me nenin 43, pika 1/1 “përditësimi i të dhënave të regjistrimit” të ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili përcakton se:

*1/1. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia.*

-Sa më sipër, ky OE nuk rezulton të ketë likuiduar detyrimet vendore pranë kësaj bashkie.  
2. BOE “P.G” shpk, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3/III të DST** për stafin teknik, të cilët duhet të jenë të siguruar për vitin 2018...dhe profesionet përkatëse të kërkuara. Mangësitë lidhur me stafin teknik janë si vijon:

**a.** Nuk përmbush kriterin për 1 murator pasi punonjësi i deklaruar ka mangësi si vijon:

-M.P, figuron në listëpagesë me kod punësimi 8322.01 – *për shofer*;

**b.** Nuk përmbush kriterin për 1 hekurkthyes pasi punonjësi i deklaruar ka mangësi si vijon:

-GJ.N shpk, figuron në listëpagesë me kod punësimi 8322.01 – *për shofer*;

**c.** Nuk përmbush kriterin për 2 saldatorë pasi punonjësit e deklaruar kanë mangësi si vijon:

-L.B dhe I.P, figurojnë në listëpagesë me kod punësimi 8332.14 – *shofer kamioni*. Punonjësi I.P, njëkohësisht nuk figuron në listëpagesa për gjithë vitin 2018, sipas kërkesës në DST.

**ç.** Nuk përmbush kriterin për 1 mekanik pasi punonjësi i deklaruar ka mangësi si vijon:

-LL.S, nuk figuron i siguruar për gjithë vitin 2018;

**d.** Nuk përmbush kriterin për 1 teknik ndërtimit, pasi punonjësi i deklaruar ka mangësi si vijon:

-S.P, nuk figuron i siguruar dhe në listëpagesë për gjithë vitin 2018;

**dh.** Nuk përmbush kriterin për 1 karpentier pasi punonjësi i deklaruar ka mangësi si vijon:

-L.Q, figuron në listëpagesë me kod punësimi 9312.02 – *punëtor krahu*;

**e.** Nuk përmbush kriterin për 1 hidraulik, pasi punonjësi i deklaruar ka mangësi si vijon:

-E.S, figuron në listëpagesë me kod punësimi 8322.01 – *për shofer*, ndërkohë që nuk figuron për gjithë vitin 2018 i siguruar pranë këtij OE;

**ë.** Nuk përmbush kriterin për 2 pllakashtrues nga 4 të kërkuar, pasi punonjësit e deklaruar kanë mangësi si vijon:

-V.T figuron sipas listëpagesës i deklaruar me kod punësimi 8342.02 – *drejtues ekskavatori*, ndërsa punonjësi M.M, figuron me kod punësimi 7411.10 – *elektracist për linjat e tensionit të ulët*, njëkohësisht nuk figuron për gjithë vitin 2018 i siguruar dhe në listëpagesën e shoqërisë;

-*Punonjësit e mësipërm të cituar me mangësi që lidhen me deklarinimin e tyre në listëpagesat e shoqërisë, bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, e cila përcakton kodet përkatëse të çdo profesioni të cilat pasqyrohen në listëpagesat përkatëse.*

#### **4.Tenderi me objekt: “Sistemim, Asfaltim, Ndriçim i Rrugës Auto Lagjja e Vjetër në Qytetin Fushë Arrëz”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim, asfaltim, ndricim i rruges auto L.Vjeter”</b>		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.92, datë 29.03.2019	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.92, datë 29.03.2019	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.07, datë 11.01.2019
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Kerkese me propozim	1. L.Gj – Juriste 2. T.P – Inxhinier 3. E.M – Ekonomiste	1. K.S – (Kryetar) 2. F.D – (Anëtar) 3. A.D – (Anëtar)

5.Fondi Limit (pa Tvsh) 3,165,586- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE- P.G shpk me ofertë 3,120,976.95 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 17.05.2019, me afat 3 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 44,609.05- lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 12.04.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkise + Grandi	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

#### **Hartimi i kriterëve.**

Mungon hartimi dhe argumentimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

#### **AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik ka kërkuar:**

1.Kërkesa për 1 mjek është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1 ku përcaktohet se:

“Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“6.Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.

#### **Vlerësimi i ofertës.**

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s’kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	P.G shpk & J shpk	3,120,977	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz z. F.T me nr. 4, datë 03.03.2020, është ngritur KVO i cili përbëhet nga z. K.S (kryetar), z. F.D, dhe z. A.D (anëtar). Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, i cili është kualifikuar, dhe shpallur fitues BOE “P.G” shpk & “J” shpk me ofertë në vlerën **3,120,977 lekë** me diferencë nga fondi limit në vlerën **44,609 lekë**.

-Ndërmjet operatorëve “P.G” shpk dhe “J” shpk, është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me nr. 2711 Rep., Nr. 849 Kol., datë 10.04.2019. Sipas marrëveshjen shoqëria “P.G” merr përsipër kryerjen e 95% të punimeve dhe shoqëria “J” shpk 5% të tyre sipas ndarjes në preventiv që lidhen me punimet elektrike.

*A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se BOE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:*

1.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/a të DST** e cila kërkon vërtetim se ka plotësuar detyrimet vendore për taksat dhe tarifatat për vitin 2018. OE “P.G” shpk, ka kryer punime në

Bashkinë Vlorë të pasqyruara në QKB për vitin 2018, ndërkohë që vërtetimi i paraqitur nga ky subjekti, është lëshuar nga Njësia Administrative Qendër Vlorë, ku përcaktohet se nuk ka detyrime ndaj kësaj njësie. Lidhur me këtë vërtetim, sqarohet se dokumenti i firmosur nga Administratorja e Njesisë, nuk është në përputhje me kompetencat që përcakton neni 64, germa (gj) “Kompetencat e Kryetarit” të ligjit me nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili përcakton se, *Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:*

*gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët;*

-Sa më sipër, është kompetencë e kryetarit të bashkisë, ose personit të autorizuar prej tij, lëshimi i dokumenteve të tilla, në rastin konkret vërtetimit për likuidimin e tarifave vendore, dhe jo njësive administrative.

-Gjithashtu, evidentohet se edhe vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Shkodër për OE “J” shpk, në të cilin përcaktohet se ky subjekt nuk ka detyrime ndaj taksave dhe tarifave vendore kundrejt kësaj bashkie për vitin 2018, është cituar se përjashtohet kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i bashkisë apo buxheti i shtetit. Ky përcaktim është në kundërshtim me nenin 43, pika 1/1 “përditësimi i të dhënave të regjistrimit” të ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili përcakton se:

*1/1. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia.*

-Sa më sipër, ky OE nuk rezulton të ketë likuiduar detyrimet vendore pranë kësaj bashkie.

2. BOE “P.G” shpk, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3/III të DST** për stafin teknik, të cilët duhet të jenë të siguar për vitin 2018...dhe profesionet përkatëse të kërkuara. Mangësitë lidhur me stafin teknik janë si vijon:

**a.** Nuk përmbush kriterin për 1 murator pasi punonjësi i deklaruar ka mangësi si vijon:

-M.M, figuron në listëpagesë me kod punësimi 8322.01 – *për shofer;*

**b.** Nuk përmbush kriterin për 1 mekanik pasi punonjësi i deklaruar ka mangësi si vijon:

-LL.S, nuk figuron i siguar për gjithë vitin 2018;

-*Punonjësit e mësipërm të cituar me mangësi që lidhen me deklarin e tyre në listëpagesat e shoqërisë, bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, e cila përcakton kodet përkatëse të çdo profesioni të cilat pasqyrohen në listëpagesat përkatëse.*

3. BOE nuk përmbush kriterin për mjetin *Asfaltoshtruese*. Së pari, punimet që lidhen me shtresat, janë marrë përsipër nga OE “P.G” shpk, ndërkohë rezulton se ky OE nuk provon se disponon këtë mjet. Së dyti, është paraqitur një deklaratë doganore e OE “J” shpk me nr. R 620. Kjo deklaratë rezulton fotokopje e panoterizuar, në kundërshtim me paragrafin e fundit të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, i cili përcakton se *Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre...*

-Sa më sipër dokumenti nuk është në përputhje me DST.

4. BOE nuk përmbush kriterin për *Grejder*. Është paraqitur një deklaratë doganore me nr. R 7689 në emër të subjektit “P.G”, mjet për të cilin nuk disponohen dokumentet e nevojshme si, Certifikata e Pronësisë, Leja e Qarkullimit, Polica e Sigurimit dhe Certifikata e Kontrollit Teknik.

## **5. Tenderi me objekt: “Ndërtim i Palestrës dhe Ambienteve Sportive, Shkolla 70-Vjetori i Pavarësisë”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim i Palestrës dhe Ambienteve Sportive, Shkolla 70-Vjetori i Pavarësisë”</b>		
1. Urdhër Prokurimi : Nr.121, datë 02.05.2019	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.121, datë 02.05.2019	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.07, datë 11.01.2019 1. K.S – (Kryetar)



4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedure e Hapur	1. L.Gj – Juriste 2. T.P – Inxhinier 3. E.M – Ekonomiste	2. F.D – (Anëtar) 3. A.D – (Anëtar )
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 41,295,043- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: BOE P.G & J shpk me ofertë 39,253,838.89 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 15.07.2019, me afat 8 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 2,041,204.11- lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 07.06.2019	9.Burimi Financimit: Ministria Arsimit, Rinis dhe Sporteve	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b)Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

#### **Hartimi i kriterëve.**

Nuk është mbajtur procesverbali për hartimin dhe argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

#### **AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik ka kërkuar:**

1.Kërkesa e pikës **1 të DST** e cila kërkon për zbatimin e kësaj kontrate 9 inxhinierë, nga të cilët 1 inxhinier mjedisi, 1 arkitekt, 1 inxhinier ndërtimi profil strukturist, dhe 1 gjeolog, janë kërkesa të tepërta dhe të paargumentuara, jo në raport me vlerën dhe volumin e punimeve. Nuk është bërë argumentim nga AK për profilet e inxhinierëve të cituar më sipër, ndërkohë nuk ka zëra konkret punimesh. Kërkesa është kufizuese.

2.Kërkesa për 1 mjek është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1 ku përcaktohet se:

“Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“6.Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.

3.Kërkesa për 3 ekskavator, nga të cilët 2 me zinxhir dhe 1 me gomë, 2 fadroma me goma dhe 2 miniekstavator, janë kërkesa të tepërta dhe jo në përputhje me volumin e punimeve. AK nuk ka bërë një argumentim të këtij numri të madh mjetesh gërmimi që janë 7 në total, ndërkohë punimet konkrete dhe periudha 8 mujore e kërkuar për zbatimin e kësaj kontrate, nuk përkon me nevojën për këtë numër të lartë mjetesh gërmimi.

3.1.Kërkesa për 2 kontejner, nuk është kërkesë esenciale për zbatimin e punimeve, dhe si e tillë është e tepërt dhe jo në raport me punimet e objektit.

#### **Vlerësimi i ofertës.**

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s’kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
-----	---------------	------------------	--

1	E VI shpk	0	<i>S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:</i> 1. Nuk ka paraqitur ofertë dhe asnjë dokumentacion të nevojshëm
2	V.N IS shpk & N shpk	34,738,920	<i>S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:</i> 1. Mungojne 5 (pese) puntore krahu, te kerkuar ne DST, pika 2.3, pika 1, Stafi Teknik, paragrafi 4 "Operatori Ekonomik duhet te kete te punesuar dhe te shoqeruar me listpagesa perkatese tre muajt e fundit..." pika 14 <u>Punetor Krahu 5...</u> " stafi teknik i mesiperm duhet te kete deshmi te kualifikimit te sigurimit teknik...", pra mungojne Punetore e krahut te pajisur me deshmi te kualifikimit te sigurimit teknik. 2. Me date 21.06.2019 ne sistemin e APP erdhi <u>Deklarate e terheqjes</u> nga tenderi me objekt: "Ndertim i Paletes IS shpk, deklarate e cila erdhi edhe ne shkrese zyrtare e cila u protokollua me <u>Nr.1932 Prot, date 21.06.2019, ora 15:00</u> ne Bashkine Fushe-Arrez, deklarate ne te cilen operatori ekonomik citon se arsyeja e terheqjes eshte keqlllogaritja e vleres se ofertes se dhene, <u>ku terhiqen nga oferta e dhene ne proceduren</u> qe u zhvillua me date 07.06.2019, nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Fushe-Arrez me objekt: Ndertim i palestres dhe ambienteve sportive, shkolla 70-Vjetori i pavarisise" me fond limit: 41,295,043 (dyzet e nje milion e dyqind e nentehjete e pese mijë e dyzet e tre) leke pa TVSH.
3	P.G shpk & J shpk	39,253,839	<i>Kualifikuar dhe shpallur fitues</i>

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz z. F.T me nr. 4, datë 03.03.2020, është ngritur KVO i cili përbëhet nga z. K.S (kryetar), z. F.D z. A.D (anëtar). Në këtë tender ka marrë pjesë 3 OE, është kualifikuar 1 OE, dhe shpallur fitues BOE "P.G" shpk & "J" shpk me ofertë në vlerën **39,253,839 lekë** me diferencë nga fondi limit në vlerën **2,041,204 lekë**.

-Ndërmjet operatorëve "P.G" shpk dhe "J" shpk, është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me nr. 2619 Rep., Nr. 820 Kol., datë 05.04.2019. Sipas marrëveshjen shoqëria "P.G" merr përsipër kryerjen e 60% të punimeve dhe shoqëria "J" shpk 40% të tyre sipas ndarjes në preventiv.

*A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se BOE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:*

1. BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/a të DST** e cila kërkon vërtetim se ka plotësuar detyrimet vendore për taksat dhe tarifatat për vitin 2018. OE "P.G" shpk, ka kryer punime në Bashkinë Vlorë të pasqyruara në QKB për vitin 2018, ndërkohë që vërtetimi i paraqitur nga ky subjekti, është lëshuar nga Njësia Administrative Qendër Vlorë, ku përcaktohet se nuk ka detyrime ndaj kësaj njësie. Lidhur me këtë vërtetim, sqarohet se dokumenti i firmosur nga Administratorja e Njesisë, nuk është në përputhje me kompetencat që përcakton neni 64, germa (gj) "Kompetencat e Kryetarit" të ligjit me nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i cili përcakton se, *Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:*

*gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët;*

-Sa më sipër, është kompetencë e kryetarit të bashkisë, ose personit të autorizuar prej tij, lëshimi i dokumenteve të tilla, në rastin konkret vërtetimit për likuidimin e tarifave vendore, dhe jo njësive administrative.

-Ky subjekt, në shtojcën nr. 11 për kontratat e lidhura ose në proces, ka deklaruar 2 punë në Shkodër dhe Kukës, konkretisht *Rikonstruksion i fasadës dhe ambientesh në zyrën doganore Muriqan* në Shkodër, dhe *"Rehabilitim i sistemit ujitës dhe kullimit"* në Kukës. Sipas DST OE duhet të paraqesin vërtetim për likuidimin e taksave për vitin 2019, ndërkohë në 2 njësitë e vetëqeverisjes vendore të cituara më sipër, nuk figuron të jenë likuiduar detyrimet për vitin 2019, në kundërshtim me DST.

-Gjithashtu, evidentohet se edhe vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Shkodër për OE "J" shpk, në të cilin përcaktohet se ky subjekt nuk ka detyrime ndaj taksave dhe tarifave vendore kundrejt kësaj bashkie për vitin 2018, është cituar se përjashtohet kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i bashkisë apo buxheti i shtetit. Ky përcaktim është në kundërshtim me nenin 43, pika 1/1 "përditësimi i të dhënave të regjistrimit" të ligjit nr. 9920 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, i cili përcakton se:

*1/1. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo*

*certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia.*

-OE “J” shpk, ka deklaruar gjithashtu punime të kryera në Shkodër, konkretisht në kontratën me objekt “Ndërtim i objekteve të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër”, e cila është në zbatim përgjatë vitit 2019, ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetim të lëshuar nga kjo bashki për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore.

-Sa më sipër, ky OE nuk rezulton të ketë likuiduar detyrimet vendore pranë kësaj bashkie.

2.BOE “P.G” shpk & “J” shpk, nuk përmbushin kriterin e pikës **2.3/III të DST** për stafin teknik, të cilët duhet të jenë të siguruar për vitin 2018...dhe profesionet përkatëse të kërkuara. Mangësitë lidhur me stafin teknik janë si vijon:

**a.**Nuk përmbush kriterin për 2 saldatorë pasi punonjësit e deklaruar kanë mangësi si vijon:

-L.B dhe I.P, figurojnë në listëpagesë me kod punësimi 8332.14 – *shofer kamioni*. Punonjësi I.P, njëkohësisht nuk figuron në listëpagesa për gjithë vitin 2018, sipas kërkesës në DST.

**b.**Nuk përmbush kriterin për 2 mekanik pasi punonjësit e deklaruar kanë mangësi si vijon:

-LL.S, nuk figuron i siguruar për gjithë vitin 2018;

-A.GJ figuron në listëpagesë me kod punësimi 8322.01 – *shofer*;

**c.**Nuk përmbush kriterin për 1 bojaxhi nga 2 të kërkuar pasi punonjësit e deklaruar kanë mangësi si vijon:

-R.K, nuk figuron përgjatë gjithë vitit 2018 në listëpagesat e shoqërisë, sipas kërkesës në DST.

**ç.**Nuk përmbush kriterin për 1 pllakashtrues, pasi punonjësi i deklaruar ka mangësi si vijon:

-M.M, figuron me kod punësimi 7411.10 – *elektricit për linjat e tensionit të ulët*, njëkohësisht nuk figuron për gjithë vitin 2018 i siguruar dhe në listëpagesën e shoqërisë;

**d.**Nuk përmbush kriterin për 2 karpentier nga 3 të kërkuar, pasi punonjësit e deklaruar kanë mangësi si vijon:

-L.Q dhe M.N, figurojnë në listëpagesë me kod punësimi 9312.02 – *punëtor krahu*; Vetëm punonjësi i OE “J” shpk, A.L përmbush kriteret.

**dh.**Nuk përmbush kriterin për 2 hekurkthyes nga 3 të kërkuar pasi punonjësit e deklaruar kanë mangësi si vijon:

-GJ.N shpk, figuron në listëpagesë me kod punësimi 8322.01 – *për shofer*; A.K figuron në listëpagesë me kod punësimi 8342.02 – *drejtues ekskavatori*; Vetëm punonjësi V.N i OE “J” shpk, përmbush kriterin.

**e.**Nuk përmbush kriterin për 1 hidraulik, pasi punonjësi i deklaruar ka mangësi si vijon:

-L.P, figuron në listëpagesë me kod punësimi 8322.01 – *për shofer*;

**ë.**Nuk përmbush kriterin për 1 murator nga 3 të kërkuar, pasi punonjësi i deklaruar ka mangësi si vijon:

-M.P, figuron në listëpagesë me kod punësimi 8322.01 – *për shofer*;

-Punonjësit e mësipërm të cituar me mangësi që lidhen me deklarinimin e tyre në listëpagesat e shoqërisë, bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, e cila përcakton kodet përkatës të çdo profesioni të cilat pasqyrohen në listëpagesat përkatëse.

## **6.Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i kanalit, fshati Iballë”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i kanalit, fshati Iballë”</b>		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.152, datë 24.05.2019	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.152, datë 24.05.2019 1. L.Gj – Juriste	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.07, datë 11.01.2019 1. K.S – (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedure e hapur	2. T.P – Inxhinier 3. E.M – Ekonomiste	2. F.D – (Anëtar) 3. A.D – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 24,473,446- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “P.G” shpk” me ofertë 24,131,095 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 31.07.2019, me afat 8 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 342,351- lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 28.06.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë/ Shtetit Ministria Bujqesise dhe Zhvillimi Rural	10.Operatorët Ekonomikë <b>a)</b> Pjesëmarrës në tender 2 OE <b>b)</b> Skualifikuar 1 OE,

		c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik ka kërkuar:**

1. Kërkesa e pikës 2.4 e DST e cila kërkon kategorinë e zbatimit të licencës NP-1B, NP-2B, NP-6B, NP-12B, NS-4B, janë kërkesa të ekzagjeruara dhe jo në raport me vlerën e punimeve konkrete sipas preventivit. Shumica e kategorive të kërkuara janë për punime me vlerë mbi 20 milion, ndërkohë zërat konkret në preventiv nuk janë në vlerën e kërkuar, pasi i gjithë investimi është 24 milion lekë. Theksohet se zërat konkretë që lidhen me kategoritë e cituara më sipër nuk janë në vlerën e caktuar për të kërkuar kategorinë **B** të licencës. Është kërkesë kufizuese, dhe jo në raport me vlerën e punimeve, e cila pengon konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

2. Kërkesa e pikës 2.5 e DST e cila kërkon nga OE të përcaktojë drejtuesin teknik të punimeve, i cili të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, është kërkesë në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i cili përcakton se *Për vlera me vlerë të plotë të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi. Ky tender ka fond limit 24,473,446 lekë, vlerë e cila është më e vogël se vlera e kërkuar për drejtuesin teknik të punimeve në kantier dhe të paangazhuar në kontrata tjera.*

3. Kërkesa e pikës 2.8 e DST e cila kërkon 1 mjek është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1 ku përcaktohet se:

“Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“6. Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.

4. Kërkesa e pikës 2.11 e DST e cila kërkon ndër të tjera 3 drejtues mjeteve të rënda dhe 2 manovrator, çka përbën në total prej 5 drejtues për këto mjete, është numër i lartë dhe jo në raport me numrin e mjeteve të rënda të kërkuara për zbatimin e kësaj kontrate, pasi në DST kërkohej 2 fadroma dhe 2 miniekskavator. Sa më sipër, kërkesa nuk është në përputhje me numrin e mjeteve, dhe përbën kërkesë të tepërt dhe kufizuese për OE.

5. Kërkesa e pikës 2.12 e DST e cila kërkon 2 fadroma, njëra nga të cilat me kapacitet 0.25 m<sup>3</sup> dhe tjetra me kapacitet 3.6 m<sup>3</sup>, njëkohësisht dhe 1 kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 13 – 15 Ton, janë kërkesa të cilat mund të paargumentuara, fikse ose me kufinj minimal mes kapacitetit minimal dhe maksimal, të cilat mund të kufizojnë konkurrencën. Konkretisht, për

fadromat është kërkuar kapaciteti i kovës të jetë për një të 0.25 m<sup>3</sup> dhe për tjetrën 3.6 m<sup>3</sup>. AK duhej të përcaktonte një hapësirë të ndërmjetme midis kapacitetit minimal apo maksimal të lejuar, pasi përcaktimi fiks mund të pengojë OE të cilët posedojnë mjete të njëjta, por me kapacitet të kovës të përafërt me atë të kërkuar. E njëjta situatë vlen edhe për kërkesën për kamion me kapacitet mbajtës 13 – 15 Ton. Vihet re një diferencë e vogël mes kapacitetit minimal dhe maksimal të lejuar, çka mund të përbëjë kufizim ose arsye s’kualifikimi jo të genësishme për OE.

### Vlerësimi i ofertës.

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s’kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	A shpk	23,993,852	<p><i>S’kualifikuar për arsyet e mëposhtme:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <u>Mungon Injiniери i Mjedisit , me Profil Trajtim Ujrash</u>, i kërkuar ne DST, pika 2.7, paragrafi 4, <i>ingjiniери i paraqitur eshte ne Profil Energjitike, kjo bie ndesh me DST e per pasoje ky kriter nuk permbushet.</i></li> <li>2. <u>Mungon Gjeneratori 30 KVA 1 ( nje ) cope</u>, kërkuar ne DST, pika 2.12, e per pasoje ky kriter nuk permbushet.</li> <li>3. <u>Mungon Certifikata e Pronesise per Mjetin me Targa AA</u>, kërkuar ne DST, pika 2.12, paragrafi 7 ku citohet se : " <i>Per mjetet qe shenohen ne regjistrat publike, kur jane ne pronesi, duhet te paraqitni dokumentacionin qe vertetojne pronesine e mjetit si Certifikaten e pronesise , lejen e qarkullimit.....</i>" ndersa "<i>...kur mjetet jane marre me qera krahas dokumenatcionit te mesiperm , duhet edhe kontrata e qerese</i>".</li> <li>4. <u>Mungon Saldatrice 200 A e siper 1 ( nje ) cope</u>, kërkuar ne DST, pika 2.12, paragrafi 1, e per pasoje ky kriter nuk permbushet.</li> <li>5. <u>Mungojne 2 ( dy ) betoniere</u>, kërkuar ne DST 4 ( kater ) cope paraqitur vetem 2 ( dy ) cope , konkretisht pika 2.12, paragrafi 1 i DST, e per pasoje ky kriter nuk permbushet.</li> <li>6. <u>Mungon Autobot Uji 1 ( nje ) cope</u>, kërkuar ne DST, pika 2.12, paragrafi 1, e per pasoje ky kriter nuk permbushet.</li> <li>7. <u>Mungon Rimorkiator 1 ( nje ) cope</u>, kërkuar ne DST, pika 2.12, paragrafi 1, e per pasoje ky kriter nuk permbushet.</li> <li>8. <u>Mungon Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 13 ton - 15 ton 1 ( nje ) cope</u>, kërkuar ne DST, pika 2.12, paragrafi 1, e per pasoje ky kriter nuk permbushet.</li> <li>9. <u>Mungojne Deshmite e Kualifikimit te Sigurmit Teknik per 10 ( dhjete ) punetore te thjeshte</u>, te kërkuar ne DST, pika 2.11, ku citohet se : " <i>Per stafin e sipercituar te paraqiten kontrata e punes per secilin, deshmi te sigurimit teknik IQT perkatese</i>", e per pasoje ky kriter nuk permbushet.</li> <li>10. <u>Mungojne 3 ( tre ) Drejtues mjetesh te renda</u>, kërkuar ne DST, pika 2.11, e per pasoje ky kriter nuk permbushet.</li> <li>11. <u>Mungojne 1 ( nje ) shofer</u>, kërkuar ne DST 2 ( dy ) , konkretisht pika 2.11, e per pasoje ky kriter nuk permbushet.</li> <li>12. <u>Mungon 1 ( nje ) Teknik Ndertimi i certifikuar " Specialist per sigurine dhe mbrojtjen ne pune"</u>, kërkuar ne DST pika 2.10.</li> <li>13. <u>Mungon 1 ( nje ) Teknik Hidro</u>, kërkuar ne DST pika 2.11.</li> <li>14. <u>Mungon Certifikata e Pronesise per Mjetin me Targa AA</u>, kërkuar ne DST, pika 2.12, paragrafi 7 ku citohet se : " <i>Per mjetet qe shenohen ne regjistrat publike, kur jane ne pronesi, duhet te paraqitni dokumentacionin qe vertetojne pronesine e mjetit si Certifikaten e pronesise , lejen e qarkullimit.....</i>" ndersa "<i>...kur mjetet jane marre me qera krahas dokumenatcionit te mesiperm , duhet edhe kontrata e qerese</i>", e per pasoje nuk permbushet kriteri per Fadrome me goma me kove para dhe mbrapa 1 ( nje cope ) kërkuar ne DST.</li> <li>15. <u>Mungojne Karroca dore 8 ( tete ) cope</u>, kërkuar ne DST, pika 2.12, paragrafi 1, e per pasoje ky kriter nuk permbushet.</li> <li>16. Shtojca 10, <u>mbi disponimin e makinerive</u>, nuk jane perfshire te gjitha mjetet e pajisjet pasi nuk disponohen nga operatori, mjete e pajisje qe jane kërkuar ne DST.</li> <li>17. <u>Mungojne Shtojcat : Shtojca 1/1 " Deklarata per paraqitje oferte te pavarur"; Shtojca 5 " Deklarate per permbushjen e specifikimeve teknike";</u></li> </ol>

			<i>Shtojca 7 " Deklarate mbi Konfliktin e Interesit" , kerkuar ne DST, pika 2 "Kriteret e Vecanta".</i>
2	P.G shpk	24,131,095	<i>Kualifikuar dhe shpallur fitues</i>

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Fushë - Arrëz z. F.T me nr. 7, datë 11.01.2019, është ngritur KVO i cili përbëhet nga z. K.S (kryetar), z. F.D z. A.D (anëtar). Në këtë tender ka marrë pjesë 2 OE, është kualifikuar 1 OE, dhe shpallur fitues OE "P.G" shpk me ofertë në vlerën **24,131,095 lekë** me diferencë nga fondi limit në vlerën **342,351 lekë**.

*A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se BOE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:*

1.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/a të DST** e cila kërkon vërtetim se ka plotësuar detyrimet vendore për taksat dhe tarifat për vitin 2018. OE "P.G" shpk, ka kryer punime në Bashkinë Vlorë të pasqyruara në QKB për vitin 2018, ndërkohë që vërtetimi i paraqitur nga ky subjekti, është lëshuar nga Njësia Administrative Qendër Vlorë, ku përcaktohet se nuk ka detyrime ndaj kësaj njësie. Lidhur me këtë vërtetim, sqarohet se dokumenti i firmosur nga Administratorja e Njesisë, nuk është në përputhje me kompetencat që përcakton neni 64, germa (gj) "Kompetencat e Kryetarit" të ligjit me nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i cili përcakton se, *Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:*

*gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët;*

-Sa më sipër, është kompetencë e kryetarit të bashkisë, ose personit të autorizuar prej tij, lëshimi i dokumenteve të tilla, në rastin konkret vërtetimit për likuidimin e tarifave vendore, dhe jo njësie administrative.

-Ky subjekt, në shtojcën nr. 11 për kontratat e lidhura ose në proces, ka deklaruar kontratën e lidhur me Bashkinë Kukës me objekt "*Rehabilitim i sistemit ujitës dhe kullimit*". Sipas DST OE duhet të paraqesin vërtetim për likuidimin e taksave për vitin 2019, ndërkohë në këtë njësi të vetëqeverisjes vendore të cituar më sipër, nuk figuron të jenë likuiduar detyrimet për vitin 2019, në kundërshtim me DST.

-Sa më sipër, ky OE nuk rezulton të ketë likuiduar detyrimet vendore pranë kësaj bashkie.

2.OE "P.G" shpk, nuk përmbush kriterin e DST për stafin teknik, të cilët duhet të jenë të siguar për vitin 2018...dhe profesionet përkatëse të kërkuara. Mangësitë lidhur me stafin teknik janë si vijon:

**a.**Nuk përmbush kriterin për 2 saldatorë pasi punonjësit e deklaruar kanë mangësi si vijon:

-L.B dhe I.P, figurojnë në listëpagesë me kod punësimi 8332.14 – *shofer kamioni*. Punonjësi I.P, njëkohësisht nuk figuron në listëpagesa për gjithë vitin 2018, sipas kërkesës në DST.

**b.**Nuk përmbush kriterin për 2 mekanik pasi punonjësit e deklaruar kanë mangësi si vijon:

-LL.S, nuk figuron i siguar për gjithë vitin 2018;

-A.Gj figuron në listëpagesë me kod punësimi 8322.01 – *shofer*;

**c.**Nuk përmbush kriterin për 1 bojaxhi nga 2 të kërkuar pasi punonjësit e deklaruar kanë mangësi si vijon:

-R.K, nuk figuron përgjatë gjithë vitit 2018 në listëpagesat e shoqërisë, sipas kërkesës në DST.

**ç.**Nuk përmbush kriterin për 1 pllakashtrues, pasi punonjësi i deklaruar ka mangësi si vijon:

-M.M, figuron me kod punësimi 7411.10 – *elektricit për linjat e tensionit të ulët*, njëkohësisht nuk figuron për gjithë vitin 2018 i siguar dhe në listëpagesën e shoqërisë;

**d.**Nuk përmbush kriterin për 2 karpentier nga 3 të kërkuar, pasi punonjësit e deklaruar kanë mangësi si vijon:

-L.Q dhe M.N, figurojnë në listëpagesë me kod punësimi 9312.02 – *punëtor krahu*; Vetëm punonjësi i OE "J" shpk, A.L përmbush kriteret.

**dh.**Nuk përmbush kriterin për 2 hekurkthyes nga 3 të kërkuar pasi punonjësit e deklaruar kanë mangësi si vijon:

-GJ.N shpk, figuron në listëpagesë me kod punësimi 8322.01 – *për shofer*; A.K figuron në listëpagesë me kod punësimi 8342.02 – *drejtues ekskavatori*; Vetëm punonjësi V.N i OE "J" shpk, përmbush kriterin.

e.Nuk përmbush kriterin për 1 hidraulik, pasi punonjësi i deklaruar ka mangësi si vijon:

-L.P, figuron në listëpagesë me kod punësimi 8322.01 – *për shofer*;

ë.Nuk përmbush kriterin për 1 murator nga 3 të kërkuar, pasi punonjësi i deklaruar ka mangësi si vijon:

-M.P, figuron në listëpagesë me kod punësimi 8322.01 – *për shofer*;

-*Punonjësit e mësipërm të cituar me mangësi që lidhen me deklarinimin e tyre në listëpagesat e shoqërisë, bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, e cila përcakton kodet përkatëse të çdo profesioni të cilat pasqyrohen në listëpagesat përkatëse.*

3.OE Nuk përmbush kriterin e pikës 2 të DST për mjetet e nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate, dhe konkretisht:

a.Nuk përmbush kriterin për 2 fadroma, pasi mjetet e deklaruara me targa **AA** dhe **AA**, figurojnë njëkohësisht të deklaruara në tenderin me objekt “*Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70-Vjetori i Pavarësisë*”, procedurë e vlerësuar nga e njëjta KVO me datë 07.06.2019, ndërkohë që procedura objekt shqyrtimi ka datë zhvillimi 28.06.2019.

b.Nuk përmbush kriterin për 2 miniekskavator, pasi mjetet e deklaruara me dokument justifikues deklaratë doganore **R 58336** dhe **R 60665**, figurojnë njëkohësisht të deklaruara në tenderin me objekt “*Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70-Vjetori i Pavarësisë*”, procedurë e vlerësuar nga e njëjta KVO me datë 07.06.2019, ndërkohë që procedura objekt shqyrtimi ka datë zhvillimi 28.06.2019.

c.Nuk përmbush kriterin për 2 kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 20 – 25 Ton, pasi mjetet me targa **AA** dhe **AA**, figurojnë njëkohësisht të deklaruara në tenderin me objekt “*Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70-Vjetori i Pavarësisë*”, procedurë e vlerësuar nga e njëjta KVO me datë 07.06.2019, ndërkohë që procedura objekt shqyrtimi ka datë zhvillimi 28.06.2019. Njëkohësisht, këto 2 mjete rezultojnë me kapacitet 26 Ton, kapaciteti i cili nuk është në përputhje me atë të vendosur në DST.

ç.Nuk përmbush kriterin për 1 kamion me kapacitet mbajtës 13 – 15 Ton, pasi mjete i deklaruar me targa **AA**, figuron njëkohësisht i deklaruar në tenderin me objekt “*Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70-Vjetori i Pavarësisë*”, procedurë e vlerësuar nga e njëjta KVO me datë 07.06.2019, ndërkohë që procedura objekt shqyrtimi ka datë zhvillimi 28.06.2019.

d.Nuk përmbush kriterin për 1 kamion vetëshkarkues deri 5 ton nga 2 të kërkuar, pasi mjete me targa **AA**, figuron njëkohësisht i deklaruar në tenderin me objekt “*Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70-Vjetori i Pavarësisë*”, procedurë e vlerësuar nga e njëjta KVO me datë 07.06.2019, ndërkohë që procedura objekt shqyrtimi ka datë zhvillimi 28.06.2019.

dh.Nuk përmbush kriterin për 1 Autobot Uji, pasi mjete i deklaruar me targa **AA**, figuron njëkohësisht i deklaruar në tenderin me objekt “*Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70-Vjetori i Pavarësisë*”, procedurë e vlerësuar nga e njëjta KVO me datë 07.06.2019, ndërkohë që procedura objekt shqyrtimi ka datë zhvillimi 28.06.2019.

e.Nuk përmbush kriterin për 1 Autobetoniere, pasi mjete i deklaruar me targa **AA**, figuron njëkohësisht i deklaruar në tenderin me objekt “*Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70-Vjetori i Pavarësisë*”, procedurë e vlerësuar nga e njëjta KVO me datë 07.06.2019, ndërkohë që procedura objekt shqyrtimi ka datë zhvillimi 28.06.2019.

ë.Nuk përmbush kriterin për 1 Rimorkiator, pasi mjete i deklaruar me targa **AA**, figuron njëkohësisht i deklaruar në tenderin me objekt “*Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70-Vjetori i Pavarësisë*”, procedurë e vlerësuar nga e njëjta KVO me datë 07.06.2019, ndërkohë që procedura objekt shqyrtimi ka datë zhvillimi 28.06.2019.

-Disa prej këtyre mjeteve, figurojnë njëkohësisht të deklaruara edhe në kontratat tjera të cilat janë në zbatim, konkretisht kontratat me objekt “*Sistemim, Asfaltim, Ndriçim i Rrugës Auto Lagjja e Vjetër në Qytetin Fushë - Arrëz*”, dhe “*Shtesë në Pedonale + Lulishte ne Qytetin Fushë - Arrëz*”.

*Në DST, kërkohet që makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata tjera....* Sa më sipër, rezulton që këto mjete rezultojnë të angazhuara në kontrata tjera, dhe njëkohësisht të shpallura fituese në procedura tjera të vlerësuara nga i njëjti AK, çka e bën vlerësimin në kundërshtim me kriteret e vendosura në DST.

**7.Tenderi me objekt: “Blerje lënde djegëse për ngrohje në Shkolla, Kopsht, Çerdhe për vitin 2019”, me këto të dhëna.**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje lende djegese per ngrohje ne Shkolla, kopsht dhe Çerdhe per vitin 2019”,</b>		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.187, datë 04.07.2019	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.187, datë 04.07.2019	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.07, datë 11.01.2019 1. K.S – (Kryetar) 2. A.D – (Anëtar) 3. F.D – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kerkese me Propozim”	1. L.Gj – Juriste 2. T.P – Inxhinier 3. E.M – Ekonomiste	
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 1,738,800 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “S.T” shpk” me ofertë 1,620,000 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 31.07.2019, me afat deri ne përfundim te sezonit te ngrohjes	7.Diferenca me fondin limit: 118,800- lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 16.07.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë/ Shtetit Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve.**

Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga znj. L.Gj, z. T.P dhe z. E.M.

**AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik ka kërkuar:**

1.Kërkesa e pikës **2.2 e DST Për kapacitetin ekonomik dhe financiar**, kërkohet për OE *Furnizime të ngjashme të kryera në vitet 2016-2017-2018 të shoqëruar me akt marrje në dorëzim të materialeve dhe formular vlerësimi nga autoritete kontraktore, vlera e tyre e marrë së bashku për te 3-vitet duhet te jete sa fondi limit qe prokurohet.*

Njëkohësisht, NJP ka hartuar në pikën **2.3 të DST Për kapacitetin teknik**, kërkesën që *OE të ketë furnizime të ngjashme në masën 40% të vlerës së objektit që prokurohet duke e vërtetuar me faturë tatimore ose me vërtetim të lëshuar nga blerësi.*

-Sa më sipër, kërkesat janë konfonduese, pasi pika e parë e saj e cila kërkon furnizime të ngjashme të realizuara përgjatë viteve 2016-2017-2018 vlera e të cilave të jetë sa fondi limit, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 27 “Kontrata e mallrave” të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, e cila përcakton qartë se për të provuar përvojën e mëparshme, AK kërkon furnizime të ngjashme të realizuar gjatë 3 viteve të fundit në një vlerë jo më të madhe se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, ndërkohë që AK ka kërkuar ekzaktësisht për 3 vitet e fundit që vlera të jeta **fiks sa fondi limit që prokurohet**, e cila është e pamundur për OE të plotësohet sa kërkohet.

-Lidhur me pikën 2 të kërkesës, sërish NJP në hartimin e kriterit, ka përcaktuar që furnizimet e ngjashme të jenë në masën 40% të vlerës së objektit që prokurohet, ndërkohë që duhej ti përmbahej dispozitës së cituar më sipër, ku kërkesën duhej të kërkonte për furnizime të



ngjashme në një vlerë jo më të madhe, dhe gjithashtu duhej të përcaktonte edhe periudhën e për vitet në të cilat kërkohen këto furnizime, e cila nuk është përcaktuar në DST.

-Gjithashtu, kërkesa e pikës **2.3 e DST**, ndër të tjera kërkon nga OE fitues të sigurojnë ambiente për magazinimin e druve, pasi institucionet që do ti përdorin nuk kanë hapësira të tilla për mbajtjen e tyre për një kohë të gjatë. Kjo kërkesë, në kushtet e mungesës së magazinimit të lëndëve, është e pa plotë, pasi NJP nuk ka parashikuar vendndodhjen e magazinës ose distancën nga e cila do bëhet shpërndarja, çka potencialisht mund të përbëjë pengesë për shërbimin e shpërndarjes së lëndës djegëse, duke marrë parasysh dhe zonën malore dhe dimrin e ashpër. Kjo anomali, bëhet me qartë pasi dhe OE fitues i kësaj procedure, S.T shpk, pavarësisht se plotëson kriterin formal të DST, rezulton se ka paraqitur kontratën për magazinimin e kësaj lënde në Lushnje, që është 188 km larg nga qendra e qytetit.

## **8.Tenderi me objekt: “Rikonstrukcion i kanalit ujitës, lagjja Fushaxhi”, me këto të dhëna.**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i kanalit ujitës, lagjja Fushaxhi”.</b>		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.235, datë 06.08.2019	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. L.Gj – Juriste 2. T.P – Inxhinier 3. E.M – Ekonomiste	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 07, datë 11.01.2019 1. K.S – (Kryetar) 2. F.D – (Anëtar) 3. A.D – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Kërkesë me propozim		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 3,429,985- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “D-1” shpk” me ofertë 3,305,788 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 23.09.2019, me afat 4 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 124,197- lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 19.08.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë/ Shtetit	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriteve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriteve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriteve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriteve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

### **Hartimi i kriteve.**

#### **AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik ka kërkuar:**

1.Kërkesa e pikës 2.2 e DST e cila kërkon nga OE *Punë të ngjashme në një kontratë të vetme e barabartë me 2.200.000 (dy milion e dyqind mijë) lekë të realizuar gjatë tri viteve të fundit ose kontrata për tre vitet e fundit e barabartë me 9.000.000 (nëntë milion) lekë*, është kërkesë në kundërshtim me pikën 6, germa *a dhe b* të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili përcakton si më poshtë: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

-NJP në hartimin e kriterit ka vendosur vlera për kontrata fikse 2,200,000 lekë për një kontratë të vetme dhe 9,000,000 për kontrata të ndryshme të realizuara 3 vitet e fundit. Kjo kërkesë, është në kundërshtim me aktet nënligjore të prokurimit publik, e cila krijon konfuzion dhe vlerësim jo objektiv të ofertave që paraqiten. Gjithashtu, është e pamundur që OE të kenë kontrata fikse siç është përcaktuar në DST nga NJP.

2.Kërkesa e pikës 2.2 të DST e cila kërkon nga OE *Vërtetim nga një bankë e nivelit të dytë për gjendjen financiare në vlerën prej 10% te fondit limit*, është kërkesë dhe standard i dyfishtë i përdorur nga NJP, pasi në asnjë nga procedurat tjera të zhvilluara për vitin 2019, nuk është vendosur ky kriter. Vlera e kontratës objekt prokurimi është 3.4 milion lekë, vlerë relativisht modeste për të kërkuar garanci apo vërtetime të kësaj natyre, që siç e citova më sipër nuk është kërkuar në asnjë procedura tjetër të zhvilluar për vitin 2019 nga ky AK.

3.Kërkesa për 1 mjek është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 "Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1 ku përcaktohet se:

"Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:

"6.Punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B", në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve "C" dhe "D", për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.

#### Vlerësimi i ofertës.

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	N shpk	2,844,510	<p><i>Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:</i></p> <p>1. <u>Mungon vërtetimi nga një bankë e nivelit të dytë për gjendjen financiare në vlerën prej 10% te fondit limit e kërkuar në DST, pika 2.2</u>"Kapaciteti ekonomik e financiar" paragrafi 2.</p> <p>2. <u>Kontrata e punës</u> (pune te ngjashme ) me nr 2334 Prot date 02.05.2019 "Ndërtim rruga konferenca e Mukjes vazhdim" është e parregullt pasi nuk është e firmosur faqe per faqe nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamez si dhe Deklarata per disa ndryshime ne Kontraten e Bashkepunimit nr.162 prot e nr.61/1 kol, date 07.03.2019 eshte e pasakte pasi nuk eshte e noterizuar (kjo bie ndesh edhe me formularin e vleresimit ku specifikohet se punet jane realizuar shume mire sipas kontrates se bashkepunimit mes dy operateveve ekonomik N shpk dhe K shpk 51% me 49% e per pasoje nuk permbushet kriteri i kerkuar ne DST, pika 2.2"Kapaciteti ekonomik e financiar" paragrafi 1, "Pune te ngjashme ne nje kontrate te vetme te barabarte 2.200.000 leke te realizuar tre vitet e fundit ose kontrate per tre vitet e fundit e barabarte me 9.000.000 leke, kjo e vertetuar me kontrate sipermarrje, situacion perfundimtar, akt kolaudim, certifikate e marrjes ne dorezim nga autoriteti kontraktor.</p>
2	A shpk	2,801,193	<p><i>Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:</i></p> <p>1. <u>Mungon dokumenta që vërtetojnë punë të ngjashme në një kontratë të vetme të barabarte 2.200.000 leke të realizuar tre vitet e fundit ose kontratë për tre vitet e fundit e barabarte me 9.000.000 leke, kjo e vërtetuar me kontratë sipermarrje, situacion perfundimtar, akt kolaudim, certifikate e marrjes ne dorezim nga autoriteti kontraktor, per operator privat kontrate sipermarrje , situacion perfundimtar dhe fature tatimore shitje te kerkuar ne DST pika 2.2 "Kapaciteti ekonomik e financiar" paragrafi 1, (nuk keni paraqitur asnje dokument qe vortetojne pune te ngjashme).</u></p> <p>2.<u>Mungon shtojca 9</u> "Deklarate mbi disponueshmerine e mjeteve" kerkuar ne DST pika 2"Kritere te vecanta", shkronja f.</p> <p>3.<u>Mungon shtojca 6</u> "Deklarate mbi permbushjen e specifikimeve teknike" kerkuar ne DST, pika 2 "Kritere te vecanta",shkronja ç.</p> <p>4. <u>Mungon shtojca 7</u> "Deklarate e konfliktit e interesit" kerkuar ne DST, pika 2 "Kritere te vecanta",shkronja d.</p>
3	D-1 shpk	3,305,788	<i>Kualifikuar dhe shpallur fitues</i>

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Fuzhë Arrëz z. F.T me nr. 4, datë 03.03.2020, është ngritur KVO i cili përbëhet nga z. K.S (kryetar), z. F.D dhe znj. A.D (anëtar). Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE, është kualifikuar 1 OE, dhe shpallur fitues OE "D-1" shpk me ofertë në vlerën **3,305,788 lekë** me diferencë nga fondi limit në vlerën **124,197 lekë**.

A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:

1.OE “D-1” shpk, nuk përmbush kriterin e pikës 2.3 të DST për 1 inxhinier miniere/gjeodet/markshajder. Është deklaruar inxhinier markshajder L.Ç për të cilin ka paraqitur diplomën fotokopje të panoterizuar. Në DST kërkohet ekzaktësisht që të gjitha dokumentet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

2.OE nuk përmbush kriterin për stafin teknik si më poshtë:

a.Nuk përmbush kriterin për 1 drejtues mjetesh, pasi punonjësit H.Q, figuron në listëpagesë me kod punësimi 8112.16 – *maknist i përpunimit të gurëve*;

b.Nuk përmbush kriterin për 1 armator pasi punonjësi i deklaruar A.F, figuron në listëpagesë me kod punësimi 9312.04 – *punëtor krahu mirëmbajtje rrugësh*;

c.Nuk përmbush kriterin për 1 manovrator pasi punonjësi i deklaruar J.GJ figuron në listëpagesë me kod punësimi 9312.04 – *punëtor krahu mirëmbajtje rrugësh*;

-Punonjësit e mësipërm të cituar me mangësi që lidhen me deklarin e tyre në listëpagesat e shoqërisë, bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, e cila përcakton kodet përkatëse të çdo profesioni të cilat pasqyrohen në listëpagesat përkatëse.

3.OE nuk përmbush kriterin për 1 mjek, pasi punonjësi i deklaruar N.C, rezulton se ka licencën e ushtrimit individual të profesionit për mjek jashtë afatit të vlefshmërisë, pasi licenca që ka paraqitur mban datën 02.09.2013 e cila është e vlefshme për 5 vjet. Data e zhvillimit të procedurës është 19.08.2019 e cila është përtej afatit të vlefshmërisë së licencës. Gjithashtu, kontrata dhe diploma e paraqitur rezultojnë kopje të pa noterizuara në kundërshtim me DST.

4.OE nuk përmbush kriterin për mjetin Autobetoniere, për të cilën duhet të paraqesë taksa, kolaudim dhe siguracion. Ky OE ka paraqitur për këtë mjet deklaratën doganore me nr. R 24627 për autobetoniere tip fiori... ky mjet rezulton mjet vetëlëvizës me goma i cili regjistrohet në regjistrat publikë, dhe për të cilin është e detyrueshme të disponojë policën e sigurimit, kolaudimin, pagesën e taksave vjetore të mjetit sipas kërkesës në DST.

## 9.Tenderi me objekt: “Shërbime projektimi për projekte të financuara nga Bashkia Fushë - Arrëz”, me këto të dhëna.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbime projektimi për projekte të financuara nga Bashkia Fushe-Arrez, për vitin 2019”		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.366, datë 14.11.2019	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.366, datë 14.11.2019	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.07, datë 11.01.2019 1. K.S – (Kryetar) 2. F.D – (Anëtar) 3. A.D – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Kerkese me propozim	1. S.M – Juriste 2. T.P – Inxhinier 3. A.I – Ekonomiste	
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 7,034,166- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE - BOE A S & H C & T H C shpk me ofertë 6,401,091 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 26.12.2019, me afat 25 dite	7.Diferenca me fondin limit: 633,075- lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 02.12.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë/ Shtetit Grandi i Bashkise Fushe-Arrez	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b)Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriteve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriteve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

## Vlerësimi i ofertës.

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	GJ & C shpk	6,408,125	<i>S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:</i> 1. Mungon 1 (një) inxhinier Gjeoteknik, kërkuar në DST, pika 2.2.4, pasi z.B.B nuk është inxhinier Gjeoteknik pasi ka DNP për Inxhinieri Gjeoinformatike dhe DND në inxhinieri Gjeologjike me profil "Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji", kjo vërtetohet edhe nga Kontrata Individuale Pune me nr.214 rep e nr.60 kol, datë 16.01.2016, tek Objekti i Kontratës përcaktohet se z.B.B merr përsipër të kryej detyrën e Inxhinierit Gjeolog, e për pasojë kriteri 2.2.4, PARAGRAFI 7, "1(një) Inxhinier Gjeoteknik", nuk plotësohet.
2	N.G shpk	6,645,613	<i>S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:</i> 1. Mungon Bilanci i vitit 2016, kërkuar në DST pika 2.1.2. 2. Mungojnë Licensat e Shoqërisë N G, Kat. 4 (d) dhe Kat. (e), kërkuar në DST, pika 2.2.3. 3. Diplomat e z.E.S e z.I.K, janë fotokopje (të panoterizuara) e për pasojë janë të pasakta. 4. Kontrata e z. V.B e z. E.L janë të panoterizuara, kërkuar të noterizuar në DST, pika 2.2.4. 5. Mungon Inxhinieri 1 (një) Hidroteknik, kërkuar në DST pika 2.2.4. 6. Mungon Inxhinier 1 (një) Gjeodet, kërkuar në DST pika 2.2.4. 7. Mungon Inxhinier 1 (një) Mjedisi, kërkuar në DST pika 2.2.4. 8. Mungojnë Licensat e Projektimit për Stafin Teknik, kërkuar në DST, pika 2.2.4. 9. Kontrata nr.4050 rep e nr.1612 kol, datë 06.09.2017, e zj. L.K, është fotokopje e aktit noterial e për pasojë është e pavlefshme.
3	BOE A S & H C & T H C	6,401,091	<i>Kualifikuar dhe shpallur fitues</i>

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz z. F.T me nr. 07, datë 11.01.2019, është ngritur KVO i cili përbëhet nga z. K.S (kryetar), z. F.D dhe z. A.D (anëtar). Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE, është kualifikuar 1 OE, dhe shpallur fitues BOE "A S & H C & T H C" shpk me ofertë në vlerën **6,401,091 lekë** me diferencë nga fondi limit në vlerën **633,075 lekë**.

-Ndërmjet operatorëve "A S & H C & T H C", është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me nr. 9881 Rep., Nr. 2565 Kol., datë 03.12.2019. Sipas marrëveshjen shoqëria "A S" merr përsipër kryerjen e 36% të shërbim projektimit për Kat 3 -a, Kat 4 - a, b, c, f, i, j, Kat 5 - b, c, d, Kat 6 -a, Kat 7 -a, Kat 10 - c; Shoqëria "H C" shpk merr përsipër shërbimet në masën 31% për Kat 2 - b1, b2, Kat 4 - d, e, Kat 5 b, c, d, e, f, Kat 6- a, Kat 7 - a, b, Kat 8 - e, Kat. 9 - e dhe Kat 11 -a; Shoqëria "T H C" shpk merr përsipër shërbimet në masën 33% për Kat. 1 -c, Kat 2 - a, c, d, Kat 3 - c2, Kat 5 - b, c, d, Kat 7 - b, Kat 8 - a, b, c, d, dhe Kat 9 - a.

*A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se BOE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:*

-Ndërmjet operatorëve "A S & H C & T H C", është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me nr. 9881 Rep., Nr. 2565 Kol., datë 03.12.2019. Sipas marrëveshjen shoqëria "A S" merr përsipër kryerjen e 36% të shërbim projektimit për Kat 3 -a, Kat 4 - a, b, c, f, i, j, Kat 5 - b, c, d, Kat 6 -a, Kat 7 -a, Kat 10 - c; Shoqëria "H C" shpk merr përsipër shërbimet në masën 31% për Kat 2 - b1, b2, Kat 4 - d, e, Kat 5 b, c, d, e, f, Kat 6- a, Kat 7 - a, b, Kat 8 - e, Kat. 9 - e dhe Kat 11 -a; Shoqëria "T H C" shpk merr përsipër shërbimet në masën 33% për Kat. 1 -c, Kat 2 - a, c, d, Kat 3 - c2, Kat 5 - b, c, d, Kat 7 - b, Kat 8 - a, b, c, d, dhe Kat 9 - a.

1.OE "A S" shpk, i cili ka marrë përsipër kryerjen e 36% të shërbimit sipas marrëveshjes dhe kategorive përkatëse, nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.4 të DST** për 1 inxhinier ndërtimi dhe 1 Arkitekt të cilët duhet të jenë drejtues teknik të shoqërisë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se ky OE ka paraqitur inxhinierët A.A si inxhinier ndërtimi dhe R.H si Arkitekt, ndërkohë në licencën e shoqërisë me Nr.6719/1 asnjëri nga këta inxhinier nuk figuron drejtues teknik.

2.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.4 të DST** për një 1 inxhinier gjeoteknik i cili duhet të jetë drejtues teknik në licencën e shoqërisë. Është paraqitur inxhinieri P.A, i deklaruar nga OE "T H C" shpk, i cili nuk figuron drejtues teknik në licencën e paraqitur nga ky subjekt me N.4851/7.

3.OE T.H.C nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.4 të DST** për 1 inxhinier hidroteknik i cili duhet të jetë drejtues teknik në licencën e shoqërisë. Ky OE, i cili ka marrë përsipër shërbime që lidhen me hidroteknikën, ka deklaruar inxhinierët F.Q dhe A.K, të cilët nuk figurojnë në licencën e shoqërisë me nr. 4851/7 të paraqitur nga ky subjekt.

**10.Tenderi me objekt: “Ndërtim i mureve mbajtës të pallateve në Qytetin Fushë-Arrëz (Faza-1-rë)” me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim i mureve mbajtës të pallateve në Qytetin Fushë-Arrëz (Faza I-rë)”</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi Nr. 303, Datë 30.09.2020</b>	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Urdhër Nr. 41 dt. 10.02.2020	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër Nr. 251/1 dt. 19.09.2020
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për Propozim	1. S.M 2. T.P 3. A.I	1. S.Gj – (Kryetar) 2. K.S – (Anëtar) 3. A.D – (Anëtar)
<b>5. Fondi Limit (pa TVSH)</b> 11,666,666	<b>6. Oferta fituese (pa TVSH)</b> OE "U", Sh.P.K, 11,550,008 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)</b> 116,658 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 14.10.2020	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë dhe Grandi i qeverisjes qendrore	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) S’kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>11. Ankimime</b> AK-s’ka; APP–s’ka KPP-s’ka.	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S’ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP</b> S’ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 2884, datë 13.11.2020	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 13,860,010 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.</b>
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> 3 muaj	<b>19. Zgjatja e kontratës me - ditë</b> -

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Mbi përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të ndryshuara nëpërmjet shtojcës së ndryshimit datë 09.10.2020, dokumentuar nëpërmjet procesverbalit nr.2, datë 30.09.2020 të mbajtur nga NJP për argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit. AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik ka kërkuar:**

**Pika 2.3.1.a-Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:** Në lidhje me përvojën e mëparshme të ofertuesit, kërkohet pune te ngjashme në një vlerë jo me te madhe 50% të fondit limit për të cilin prokurohet, të realizuara nga operatori ekonomik gjate tri vitet e fundit – Ndërkohë sipas përcaktimit të bërë në shkronjën “a” të pikës 6 në nenin 26, përcaktimi për të vërtetuar përvojën e mëparshme është: “punë të ngjashme **për një objekt të vetëm** në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”. Pra është specifikuar duke shtuar togfjalëshin “për një objekt të vetëm”. Gjithashtu në kriterin e mësipërm, pas fjalëve “gjatë tri viteve të fundit” nuk është vendosur edhe togfjalëshi “nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit” duke përjashtuar automatikisht OE, të cilët kanë kryer punime të ngjashme gjatë periudhës Janar-Shtator 2020.

Në vijim kërkohet, që për të vërtetuar plotësimin e kushteve të mësipërme, duhet të dorëzohet: “Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore: Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 8) i shoqëruar me: - Kontratë punimesh; - Situacion përfundimtar; - Akt-kolaudimi; - Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera – faturën tatimore të deklarimit të objektit në organet tatimore” – Pra konstatohet se nuk përcaktohet qartë dokumentacioni i kërkuar, dorëzimi i procesverbalit të **përkohëshëm** për marrje në dorëzim të punimeve të kryera apo procesverbal **përfundimtar**. Kërkesa e mësipërme nuk është e plotë, por është evazive duke krijuar mundësinë për subjektivitet gjatë vlerësimit të ofertave nga KVO.

**Pika - 2.3.3** - AK kërkon që për personelin dhe fuqinë punëtore Kandidati/ofertues duhet të vërtetojë se disponon numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontrates dhe për këtë provuar këtë kusht, duhet të ketë një punësim mesatar për periudhën Janar 2020 - Gusht 2020 i të paktën 20 punonjës - Periudha e vendosur Janar 2020 - Gusht 2020, *nuk është argumentuar nga NJP, në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës*. Për më tepër që numri i tyre nuk argumentohet me analizë sipas zërave të punimeve, grafikut, pra sa kohë do të zgjasin punimet e gërmimit, mbushjes etj, si do të organizohet puna me 1 turn apo më tepër dhe sa punonjës do të angazhohen për këtë zë punimi, duke arritur në përfundimin se duhet ky numër punonjësish. Gjithashtu sqarojmë se një inxhinier që të jetë drejtues teknik në një shoqëri duhet të ketë minimalisht 5 vite/3 vite pune eksperiencë (jo me të njëjtën shoqëri për 3/5 vite)<sup>22</sup>. Në këto kushte inxhinieri mund të ketë mbi 5 vite pune eksperiencë, si dhe 3 muaj që është i punësuar në një subjekt që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit, pra nga OE plotësohet kërkesa për inxhinierin, duke dorëzuar edhe licencën e kërkuar (ku inxhinieri/ët të jenë drejtues teknik) e cila tregon se OE është vlerësuar nga institucionet e autorizuar me ligj, dëshmohet edhe kapaciteti që OE zotëron, por nuk plotësohet afati prej 6 muajsh që të jetë i punësuar pranë këtij OE, duke sjellë që ky OE megjithëse në thelb i plotëson kapacitetet teknike, të mos konkurrojë, duke ndikuar negativisht në konkurrencën në treg. Vendosja e periudhës së mësipërme tregon më tepër qëndrueshmëri financiare, besueshmëri të OE, por jo përmbushjen e kapaciteteve teknike.

**Pika 2.3.4** - Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar stafin inxhinierik me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, ndër të tjerë edhe Inxhinier Gjeolog - 1 (një) – Kërkesa për inxhinierin gjeolog është e paargumentuar, pasi projektimi i punimeve ka përfunduar (faza ku kërkohet inxhinieri gjeolog për të studiuar morfologjinë e tokës, studim i cili është bërë në specifikimet teknike të projektit të mësipërm) dhe në këtë rast jemi në fazën e zbatimit të punimeve.

-**Në pikën 2.3.5** kërkohet që operatori ekonomik duhet të ketë **1 (një) mjek** të përgjithshëm të punësuar - Kërkesa për mjek është e tepërt dhe nuk ka lidhje me asnjë nga përcaktimet e kontratës dhe është në kundërshtim me VKM nr. 632, datë 15.07.2015, e cila ka ndryshuar VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1, ku përcaktohet se: “Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje, si më poshtë vijon: “6. Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë”.

-Gjithashtu në DST citohet: “*Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike secili operator duhet të ketë në stafin e tij të punësuar 1(një) mjek të përgjithshëm*” - Vendosja e kriterit se në rastin e BOE secili prej operatorëve ekonomikë duhet të plotësojë këtë kriter është i padrejtë dhe është në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **neni 74 pika 3** ku citohet ....“*secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe atë të përcaktuara në DT. Kërkesat ekonomike, financiarë, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me % e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të*

<sup>22</sup> Shkronja “a” pika 1 në Kreun IV të VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

*percaktuar në aktmarrëveshje*". Rrjedhimisht, kërkesa e mësipërme zvogëlon konkurrencën, pasi një operator, i cilit nuk disponon "*Mjek*" nuk mund të kryejë bashkim operatorësh apo aktmarrëveshje për realizim punimesh, pra përjashtohen OE **duke i mohuar mundësinë e bashkimit**. Veç sa më sipër, kërkesa është jo në përputhje edhe me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontraktojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë, pra jo domosdoshmërisht ta ketë të punësuar në stafin e tij.

-Në pikën 2.3.6 është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, nga të cilët të paktën:

- Karpentirë 3 (tre)
- Hekurkthyes 2 (dy)
- Specialist Ndërtimi 2 (dy)
- Pllakashtrues 1 (një)

-Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën **1 (një) teknik ndërtimi, 1 (një) teknik gjeodet të certifikuar**, për të cilët duhet të paraqesë kontratën e punës të vlefshme, diplomë, kartela personale të sigurimit teknik IQT ose ekuivalente dhe të jetë në listëpagesat e shoqërisë.

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht **2 (dy) manovratorë** të mjeteve të rënda, dhe **3 (tre) drejtues mjjetesh** të pajisur me dëshmitë perkatese, kontratë pune të vlefshme dhe të jetë në listëpagesat e shoqërisë. Për këto punonjës duhet të paraqitet dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse, kartela personale të sigurimit teknik IQT ose ekuivalente si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Operatori ekonomik duhet të percaktojë me anë të një deklarate (nga administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që punimet do të kryhen në objekt shoqëruar me dokumentacionin si me poshtë: Libreze pune; Cv; Kontrate pune te vlefshme.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë – Për kërkesat e mësipërme sqarojmë se:

-Numri i punonjësve të mësipërm nuk është i argumentuar nga AK, duke u bazuar në analizë teknike, grafikun e punimeve, orët e punës që duhen për të realizuar secilin prej zërave të punimeve sipas preventivit;

-Nëse do të mblidhim numrin e punonjësve të kërkuar në mënyrë të detajuar sipas llojit të profesionit, rezulton se kërkohen gjithësej 23 punonjës, ndërkohë që në pikën 2.3.3, kërkohet që numri i punonjësve të jetë 20 gjithësej;

-Sa i përket kërkesës për dëshmi të sigurimit teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga një trup certifikuese e akredituar, sqarojmë se kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, pasi në preventiv ekzistojnë *vetëm punime ndërtimi dhe nuk ka punime elektrike*. Referuar dispozitave të ISHTI, dëshmitë u jepen për kategoritë mëposhtme:

Për Naftën dhe Gazin Natyror. 1. Për pajisje nën Presion, 2. Për Instalimet Elektrike, 3. Për laborator të kontrolleve. Për rrjedhojë, në kushtet kur preventivi, nuk ka asnjë pajisje në proces pune që ka të bëjë me rrjetin, apo skemat elektrike, atëherë është e qartë se kjo dëshmi e sigurimit teknik që janë për punime elektrike, nuk ndikon në vlerësimin e kualifikimit teknik të stafit.

-Nuk specifikohet lloji i certifikatës për teknikun gjeodet, duke vendosur një kriter evaziv dhe jo konkret, ç'ka mund të sjellë subjektivitet në vlerësimin e përmbushjes së këtij kriteri, gjatë vlerësimit të ofertave nga KVO.

-Në vijim të kërkesës së mësipërme, është i paargumentuar ligjërisht përcaktimi i certifikimit të manovratorëve, ndërkohë që kuadri rregullator i fushës<sup>23</sup> përcakton se manovratorët duhet

<sup>23</sup> VKM nr.736, datë 1.7.2009 për disa ndryshime në VKM nr.808, datë 4.12.2003 të këshillit të ministrave "Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit" dhe Urdhër nr. 200, datë 16.5.2019 për miratimin e rregullores "për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së

të kenë dëshmi aftësie për përdorimin e mjeteve të caktuara. Pra kërkesa për certifikimin e tyre, pa përcaktuar objektin konkret, ngushton edhe konkurrencën, pasi një subjekt mund të ketë 6 manovrator të pajisur me dëshmi aftësie, por nuk i ka të certifikuar.

-Kërkesa që OE ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, njërin nga drejtuesit teknik të tij, si Drejtues Teknik të punimeve në objekt përgjatë gjithë afatit të punimeve – Sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, shprehimisht: “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”. Pra sa më sipër nuk jemi në kushtet kur preventivi i punimeve është mbi 30,000,000 lekë, si dhe nuk është e nevojshme deklarata e mësipërme.

-Është kërkuar që OE të ketë 1 inxhinier ndërtimi, 2 specialist ndërtimi dhe 1 teknik ndërtimi, pra nuk argumentohet se përse njëkohësisht duhet specialisti dhe tekniku i ndërtimit, ndërkohë që detyrat mund t'i kryej njëri prej tyre. Gjithashtu nuk argumentohet kërkesa e AK që OE duhet të ketë 1 inxhinier gjeodet dhe njëkohësisht 1 teknik gjeodet, pasi detyra e topografit/inxhinierit gjeodet është identifikimi dhe lidhja e projektit me terrenin, detyrë e cila kryhet prej tij dhe nuk ka nevojë edhe për 1 teknik gjeodet.

**Në pikën 2.3.7** kërkohen dëshmi për makineritë dhe paisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, për makineritë dhe paisjet e mëposhtme (në pronësi ose me qera):

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamione vetëshkarkues, kapaciteti total mbajtës minimumi 27 ton	në pronësi ose me qera	copë	1
2	Kamion vetë shkarkues me kap mbajtes 5 - 7 ton	në pronësi ose me qera	copë	1
3	Kamionçine 2-3 Ton	në pronësi ose me qera	copë	1
4	Kamion me vinq	në pronësi ose me qera	copë	1
5	Autobetoniere vete ngarkuese mbi 3.5 m <sup>3</sup>	në pronësi ose me qera	copë	1
6	Fadromë me goma	në pronësi ose me qera	copë	1
7	Minieskavator	në pronësi ose me qera	copë	1
8	Rul ngjeshes 7 deri 9 ton	në pronësi ose me qera	copë	1
9	Motogjeneratorë	në pronësi ose me qera	copë	1
10	Betoniere	në pronësi ose me qera	copë	3
11	Vibrator betoni	në pronësi ose me qera	copë	3
12	Tokmak Elektrik	në pronësi ose me qera	copë	1
13	Matrapik	në pronësi ose me qera	copë	2
14	Çekic pneumatik	në pronësi ose me qera	copë	1
15	Pompe uji	në pronësi ose me qera	copë	2
16	Betoforma metalike/druri	në pronësi ose me qera	m2	200
17	Skeleri metalike	në pronësi ose me qera	m2	100
18	Lende druri e sharruar	në pronësi ose me qera	m3	4

- Sa më sipër, konstatohen kërkesa kualifikuese jo në përputhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës.

Sic vërehet janë kërkuar numër i konsiderueshëm mjeteve në mënyrë të pajustificuar e të paargumentuar teknikisht në lidhje me natyrën dhe volumin e punimeve. Është kërkuar tokmak elektrik, por sipas preventivit të punimeve nuk kemi zë punimesh (ngjeshje dheu) ku kërkohet përdorimi i tokmakut elektrik.

-Nuk është kërkuar dorëzimi i dokumentacionit teknik të mjeteve, ku përveç lejes së qarkullimit, duhej kontrolli teknik i mjetit, pagesa e taksës vjetore të automjetit, me qëllim vërtetimin e plotësisht të kërkesës së përcaktuar në shkronjën “dh” të pikës 2 në nenin 45 në LPP nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

-Kërkohet kamion 5-7 ton ndërkohë edhe kamionçinë 2-3 ton, kërkesë e cila nuk argumentohet sipas grafikut dhe volumit të punimeve.

---

aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”.



-Në vijim të pikës së mësipërme është kërkuar rul ngjeshës dhe eskavator, ndërkohë nuk kërkohet rimorkiatori për transportin e tyre, pasi përfshihen në kategorinë e mjeteve të cilat nuk mund të qarkullojnë<sup>24</sup>.

**Pika 2.3.8** - Nga AK kërkohet që Kandidati/Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatat e Standartizimit si:

**1.ISO-14001:2015** (Sistemi i menaxhimit të ambientit) – Kërkesa për këtë certifikatë nuk argumentohet nga AK. Sqarojmë se ISO 14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. Në rastin në fjalë projekti si fillim i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis, përpara se ai të miratohet dhe kjo fazë është ezauruar përpara zbatimit të tij. Gjithashtu menaxhimi mjedisor (përsëmbull mbrojtja e mjedisit nga zhurmat e mjeteve të cilat do të punojnë në segmentin rrugor) që duhet të sigurojë subjekti gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, është detyrim ligjor<sup>25</sup> që duhet të respektohet nga subjekti nëpërmjet marrjes së masave paraprake, të cilat nuk plotësohen nëpërmjet disponimit të certifikatës së sipërpërmendur. Pra që të përcaktosh kritere të tilla duhet një bazë ligjore, si dhe të jepen arsye/argumentim konkrete për përcaktimin/nejvojën e tyre, që në këtë rast nuk është dhënë, si dhe duhet të jenë përputhje me zërat e punimeve që do të realizojë OE.<sup>26</sup> Për më tepër referuar procesverbalit të mbajtur nga NJP, për vendosjen e kërkesës për certifikatat ISO, pasqyrohet argumenti se janë vendosur për cilësinë e mallit. Për këtë argument, sqarojmë se referuar përcaktimit të bërë në shkronjën “c” të pikës 1 dhe shkronjën “dh” në pikën 9 në Kreun III të Udhëzimit Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, cilësia e mallit vërtetohet nëpërmjet dokumenteve (certifikatë analizat e mallit) që dorëzohen gjatë zbatimit të punimeve, ku plotësohet dosja e kantierit dhe kontrollohen nga përgjegjësi/drejtuesi teknik i kantierit.

Në **pikën 2.3.9** kërkohet që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi, ose nga distributor i licencuar për prodhim të pllakave të gurit dhe betoneve - Vendosja e këtij kriteri nuk argumentohet pasi OE mund të jetë edhe shpërndarës i këtij produkti, hallka e fundit e zinxhirit të furnizimit të produktit në treg (Prodhues – Distributor i Autorizuar – Importues për Shqipërinë – Shpërndarës)<sup>27</sup>. Gjithashtu OE mund të pasqyrojë edhe kontratë furnizimi të betonit dhe pllakave të gurit, mund të ketë gjëndje të tyre (pllaka guri) të cilat mund ti ketë blerë nga subjekte të tjera ekonomike, mund të ketë kontratë qiraje për impiant të prodhimit të betonit.

Sa më sipër konstatohet: Vendosja e kriterëve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe jo në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës së prokuruar, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

### **Vlerësimi i ofertave.**

KVO është ngritur me urdhër Nr. 251/1 dt. 19.09.2020 të Kryetarit të Bashkisë dhe përbëhet nga z. S.Gj, Kryetar, z. K.S dhe z. A.D Anëtar.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE përkatësisht:

BOE “A” Sh.P.K dhe “A.I.G.C” Sh.P.K, me ofertën ekonomike në shumën 9,814,870 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit, gjithësej 1,851,796 lekë.

BOE “O” Sh.P.K dhe “S A” Sh.P.K, me ofertën ekonomike në shumën 10,996,640 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit, gjithësej 670,026 lekë.

OE “U” Sh.P.K me ofertën ekonomike në shumën 11,550,008 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit, gjithësej 166,658 lekë.

<sup>24</sup> Pika 2 në nenin 173 në Kodin Rrugor.

<sup>25</sup> Neni 4 në Ligjin nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar.

<sup>26</sup> Pika 2 në nenin 61 në VKM nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, si dhe njoftimin nr.3341/1 datë 20.03.2018 të APP për AK.

<sup>27</sup> Pikat 5-9 në nenin 3 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar.

Janë s'kualifikuar 2 BOE "A" Sh.P.K dhe "A.I.G.C" Sh.P.K, si dhe BOE "O" Sh.P.K dhe "S AL" Sh.P.K.

-Është shpallur fitues OE "U" Sh.P.K me ofertën ekonomike më të lartë në krahasim me dy BOE, përkatësisht, 1,735,138 lekë diferencë nga BOE "A" Sh.P.K dhe "A.I.G.C" Sh.P.K, si dhe 553,368 lekë nga BOE "O" Sh.P.K dhe "S AL" Sh.P.K.

BOE të skualifikuar:

➤ "A" Sh.P.K dhe "A.I.G.C" Sh.P.K, është s'kualifikuar me arsyet e mëposhtme:

1. Mungon një mjek i shoqërisë A.
2. Mungojnë diplomat për Teknikun e Ndërtimit dhe Teknikun Gjeodet.
3. Mungon autorizimi i prodhuesit ose distributorit të licensuar për prodhime të pllakave të gurit dhe betoneve, kërkuar në DST, pika 2.3.9, konkretisht është paraqitur Autorizim nga D. I. datë 19.10.2020, por pas verifikimit të ekstraktit të QKB rezultoi se shoqëria D. I. shpk, nuk është prodhuese ose distributor për prodhim pllakash guri dhe betoneve.
4. Mungon një fadromë me goma, kërkuar në DST, pika 2.3.7, pika 6.
5. Mjetet e paraqituara nga A Sh.P.K, nuk kanë dokumenta shoqërues, kërkuar në DST, pika 2.3.7, paragrafi III.
6. Shoqëria A Sh.P.K, nuk ka numrin e punonjësve gjatë periudhës Janar – Gusht 2020, (6 gjastë punetor) numer që është i domosdoshëm për 30 % të punimeve që ka marrë përsipër të kryejë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me Nr.913 Rep. dhe Nr.432/1 Kol, i datës 19.10.2020 dhe Prokurës së Posacme me Nr.914 Rep. dhe Nr.433/1 Kol, datë 19.10.2020.
7. A shpk nuk ka paraqitur asnjë ISO sipas punëve që ka marrë përsipër të kryejë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me Nr.913 Rep. dhe Nr.432/1 Kol, i datës 19.10.2020 dhe Prokurës së Posacme me Nr.914 Rep. dhe Nr.433/1 Kol, datë 19.10.2020, të kërkuar në DST, pika 2.3.8.
8. Deklarata e disponshmërisë së makinerive është e pasaktë, kërkuar në DST, pika 2.3.7, paragrafi II.

➤ BOE "O" Sh.P.K dhe "S AL" Sh.P.K, është s'kualifikuar me arsyet e mëposhtme:

1. Mungon dokumenti që verteton punët e ngjashme të shoqërisë O Sh.P.K, kërkuar në DST, pika 2.3.1, shkronja "a".
2. Mungon autorizim i prodhuesit ose distributorit të licensuar për prodhime të pllakave të gurit dhe betoneve, kërkuar në DST, pika 2.3.9, konkretisht është paraqitur autorizim nga GJ –AN Sh.P.K datë 19.10.2020, por pas verifikimit të ekstraktit të QKB rezultoi se shoqëria GJ – AN Sh.P.K, nuk është prodhuese ose distributor për prodhim pllakash guri, e për pasojë ky kriter nuk plotësohet.

-S'kualifikimi i BOE të mësipërm qëndron.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit përse i përket vlerësimit të ofertës konstatohet se:

-Nga OE U shpk nuk është plotësuar kërkesa e vendosur në pikën 2.2.2 të DST, konkretisht: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2019 – Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, me qëllim evidentimin e procedurave të prokurimit publik, në të cilat është shpallur fitues OE U Sh.P.K, konstatohet se jo për të gjitha vëndet e ushtrimit të aktivitetit ku ka kryer punime ndërtimi ka sjellë vërtetimin e pagesave të taksave dhe tarifave vendore, pasqyruar si më poshtë vijon:

Autoriteti_kontraktues	Objekti_i_prokurimit	Fituesi	Teritorri Administrativ	Ka dorëzuar vërtetim
Bashkia Kamez	Ndertim Rruga "Adem Jashari+Muharrem bajraktari+Orikumi"Laknas	U	NJQV Kamëz	Jo
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	Loti 3 - Argjinatura mbrojtëse Zalli Sines	U	NJQV Dibër	Jo

Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhe	Rehabilitim i argjinatures se lumit Buna Pentar-Luarez Shkoder	U	NJQV Shkodër	Jo
Bashkia Kruje	'Sistemim-asfaltim i rrugëve të "Sinurit", Fshat Fushë Krujë, Nj.A.Fushë Krujë	U	NJQV Krujë	Jo
Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës	Punime mirembajtje ne kanalim ujites, Klos	U	NJQV Klos	Jo
Bashkia Kavaje	Ndertim i shkollës 9 vjecare Golem,Kavaje	U	NJQV Kavajë	Jo
Bashkia Kamez	Rehabilitim i digaes rezervuari paskuqan	U	NJQV Kamëz	Jo

-Nuk janë dorëzuar certifikatat e aftësisë profesionale, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 115/1 në Ligjin nr. datë 22.7.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht: *"Drejtuesit e mjeteve, mbajtës të lejedrejtimit të kategorive C1 ose C, C1E apo CE, e marrin certifikatën e aftësisë profesionale për transportin e mallrave dhe drejtuesit e mjeteve, titullarë të lejedrejtimit të kategorive D1, D1E, D dhe DE, e marrin certifikatën e aftësisë profesionale për transportin e pasagjerëve. Kjo e fundit është e nevojshme gjithmonë në rastin e transportit të nxënësve"*, si dhe me përcaktimin e bërë në nenin 39/1 në Ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar: *"Drejtuesit e mjeteve me peshë të përgjithshme të lejuar me ngarkesë mbi 6 tonë ose kur ngarkesa e lejuar, përfshirë rimorkion ose gjysmërimorkion, i kalon 3,5 tonë në transportin e mallrave, pajisen me certifikatën e aftësisë profesionale, në përputhje me udhëzimin e ministrit"*.

-Dy shoferat SH.Ç dhe A.S kanë leje drejtimi të kategorisë B, C, D, BE, CE, DE. Gjithashtu shoferit N.B për drejtimin e kamionit tjetër, afati i vlefshmërisë së kategorisë C dhe CE ka mbaruar.

-Për manovratorët nuk është dorëzuar leje drejtimi, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 2 në nenin 8 në Kreun III të Urdhrit Nr. 200, datë 16.5.2019 Për miratimin e rregullores "për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit", ku përcaktohet shprehimisht:

2. Për lëvizjen apo qarkullimin në rrugë, makineritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nëse janë të pajisura me rrota pneumatike, duhet të plotësojnë kërkesat e nenit 113 dhe 122 të Kodit Rrugor, kurse drejtuesit e tyre, në varësi të makinerisë, duhet të jenë të pajisur me kategorinë përkatëse të lejedrejtimit.

-Gjithashtu nuk është sjellë dëshmi profesionale të kategorisë "Buldozerist" dhe "Automakinist", për drejtimin e rullit dhe autobetonieres.

OE U ka dorëzuar kontratën e punës për A.K, si specialist ndërtimi, ndërkohë në listë-pagesen e subjektit figuron si ekonomist.

Sipas VKM nr. Nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", të rishikuar, kodi i profesionit 2631.05 është: "Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve "Ekonomistë", niveli i katërt i kompetencës në LKP. Ekonomisti bën kërkime, monitoron të dhënat, analizon informacionin, përgatit raporte për të zgjidhur problemet ekonomike të biznesit, shpjegon dhe bën parashikime ekonomike, këshillon biznesin, grupet e interesit, qeverinë për të formuluar zgjidhje për problemet e tyre ekonomike. Ekonomisti bën prognoza si do shkojnë çmimet, kush janë konkurrentët, furnitorët, klientët, strategjitë duke aplikuar metoda statistikore dhe matematikore. Ai mund të punësohet në organizata biznesi dhe institucione publike. Funksionet kryesore

- Parashikojnë ndryshimet në një njësi ekonomike, planifikojnë buxhet afatshkurtër, afatgjatë dhe bëjnë vlerësim për investime;
- Formulojnë rekomandime, politika dhe planifikojnë strategji për investime të korporatave;
- Monitorojnë të dhënat ekonomike për politikën fiskale dhe monetare dhe japin këshilla në bazë të tyre;
- Parashikojnë prodhimin e produkteve apo shërbimeve të caktuara, bazuar në të dhënat e konsumit dhe kushteve specifike të industrisë;
- Përgatitin parashikime për të ardhurat dhe shpenzimet, nivelin e interesave dhe të këmbimit valutës;

- f) Analizojnë faktorët që përcaktojnë punësimin, pagat, papunësinë dhe rezultatet e tjera të tregut të punës;
- g) Aplikojnë formula matematikore dhe teknika statistikore për të testuar teori ekonomike si dhe u japin zgjidhje problemeve ekonomike;
- h) Përpilojnë, analizojnë dhe interpretojnë të dhënat ekonomike duke përdorur teoritë ekonomike dhe teknika të tjera statistikore;
- i) Vlerësojnë rezultatin e vendimeve politike lidhur me ekonominë dhe financat publike dhe këshillojnë politika ekonomike;
- j) Ekzaminojnë problemet lidhur me aktivitetet ekonomike të kompanive individuale;
- k) Kryejnë studime në kushtet e tregut në nivel lokal apo kombëtar për të përcaktuar nivelin e çmimeve dhe shitjeve për produkte e shërbime, për të përcaktuar potencialin e tregut, trendin e ardhshëm dhe për të zhvilluar strategji biznesi;
- l) Përpilojnë ofertat ekonomike të cilat mund t'u drejtohen njësisve publike apo private;
- m) Monitorojnë dhe konsultohen me specialistët mbi ndryshimet ligjore;
- n) Respektojnë legjislacionin dhe udhëzimet e tij;
- o) Rritin dhe zhvillojnë aftësitë e veta përmes kualifikimeve në këtë sektor.

Kërkesat për punësim

a. Arsim i Lartë;

b. Preferohen kualifikime në fushën e ekonomisë apo financës;

c. Të ketë aftësi për të vepruar.

-Sqarojmë se bazuar në Udhëzimin nr.23, datë 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar, për plotësimin e rubrikave të deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë mbajnë parasysh sa më poshtë respektimin e pikave 1-12, ndër të cilat është edhe pika 11. *Në rubrikën 11 “Detyra, funksioni, profesioni apo puna që ka kryer punonjësi” – shënohet detyra apo profesioni që punonjësi kryen në tatimpaguesin përkatës. Detyra apo profesioni zgjidhen nga lista kombëtare e profesioneve.*

-Po kështu edhe për punonjësin B.A, për të cilin është dorëzuar kontrata si pllakashtrues, ndërkohë në listë-pagesen e subjektit figuron si puntor krahu ndërtimi. Sipas VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, kodi i profesionit për pllakashtrues është 7122; Për punonjësin E.P, për të cilin subjekti ka dorëzuar kontratë si karpentier, ndërkohë në listë-pagesë figuron si drejtues i mjeteve të rënda dhe si menaxher kantieri; Për punonjësin I.Ç, për të cilin subjekti ka dorëzuar kontratë si karpentier, ndërkohë në listë-pagesë figuron si konsulent menaxhimi; Për punonjësin SH.Ç, për të cilin subjekti ka dorëzuar kontratë si shofer, ndërkohë në listë-pagesë figuron si punonjës murature; -Pra subjekti ka paraqitur informacion jo të vërtetë.

## 11. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Hapje rruge e re auto Strame – Aprripe Guri”.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Hapje rruge e re auto Strame –Aprripe Guri”		
<b>1. Urdhër Prokurimi Nr. 331, Datë 04.11.2020</b>	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Urdhër Nr. 41 dt. 10.02.2020	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër Nr. 251/1 dt. 14.09.2020
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për Propozim	1.S.M 2.T.P 3.A.I	-S.Gj, Kryetar, -K.S, Anetar. -A.D, Anëtar,
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 2,083,333	<b>6. Oferta fituese (pa TVSH)</b> OE " S - AL ", sh.p.k, 1,999,735 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)</b> 83,598 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 17.11.2020	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë dhe Grandi i qeverisjes qendrore	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>11. Ankimime</b> AK-s'ka; APP-s'ka KPP-s'ka.	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S'ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP</b> apo AKKP S'ka

<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 3155, datë 10.12.2020	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> 2,399,682 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.</b>
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në dite</b> 3 muaj	<b>19. Zgjatja e kontratës me - ditë</b>

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Mbi përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të ndryshuara nëpërmjet shtojcës së ndryshimit datë 09.10.2020, dokumentuar nëpërmjet procesverbalit nr.2, datë 10.07.2020 të mbajtur nga NJP për argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit.**

***AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik ka kërkuar:***

**Pika 2.3.1.a-Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:** Në lidhje me përvojën e mëparëshme të ofertuesit, kërkohet pune të ngjashme në një kontratë të vetme jo më të madhe se 50% të fondit limit për të cilin prokurohet, të realizuara nga operatori ekonomik gjatë tri viteve të fundit – Në kriterin e mësipërm, pas fjalëve “gjatë tri viteve të fundit” nuk është vendosur edhe togfjalëshi “nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit” duke përjashtuar automatikisht OE, të cilët kanë kryer punime të ngjashme gjatë periudhës Janar-Shtator 2020. Në vijim kërkohet, që për të vërtetuar plotësimin e kushteve të mësipërme, duhet të dorëzohet: “Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore: Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 8) i shoqëruar me: - Kontratë punimesh; - Situacion përfundimtar; - Akt-kolaudimi; - Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera – faturën tatimore të deklarimit të objektit në organet tatimore” – Pra konstatohet se nuk përcaktohet qartë dokumentacioni i kërkuar, dorëzimi i procesverbalit të **përkohëshëm** për marrje në dorëzim të punimeve të kryera apo procesverbal **përfundimtar**. Kërkesa e mësipërme nuk është e plotë, por është evazive duke krijuar mundësinë për subjektivitet gjatë vlerësimit të ofertave nga KVO.

**Në pikën 2.3.7** kërkohen dëshmi për makineritë dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, për makineritë dhe pajisjet e mëposhtme (në pronësi ose me qera):

<b>Nr</b>	<b>Lloji i makinerive</b>	<b>Pronësia</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
1	Mjete të rënda gërmimi me goma copë 2(dy) me kapacitet 2 m <sup>3</sup> .	në pronësi ose me qera	copë	2
2	Mjete të rënda gërmimi me zinxhir copë 1.	në pronësi ose me qera	copë	1
3	Mjet i lehtë gërmimi (bobcat) me zinxhir copë 1(një).	në pronësi ose me qera	copë	1
4	Kamionçinë 1.5 t e lart copë 1(një).	në pronësi ose me qera	copë	1
5	Kamion me kapacitet 20 t e lart copë 1 (një).	në pronësi ose me qera	copë	1
6	Gjenerator me ndriçim copë 1(një).	në pronësi ose me qera	copë	1
7	Prozhektor ndriçimi copë 2(dy).	në pronësi ose me qera	copë	2
8	Kokore copë 12.	në pronësi ose me qera	copë	12
9	Tabelë paralajmëruese copë 2.	në pronësi ose me qera	copë	2
10	Komplet i ndihmës së shpejtë copë 1.	në pronësi ose me qera	copë	1

*-Sa më sipër, konstatohen kërkesa kualifikuese jo në përputhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës.*

-Sic vërehet janë kërkuar numër i konsiderueshëm mjeteve gjërmimi në mënyrë të pajustificuar e të paargumentuar teknikisht në lidhje me natyrën dhe volumin e punimeve, për më tepër edhe me kohëzgjatjen e punimeve (3 muaj gjithësej).

-Nuk është kërkuar dorëzimi i dokumentacionit teknik të mjeteve, ku përveç lejes së qarkullimit, duhet kontrolli teknik i mjetit, pagesa e taksës vjetore të automjetit, me qëllim vërtetimin e plotësisht të kërkesës së përcaktuar në shkronjën "dh" të pikës 2 në nenin 45 në LPP nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

-Në vijim të pikës së mësipërme është kërkuar eskavator me zinxhir, ndërkohë nuk kërkohet rimorkiatori për transportin e tyre, pasi përfshihen në kategorinë e mjeteve të cilat nuk mund të qarkullojnë<sup>28</sup>.

-Gjithashtu në asnjë rast nuk është përcaktuar se mjeti i gjërmimit me zinxhir duhet të jetë me çekiç, duke qenë se kemi punime të gjërmimit të materialit shkëmbor.

### **Vlerësimi i ofertave.**

KVO është ngritur me urdhër Nr. 251/1 dt. 14.09.2020 të Kryetarit të Bashkisë dhe përbëhet nga S.Gj, Kryetar, K.S dhe A.D Anëtar.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE përkatësisht:

BOE "A" Sh.P.K dhe "A.I.G.C" Sh.P.K, me ofertën ekonomike në shumën 1,980,900 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit, gjithësej 102,433 lekë.

BOE "D" Sh.P.K dhe "N 2014" Sh.P.K, me ofertën ekonomike në shumën 1,956,698 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit, gjithësej 126,635 lekë.

OE "S AL" Sh.P.K me ofertën ekonomike në shumën 1,999,735 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit, gjithësej 83,598 lekë.

Janë s'kualifikuar 2 BOE "A" Sh.P.K dhe "A.I.G.C" Sh.P.K, si dhe BOE "D" Sh.P.K dhe "N 2014" Sh.P.K.

-Është shpallur fitues OE "S AL" Sh.P.K me ofertën ekonomike më të lartë në krahasim me dy BOE, përkatësisht, 18,835 lekë diferencë nga BOE "A" Sh.P.K dhe "A.I.G.C" Sh.P.K, si dhe 43,037 lekë nga BOE "D" Sh.P.K dhe "N 2014" Sh.P.K.

BOE të skualifikuar:

➤ "A" Sh.P.K dhe "A.I.G.C" Sh.P.K, është s'kualifikuar me arsyet e mëposhtme:

1. Mungon dokumenti i operatorit ekonomik A Sh.P.K, që vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, kërkuar në DST - "Vërtetimi i debisë nga FSHU nr.728 prot, datë 07.10.2020, ku citohet shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike nga ana e Subjektit A Sh.P.K për muajin Gusht 2020, por duke qenë se procedura është mbyllur më datë 17.11.2020, operatori ekonomik A shpk duhet të kishte paraqitur vërtetim që ka shlyer detyrimet edhe për muajin Shtator 2020", e për pasojë ky kriter nuk përmbushet.

2. Mungojnë mjetet e rënda me goma 2 copë, kërkuar në DST, pika 2.3.5 "Mjetet dhe Pajisjet", pika 1.

3. Mungon Licensa NS-18A e operatorit ekonomik A Sh.P.K, kërkuar në DST, pika 2.3.2, Licensat Profesionale.

4. Kontrata e qirasë më datë 26.11.2019 mes subjektit R Sh.P.K e Subjektit A.I.G.C Sh.P.K, është e panoterizuar e për pasojë është e pasaktë.

5. Eskavatori me goma i paraqitur nga operatori ekonomik A.I.G.C Sh.P.K, nuk ka asnjë dokument ligjor shoqërues si: (Certifikatë pronësie, leje transporti, siguracion e kolaudim).

➤ BOE "D" Sh.P.K dhe "N 2014" Sh.P.K, është s'kualifikuar me arsyet e mëposhtme:

1. Mungon Inxhinieri i Ndërtimit (i profilizuar për rrugë), i kërkuar në DST, pika 2.3.3 "Stafi teknik", paragrafi I.

3.Mungon dokumenti i operatorit ekonomik D-1 Sh.P.K, që vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, kërkuar në DST, "Kriteret e vecanta", shkronja g, është paraqitur "Vërtetimi i debisë nga FSHU nr.729 prot, datë 07.10.2020, ku citohet

<sup>28</sup> Pika 2 në nenin 173 në Kodin Rrugor.

shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike nga ana e subjektit D-1 Sh.P.K, duke mos përfshirë muajin Shtator 2020, por duke qenë se procedura është mbyllur më datë 17.11.2020, operatori ekonomik D-1 Sh.P.K duhet të kishte paraqitur vërtetim që ka shlyer detyrimet edhe për muajin Shtator 2020”, e për pasojë ky kriter nuk përmbushet.

4. Mungon prozhektor 1 copë.

5. Mungojnë 2 (dy) mjete të rënda me goma, pasi edhe një nga mjetet e rënda me goma të paraqitur me targa AA i ka mbaruar vlefshmëria e dokumantacionit ligjor për të qarkulluar si siguracioni, taksat dhe kolaudimi.

-S'kualifikimi i BOE të mësipërm qëndron.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit përsa i përket vlerësimit të ofertës konstatohet se:

-Nga OE S Al shpk nuk është plotësuar kërkesa e vendosur në pikën 2.2.2 të DST, konkretisht: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2019 – Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, me qëllim evidentimin e procedurave të prokurimit publik, në të cilat është shpallur fitues OE S Al Sh.P.K, konstatohet se jo për të gjitha vëndet e ushtrimit të aktivitetit ku ka kryer punime ndërtimi ka sjellë vërtetimin e pagesave të taksave dhe tarifave vendore, pasqyruar si më poshtë vijon:

Autoriteti kontraktues	Objekti i prokurimit	Fituesi	Teritorri Administrativ	Ka dorëzuar vërtetim
Bashkia Elbasan	Rivitalizim i lulishtes Kozma Naska lagjja Kongresi Elbasanit	S AL	NJQV Elbasan	Jo
Bashkia Vau Dejës	Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara (Rikonstruksion) Bashkia Vau Dejës Sistemim asfaltim i rruges fshati Kukul Sistemim asfaltim i rruges te lagjes "Kapedani" Qyteti Vau Dejes (faza e parë) Asfaltimi i rruges tek ofiçina, fshati Rranxa Sistemim asfaltim i rruges se Xhamise fshati Bushat faza II “Sistemim asfaltim i rruges "Bushat-Pleshe-Superstradë". Sistemim oborrit dhe terreneve sportive,shkollat 9-vjeçare, Fshati Ri, Rranxa, Naraç, Nenshate, Barbullush, Kukul Rikonstruksion i nyjeve hidrosanitare i shkollës 9-vjeçare Barbullush Rikonstruksion Fushes sportive fshatin Barbullush	S AL	NJQV Kamëz	Jo i plotë, është i lëshuar për periudhën deri në muajin Prill 2019
Gjykata e Apelit Durres	Rikonstruksion i godnes se Gjykate se Apelit Durres	S AL	NJQV Durrëz	Jo

-Për shoferat (4 gjithësej), për të cilët është dorëzuar kontratë, leje drejtimi, certifikatë e aftësisë profesionale, certifikatë e sigurimit teknik, konstatohet se: Leja e drejtimit nuk është e plotë për arsye se nuk është dorëzuar edhe pjesa e prapme e saj, me qëllim vlerësimin e vlefshmërisë së afatit për çdo kategori drejtimi B, C, D, BE, CE, DE; Certifikatave të aftësisë profesionale u ka mbaruar afati më datë 20.10.2020, ndërkohë që afati për dorëzimin e dokumenteve për të marrë pjesë në tenderin e mësipërm është 17.11.2020, pra praktikisht shoferat nuk janë të pajisur me CAP, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 115/1 në Ligjin nr. datë 22.7.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht: “Drejtesit e mjeteve, mbajtës të lejedrejtitimit të kategorive C1 ose C, C1E apo CE, e marrin certifikatën e aftësisë profesionale për transportin e mallrave dhe drejtesit e mjeteve, titullarë të lejedrejtitimit të kategorive D1, D1E, D dhe DE, e marrin certifikatën e aftësisë profesionale për transportin e pasagjerëve. Kjo e fundit është e nevojshme gjithmonë në rastin e transportit të nxënësve”, si dhe me përcaktimin e bërë në nenin 39/1 në Ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar: “Drejtesit e mjeteve me peshë të përgjithshme të lejuar me ngarkesë mbi 6 tonë ose kur ngarkesa e lejuar, përfshirë rimorkion ose gjysmërimorkion, i kalon 3,5 tonë në transportin e mallrave, pajisen me certifikatën e aftësisë profesionale, në përputhje me udhëzimin e ministrit”.

-Për manovratorët nuk është dorëzuar leje drejtimi, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 2 në nenin 8 në Kreun III të Urdhrit Nr. 200, datë 16.5.2019 Për miratimin e rregullores “për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, ku përcaktohet shprehimisht:

2. Për lëvizjen apo qarkullimin në rrugë, makineritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nëse janë të pajisura me rrota pneumatike, duhet të plotësojnë kërkesat e nenit 113 dhe 122 të Kodit Rrugor, kurse drejtuesit e tyre, në varësi të makinerisë, duhet të jenë të pajisur me kategorinë përkatëse të lejedrejtimit.

-Për manovratorët OE S AL ka dorëzuar dokumente (dëshmi e aftësisë profesionale, dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik) për 6 punonjës, konkretisht: A.O, P.D, P.V, SH.S, SH.B, O.L. Në DST kërkohen gjithësej 3 manovrator të cilët të figurojnë në listë-pagesat e subjektit në periudhën Korrik-Shtator 2020.

Sa më sipër, manovratori SH.B nuk figuron në listë-pagesat e subjektit;

Manovratori O.L figuron vetëm në muajin Korrik dhe Gusht të vitit 2020, pra jo edhe në muajin Shtator;

Manovratori A.O, në listë-pagesën e subjektit, sipas kodit të profesionit figuron si përgjegjës guroreje;

Manovratori P.V, në listë-pagesën e subjektit, sipas kodit të profesionit figuron si shofer;

Vetëm 2 manovratorët, P.D dhe SH.S, në listë-pagesën e subjektit, sipas kodit të profesionit figurojnë drejtues të mjeteve të rënda dhe drejtues eskavatori.

Sa më sipër, sipas listës kombëtare të profesioneve miratuar me VKM nr.514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve” (LKP), të rishikuar, rezulton se kodi i profesionit 8322 përfshin: “Shoferi i makinave, taksive dhe furgonave që merret me transportin e udhëtarëve, mallrave, postës, etj. Ai drejton mjetet motorike duke u kujdesur për një transport të sigurt dhe të përshtatshëm duke zbatuar rregullat e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave. Ai mund të punësohet në kompani shërbimesh të ndryshme, shërbimesh transporti apo të vetëpunësohet”, **ndërkohë** për prokurimin në përkatës duhen punonjës me **kod profesioni 8342** “Përdorues të makinerive të punimit të tokës dhe të tjerë të ngjashme me to, që kryejnë funksione të punimeve të tokës dhe të tjerë të ngjashme me to drejtojnë makinat për të gërmuar, kategorizuar, niveluar, zbutur dhe ngjeshur tokën ose material të ngjashme me to”, si dhe **kod profesioni 8332** “Shoferë të makinave të rënda dhe kamionëve, që drejton makinat e rënda dhe kamionë me apo pa rimorkio, makina vetëshkarkuese etj. për transportimin e mallrave, lëngjeve dhe materialeve të rënda në distanca të shkurta dhe të gjata duke u kujdesur për një transport të sigurt dhe të përshtatshëm duke zbatuar rregullat e transportit rrugor. Ai mund të punësohet në kompani shërbimesh të ndryshme, shërbimesh transporti, në kompani ndërtim apo të vetëpunësohet”.

-Sqarojmë se bazuar në Udhëzimin nr.23, datë 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar, për plotësimin e rubrikave të deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë mbajnë parasysh sa më poshtë respektimin e pikave 1-12, ndër të cilat është edhe pika 11. Në rubrikën 11 “Detyra, funksioni, profesioni apo puna që ka kryer punonjësi” – shënohet detyra apo profesioni që punonjësi kryen në tatimpaguesin përkatës. Detyra apo profesioni zgjidhen nga lista kombëtare e profesioneve.

-Pra OE i shpallur fitues ka paraqitur informacion jo të vërtetë, si dhe nuk plotëson kërkesën për 3 manovrator.

## 12.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje për vitin 2020”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje lëndë djegëse për ngrohje për vitin 2020", Bashkia Fushë-Arrëz.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 253, Datë 11.08.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit 1.S.M	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave



<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	2.T.P 3.A.I	Urdhër Nr.251 dt. 06.08.2020 -O.C, Kryetar, -A.D, Anëtar. -K.S, Anëtar,
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 1,702,980	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> OE "A", sh.p.k, 1,549,540 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 171,440 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 24.08.2020	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë dhe Grandi i qeverisjes qendrore	<b>10. Operoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1OE b) S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>11. Ankimime</b> AK-s'ka; APP-s'ka KPP-s'ka.	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S'ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP</b> apo AKKP S'ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 2204, datë 14.09.2020	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> 1,859,448 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.</b>
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> Parashikuar deri në fund të sezonit të ngrohjes.	<b>19. Zgjatja e kontratës me - ditë</b> S'ka

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.2, datë 13.02.2020 nga NJP.**

**AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik ka kërkuar:**

**Në pikën 2.1.1** nga AK kërkohet “Operatori ekonomik i interesuar për kryerjen e këtij shërbimi duhet të jetë i licensuar” – pra kërkohet licencë, por pa përcaktuar kategorinë përkatëse dhe fushën e licencimit.

**Në pikën 2.3.1** nga AK kërkohet që OE të ketë kryer furnizime të ngjashme në masën 40% të vlerës së objektit që prokurohet ose dyfishi i vlerës për 3 vitet e fundit dhe për këtë OE duhet të sjellë kontratë furnizimi dhe formular vlerësimi për realizim të suksesshëm të tij, kjo për autoritet kontraktore, ndërsa për shërbime me subjekte private operatori duhet të paraqesë fatura tatimore shitjeje - Sa më sipër, kërkesat janë konfonduese, pasi pika e parë e saj e cila kërkon furnizime të ngjashme të realizuara përgjatë viteve 2017-2018-2019 vlera e të cilave të jetë sa fondi limit, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 27 “Kontrata e mallrave” të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, e cila përcakton qartë se për të prapuar përvojën e mëparshme, AK kërkon furnizime të ngjashme të realizuar gjatë 3 viteve të fundit në një vlerë jo më të madhe se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës, ndërkohë që AK ka kërkuar ekzaktësisht për 3 vitet e fundit që vlera të jeta fiks sa fondi limit që prokurohet, e cila është e pamundur për OE të plotësohet sa kërkohet.

-Lidhur me pikën 2 të kërkesës, sërish NJP në hartimin e kriterit, ka përcaktuar që furnizimet e ngjashme të jenë në masën 40% të vlerës së objektit që prokurohet, ndërkohë që duhej ti përmbahej dispozitës së cituar më sipër, ku kërkesën duhej të kërkonte për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të madhe, dhe gjithashtu duhej të përcaktonte edhe periudhën e për vitet në të cilat kërkohen këto furnizime, e cila nuk është përcaktuar në DST.

**Në pikën 2.3.2** nga AK kërkohet që OE të ketë në pronësi/me qera një mjet transporti, kamion mbi 10 ton, për mundësi lëvizje në rrugët rurale/interurbane për kryerjen e shërbimit te

furnizimit. Per kete subjekti duhet te dorezoje (leje qarkullimi, certifikate kontrollit teknik, siguracion, leje transporti dhe foto te mjetit) si dhe kontrate qeraje nese mjete eshte me qera – Për këtë pikë nuk është specifikisht se çfarë leje transporti duhet të ketë OE.

-Nuk është përcaktuar që OE shpallur fitues duhet të dorëzojë certifikatën për të vërtetuar origjinën e lëndës drusore<sup>29</sup>.

-Nuk është përcaktuar grafik lëvrimi i mallit, pra deri në datën kur do të përfundojë zbatimi i kontratës, vëndet ku do të dërgohet lënda djegëse.

-**Gjithashtu**, kërkesa e në shtojcën 9 të DST, ndër të tjera kërkon nga OE fitues të sigurojë ambiente për magazinimin e druve, pasi institucionet që do ti përdorin nuk kanë hapësira të tilla për mbajtjen e tyre për një kohë të gjatë - Kjo kërkesë, në kushtet e mungesës së magazinimit të lëndëve, është e pa plotë, pasi NJP nuk ka parashikuar vendndodhjen e magazinës ose distancën nga e cila do bëhet shpërndarja, çka potencialisht mund të përbëjë pengesë për shërbimin e shpërndarjes së lëndës djegëse, duke marrë parasysh dhe zonën malore dhe kushtet klimatike.

### **Vlerësimi i ofertave.**

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz me nr.268 dt. 10.08.2021 është ngritur KVO e cili përbëhet nga, z. O.Ç, Kryetar, z. A.D dhe z. S.LI, Anëtar.

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “A&R” ShPK me ofertë në vlerën 1,552,813 lekë pa TVSH me diferencë nga fondi limit në vlerën 81,727 lekë.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, rezulton se faturat tatimore dhe deklaratat e tatimit mbi vlerën e shtuar, pjesë e dokumentacionit për përmbushje të kriterit në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, janë fotokopje dhe jo të noterizuara.

-Sa më sipër, bazuar në përcaktimin e bërë në pikën 2 të nenit 82 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe përcaktimit të bërë në DST, që dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje e noterizuar e tyre, me OE të shpallur fitues nuk duhet të ishte bërë lidhja e kontratës.

### **13.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje për vitin 2021”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje lëndë djegëse për ngrohje për vitin 2021", Bashkia Fushë-Arrëz.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi Nr. 363, Datë 26.10.2021</b>	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> 1.S.M 2.T.P 3.A.I	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër Nr.268 dt. 10.08.2021 - O.Ç Kryetar - A.D, Anëtar, -S.LI, Anëtar.
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> E hapur e thjeshtuar		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSH)</b> 1,634,540	<b>6. Oferta fituese (pa TVSH)</b> OE "A&R", Sh.P.K, 1,552,813 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)</b> 81,727 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 08.11.2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë dhe Grandi i qeverisjes qendrore	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1OE b) S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>11. Ankimime</b> AK-s'ka; APP-s'ka KPP-s'ka.	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S'ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP</b> apo AKKP S'ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 3019, datë 25.11.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 1,863,376 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.</b>
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në dite</b> 15 ditë	<b>19. Zgjatja e kontratës me ditë</b> S'ka

*Sa më sipër u konstatua:*

<sup>29</sup> Shkronja “a” në pikën 8 në nenin 27 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”.

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 26.10.2021, i ndryshuar, nga NJP.**

***AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik ka kërkuar:***

**Në pikën 2.1.1** nga AK kërkohet që operatori ekonomik duhet të paraqes kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet financiare (2018-2019-2020), ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël 40% e fondit limit të kontratës që po prokurohet – Ndërkohë sipas përcaktimit në shkronjën "c" të pikës 2 në nenin 43 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës.

**Në pikën 2.3.1** nga AK kërkohet kërkohet që OE të ketë kryer furnizime të ngjashme në masën jo më pak se 20% të vlerës së objektit që prokurohet të realizuar gjatë 3 viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës – Ndërkohë sipas sipas përcaktimit në shkronjën "b" të në pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, vlera e furnizimeve të ngjashme duhet të kërkohet në masën jo më të madhe se 20%.

-Në DST nuk është kërkuar mjet transporti dhe kapaciteti mbajtës i tij, me qëllim garantimin e transportit të lëndës djegëse sipas nevojës së institucionit.

-Nuk është përcaktuar që OE shpallur fitues duhet të dorëzojë certifikatën për të vërtetuar origjinën e lëndës drusore<sup>30</sup>.

-Nuk është përcaktuar grafik lëvrimit i mallit, pra deri në datën kur do të përfundojë zbatimi i kontratës, vëndet ku do të dërgohet lënda djegëse.

### **Vlerësimi i ofertave.**

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz me nr.268 dt. 10.08.2021 është ngritur KVO e cili përbëhet nga, z. O.Ç, Kryetar, z. A.D dhe z. S.LI, Anëtar.

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "A&R" ShPK me ofertë në vlerën 1,552,813 lekë pa TVSH me diferencë nga fondi limit në vlerën 81,727 lekë.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, rezulton se faturat tatimore dhe deklaratat e tatimit mbi vlerën e shtuar, pjesë e dokumentacionit për përmbushje të kriterit në pikën 2.3.1 "Kapaciteti teknik", janë fotokopje dhe jo të noterizuara.

-Sa më sipër, bazuar në përcaktimin e bërë në pikën 2 të nenit 82 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, dhe përcaktimit të bërë në DST, që dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje e noterizuar e tyre, me OE të shpallur fitues nuk duhet të ishte bërë lidhja e kontratës.

**14.Tenderi me objekt:"Blerje karburanti për nevojat e bashkisë, Fushë-Arrëz për vitin 2020", me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje karburanti për nevojat e bashkisë, Fushë-Arrëz për vitin 2020".
---

<sup>30</sup> Shkronja "a" në pikën 8 në nenin 27 në Ligjin nr.57/2020 "Për pyjet".

<b>1. Urdhër Prokurimi Nr. 74, Datë 03.03.2020</b>	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Urdhër Nr. 41 dt. 12.02.2020 1.S.M 2.T.P 3.A.I	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër Nr. 42 dt. 10.02.2020 -K.S, Kryetar, -A.D, Anëtar. -A.D, Anëtar,
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për Propozim		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 5,056,666 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> OE "D", sh.p.k, 5,056,666 lekë me marzh fitimi 23%.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 0 lekë.
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 17.03.2020	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë dhe Grandi i qeverisjes qendrore	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>11. Ankimime</b> AK-s'ka; APP-s'ka KPP-s'ka.	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S'ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP</b> apo AKKP S'ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 875, datë 08.04.2020	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> 6,068,000 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.</b>
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 12 muaj, Zbatuar 12 muaj	<b>19. Zgjatja e kontratës me - ditë</b> S'ka

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.2, datë 13.02.2020 nga NJP.**

**AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik ka kërkuar:**

**Pika 2.2.1** - Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve te fundit furnizime të ngjashme në vlerën 40% të fondit limit të kontratës që prokurohet – ndërkohë që sipas pikës 4 në nenin 27 në VKM nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, në rastet e prokurimeve për mallra vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës limit të kontratës që prokurohet;

**Pika 2.3.7** - Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme:

EN- ISO 9001:2015 - Certifikatë për sistemimin e menaxhimit të cilësisë;

EN- ISO 14001:2015 - Certifikatë për sistemimin e menaxhimit të mjedisit;

OHSAS 18001:2007 - Certifikatë për sistemimin e menaxhimit të sigurisë në punë;

Nuk argumentohet vendosja e certifikatave të mësipërme dhe rolin që kanë ato në vërtetimin e cilësisë së mallit që prokurohet. Për certifikatën OHSAS 18001:2007 nuk është vendosur edhe mundësia e dorëzimit të certifikatës ekuivalente të saj ISO 45001:2018, e njohur nga standardet shqiptare.

-Në kriteret e mësipërme nuk është vendosur distanca maksimale e pikës së furnizimit me karburant në raport me Bashkinë Fushë Arrëz, duke bërë edhe një analizë kosto oportune të distancës që duhet, për arsye se ky kriter mbron interesat e institucionit, pasi mospërcaktimi i këtij kriteri sjell që në këtë procedurë të marrin pjesë edhe subjekte të cilat kanë stacione furnizimi në qytete të tjera dhe në këto kushte nuk është praktike që mjetet e Bashkisë Fushë Arrëz të shkojnë në një qytet tjetër për tu furnizuar me karburant dhe më pas të kthehen në qytetin Fushë Arrëz për të kryer punën/aktivitetin për të cilin është autorizuar të kryejë.

**Në shtojcën 9** "Specifikimet teknike" është kërkuar që furnizimi i mjeteve të realizohet nëpërmjet tollonave 10 litra/20 litra, ndërkohë që sipas përcaktimit të bërë në pikën 1 të VKM nr.561, datë 29.7.2016 "Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në

njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, duhet që njësitë e qeverisjes së përgjithshme sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj.

### **Vlerësimi i ofertave.**

-KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me Urdhër Nr. 42 dt. 10.02.2020 dhe përbëhet nga K.S, Kryetar, A.D dhe A.D, Anëtar.

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, dhe është dhe shpallur fituese OE “D” ShPK me marzh fitimi 23%.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Nga OE shpallur fitues nuk është dorëzuar licenca për tregëtimin e karburanteve për stacionin e furnizimit në Bashkinë Fushë Arrëz dhe Bashkinë Tiranë, ndërkohë që nga Bashkia Fushë Arrëz, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore përfaqësuar nga z.E.M, Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Kryetari i Bashkisë kanë nënshkruar vërtetimin se subjekti nuk ka detyrime për taksa dhe tarifa vendore. Në vijim të këtij vërtetimi të lëshuar ndaj OE shpallur fitues dhe bazuar në përcaktimin e bërë në nenin 4, nenin 15, nenin 17, nenin 19, nenin 20 dhe nenin 21, si dhe Kreun II në VKM Nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, të ndryshuar, duhet që subjekti të pajisej me licencën për tregëtimin e karburantit për stacionin e furnizimit në Bashkinë Fushë Arrëz, duke u bërë automatikisht subjekti i tarifës vendore në vlerën 1,000,000 lekë që paguhet për llogari të Bashkisë Fushë Arrëz. Pra subjekti ka ushtruar aktivitet pa licencë në teritorrin administrativ të Bashkisë Fushë Arrëz dhe për rrjedhojë ka detyrimin për tu pajisur dhe likujduar tarifën përkatëse. Në këto kushte subjekti është shpallur fitues në kushtet e mungesës së licencës së mësipërme. Situata e mësipërme vlenë edhe për stacionin e furnizimit në Bashkinë Tiranë.

-Certifikata laboratorike e lëshuar nga ISHTI për cilësinë e naftës, i përket vetëm mostrës së marrë në pikën e furnizimit “A.P” me adresë Rruga Ali Demi, pra jo edhe në pikat e tjera të furnizimit, me të cilat subjekti ka marrë pjesë në procedurën e tenderit, ndërkohë që në DST është përcaktuar shprehimisht: “OE duhet të paraqesë fletë-analizë të lëshuar nga ISHTI për produktin për cilësinë, sigurinë në tregtim dhe garancinë e pikave të shitjes”.

### **15.Tenderi me objekt:“Blerje karburanti për nevojat e bashkisë, Fushë-Arrëz për vitin 2021”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje karburanti për nevojat e bashkisë, Fushë-Arrëz për vitin 2021".</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi Nr. 54, Datë 03.02.2021</b>	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Urdhër Nr.22 dt. 15.01.2021 1.S.M 2.T.P 3.A.I	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër Nr. 26 dt. 21.01.2021 - O.Ç, Kryetar, - A.D Anëtar. - K.S, Anëtar.
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për Propozim		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSH)</b> 5,056,666 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSH)</b> OE "D", sh.p.k, 5,056,666 lekë me marzh fitimi 25%.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)</b> 0 lekë.
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 19.02.2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë dhe Grandi i qeverisjes qendrore	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>11. Ankimime</b> OE D për dokumentet e tenderit, datë 09.02.2021	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> Ndryshimi i dokumenteve të tenderit	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP</b> apo AKKP S’ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 632, datë 16.03.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 6,068,000 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.</b>

<b>17- Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 12 muaj, Zbatuar 12 muaj	<b>19. Zgjatja e kontratës me - ditë</b> S'ka

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.2, datë 03.02.2021 nga NJP.**

**AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik ka kërkuar:**

**Pika 2.2.1** - Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit furnizime të ngjashme në vlerën jo më të vogël se 40% të fondit limit të kontratës që prokurohet – ndërkohë që sipas pikës 4 në nenin 27 në VKM nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, në rastet e prokurimeve për mallra vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës limit të kontratës që prokurohet;

**Pika 2.3.7** - Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme:

EN- ISO 9001:2015 - Certifikatë për sistemimin e menaxhimit të cilësisë;

EN- ISO 14001:2015 - Certifikatë për sistemimin e menaxhimit të mjedisit;

Nuk argumentohet vendosja e certifikatave të mësipërme dhe rolin që kanë ato në vërtetimin e cilësisë së mallit që prokurohet.

-Në kriteret e mësipërme nuk është vendosur distanca maksimale e pikës së furnizimit me karburant në raport me Bashkinë Fushë Arrëz, duke bërë edhe një analizë kosto oportune të distancës që duhet, për arsye se ky kriter mbron interesat e institucionit, pasi mospërcaktimi i këtij kriteri sjell që në këtë procedurë të marrin pjesë edhe subjekte të cilat kanë stacione furnizimi në qytete të tjera dhe në këto kushte nuk është praktike që mjetet e Bashkisë Fushë Arrëz të shkojnë në një qytet tjetër për tu furnizuar me karburant dhe më pas të kthehen në qytetin Fushë Arrëz për të kryer punën/aktivitetin për të cilin është autorizuar të kryejë.

-Në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është vendosur detyrimi që OE të jetë i pajisur me certifikatë elektronike nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, me qëllim lëshimin e faturës elektronike<sup>31</sup>.

**Në shtojcën 9** “Specifikimet teknike” është kërkuar që furnizimi i mjeteve të realizohet nëpërmjet tollonave 10 litra/20 litra, ndërkohë që sipas përcaktimit të bërë në pikën 1 të VKM nr.561, datë 29.7.2016 “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, duhet që njësitë e qeverisjes së përgjithshme sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj.

### **Vlerësimi i ofertave.**

-KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me Urdhër Nr. 26, datë 21.01.2021 dhe përbëhet nga z. O.Ç, Kryetar, z. A.D dhe z. K.S, Anëtar.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE përkatësisht:

-OE “K” Sh.P.K, me ofertën ekonomike me marzh fitimi 15.4%.

-OE “D” ShPK me marzh fitimi 25%.

Është s’kualifikuar OE “K” Sh.P.K.

<sup>31</sup> Neni 48 në Ligjin nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar.

-Është shpallur fitues OE “D” Sh.P.K me marzh fitimi 25%.

OE i s’kualifikuar:

➤ “K” Sh.P.K me arsytet e mëposhtme:

1. Mungojnë dokumentet që vërtetojnë se ka plotësuar të gjitha detyrimet për taksat dhe tarifave vendore, lëshuar nga administrata e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetet për vitin 2020, kërkuar në DST, pika 2.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar", paragrafi 2.2.2, konkretisht mungojnë vërtetimet për disa nga adresat e shitjes në pikat e Durrësit, Bashkisë Mat etj. Po ashtu sipas ekstraktit të QKB, nuk rezulton asnjë pikë shitje në Bashkinë Fushë-Arrëz.

2. Mungon dokumenti që vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të energjisë elektrike, kërkuar në DST, pika 2 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", shkronja d, pasi vërtetimi i paraqitur i debisë nga FSHU nr.638 prot., datë 22.01.2021, citon se ka 0 (zero) detyrime të energjisë elektrike (sipas listës bashkëlidhur), listë e cila mungon bashkëlidhur vërtetimit të paraqitur në sistem, e për pasojë dokumenti është i pasaktë.

-S’kualifikimi i OE të mësipërm qëndron.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Nga OE shpallur fitues nuk është dorëzuar licenca për tregëtimin e karburanteve për stacionin e furnizimit në Bashkinë Fushë Arrëz, Bashkinë Vorë dhe Bashkinë Tiranë, ndërkohë që nga Bashkia Fushë Arrëz, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore përfaqësuar nga zj.A.D, Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe zv.Kryetari i Bashkisë z.O.Ç kanë nënshkruar vërtetimin se subjekti nuk ka detyrime për taksat dhe tarifave vendore. Në vijim të këtij vërtetimi të lëshuar ndaj OE shpallur fitues dhe bazuar në përcaktimin e bërë në nenin 4, nenin 15, nenin 17, nenin 19, nenin 20 dhe nenin 21, si dhe Kreun II në VKM Nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, të ndryshuar, duhet që subjekti të pajisej me licencën për tregëtimin e karburantit për stacionin e furnizimit në Bashkinë Fushë Arrëz, duke u bërë automatikisht subjekti i tarifës vendore në vlerën 1,000,000 lekë që paguhet për llogari të Bashkisë Fushë Arrëz. Pra subjekti ka ushtruar aktivitet pa licencë në teritorrin administrativ të Bashkisë Fushë Arrëz dhe për rrjedhojë ka detyrimin për tu pajisur dhe likuiduar tarifën përkatëse. Në këto kushte subjekti është shpallur fitues në kushtet e mungesës së licencës së mësipërme.

-Certifikata laboratorike e lëshuar nga ISHTI për cilësinë e naftës, i përket vetëm mostrës së marrë në pikën e furnizimit “A.P”, pra jo edhe në pikat e tjera të furnizimit, me të cilat subjekti ka marrë pjesë në procedurën e tenderit, ndërkohë që në DST është përcaktuar shprehimisht: “OE duhet të paraqesë fletë-analizë të lëshuar nga ISHTI për produktin për cilësinë, sigurinë në tregëtim dhe garancinë e pikave të shitjes”.

-Nuk është dorëzuar vërtetimi për likuidimin e detyrimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore – formulari E-SIG, si dhe urdhër pagesa bashkëlidhur sipas formatit standard<sup>32</sup>.

## 16.Tenderi me objekt: “Mirëmbajtje në kanale vaditëse në Njësitë Administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje në kanale vaditëse në Njësitë Administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz”		
<b>1. Urdhër Prokurimi Nr. 65, Datë 15.02.2021</b>	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Urdhër Nr. 22 dt. 15.01.2021	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër Nr. 26 dt. 21.01.2021
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për Propozim	1. S.M 2. T.P 3. A.I	1. O.Ç – (Kryetar) 2. A.D – (Anëtar) 3. K.S – (Anëtar)

<sup>32</sup> <https://ëëë.tatime.gov.al/d/8/129/209/188/kontributet-e-sigurimeve-shoqerore-dhe-shendetesore>.

<b>5. Fondi Limit (pa TVSH)</b> 1,510,618 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSH)</b> BOE "A" dhe "A.I.G.C", Sh.P.K, me ofertë 1,471,680 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)</b> 38,938 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 17.03.2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë dhe Grandi i qeverisjes qendrore	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 BOE b) S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 BOE
<b>11. Ankimime</b> AK-s'ka; APP-s'ka KPP-s'ka.	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK S'ka	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP S'ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 831, datë 12.04.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 1,766,016 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.</b>
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> 30 ditë	<b>19. Zgjatja e kontratës me - ditë</b> -

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Mbi përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, dokumentuar nëpërmjet procesverbalit nr.2, datë 15.02.2021 të mbajtur nga NJP për argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit.**

**AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik ka kërkuar:**

**Pika 2.3.1** - Në lidhje me përvojën e mëparshme të ofertuesit, kërkohet shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël 40% të fondit limit për të cilin prokurohet, të realizuara nga operatori ekonomik gjatë tri vitet e fundit – Ndërkohë sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 në nenin 28, përcaktimi për të vërtetuar përvojën e mëparshme është: “vlera e kërkuar nuk mund të jetë më e madhe se 40%”.

**Pika 2.3.2** - AK kërkon që OE të ketë licencat N.P-1/A, N.P-7/A – ndërkohë që licenca e kategorisë N.P-7/A sipas përkufizimit të saj përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Sipas preventivit të punimeve, nuk rezulton të ketë asnjë punim tjetër përveç gërmimit, që ezaurohet nëpërmjet licencës N.P-1/A.

**Pika - 2.3.3** - AK kërkon që për personelin dhe fuqinë punëtore Kandidati/ofertues duhet të vërtetojë se disponon numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës dhe për këtë provuar këtë kusht, duhet të ketë një punësim mesatar për periudhën Korrik 2020-Dhjetor 2020 i të paktën 21 punonjës (20 punonjës të thjeshtë dhe 1 teknik të mesëm ndërtimi/topograf) - Periudha e vendosur Korrik 2020-Dhjetor 2020, nuk është argumentuar nga NJP, në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës. Për më tepër që numri i tyre nuk argumentohet me analizë sipas zërave të punimeve, grafikut, pra sa kohë do të zgjasin punimet e gërmimit, mbushjes etj,



si do të organizohet puna me 1 turn apo më tepër dhe sa punonjës do të angazhohen për këtë zë punimi, duke arritur në përfundimin se duhet ky numër punonjësish. Veç sa më sipër në kërkesat e mësipërme nuk është përfshirë perioda Janar-Shkurt 2021, duke qenë se tenderi zhvillohet më datë 17.03.2021. Pra sipas kërkesës së vendosur nga NJP, OE mund të ketë stafin e kërkuar përgjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2020, pavarësisht se si mund të jetë situata e puntorisë 1 muaj përpara zhvillimit të tenderit.

**Pika 2.3.5** - Subjekti fitues duhet që të hartojë dosjen e zbatimit, librezën e masave për objektin pa të cilën nuk merret në dorëzim nga Bashkia Fushë-Arrëz – Ky kriter është në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 7 dhe nenin 12 në Ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pasi në asnjë rast sipërmarrësi i punimeve (OE shpallur fitues) nuk mund të jetë mbikëqyrës i punimeve dhe/ose kolaudator i punimeve. Institucioni ka detyrimin që të caktojë mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, nëpërmjet procedurës së prokurimit, duke lidhur kontratë shërbimi.

### **Vlerësimi i ofertave.**

KVO është ngritur me urdhër nr.26, datë 21.01.2021 të Kryetarit të Bashkisë dhe përbëhet nga z. O.Ç, Kryetar, z. A.D dhe z. K.S, Anëtar.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 BOE përkatësisht:

BOE “A” Sh.P.K dhe “A.I.G.C” Sh.P.K, me ofertën ekonomike në shumën 1,471,680 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit, gjithësej 38,938 lekë.

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit përsa i përket vlerësimit të ofertës konstatohet se:*

-OE A pjesë e BOE së mësipërm, nuk përmbush kriterin e numrit të punonjësve për periudhën Korrik 2020-Dhjetor 2020, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së punimeve sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me Nr.245 Rep., datë 15.03.2021.

-Shtojca “Deklaratë për paraqitje ofertë të pavarur”, shkronjat “a” dhe “b” në pikën 6 nuk janë plotësuar nga OE A, të cilat pasqyrojnë nëse subjekti po konkurren vetëm apo nëpërmjet bashkimit të operatorëve.

-Nga OE A shpk nuk është plotësuar kërkesa e vendosur në pikën 2.2.2 të DST, konkretisht: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2020 – Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, me qëllim evidentimin e procedurave të prokurimit publik, në të cilat është shpallur fitues OE A Sh.P.K, konstatohet se jo për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit ku ka kryer punime ndërtimi ka sjellë vërtetimin e pagesave të taksave dhe tarifave vendore, pasqyruar si më poshtë vijon:

AK	Objekti_i_prokurimit	Fituesi	Teritorri Administrativ	Ka dorëzuar vërtetim
Bashkia Pukë	Rikonstruksion i pjesshem i rruges autor rurale fshati Rras, Njesia Administrative Gjegjan	A	NJQV Pukë	Jo

### **17.Tenderi me objekt: “Ndërtim i shpatullave të urave auto Koprart dhe Micoj” me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim i shpatullave të urave auto Koprart dhe Micoj”</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi Nr.307, Datë 15.09.2021</b>	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Urdhër Nr. 22 dt. 15.01.2021	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër Nr. 268 dt. 10.08.2021
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> E hapur e thjeshtuar	1. S.M 2. T.P 3. A.I	1. O.Ç – (Kryetar) 2. A.D – (Anëtar) 3. S.LI – (Anëtar)
<b>5. Fondi Limit (pa TVSH)</b> 2,642,916 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSH)</b> OE “N 2014”, me ofertë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)</b> 28,746 lekë

	2,614,170 lekë	
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 27.09.2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë dhe Grandi i qeverisjes qendrore	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S'kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>11. Ankimime</b> AK-s'ka; APP-s'ka KPP-s'ka.	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK S'ka	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP S'ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr.2759, datë 08.11.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 3,137,004 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.</b>
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> 60 ditë	<b>19. Zgjatja e kontratës me - ditë</b> -

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Mbi përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, dokumentuar nëpërmjet procesverbalit nr.s'ka, datë 15.09.2021 të mbajtur nga NJP për argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit.**

***AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik ka kërkuar:***

**Pika 2.2.1 -** Operatori Ekonomik duhet të paraqes kopje të deklaratimit të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet financiare (2018, 2019, 2020), ose vërtetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të kontratës që po prokurohet – Ndërkohë sipas përcaktimit në shkronjën "c" të pikës 2 në nenin 43 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës.

**Pika 2.3.1 -** AK kërkon punë të ngjashme për një objekt të vetëm me **vlerë 50%** e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës / Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet – Pra AK kërkon vlerë fikse, duke kufizuar konkurrencën në këtë procedurë, pasi është vështirë që një OE të ketë 50 % të 2,666,666 lekë (fondi limit) = 1,333,333 lekë / 5,333,332 lekë. Për më tepër që ky kriter bie në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet:

"Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve: i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të madhe se 30 %** e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet**". Pra duket qartë që kriteri i mësipërm është kufizues dhe jo në përputhje me kuadrin rregullator.

**Në pikën 2.3.2** kërkohet disponimi i makinerive dhe paisjeve teknike, si më poshtë vijon:

Eskaator me zinxhir/goma cop 1

Kamion vetëshkarkues 15 ton e lart cop 1  
Komionçine 1.5 ton e lart cop 1  
Autobetoniere 4 m<sup>3</sup> e lart cop 1  
Betoforma druri 200 m<sup>2</sup>  
Vibrator betoni elektrik/djegje të brendshme cop 1  
Mjete mbrojtëse dhe identifikuese (kapele, jelek)

-Sa më sipër kërkesa për eskavator nuk është konkrete, por përfshinë të dy variantet, ndërkohë, që në vijim të kësaj kërkesë, duhet të ishte shtuar togëfjalëshi, nëse disponohet eskavator me zinxhir, OE duhet të disponojë rimorkiator për transportin e tij, pasi përfshihet në kategorinë e mjeteve të cilat nuk mund të qarkullojnë<sup>33</sup>.

-Kërkohet kamion vetëshkarkues minimuni 15 ton ndërkohë, kamionçinë minimumi 1.5 ton dhe autobetoniere me kapacitet 4 m<sup>3</sup> e lart, kërkesë e cila nuk argumentohet sipas volumit të materialeve dhe peshës së tyre.

**Në pikën 2.3.4** kërkohet që OE duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar/drejtues mjetesh, si më poshtë si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin Qershor 2021:

-Armator/karpentier 3

-Manovrator 1

-Drejtues mjetesh 3

Të gjithë specialistët duhet të jenë të shoqëruar me dëshmitë e kualifikimit dhe kontratë pune. Në pikën **2.3.5** kërkohet që OE, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 6 persona**, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin Qershor 2021. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

-Sa më sipër në pikën 2.3.4 kërkohet që specialistët të kenë dëshmitë e kualifikimit, por pa përcaktuar në mënyrë konkrete emërtimin e dëshmive të kualifikimit dhe institucionin/strukturën përkatëse që i lëshon dëshmitë. Numri i punonjësve nuk argumentohet, konkretisht kërkohen 2 mjete të rënda punimi, ndërkohë që në pikën 2.3.4 kërkohet 1 manovrator. Kërkohen 3 drejtues mjetesh, numër i cili nuk përputhet me numrin e mjeteve të kërkuar. Në pikën 2.3.5 kërkohen 6 punonjës, por pa përcaktuar profilin e tyre të formimit profesional. Gjithashtu numri i karpentierëve (3 gjithësej) dhe fuqisë punëtore (6 gjithësej) nuk argumentohet me analizë sipas zërave të punimeve, grafikut, pra sa kohë do të zgjasin punimet e ngritjes së armaturës dhe si do të organizohet puna me 1 turn apo më tepër, duke arritur në përfundimin se duhet ky numër punonjësish. Veç sa më sipër në kërkesat e mësipërme nuk është përfshirë periudha Korrik-Gusht 2021, duke qenë se tenderi zhvillohet më datë 27.09.2021. Pra sipas kërkesës së vendosur nga NJP, OE mund të ketë stafin e kërkuar në muajin Qershor të vitit 2021, pavarësisht se si mund të jetë situata e puntorisë 1 muaj përpara zhvillimit të tenderit.

**Në pikën 2.3.6** kërkohet që OE të ketë licencat N.P-1/A, N.P-2/A, N.P-4/A dhe N.S-18/A – Licenca N.P-2/A në këtë rast është e panevojshme, pasi llojet e punimeve që do të kryhen ezaurohen nëpërmjet licencës N.P-4/A “Rrugë autostrada, **ura**, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, **punime të mureve mbajtëse**, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, **urat**, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore”.

<sup>33</sup> Pika 2 në nenin 173 në Kodin Rrugor.

### **Vlerësimi i ofertave.**

KVO është ngritur me urdhër Nr. 268 dt. 10.08.2021 të Kryetarit të Bashkisë dhe përbëhet nga z. O.Ç, Kryetar, z. A.D dhe z. S.LI Anëtar.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës. Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE përkatësisht:

OE “N 2014” Sh.P.K, me ofertën ekonomike në shumën 2,614,170 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit, gjithësej 28,746 lekë.

OE “M” Sh.P.K, me ofertën ekonomike në shumën 2,633,982 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit, gjithësej 8,934 lekë.

Është s’kualifikuar OE “M” Sh.P.K.

OE i skualifikuar:

➤ “M” Sh.P.K, është s’kualifikuar me arsyet e mëposhtme:

1.Mungojnë dokumentet që disponojnë mjete dhe paisje, nuk disponon eskavator me zinxhir/goma, Kamion vetëshkarkues 15 ton e lart, Autobetonjere, Betoforma druri 200 m<sup>2</sup>, vibrator betoni, mjete mbrojtëse dhe identifikuese”.

2. Mungojnë dokumentet shoqërues për stafin teknik, nuk disponon bashkëlidhur diplomë, liçencë dhe kontratë për Ing.Gjeodet/markshajder”.

3.Mungojnë dokumentet shoqërues për punonjësit e specializuar, kualifikuar dhe drejtuesit e mjeteve, nuk disponon dëshmitë e kualifikimit dhe kontratat e punës”.

4.Mungojnë dokumentet shoqërues për liçensat profesionale të shoqërisë, nuk disponon liçensat profesionale”.

-S’kualifikimi i BOE të mësipërm qëndron.

### **Nga shqyrtimi i dokumentacionit përsa i përket vlerësimit të ofertës konstatohet se:**

-Janë dorëzuar dokumentacion për 2 karpentier, si dhe për 3 murator nuk janë dorëzuar kontratat e punës.

-Për 1 karpentier, G.M, për të cilin është dorëzuar kontratë pune, dëshmia e kualifikimit teknik është lëshuar për një punonjës me emër dhe mbiemër përkatësisht G.M. Gjithashtu nga verifikimi i listë pagesës, për muajin Qershor 2021, nuk figuron punonjës me emër dhe mbiemër G.M. Po kështu edhe karpentieri K.P, nuk figuron në listë-pagesën e muajit Qershor të vitit 2021.

-Nuk është dorëzuar certifikata e aftësisë profesionale për shoferin P.D dhe H.S, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 115/1 në Ligjin nr. datë 22.7.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht: “Drejtuesit e mjeteve, mbajtës të lejedrejtimit të kategorive C1 ose C, C1E apo CE, e marrin certifikatën e aftësisë profesionale për transportin e mallrave dhe drejtuesit e mjeteve, titullarë të lejedrejtimit të kategorive D1, D1E, D dhe DE, e marrin certifikatën e aftësisë profesionale për transportin e pasagjerëve. Kjo e fundit është e nevojshme gjithmonë në rastin e transportit të nxënëseve”, si dhe me përcaktimin e bërë në nenin 39/1 në Ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar: “Drejtuesit e mjeteve me peshë të përgjithshme të lejuar me ngarkesë mbi 6 tonë ose kur ngarkesa e lejuar, përfshirë rimorkion ose gjysmërimorkion, i kalon 3,5 tonë në transportin e mallrave, pajisen me certifikatën e aftësisë profesionale, në përputhje me udhëzimin e ministrit”.

-Për shoferin P.D, H.S, E.O, për të cilët është dorëzuar kontratë pune, leje drejtimi, konstatohet se: Leja e drejtimit nuk është e plotë për arsye se nuk është dorëzuar edhe pjesa e prapme e saj, me qëllim vlerësimin e vlefshmërisë së afatit për çdo kategori drejtimi B, C, D, BE, CE, DE.

-Gjithashtu nuk është sjellë dëshmi profesionale të kategorisë “Automakinist”, për drejtimin e autobetonieres.

-Afati i vlefshmërisë së certifikatës së aftësisë profesionale të shoferit dhe manovratorit E.O ka përfunduar më datë 20.10.2020.

**18.Tenderi me objekt: “Ndërtim i godinës së Njësisë Administrative Blerim” me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim i godinës së Njesisë Administrative Blerim”</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi Nr. 429, Datë 01.12.2021</b>	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Urdhër Nr. 22 dt. 15.01.2021	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër Nr. 268 dt. 10.08.2021
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> E hapur e thjeshtuar	1. J.P <sup>34</sup> 2. T.P 3. A.I	1. O.Ç – (Kryetar) 2. S.LI – (Anëtar) 3. A.D – (Anëtar)
<b>5. Fondi Limit (pa TVSH)</b> 4,708,333	<b>6. Oferta fituese (pa TVSH)</b> OE "N 2014", Sh.P.K, 4,690,670 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)</b> 17,663 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 16.12.2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë dhe Grandi i qeverisjes qendrore	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>11. Ankimime</b> AK-s’ka; APP-s’ka KPP-s’ka.	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S’ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP</b> S’ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 563, datë 22.02.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 5,628,804 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.</b>
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> 90 ditë	<b>19. Zgjatja e kontratës me - ditë</b> -

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Mbi përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, dokumentuar nëpërmjet procesverbalit nr.s’ka, datë 18.11.2021, për argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit.**

**AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik ka kërkuar:**

-Me procesverbalin nr.s’ka, datë 18.11.2021 janë përcaktuar kriteret e veçanta të kualifikimit dhe teknike për OE, stafi, makineritë, mjetet e transportit, pajisje pune, licenca profesionale për zbatim punimesh, të cilat janë hartuar nga Inxhinieri, Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës, z.T.P, pjesë e NJP në procedurën e mësipërme. Procesverbali i mësipërm është bërë pjesë e DST së procedurës së mësipërme.

**Pika 2.3.1 - AK kërkon punë të ngjashme deri në 30% të fondit limit që prokurohet për një vit të realizuar në 5 vitet e fundit / ose 100% e fondit limit të realizuar për keto vite – Në kërkesën për kapacitetin teknik nuk është përfshirë periudha Janar-deri në datën e shpalljes së njoftimit të kontratës, pra 01.12.2021, ose rreth 1 vit (pa 1 muaj) nuk është kërkuar si referencë që subjekti të sjellë dëshmi për plotësimin e kërkesës së mësipërme. Në këtë mënyrë një subjekt, i cili ka filluar aktivitetin e tij në muajin Dhjetor të vitit 2017, nuk mund të konkurrojë për arsye, se me kriterin e mësipërm duhet që subjekti të ketë filluar aktivitet në fushën e ndërtimit në vitin 2016. Gjithashtu AK kërkon vlerë fikse, duke kufizuar konkurrencën në këtë procedurë, pasi është vështirë që një OE të ketë punime të realizuara vlera e të cilave është 100% e fondit limit. Për më tepër që ky kriter bie në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet:**

<sup>34</sup> Shtuar në NJP me Urdhrin e titullarit të bashkisë nr.393, datë 11.11.2021, për ndryshimin e Urdhrit nr.22, datë 15.01.2021.

“Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve: i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të madhe se 30 %** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**. ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet**”. Pra duket qartë që kriteri i mësipërm është kufizues dhe jo në përputhje me kuadrin rregullator.

Në vijim kërkohet, që për të vërtetuar plotësimin e kushteve të mësipërme, duhet të dorëzohet: “Nëse kontrata është realizuar me ente publike: Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: - Kontratë punimesh; - Situacion përfundimtar; - Procesverbal-kolaudimi; -certifikatë për marrje në dorëzim të punimeve të kryera” – Pra konstatohet se nuk përcaktohet qartë dokumentacioni i kërkuar, dorëzimi i procesverbalit të **përkohëshëm** për marrje në dorëzim të punimeve të kryera apo procesverbal **përfundimtar**. Kërkesa e mësipërme nuk është e plotë, por është evazive duke krijuar mundësinë për subjektivitet gjatë vlerësimit të ofertave nga KVO.

**Në pikën 2.3.2** kërkohet disponimi i makinerive dhe paisjeve teknike, si më poshtë vijon:

- Eskavator me zinxhir/goma copë-1
- Kamion vetëshkarkues 12 ton e lart copë-1
- Komionçine 1.5 ton e lart copë-1
- Autobetoniere 4 m<sup>3</sup> e lart copë-1
- Betoforma druri 200 m<sup>2</sup>
- Vibrator betoni elektrik/djegje të brendshme copë-1
- Motogjenerator me djegie të brendshme copë-1
- Freksibël copë-1
- Skeleri metalike 100 m<sup>2</sup>
- Hekur kthyese mekanike/hidraulike copë-1
- Mjete mbrojtëse dhe identifikuese (kapele, jelek) copë-20
- Sa më sipër kërkesa për eskavator nuk është konkrete, por përfshinë të dy variantet, ndërkohë, që në vijim të kësaj kërkesë, duhet të ishte shtuar togëfjalëshi, nëse disponohet eskavator me zinxhir, OE duhet të disponojë rimorkiator për transportin e tij, pasi përfshihet në kategorinë e mjeteve të cilat nuk mund të qarkullojnë<sup>35</sup>.
- Kërkohet kamion vetëshkarkues minimumi 12 ton ndërkohë, kamionçinë minimumi 1.5 ton dhe autobetoniere me kapacitet 4 m<sup>3</sup> e lart, kërkesë e cila nuk argumentohet dhe pasqyrohet me analizë teknike sipas volumit të materialeve dhe peshës së tyre.

**Në pikën 2.3.4** kërkohet që OE duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar/drejtues mjetesh, si më poshtë si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin Qershor 2021:

- Hekur kthyes 2 punonjës
- Plaka shtrues 1
- Suvator 2
- Hidraulik 1
- Elektriçist 1
- Specialist per tavane gipsi
- Bojaxhi
- Karpentier 2
- Manovrator 1
- Drejtues mjeteve 3

Të gjithë specialistët duhet të jenë të shoqëruar me dëshmitë e kualifikimit dhe kontratë pune, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit.

**Në pikën 2.3.5** kërkohet që OE, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 5 persona**, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit.

<sup>35</sup> Pika 2 në nenin 173 në Kodin Rrugor.

-Sa më sipër në pikën 2.3.4 kërkohet që specialistët të kenë dëshmitë e kualifikimit, por pa përcaktuar në mënyrë konkrete emërtimin e dëshmive të kualifikimit dhe institucionin/strukturën përkatëse që i lëshon dëshmitë. Nuk është përcaktuar numri i punonjësve të profilit “bojaxhi” dhe “specialist për tavane gipsi”. Numri i punonjësve nuk argumentohet, konkretisht kërkohen 2 mjete të rënda punimi, ndërkohë që në pikën 2.3.4 kërkohet 1 manovrator. Kërkohen 3 drejtues mjetesh, numër i cili nuk përputhet me numrin e mjeteve të kërkuar. Në pikën 2.3.5 kërkohen 5 punonjës, por pa përcaktuar profilin e tyre të formimit profesional.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi T.P.

### **Vlerësimi i ofertave.**

KVO është ngritur me urdhër Nr. 268 dt. 10.08.2021 të Kryetarit të Bashkisë dhe përbëhet nga z. z. O.Ç, Kryetar, z. A.D dhe z. S.LI Anëtar.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës. Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE përkatësisht:

OE “N 2014” Sh.P.K, me ofertën ekonomike në shumën 4,690,670 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit, gjithësej 17,663 lekë.

OE “A” Sh.P.K, me ofertën ekonomike në shumën 4,705,040 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit, gjithësej 3,293 lekë.

OE “A” Sh.P.K nuk është shpallur fitues si rrjedhojë e çmimit më të lartë në krahasim me ofertën ekonomike të OE “N 2014” Sh.P.K, pasi sipas vlerësimit të bërë nga KVO, i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit.

### **Nga shqyrtimi i dokumentacionit përsa i përket vlerësimit të ofertës fituese konstatohet se:**

-Listë-pagesa është e muajit Tetor 2021 dhe jo e muajit të fundit, pra muajit Nëntor 2021. Bazuar në pikën 4.3, shkronja “a” në Udhëzimin nr.23, datë 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar, subjekti brenda datës 20 të muajit pasardhës duhet të dorëzojë listë-pagesën për muajin e kaluar, pra brenda datës 20 Dhjetor të vitit 2021, subjekti duhet të dorëzojë listë-pagesën e muajit Nëntor të vitit 2021. Oferta e mësipërme është dorëzuar më datë 16.12.2021, ç’ka do të thotë se subjekti ka pasur kohën e mjaftueshme për të dorëzuar listë-pagesën e muajit Nëntor në DRT Shkodër dhe më pas dorëzimin e saj në procedurën e mësipërme.

-Gjithashtu edhe pas njoftimit të fituesit më datë 22.12.2021, ku në zbatim të pikës 6 të nenit 26 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke kaluar edhe afati i ankimit (7 ditë nga momenti i njoftimit) OE “N 2014” Sh.P.K ka dorëzuar dokumentacionin, përsëri ka qenë në mospërmbushje të kriterit të mësipërm në DST, pra për dorëzimin e listë-pagesës së muajit të fundit.

-Veç sa më sipër një nga karpentierët, konkretisht S.M, nuk figuron në listë-pagesën e dorëzuar nga OE “N 2014” Sh.P.K

-Për 1 karpentier, G.M, për të cilin është dorëzuar kontratë pune, dëshmia e kualifikimit teknik është lëshuar për një punonjës me emër dhe mbiemër përkatësisht G.M. Gjithashtu nga verifikimi i listë pagesës, nuk figuron punonjës me emër dhe mbiemër G.M.

-Nuk është dorëzuar certifikata e aftësisë profesionale për shoferin H.S, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 115/1 në Ligjin nr. datë 22.7.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht: “*Drejtuesit e mjeteve, mbajtës të lejedrejtimit të kategorive C1 ose C, C1E apo CE, e marrin certifikatën e aftësimin profesional për transportin e mallrave dhe drejtuesit e mjeteve, titullarë të lejedrejtimit të kategorive D1, D1E, D dhe DE, e marrin certifikatën e aftësimin profesional për transportin e pasagjerëve. Kjo e fundit është e nevojshme gjithmonë në rastin e transportit të nxënësve*”, si dhe me përcaktimin e bërë në nenin 39/1 në Ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar: “*Drejtuesit e mjeteve me peshë të përgjithshme të lejuar me ngarkesë mbi 6 tonë ose kur ngarkesa e lejuar, përfshirë rimorkion ose gjysmërimorkion, i kalon 3,5 tonë në transportin e mallrave, pajisen me certifikatën e aftësisë profesionale, në përputhje me udhëzimin e ministrit*”.

-Për shoferin H.S, E.O, për të cilët është dorëzuar kontratë pune, leje drejtimi, konstatohet se: Leja e drejtimit nuk është e plotë për arsye se nuk është dorëzuar edhe pjesa e prapme e saj, me qëllim vlerësimin e vlefshmërisë së afatit për çdo kategori drejtimi B, C, D, BE, CE, DE.  
-Gjithashtu nuk është sjellë dëshmi profesionale të kategorisë “Automakinist”, për drejtimin e autobetonieres.  
-Afati i vlefshmërisë së certifikatës së aftësisë profesionale të shoferit dhe manovratorit E.O ka përfunduar më datë 20.10.2020.

### **Konkluzion**

Sa më sipër rezulton se OE dhe BOE shpallur fitues në tenderat e mësipërm nuk përmbushin plotësisht kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte, KVO nuk duhej të kishte bërë kualifikimin e tyre, por duhet të kishte anuluar tenderat përkatës.

*-Sa më sipër, për vitin 2019 mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje: L.Gj, T.P dhe E.M;  
Për vitin 2020 dhe 2021 mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje: S.M, T.P dhe A.I;  
-Sa më sipër, për vitin 2019 mbanë përgjegjësi KVO, me përbërje K.S (Kryetar), F.D dhe A.D (Anëtar);  
Për vitin 2020 dhe 2021 mbanë përgjegjësi KVO, të cilat sipas rastit kanë pasur përbërje si vijon:  
-S.Gj (Kryetar), K.S dhe A.D (Anëtar)  
-O.C (Kryetar), K.S dhe A.D (Anëtar).  
-O.C (Kryetar), A.D dhe S.Ll (Anëtar).  
-K.S (Kryetar), A.D dhe A.D (Anëtar).*

**Kriteri:** Shkronja “ç” në pikën 1 në nenin 24, pika 1 dhe 3 në nenin 46 dhe pika 3 në nenin 53 në Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;  
Nenin 2, pikën 2 në nenin 3, nenin 77 dhe nenin 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”;

Pikën 5 në nenin 26, pikat 1, 3, 5 në nenin 27, pikën 2 në nenin 61 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

Shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 2, Shkronjën “b” të pikës 3 në nenin 15, pikën 4 në nenin 39, pikën 1 të nenit 40, shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43, pikën 1 të nenit 44 dhe pikën 4 në nenin 55, pikën 2 të nenit 82, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Kufizim të konkurrencës dhe cenimin e qëllimeve të kuadrit ligjor për prokurimin: Të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; Të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; Të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; Të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Njësia e Prokurimit Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

-Njësia e Prokurimit në Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa që në vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në procedurat e prokurimit për blerjen e mallrave me natyrë lëndë djegëse për ngrohje dhe transport, të përcaktohet distanca e favorshme e magazinimit të lëndës djegëse, si dhe e stacionit të shitjes së karburantit, me qëllim plotësimin e nevojave të institucionit në kohë dhe me cilësi.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e përcaktimit të kriterëve të kualifikimit në kundërshtim me kuadrin rregullator, si dhe të kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë



masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

### **III.Gjetje mbi argumentimin dhe dokumentimin e përlogaritjes së fondit limit.**

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e argumentimit, dokumentimit dhe përlogaritjes së fondit limiti, të cilat sipas rastin kanë shkaktuar përdorim pa ekonomikitet të fondeve publike.

**Situata:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit të mësipërme, u konstatua se në 5 raste nga NJP nuk është argumentuar dhe dokumentuar përlogaritja e fondit limit, duke shkaktuar përdorim pa eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën 3,139,712 lekë<sup>36</sup>. Konkretisht rastet si më poshtë vijon:

#### **Tenderat me objekt “Blerje lëndë djegëse për ngrohje për vitin 2020 dhe 2021”.**

##### **1.Blerje lëndë djegëse për vitin 2020**

-Burimi i financimit është nga buxheti i bashkisë. Preventivi në vlerën 1,702,980 lekë pa TVSH është hartuar nga anëtari i NJP Inxhinier T.P mbi bazën e kërkesave për sasi dru zjarri dhe pelet, nga 22 struktura (shkolla, kopshte, çerdhe, qendra kulturore), si dhe dokumentuar me procesverbalin nr.1 datë 10.08.2020 të mbajtur nga NJP, pasqyruar në tabelën nr.1, si më poshtë vijon:

Nr	Subjekti	Lënda	Njësia	Sasia	Çmimi/m <sup>3</sup> + transport	Vlera
1	Shkolla 9-vjecare F.Arrëz	Dru	m <sup>3</sup>	53	3,000	159,000
2	Aneksi Micoj	Dru	m <sup>3</sup>	3	3,000	9,000
3	Aneksi parashkollor F.Arrëz	Dru	m <sup>3</sup>	6	3,000	18,000
4	QKF F.Arrëz	Dru	m <sup>3</sup>	23	3,000	69,000
5	Çerdhja F.Arrëz	Dru	m <sup>3</sup>	50	3,000	150,000
6	Kopështi F.Arrëz	Dru	m <sup>3</sup>	58	3,000	174,000
7	Shkolla 9-vjecare Kryezi	Dru	m <sup>3</sup>	33	3,000	99,000
8	Aneksi Orosh Kryezi	Dru	m <sup>3</sup>	6	3,000	18,000
9	Aneksi Lumbardhë Kryezi	Dru	m <sup>3</sup>	6	3,000	18,000
10	Aneksi Lajthizë Kryezi	Dru	m <sup>3</sup>	6	3,000	18,000
11	Aneksi Bardhet Kryezi	Dru	m <sup>3</sup>	6	3,000	18,000
12	Aneksi Levozhë Iballë	Dru	m <sup>3</sup>	6	3,000	18,000
13	Aneksi Shopel Iballë	Dru	m <sup>3</sup>	6	3,000	18,000
14	Aneksi Berishë e Vogël Iballë	Dru	m <sup>3</sup>	6	3,000	18,000
15	Aneksi Berishë Vendi Iballë	Dru	m <sup>3</sup>	6	3,000	18,000
16	Aneksi Dushkajë Iballë	Dru	m <sup>3</sup>	6	3,000	18,000
17	Aneksi Mertur Iballë	Dru	m <sup>3</sup>	6	3,000	18,000
18	Shkollat NJA Blerim	Dru	m <sup>3</sup>	50.5	3,000	151,500
19	Shkollat NJA Fierzë	Dru	m <sup>3</sup>	43	3,000	129,000
20	Gjinnazi F. Arrëz	Pelet	Kg	13,000	28	364,000
21	Shkolla Iballë	Pelet	Kg	4,446	28	124,488
22	Shkolla Fierzë	Pelet	Kg	2,714	28	75,992
	<b>Total pa TVSH</b>					<b>1,702,980</b>
					TVSH	340,596
	<b>Total</b>					<b>2,043,576</b>

Në preventiv është përcaktuar lloji i mjetit ngrohës, sobë ose kaldajë dhe produkti djegës, dru dhe pelet. Në procesverbalin për dokumentimin e përlogaritjes së fondit limit, NJP ka përcaktuar çmimin 3,000 lekë pa TVSH për drutë dhe 28 lekë pa TVSH kg për pelet (mall + transport). Në përcaktimin e këtij çmimi, NJP shprehet se testoi tregun lokal dhe rajonal dhe studioj procedura të ngjashme të hartuara nga AK të ndryshme. Referuar mbishkrimit në pv., nr.1, datë 10.08.2020, në dosjen përkatëse nuk administrohet asnjë dokument bashkëlidhur (oferta të marra në treg nga subjekte të ndryshme, publikimit në INSTAT etj). Pra arrihet në përfundimin se nga NJP nuk është dokumentuar mënyra e përlogaritjes së vlerës së kontratës, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Ndodhur në kushtet e mësipërme, ku nuk dokumentohet mënyra e përlogaritjes së çmimit për dru zjarri dhe kosto e transportit për këtë lëndë punimi, me qëllim kryerjen e përlogaritjes, për

<sup>36</sup> Vlerë e matshme.

të vlerësuar mundësinë e kursimit të fondeve, grupi i auditimit i'u referua çmimeve të përcaktuara në manualet e ndërtimit miratuar me VKM nr.629, datë 15.07.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", i ndryshuar, konkretisht në tabelën nr.2, rrjeshti 74, për lëndën djegëse (dru zjarri) me çmimin 2,500 lekë/m<sup>3</sup> dhe çmimin mesatar 20.5 lekë/m<sup>3</sup> të transportit (në manualin e çmimeve dhe të punimeve të ndërtimit me analizat përkatëse) të lëndës dru zjarri/m<sup>3</sup>, do të kishim 379.5 m<sup>3</sup> dru zjarri të kërkuar gjithësej \* 2520.5 lekë/m<sup>3</sup> = 956,529.8 lekë pa TVSH gjithësej kosto për lëndën djegëse dhe transportin e saj, ndërkohë që sipas preventivit të mësipërm kosto e lëndës djegëse dru zjarri është 1,138,500 lekë, ose 181,970 lekë më tepër. Pra sa më sipër arrihet në përfundimin se në prokurimin e lëndës djegëse dru zjarri, duke zbritur edhe diferencën e ofertës fituese me fondin limit pra 171,440 lekë, NJP mund të kursente fonde publike në vlerën 10,530 lekë, të cilat në gjykimin e grupit të auditimit, si dhe mbështetur në analizën e mësipërme përbëjnë shpenzime pa ekonomicitet<sup>37</sup>.

*-Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga, zj.S.M, z.T.P dhe zj.A.I.*

## **2.Blerje lëndë djegëse për vitin 2021**

-Burimi i financimit është nga buxheti i bashkisë. Preventivi në vlerën 1,634,540 lekë pa TVSH është hartuar nga anëtari i NJP Inxhinier T.P mbi bazën e kërkesave për sasi dru zjarri dhe pelet, nga 22 struktura (shkolla, kopshte, çerdhe, qendra kulturore), si dhe dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka datë 20.10.2021 të mbajtur nga NJP, pasqyruar në tabelën nr.2, si më poshtë vijon:

Nr	Subjekti	Lënda	Njësia	Sasia	Çmimi/m3	Vlera
1	Shkolla 9-vjecare F.Arrëz	Dru	m3	72	3,000	216,000
2	Aneksi Micoj	Dru	m3	3	3,000	9,000
3	Aneksi parashkollor F.Arrëz	Dru	m3	6	3,000	18,000
4	QKF F.Arrëz	Dru	m3	15	3,000	45,000
5	Çerdhja F.Arrëz	Dru	m3	25	3,000	75,000
6	Kopështi F.Arrëz	Dru	m3	48	3,000	144,000
7	Shkolla 9-vjecare Kryezi	Dru	m3	33	3,000	99,000
8	Aneksi Orosh Kryezi	Dru	m3	6	3,000	18,000
9	Aneksi Lumbardhë Kryezi	Dru	m3	6	3,000	18,000
10	Aneksi Lajthizë Kryezi	Dru	m3	6	3,000	18,000
11	Aneksi Bardhet Kryezi	Dru	m3	6	3,000	18,000
12	Aneksi Levozhë Iballë	Dru	m3	6	3,000	18,000
13	Aneksi Shopel Iballë	Dru	m3	6	3,000	18,000
14	Aneksi Berishë e Vogël Iballë	Dru	m3	6	3,000	18,000
15	Aneksi Berishë Vendi Iballë	Dru	m3	6	3,000	18,000
16	Aneksi Dushkajë Iballë	Dru	m3	6	3,000	18,000
17	Aneksi Mertur Iballë	Dru	m3	6	3,000	18,000
18	Shkollat NJA Blerim	Dru	m3	50.8	3,000	152,400
19	Shkollat NJA Fierzë	Dru	m3	50	3,000	150,000
20	Shkolla Fierzë	Pelet	Kg	1,964	28	54,992
21	Gjimnazi F. Arrëz	Pelet	Kg	13,095	28	366,660
22	Shkolla Iballë	Pelet	Kg	4,446	28	124,488
	<b>Total pa TVSH</b>					<b>1,634,540</b>
					TVSH	326,908
	<b>Total</b>					<b>1,961,448</b>

Në preventiv është përcaktuar lloji i mjetit ngrohës, sobë ose kaldajë dhe produkti djegës, dru dhe pelet. Në procesverbalin për dokumentimin e përlllogaritjes së fondit limit, NJP ka përcaktuar çmimin 3,000 lekë pa TVSH për drutë dhe 28 lekë pa TVSH kg për pelet (mall + transport). Në përcaktimin e këtij çmimi, NJP shprehet se testoi tregun lokal dhe rajonal dhe studioj procedura të ngjashme të hartuara nga AK të ndryshme. Referuar mbishkrimit në pv., nr.s'ka, datë 20.10.2021, në dosjen përkatëse nuk administrohet asnjë dokument bashkëlidhur (oferta të marra në treg nga subjekte të ndryshme, publikimit në INSTAT etj).

-Pra arrihet në përfundimin se nga NJP nuk është dokumentuar mënyra e përlllogaritjes së vlerës së kontratës, në kundërshtim me pikat 1 dhe 4 të nenit 13 dhe pikën 2 të nenit 76 të

<sup>37</sup> Pika 23 në nenin 3 në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku përcaktohet: "**Përdorim me ekonomi**" është përdorimi i një sasive dhe cilësie të dhënë të inputeve (**në këtë rast të fondeve të buxhetit të bashkisë**) në një kohë të dhënë dhe me koston më të ulët.

VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Ndodhur në kushtet e mësipërme, ku nuk dokumentohet mënyra e përlllogaritjes së çmimit për dru zjarri dhe kosto e transportit për këtë lëndë punimi, me qëllim kryerjen e përlllogaritjes, për të vlerësuar mundësinë e kursimit të fondeve, grupi i auditimit i’u referua çmimeve të përcaktuara në manualin e ndërtimit miratuar me VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, konkretisht çmimet e materialeve të ndërtimit, tabela nr.2, rrjeshti 74, për lëndën djegëse (dru zjarri) me çmimin 2,500 lekë/m<sup>3</sup> dhe çmimin mesatar 20.5 lekë/m<sup>3</sup> të transportit (në manualin e çmimeve dhe të punimeve të ndërtimit me analizat përkatëse) të lëndës dru zjarri/m<sup>3</sup>, do të kishim 379.5 m<sup>3</sup> dru zjarri të kërkuar gjithësej \* 2520.5 lekë/m<sup>3</sup> = 914,437.4 lekë pa TVSH gjithësej kosto për lëndën djegëse dhe transportin e saj, ndërkohë që sipas preventivit të mësipërm kosto e lëndës djegëse dru zjarri është 1,088,400 lekë, ose 173,962 lekë më tepër.

Pra sa më sipër arrihet në përfundimin se në prokurimin e lëndës djegëse dru zjarri, duke zbritur edhe diferencën e ofertës fituese me fondin limit pra 81,727 lekë, NJP mund të kursente fonde publike në vlerën 92,235 lekë, të cilat në gjykimin e grupit të auditimit, si dhe mbështetur në analizën e mësipërme përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet<sup>38</sup>.

*-Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga, zj.S.M, z.T.P dhe zj.A.I.*

### **Të tjera çështje të krijuara gjatë auditimit të procedurave të prokurimit të lëndës djegëse, lloji dru zjarri, për periudhën 2019-2021.**

Grupi i auditimit gjatë auditimit të procedurave të mësipërme, duke pasur në konsideratë burimet natyrore (florën) të disponueshme në teritorrin administrativ të Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe sipërfaqet pyjore dhe kullimore, të cilat me VKM nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive”<sup>39</sup>, të ndryshuar, vlerësoi nëse Bashkia Fushë Arrëz ka mundësinë (kuadri rregullator dhe kapacitetet), që lëndën djegëse dru zjarri ta siguroj nëpërmjet prerjeve në fondin e saj pyjor dhe jo ta blejë atë në subjekte private.

Sa më sipër, parashtrijmë si më poshtë vijon:

-Nga shqyrtimi i kuadrit rregullator të fushës, pra të sektorit të pyjeve, rezulton se baza ligjore, konkretisht VKM nr.438, datë 8.6.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”, i ndryshuar, ka si objekt përcaktimin e procedurës, kriterëve dhe rregullave për shfrytëzimin e pyjeve për ngrohje të banorëve të bashkisë.

-Për çdo vit nga struktura e pyjeve në bashki përcaktohet sasia e shfrytëzueshme e lëndës drusore për ngastrat/grup ngastrat, duke bërë miratimin projektit tekniko-ekonomik të trajtimit dhe shfrytëzimit të pyjeve.

-Bashkitë, brenda datës 30 prill të çdo viti, **pasi vlerësojnë nevojat e komunitetit dhe enteve të tjera publike për dru zjarri**, pa tejkalar mundësinë e shfrytëzimit të pyjeve shtetërore dhe private, dërgojnë për miratim, në drejtorinë përkatëse, në Ministrinë e Mjedisit, kapacitetin dhe mundësinë vjetore të shfrytëzimit.

-Ministri i Mjedisit, me urdhër të veçantë, miraton për çdo vit pyjor mundësinë vjetore të shfrytëzimit të pyjeve shtetërore dhe të pronarëve privatë për secilën bashki.

**-Shfrytëzimi dhe trajtimi i pyjeve** nga bashkitë për sigurimin e nevojave për ngrohje, nxjerrja dhe magazinimi i tyre në sheshet e depozitimit, të përcaktuara paraprakisht, realizohet nga:

<sup>38</sup> Pika 23 në nenin 3 në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “**Përdorim me ekonomi**” është përdorimi i një sasive dhe cilësie të dhënë të inputeve (**në këtë rast të fondeve të buxhetit të bashkisë**) në një kohë të dhënë dhe me koston më të ulët.

<sup>39</sup> 51. Sipërfaqet pyjore dhe kullimore, sipas listës së inventarit, dhe asete të tjera, që transferohen në pronësi të Bashkisë Fushë-Arës, janë sipas shtojcës 49, bashkëlidhur këtij vendimi. Shtojca përmban: a) listën e inventarit që fillon me numrin rendor 1 (një) deri 3 571 (tre mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një); b) godinën e DSHP.

**a) subjekte të licencuara, të kontraktuara nga bashkia, në bazë të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, me objekt prerjen e materialit drusor në këmbë (të paprerë) dhe transportin e tyre;**

b) ndërmarrjet e specializuara, të ngritura pranë bashkisë.

➤ Po kështu edhe në Udhëzimin nr. 2, datë 3.3.2017 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”, përcaktohet se:

-Nxjerrja e ngastrave për trajtimin e grumbujve pyjorë me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje do të bëhet me ekonomi pyjore. Vetëm në rastet e ndërhyrjeve kur nuk ka mundësi të krijohen grupngastra, do të bëhet me ngastër të veçantë.

-**Trajtimi i pyjeve nga bashkitë** për sigurimin e nevojave për ngrohje, nxjerrja dhe depozitimi i tyre në sheshet e përcaktuara paraprakisht do të realizohet nga **subjektet me licencë të kontraktuara nga bashkia** për prerjen e lëndës drusore në këmbë dhe transportin e materialit drusor deri në sheshin e depozitimit të bashkisë ose nga ndërmarrjet e specializuara të ngritura në bashki.

-**Me kompaninë që shpallet fituese nga tenderimi për trajtimin e fondit pyjor, me qëllim vjeljen e druve të zjarrit për ngrohje dhe vjeljen e prodhimeve drunore e jodrunore, lidhet kontrata.** Në kontratë pasqyrohen vëllimet e lëndës drusore në këmbë sipas llojeve dhe asortimenteve që do të prodhohen për çdo ngastër pyjore, datat e fillimit e përfundimit të prerjes, nxjerrjes e stivimit së materialit drusor në anë të rrugës dhe të kolauditimit të ngastrave/nënngastrave.

-Në vijim të sa më sipër për periudhën 2019-2021, me qëllim kryerjen e prerjeve rigjeneruese dhe shëndetësuese të fondit pyjor, si dhe sigurimin edhe të lëndës djegëse për ngrohje, **nga DSHP Bashkia Fushë Arrëz, janë hartuar dhe miratuar projektet e shfrytëzimit**, të cilat i janë përcjellë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, konkretisht:

-Me shkresën nr.1302 prot., datë 26.04.2019, Bashkia Fushë Arrëz i është drejtuar MTM, e cila me urdhrin nr.231, datë 03.07.2019 ka miratuar shfrytëzimin e pyjeve për periudhën 2019-2020;

-Me shkresën nr.1656 prot., datë 06.07.2020, Bashkia Fushë Arrëz i është drejtuar MTM, e cila me urdhrin nr.297, datë 18.11.2020 ka miratuar shfrytëzimin e pyjeve për periudhën 2020-2021.

-Gjithësej për periudhën e mësipërme lëndë dru zjarri e vlerësuar për përdorim për ngrohje të popullatës është **7864 m<sup>3</sup>**, nga të cila 4424 m<sup>3</sup> për periudhën 2019-2020 dhe 3440 m<sup>3</sup> për periudhën 2020-2021, ndërkohë kërkesat e Bashkisë Fushë Arrëz për lëndë djegëse dru zjarri, për këtë periudhë janë **1066.3 m<sup>3</sup>**, nga të cilat 324 m<sup>3</sup> për vitin 2019, 379.5 m<sup>3</sup> për vitin 2020 dhe 362.8 m<sup>3</sup> për vitin 2021, ose **13.5%** të sasisë së lëndës djegëse dru zjarri të miratuar për t'u shfrytëzuar për periudhën 2019-2021. Në projektet e mësipërme të shfrytëzimit janë miratuar edhe sheshet e depozitimit të druve të zjarrit.

-Gjithashtu u verifikuan regjistrat e realizimit, si dhe procedurat e shpallura në sistemin elektronik të prokurimeve për periudhën e mësipërme, me qëllim vlerësimin nëse nga Bashkia Fushë Arrëz përgjatë kësaj periudhe është realizuar apo testuar tregu për kontraktimin e shërbimit të prerjes së druve. Nga ky verifikim rezultoi se në asnjë rast nuk është kryer një veprim i tillë, pra të jenë ftuar subjekte të cilat ushtrojnë aktivitet në shfrytëzimin e fondit pyjor, për të ofruar shërbimin e prerjes së druve, apo të jetë parashikuar në regjistrin e procedurave të prokurimit, të jetë shpallur si procedurë në sistemin elektronik dhe mos të ketë pasur asnjë subjekt të interesuar për të ofruar këtë shërbim, që të kushtëzonte Bashkinë Fushë Arrëz në prokurimin e mallit “dru zjarri”.

-Veç sa më sipër u verifikua edhe regjistri i taksave dhe tarifave vendore, ku rezultoi se në teritorrin administrativ të Bashkisë Fushë Arrëz, ushtrojnë aktivitet disa subjekte, që kanë objekt aktiviteti “shfrytëzim i fondit pyjor”, të cilat mund të ofrojnë shërbimin e prerjes së druve.

-Sa më sipër arrihet në konkluzionin se nga Bashkia Fushë Arrëz përgjatë periudhës 2019-2021, nuk janë marrë masa për të vlerësuar mundësinë e kontraktimit të shërbimit të prerjes së druve pyjor, pasi edhe transportin e lëndës djegëse dru zjarri, e ka mundësinë ta sigurojë vetë<sup>40</sup>, pa pasur nevojën e kontraktimit të tij.

-Në kushtet e mësipërme, duke marrë në konsideratë kuadrin rregullator, burimet natyrore, kapacitetet e nevojshme, praninë e subjekteve me aktivitet të tillë në territorin administrativ të bashkisë, arrihet në konkluzionin se burimet (financiare, njerëzore, natyrore dhe kuadri rregullator) nuk janë përdorur në përputhje me parimet e eficiencës dhe ekonomicitetit, *për rrjedhojë fondet e përdorura për blerjen e lëndës djegëse dru zjarri, në vlerën 2,733,040 lekë gjithësej, përbëjnë shpenzime pa eficiencë dhe ekonomicitet, nga të cilat:*

-972,000 lekë për vitin 2019;

-944,740 lekë për vitin 2020;

-816,300 lekë për vitin 2021.

*Për sa më sipër, mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 1 të nenit 8 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, mbanë përgjegjësi titullari i Bashkisë Fushë Arrëz, z. F.T.*

## **Tenderat me objekt “Blerje karburanti për nevojat e bashkisë, Fushë-Arrëz për vitin 2020 dhe 2021”.**

### **3.Blerje karburanti për vitin 2020**

Hartimi i fondit limit dhe përcaktimi i kërkesave për karburant.

-Fondi limit është përlogaritur në vlerën 5,056,666 lekë pa TVSH, si dhe miratuar me procesverbalin nr.1, datë 12.02.2020. Në procesverbalin e mësipërm nuk pasqyrohet përlogaritja e fondit limit, konkretisht pasqyrohet informacioni se NJP i'u referua çmimeve të publikuara në buletinin e APP, çmimeve e shitjeve me pakicë dhe eksperiencave të mëparshme, por në asnjë rast nuk pasqyrohet, se buletini i cilës datë është marrë për referencë, cilës bursë i janë referuar për të dhënat, përlogaritjen e kryer (çmimi në bursë për ton, shtesat për ton, aplikimin e taksave kombëtare, si dhe më e rëndësishmja përcaktimi i marzhit të fitimit). Veç sa më sipër, nuk dokumentohet se kujt subjekteve që tregtojnë karburant i është drejtuar NJP me qëllim marrjen e ofertave prej tyre për të testuar tregun.

-Sasia totale e nevojshme për konsum për vitin 2020 është bërë sipas kërkesave nga 7 sektorë, përkatësisht: Policia Bashkiake; Drejtoria e Shërbimit Pyjor; Sektori i Shërbimeve Publike; Sektori i Rrugëve Rurale; Administrata; Njësia Administrative Iballë dhe Sektori i Zjarrëfikses.

-Konstatohet se nga Sektori i Zjarrëfikses është kërkuar karburant, lloji naftë, gjithësej 6000 litra, ndërkohë që për mjetin e zjarrëfikses, nuk është bërë përcaktimi i konsumit litër/km.

### **4.Blerje karburanti për vitin 2021**

Hartimi i fondit limit dhe përcaktimi i kërkesave për karburant.

-Fondi limit është përlogaritur në vlerën 5,056,666 lekë pa TVSH, si dhe miratuar me procesverbalin nr.1, datë 02.02.2021. Në procesverbalin e mësipërm nuk pasqyrohet përlogaritja e fondit limit, konkretisht pasqyrohet informacioni se NJP iu referua çmimeve të publikuara në buletinin e APP, çmimeve e shitjeve me pakicë dhe eksperiencave të mëparshme, por në asnjë rast nuk pasqyrohet, se buletini i cilës datë është marrë për referencë, cilës bursë i janë referuar për të dhënat, përlogaritjen e kryer (çmimi në bursë për ton, shtesat për ton, aplikimin e taksave kombëtare, si dhe më e rëndësishmja përcaktimi i marzhit të fitimit). Veç sa më sipër, nuk dokumentohet se kujt subjekteve që tregëtojnë karburant i është drejtuar NJP me qëllim marrjen e ofertave prej tyre për të testuar tregun.

-Sasia totale e nevojshme për konsum për vitin 2021 është bërë sipas kërkesave nga 10 sektorë, përkatësisht: Policia Bashkiake; Drejtoria e Shërbimit Pyjor; Sektori i Shërbimeve Publike;

<sup>40</sup> Sipas inventarit të llogarisë nr.215, rezulton se Bashkia Fushë Arrëz, ka mjet transporti, kamion.

Sektori i Rrugëve Rrurale; Administrata; Njësia Administrative Iballë, Qafë Mali, Fierzë, Blerim dhe Sektori i Zjarrëfikses.

-Konstatohet se nga Sektori i Zjarrëfikses është kërkuar karburant, lloji naftë, gjithësej 3500-4500 litra, ndërkohë që për mjetin e zjarrëfikses, nuk është bërë përcaktimi i konsumit litër/km. Për më tepër që në vitin 2020, konsumi i karburantit nga ky sektor është 2196 litra, ndërkohë kërkohej 1000-2300 litra më tepër.

-Në të dy rastet e mësipërme konstatohet se përjashtuar Policinë Bashkiake, në asnjë rast nuk pasqyrohet targa e automjetit, për të përligjur nevojën për karburant të sektorit përkatës.

-Gjithashtu, asnjë prej kërkesave nuk dokumentohet me program pune vjetor, ku përcaktohen punët që do të kryhen nga secili sektor, për të arritur në vlerësimin e sasisë së nevojshme për karburant, e cila kushtëzon edhe përcaktimin e fondit limit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk mbrojnë interesat ekonomik të AK, pasi mos dokumentimi konkret i mënyrës së përllogaritjes së fondit limit, mund të mbivlerësojë fondin e për rrjedhojë rritë shpenzimet e institucionit për blerjen e karburantit.

-Sa më sipër, për mosdokumentimin e përllogaritjes së fondit limit mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, S.M, T.P dhe A.I.

### **5. Tenderi me objekt “Ndërtim i shpatullave të urave auto Koprart dhe Micoj”.**

-Preventivi i punimeve dhe dokumentacioni teknik është hartuar nga Inxhnieri T.P, Përgjegjës i Urbanistikës pranë Bashkisë Fushë Arrëz, pjesë e NJP, dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka., datë 13.08.2021 dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë z. F.T. Preventivi i punimeve me vlerën 2,642,916 lekë pa TVSH, përbëhet nga dy zëra punimesh, gjërmim dhe struktura monolite betoni. U testuan zërat e preventivit me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së çmimeve për njësi në preventiv me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, dhe rezultuan diferenca, konkretisht:

<b>Punime gjërmimi dhe betoni ura Koprart</b>						
Analiza	Emërtimi	Sasia	Çmimi Preventiv	Çmimi Manual	Diferenca në çmim	Diferenca total
2.59/b	Gjërmim themeli i veçuar tokë e zakonshme me mekanike	55 m <sup>3</sup>	400	S’ka		
3.244	Struktura monolite betoni C20/25 për shpatullat e urës	92.4 m <sup>3</sup>	13,800	11,494		213,074
<b>Total</b>						<b>213,074</b>

<b>Punime gjërmimi dhe betoni ura Micoj</b>						
Analiza	Emërtimi	Sasia	Çmimi Preventiv	Çmimi Manual	Diferenca në çmim	Diferenca total
2.59/b	Gjërmim themeli i veçuar tokë e zakonshme me mekanike	38 m <sup>3</sup>	400	S’ka		
3.244	Struktura monolite betoni C20/25 për shpatullat e urës	96.42 m <sup>3</sup>	13,800	11,494		222,344
<b>Total</b>						<b>222,344</b>

-Sa më sipër konstatohet se përllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë bazuar përcaktimeve të bëra në VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar dhe rezultuan diferenca. *Kjo ka sjellë rritje të pajustificuar të fondit limit në vlerën 435,418 lekë – 28,746 lekë diferencë nga fondi limit = 406,672 lekë, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet.*

-Gjithashtu konstatohet se zëri i punimeve me analizë nr 2.59/b “Gjërmim themeli i veçuar tokë e zakonshme me mekanike”, nuk bazohet në VKM nr.629, datë 15.07.2017, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, pasi në manualet teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit nuk ka një zë me nr.,

2.59/b. Për më tepër ky zë punimesh në kushtet e mungesës së çmimit referues, nuk është shoqëruar me analizë teknike të tij.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi inxhinieri T.P dhe Kryetari i Bashkisë z. F.T.

**Kriteri:** Pika 23 në nenin 3 në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pikën 2 në nenin 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Përdorimi pa eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve publike në vlerën 3,139,712 lekë.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të marrë masat e nevojshme, që të prokurojë shërbimin e prerjes së lëndës djegëse lloji “Dru zjarri” për ngrohje, dhe jo blerjen e tij, me qëllim eliminimin e përdorimit të fondeve publike pa eficiencë dhe ekonomikitet.

-Gjithashtu në bashkëpunim me sektorin e financës, të marrë masa për ngritjen e komisionit, me qëllim përcaktimin e normës së konsumit të karburantit për mjetet e sektorit të zjarrëfikses, si dhe argumentimin e plotë dhe të saktë të sasisë për karburant nga sektorët përkatës.

- Njësia e Prokurimit Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masat e nevojshme, që për çdo procedurë prokurimi, të argumentoj dhe dokumentoj përllogaritjen e fondit limit.

#### **Për prokurimet e realizuara në periudhën 01.01.2019-31.12.2021**

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me shkresën nr. 885/8 prot., datë 11.01.2023 si më poshtë:

#### **Pretendimi i Subjektit:**

Pretendimet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjta me ato të paraqitura mbi Akt Konstatimin nr. 9 dhe 10, të cilat janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, dhe nuk është paraqitur asnjë argument i ndryshëm apo dokumentacion i cili të konsiderojë ndryshimin e qëndrimit nga audituesit.

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet tuaja nuk pranohen, për të arsye të cilat i kemi trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit.

### **Zbatimi i punimeve.**

#### **1. “Ndërtim i mureve mbajtës të pallateve në Qytetin Fushë-Arrëz (Faza I-rë)”, Bashkia Fushë Arrëz.**

Të dhëna për			
Kontratën e zbatimit		Mbikëqyrjen	Kolaudimin
Nr.2884, datë 13.11.2020	Afati i zbatimit: 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës	Kontrata nr.2924, datë 17.11.2020	Kontrata nr.3292, datë 23.12.2020
13,860,010 lekë me TVSH		“G” Sh.P.K me licencën nr.MK2828/8 Administrator L.H	“M” Sh.P.K me licencën nr. MK1811/7 Administrator T.S
Kontraktori “U” Sh.P.K	Punimet kanë filluar më datë 18.11.2020 Punimet kanë përfunduar më datë 21.10.2021	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 220,800 lekë me TVSH	Vlera e kontratës së kolaudimit është 41,474 lekë me TVSH

Nga auditimi i dosjes teknike dhe matjeve faktike në terren nuk u konstatuan problematika përsa i përket volumeve të situacionuara me ato të matura. Muret prej beton armeje ishin realizuar sipas projektit të miratuar. Objekti është kolauduar dhe marrë në dorëzim më datë 08.11.2021.

### **III.2.5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.**

Për auditimin e pikës 5 të Projekt Raportit të Auditimit “Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, u shqyrtua:

-Dokumentacioni mbi lejet e ndërtimit dhe certifikatat e përdorimit për subjektet përfitues të lejeve të ndërtimit për periudhën 01.04.2020-31.12.2021;

-Ligji nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;

-VKM nr.408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar;

-Paketa fiskale për vitin 2021 mbi shkallën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja.

#### **-Mbi auditimin e lejeve të ndërtimit**

a)Për periudhën objekt auditimi (viti 2021) janë miratuar 6 leje ndërtimi, nga të cilat 3 shtesa kati, 1 magazinë grumbullimi, 1 rikonstruksion + çati. Të ardhurat e Bashkisë Fushë Arrëz nga taksa e ndikimit në infrastrukturë (TNI) për këto leje janë në vlerën 1,196,814 lekë.

b. Janë audituar 2 lejet e ndërtimit, konkretisht:

-Leja në emër të zhvilluesit “T” shpk me objekt “Objekt magazinë bujqësore në funksion të bujqësisë, me tarracë të gjelbëruar, 1 Kat Nëntokë”;

-Leja në emër të zhvilluesit M.T me objekt “Rikonstruksion i objektit servis i mjeteve motorrike”.

Nga auditimi, janë konstatuar mangësi si më posht:

**1. Leja e ndërtimit me objekt: “Objekt magazinë bujqësore në funksion të bujqësisë, me tarracë të gjelbëruar, 1 Kat Nëntokë”,** me zhvillues "T" shpk, me datë aplikimi 17.05.2021, me nr. çështje në sistemin e lejeve AN170520210009.

**Titulli i gjetjes:** Miratimi i lejes pa bashkërenduar me institucionet e nevojshme të ngarkuara sipas ligjit.

**Situata:** a.-Subjekti aplikues, nuk ka paraqitur mendim nga asnjë prej institucioneve të nevojshme për miratimin e lejeve të ndërtimit. Mungon Vendimi për Ndikimin në Mjedis të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Nuk ka raport dhe as mendim bashkëlidhur. Mungon kërkesa dhe mendimi nga Ujësjiellës Kanalizime. Mungon kërkesa dhe mendimi nga OSHEE. Mungon kërkesa dhe mendimi nga ASHK. Mungon konfirmim nga Ministria e Linjës (Ministri e Bujqësisë).

-Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 6 të nenit 10/1 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar i cili përcakton se:

*6. Në rast se në lidhje me kërkesën për leje duhet të shprehen, paraprakisht, edhe autoritete të tjera publike, brenda kompetencave që u njej ligji, autoriteti vendor përgjegjës ose KKT-ja, sipas fushës së kompetencës, u dërgon atyre kërkesë për mendim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve. Me dërgimin e kërkesës pezullohet llogaritja e afatit të shqyrtimit të aplikimit, sipas pikës 4, të këtij neni, deri në dhënien e mendimit/miratimit përkatës.*

**Kriteri:** 1.VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar neni 10/1 pika 6.

**Ndikimi:** Mungon garancia për zhvillimin e objektit në përputhje me kondicionet dhe mendimet e institucioneve të specializuara pjesë e procesit.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPKZHT Fushë Arrëz.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Nga DPTP të merren masa për të mos pranuar nga aplikuesit për leje ndërtimi pa disponuar dokumentacionin e plotë dhe bashkërendimin me institucionet e ngarkuara me ligj pjesë e procesit të miratimit të lejeve të ndërtimit.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:*

1.Z.F.T, Kryetar i Bashkisë Fushë Arrëz.



2.Z.T.P, Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

3.Zj.D.K me detyrë specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e nëpunësit.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me shkresën nr. 885/8 prot., datë 11.01.2023 si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

Sqarohet se me të drejtë në PRA se para dhënies së lejes së ndërtimit, duhet marrë në konsideratë opinionin e disa institucioneve, por nisur nga kërkesa e ngutshme e zhvilluesit për shkurtimin e afateve të dhënies së lejes, vonesave të dukshme të institucioneve në dhënien e informacionit dhe pozicionit ku do të ndërtohej objekti, nuk ndikonte aspak në asnjë infrastrukturë të zonës. E vlerësuam si të panevojshme marrjen e mendimeve nga institucionet, pavarësisht se ishim të ndërgjegjshëm që duheshin kërkuar ky informacion. Theksojmë se kjo leje është dhënë konform legjislacionit në fuqi, dhe zhvilluesi ka qenë korrekt me pagesën e TNI dhe tarifatat tjera sipas VKB-së.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Lidhur me observacionin e paraqitur, nuk pranohet. Siç edhe keni cituar, marrja e mendimeve nga institucionet është detyrim ligjor, dhe përsa përcaktohet si i tillë duhet zbatuar. Njëkohësisht, marrja e mendimit nga institucionet nuk sjell vonesa, pasi sipas akteve ligjore dhe nënligjore, nëse institucionet nuk shprehen me qëndrim për kërkesën tuaj, konsiderohet i miratuar në heshtje kërkesa juaj. Theksimi juaj se leja është dhënë konform legjislacionit në fuqi nuk qëndron, pasi pikërisht mos rakordimi me institucionet e përcaktuara për bashkëpunim, është kryer në mos zbatim të legjislacionit përkatës sektorial.

**III.2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).**

**Titulli i Gjetjes:** Në Bashkinë Fushë Arrëz nuk është krijuar struktura e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit. Mangësi në ushtrimin e detyrave për kontrollin e territorit.

**Situata:** Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion nga Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor, për periudhën 01.01.2021 -31.12.2021, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT), nuk është ngritur dhe nuk funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”. Për vitin 2021, sipas strukturës të miratuar me urdhrin nr. 371, datë 17.12.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Fushë Arrëz, të Njësisë Administrative dhe Institucioneve Buxhetore në varësi të bashkisë për vitin 2021” është përcaktuar një pozicion pune si inspektor i mbrojtjes së territorit, pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve, pranë Sektorit të Planifikimit të Territorit dhe Investimeve. Sa më sipër, pranë kësaj bashkie nuk funksionon inspektorati ndërtimor.

-Sipas informacionit të administruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, z. T.P me nr. 4491 prot., datë 16.11.2022, sqarohet se për vitin 2021 funksionet e inspektorit janë kryer nga znj. D.K, ku përgjatë vitit nuk janë konstatuar ndërtime pa leje.

-Sa më sipër, nga ky sektor, nuk disponohet asnjë procedurë, apo akt mbi të cilin të pasqyrohet objekti i aktivitetit për vitin 2021, duke mos dhënë asnjë garanci për mbrojtjen dhe kontrollin e territorit nga ndërtimet pa leje, apo për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë së objekteve të pajisura me leje ndërtimi.

**Kriteri:** Ligji 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar 4, 5, 11, 12; Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 51 “Inspektimi”, VKM-së nr. 894., datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore” neni 4, 5, 6, 7, 18.

**Ndikimi:** Mungon institucioni përgjegjës për kontrollin e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, si dhe për verifikimin e zbatimit të lejeve të ndërtimit

**Shkaku:** Shmangie e detyrimit ligjor në hartimin dhe miratimin e organikës nga titullari i institucionit.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

### **III.2.7. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.**

**Titulli i gjetjes:** Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

**Situata:** Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

1. Shkresa përcjellëse nr.868/6, datë 20.11.2021 e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë, si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës, protokolluar në zyrën e protokollit të Bashkisë Fushë Arrëz, më datë 05.01.2022 me shkresën nr.12 prot.
2. Shkresa kthim-përgjigje (brenda afatit 20 ditë) për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit.
3. Shkresa kthim-përgjigje (brenda afatit 6-muajsh) së bashku me raportin për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Për sa më lart në Bashkinë Fushë Arrëz, nga grupi i auditimit u mbajt akt-verifikimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

**Nga auditimi u konstatua se:**

**1.** Bashkia Fushë Arrëz nuk ka respektuar afatin prej 20-ditësh për dërgimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**Shkalla e zbatimit:** Ky detyrim ligjor nuk është zbatuar.

**2.** Bashkia Fushë Arrëz me shkresën nr.4044 prot., datë 14.10.2022 ka dërguar në KLSH, raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, jashtë afatit prej 6-muajsh, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**Shkalla e zbatimit:** Ky detyrim ligjor nuk është zbatuar në afat.

### **3. Analizimi dhe nxjerrja e përgjegjësive në Bashkinë Fushë Arrëz:**

Nga KLSH janë lënë 17 rekomandime gjithsej, nga këto:

9 masa organizative;

3 masa shpërblim dëmi;

5 masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë<sup>41</sup>:

-Në numër rekomandimesh: 17 rekomandime të dhëna, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 17 rekomandime, 1 prej tyre është zbatuar ose 6%, 2 zbatuar pjesërisht ose 11%, 1 në proces zbatimi ose 6%, si dhe 13 pa zbatuar ose 72%.

-Në vlerë monetare, sa i përket rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

3 rekomandime për shpërblimin e dëmit të krijuar për 3 subjekte në vlerën 8,271 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht nga subjekti. Nga 3 rekomandime, nuk është zbatuar asnjë prej tyre.

-Janë lënë 5 masa disiplinore, të cilat nuk janë zbatuar.

<sup>41</sup> Pasqyruar në formë tabelare në Kapitullin “Aneke” – “Aneksi nr.5” të projekt raportit të auditimit.

**Më hollësisht rekomandimet e pazbatuara dhe zbatuar pjesërisht, për të cilat nga KLSH rikërkohet zbatimi i tyre, paraqiten si më poshtë vijon (numrat rendor janë sipas renditjes në shkresën përcjellëse dërguar subjektit):**

**A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa për planifikimin e saktë dhe në përputhje me mundësitë objektive të saj, si dhe për realizimin e të ardhurave vendore, finaciare dhe tjera, në zbatim të paketës fiskale të miratuar në KB të kerkesave ligjore dhe buxhetit të miratuar.

**Në vazhdimësi**

**Zbatimi: Rekomandimi 1.1 nuk është zbatuar.**

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Fushë Arrëz:

-Të analizojë përgjegjësitë administrative ndaj personave përgjegjës, të cilët kanë larguar në mënyrë të paligjshme 4 ish-punonjësit e bashkisë, sipas vendimeve të gjykatës, pasi kanë shkaktuar efekte negative në buxhet për vlerën 3,995,202 lekë shpenzime gjyqësore.

-Të analizohet dhe të nxirret përgjegjësia për shkaktimin e vlerës 1,003,440 lekë shpenzime përmbarrimore, për sanksione nga vonesat në likuidimin e 4 vendimeve gjykatës.

**Në vazhdimësi**

**Zbatimi: Rekomandimi 3.1 nuk është zbatuar.**

**4.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës, Bashkia Fushë–Arrëz për vitet në vazhdim të implementojë mbajtjen e bilancit në një nga versionet e programeve kompjuterike Alfa 5 (financa 5), në përgjigje të standardeve bashëkohore.

**Në vazhdimësi**

**Zbatimi: Rekomandimi 4.1 nuk është zbatuar.**

**5.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës, Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa për sistemimin e llogarisë “debitor të ndryshëm” për vlerën 271,246,057 lekë, konkretisht:

-Të hartojë dhe miratojë program me afate të përcaktuara, për llogarinë “debitor të ndryshëm”, për 23 subjekte fizike e juridike dhe 97 persona për detyrime për taksa e tatime të pashlyera papambetura si dhe rekomandime të KLSH.

-Të dërgojë nëpërmjet protokollit urdhrat e bllokimit në adresë të bankave të nivelit të dytë për subjektet debitorë.

**Në vazhdimësi**

**Zbatimi: Rekomandimi 5.1 është zbatuar pjesërisht.**

**7.1. Rekomandimi:** Zyra e shërbimeve, urbanistikës dhe financës Bashkia Fushë-Arrëz të plotësojnë dokumentacionin për meremetimin dhe rikonstrukcionin e veprave të infrastrukturës, për efekt të argumentimit tyre.

**Në vazhdimësi**

**Zbatimi: Rekomandimi 7.1 nuk është zbatuar.**

**8.1 Rekomandimi:** Nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartohet dhe miratohet plani strategjik dhe aktivitetet të detajuara për realizimin e objektivave të përcaktuara në strategji, dokumentacioni të përgatitet në përputhje me kuadrin ligjor, kryesisht duke ruajtur hapat sipas gjurmës së auditimit ekonomik e finciar të miratuar nga Titullari i Bashkisë Fushë Arrëz.

**Menjëherë**

**Zbatimi: Rekomandimi 8.1 nuk është zbatuar.**

**9.1. Rekomandimi:** Plani strategjik, planifikimi vjetor, si dhe gjithë dokumentacioni tjetër i nevojshëm në procesin auditues të NJAB, të përpilohen në përputhje me kërkesat e manualit të auditit të brendshëm si dhe të bëhet praktikë pune çelja e dosjeve të përhershme për çdo njësi të audituar duke i pasuruar ato me materiale nga auditimet e reja me qëllim që kjo të shërbejë

auditimeve pasardhëse të njësisë. Nga NJAB pas përfundimit të auditimit të brendshëm të njësisë të bashkisë, të kryhet inventarizimi i dosjes koherente për çdo auditim, dhe të arkivohen në zyrë arkivin e Bashkisë Fushë Arrëz.

**Në vazhdimësi**

**Zbatimi: Rekomandimi 9.1 është zbatuar pjesërisht.**

### **C. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) - Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimit e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 8,271,878 lekë ndaj subjekteve**, si më poshtë:

**1.1.Rekomandimi:** Nga Bashkia Fushë Arrëz të merren masa që të rishikohen volumet e punimeve civile, të shoqërohen me librezat masash të sakta, në mënyrë që pagesat të argumentohen mbi bazën e volumeve të sakta.

-Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa, të ngrëjë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të cilat rezultuan të paargumentuara në vlerën 1,185,166 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjësitet ligjore e financiare, për arkëtimin e vlerës.

***Menjëherë***

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Lidhur me rekomandimin 1.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar nga Titullari i Bashkisë Fushë Arrëz është nxjerrë urdhri nr.407 datë 26.08.2022 “Për ngritjen e komisionit të studimit, vlerësimit dhe zbatimit të rekomandimit”, me përbërje **z.T.P, zj. J.M dhe z.S.LI**, për të kontrolluar punimet e realizuara, të cilat janë evidentuar mangësi në auditimin e mëparshëm, nga subjekti BOE “P.G dhe J” Sh.P.K dhe të hartojnë procesverbalin përkatës, **duke i rekomanduar mangësitë komisionit të marrjes përfundimtare në dorëzim të objektit**. Komisioni i mësipërm ka mbajtur procesverbalin nr.3450/1 prot., datë 07.09.2022 mbi verifikimin në terren të punimeve të kryera, ku në përfundim ka konkluduar se vetëm shuma 323,010 lekë për zërin “F.V Rakorderi dhe materiale të ndryshme” është përfituar padrejtësisht e cila duhet të mbahet nga garancia e punimeve. Theksojmë se në certifikatën e marrjes përfundimtare në dorëzim të objektit, nr.3469/1 prot., datë 07.09.2022, mbajtur nga komisioni përkatës me përbërje z.K.V, z.D.P dhe z.E.M, **ky fakt nuk është pasqyruar**.

Sa më sipër, grupi i auditimit sqaron, për zërin e punimeve, pasqyruar si më poshtë vijon;

Emërtimi	Njësia	Sit. përf.	Çmimi	Vlera
F.V Element radiatorit alumini + Pajisje + Rakorderi	Komplet	9	48,510	436,590

Arsyetimi i dhënë nga komisioni i verifikimit të zërave të punimeve, i pasqyruar në procesverbalin nr.3450/1 prot., datë 07.09.2022, nuk merret në konsideratë për efekt justifikimi të zbatimit të rekomandimeve. Sqarimi për këtë zë punimesh është dhënë në auditimin e mëparshëm, në përgjigje të observacionit të dërguar nga mbikëqyrësi i punime Ing. T.S, me nr. 46 prot. datë 14.10.2021, të protokolluar në Bashkinë Fushë Arrëz me nr. 2483 prot. datë 14.10.2021, shprehimisht: “Në lidhje me sistemin ngrohës, pretendimet e mbikëqyrësit mbi ndryshimet dhe mbi mbivendosjen e rakorderive nuk merren në konsideratë, pasi edhe në observacionin bashkëlidhur konstatohet mbivendosja e rakorderive në Kg”. Gjithashtu theksojmë faktin se gjetja dhe rekomandimi janë pranuar nga Bashkia Fushë Arrëz, pa kundërshtime në tërësi apo element të tij, rasti në fjalë mospranimin e rekomandimit për vlerën 436,590 lekë.

-Për zërat e tjerë të punimeve (numrin e bredhave, fidanëve dhe rezervuarin), me qëllim vërtetimin e zbatimit të rekomandimit të mësipërm, grupi i auditimit me përbërje audituesit z.K.K dhe z.A.D, **e gjykoj të nevojshme kryerjen e verifikimit në terren të zëvendësimit të bredhave, fidanëve**, në prani të grupit të komisionit të verifikimit, duke marrë në konsideratë planimetrinë e vendosjes së bredhave, librezën e masave (Në kapitullin e punimeve B/A dhe sistemeve, zëri nr. 14 "F.V bredha  $d > 10\text{ cm}$ ", janë likuiduar 58 copë dhe zëri nr. 14 "F.V fidanë dekorativë" janë likuiduar 43 copë ), informacionit të pasqyruar në procesverbalin nr.3450/1 prot., datë 07.09.2022 mbi verifikimin në terren të punimeve të kryera nga grupi i punës me përbërje **z.T.P, zj.J.M dhe z.S.Ll**, rezultoi se:

-Nga 33 bredha të vendosur, (sipas procesverbalit nr.3450/1 prot., datë 07.09.2022, gjatë periudhës së garancisë janë vendosur edhe 33 bredha të cilët kanë rezultuar mungesë nga verifikimi në auditimin e mëparshëm), në terren nuk ishte **vendosur nr. i bredhave mungesë<sup>42</sup>**, pra 33 copë për vlerën 3,502 lekë/copa = **115,566 lekë të përfituara padrejtësisht**.

-Nga 20 fidana të vendosur, (sipas procesverbalit nr.3450/1 prot., datë 07.09.2022, gjatë periudhës së garancisë janë vendosur edhe 20 bredha të cilët kanë rezultuar mungesë nga verifikimi në auditimin e mëparshëm), në terren ishin vendosur edhe 12 fidana shtesë<sup>43</sup>, **pra 8 copë më pak** për vlerën 10,000 lekë/copa = **80,000 lekë të përfituara padrejtësisht**.

-Rezervuari ishte vendosur dhe në gjëndje pune<sup>44</sup>.

**-Gjithësej përfituar padrejtësisht nga subjekti = 632,156 lekë pa TVSH**, vlerë e cila përbëhet nga 115,566 lekë bredha, 80,000 lekë fidana dhe 436,590 lekë për zërin "F.V Element radiator alumini + Pajisje + Rakorderi".

-Ndërkohë grupi i punës me përbërje z.T.P, zj.J.M dhe z.S.Ll, në procesverbalin nr.3450/1 prot., datë 07.09.2022 është shprehur se është plotësuar numri i bredhave dhe fidanëve, **pra duke dhënë një informacion jo të vërtetë**.

-Gjithashtu në certifikatën nr.3469/1 prot., datë 07.09.2022 të marrjes përfundimtare në dorëzim punimeve të kryera, nga grupi i punës me përbërje **z.K.V, z.D.P dhe z.E.M**, ngritur me Urdhrin nr.410, datë 30.08.2022 nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, pasqyrohet informacioni me mbishkrimin:

**“B.Konstatime të kontrollit:** Nga verifikimi i punimeve të zbatuara dhe të përfunduara në objekt, rezulton se **punimet janë kryer konform projekt-preventivit të aprovuar**, firmosur dhe miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve “M S Sh.P.K, me përfaqësues inxhinier T.S, në situacion përfundimtar. Këto punime janë kryer në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Fushë Arrëz dhe të pasqyruara në dokumentacionin përkatës. Punimet janë kryer në një cilësi të mirë, konform të gjithë rregullave përkatëse të zbatimit dhe pasqyrojnë përgjegjësi nga sipërmarrësi i punimeve BOE P.G Sh.P.K dhe J Sh.P.K. **Nga ana e firmës kontraktore është bërë rregullimi i defekteve të konstatuara nga grupi i punës dhe nuk konstatohet ndonjë difekt në objekt që është pasojë e cilësisë së punimeve”**.

**“5.Komisioni i marrjes përfundimtare në dorëzim të objektit “Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkola 70-Vjetori i Pavarsisë”, Bashkia Fushë Arrëz”, i përbërë nga investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi, sipërmarrësi janë dakort që të dorëzohet përfundimisht dhe garancia 5% të lirohet në favor të P.G”**.

-Pra sa më sipër arrihet në përfundimin se komisioni i marrjes përfundimtare në dorëzim të objektit ngritur me Urdhrin nr.410, datë 30.08.2022, me përbërje z.K.V, z.D.P dhe z.E.M, në certifikatën nr.3469/1 prot., datë 07.09.2022 të marrjes përfundimtare në dorëzim punimeve të kryera, **ka dhënë informacion jo të vërtetë**.

-Në vijim me urdhër shpenzimet nr.214, datë 08.09.2022 dhe nr.215, datë 08.09.2022 **është çliruar garancia (5%) e punimeve, në vlerën 2,342,983 lekë**. Pra ndaj subjektit është çliruar e gjithë garancia.

<sup>42</sup> Pasqyruar foto në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.6” të raportit përfundimtar të auditimit.

<sup>43</sup> Pasqyruar foto në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.6” të raportit përfundimtar të auditimit.

<sup>44</sup> Pasqyruar foto në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.6” të raportit përfundimtar të auditimit.

-Sa më sipër mbajnë përgjegjësi grupi i punës për verifikimin në terren të korrigjimeve në punime z.T.P, zj.J.M dhe komisioni i marrjes përfundimtare në dorëzim të objektit z.S.LI z.K.V, z.D.P dhe z.E.M.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 **nuk është zbatuar.**

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Fushë Arrëz të merren masa që të rishikohen volumet e punimeve civile, të shoqërohen me profilet tërthore e gjatësore në librezat e masave, në mënyrë që pagesat të argumentohen mbi bazën e volumeve të sakta.

-Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlersojnë e të analizojnë zërat e punimeve të paargumentuara në vlerën 2,631,616 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjësitetë ligjore e financiare, për arkëtimin e vlerës.

***Menjëherë***

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 **nuk është zbatuar.**

**3.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor Bashkia Fushë Arrëz, të formojë një grup pune me specialistë të fushës për të verifikuar dorëzimin real të projekteve dhe përputhshmërinë me aktet e mbajtura me BOE sipërmarrës për të evidentuar arsyet e mos përfundimit në afat të kontratës, përgjegjësitë respektive dhe marrjen e masave për zbatimin e kontratës për penaltete në shumën 4,455,096 lekë ndaj sipërmarrësit të realizimit të projekteve.

***Menjëherë***

**Zbatimi:** Rekomandimi 3.1 **nuk është zbatuar.**

#### **D. MASA DISIPLINORE**

**a-Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”neni 58 gërma (c)”, ndaj punonjësve si më poshtë:**

-Zj. S.M, me detyrë Specialiste e Sektorit Juridik dhe Prokurimeve.

-Z. D.L, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.

-Z. T.P, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikim-Territorit.

**b-Vëretje me paralajmërim, neni 13.3 i kontratës individuale, ndaj punonjësve si më poshtë:**

-Zj. L.N, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik.

-Z. N.M, me detyrë Administrator NjA Iballë.

**c-Njoftimin e Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit për Shërbimin Civil.**

**Zbatimi:** Rekomandimi **nuk është zbatuar.**

*-Sa më sipër, për mosrealizimin e rekomandimeve rast pas rasti, mbajnë përgjegjësi, F.T, D.L, T.P, L.N, V.P, S.Gj, J.M, S.Ll, K.V, D.P dhe E.M.*

#### **III.2.8.Të ndryshme të dala gjatë auditimit.**

**2.8.1.** Në zbatim të pikës 8 të Projekt Raportit të Auditimit “*Të ndryshme të dala gjatë auditimit*”, u auditua ankesa e shtetasit L.B, administrator i subjektit “O” Sh.P.K, me objekt “Kontrollin e kontratave, pagesave dhe çdo detyrim që ka subjekti ndaj Bashkisë Fushë Arrëz, pasi ne si shoqëri kemi 0 lekë detyrime, prandaj duhet të zhblllokohen llogaritë bankare”, dorëzuar në Zyrën e Protokollit të KLSH-së me shkresën nr.22 prot., datë 03.10.2022, si dhe administruar në KLSH me shkresën nr.914 prot., datë 06.10.2022.

**Dokumentacioni bashkëlidhur ankesës (listuar sipas datave të dokumenteve përkatës):**

-Shkresa nr.372/1 prot., datë 22.09.2009 nga ish Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave drejtuar ish Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Pukë, bashkëlidhur Urdhri nr.372 datë 01.09.2009 “Për heqjen nga fondi pyjor dhe kalimin e saj me destinacion përdorimi për veprimtari minerare subjektit “O”. Sipërfaqja që hiqet është 0.34 Ha dhe sipërfaqja që jepet me qira është 0.56 Ha.

-Kontratë qiraje datë 23.09.2009 ndërmjet subjektit O dhe ish Drejtorisë së Shërbimit Pyjor të rrethit Pukë, me afat 20 vjet, objekt: 5602 m<sup>2</sup>/0.56 Ha për hapjen e rrugës autopsyjore. Në kontratën e mësipërme nuk është e dukshme vlera e qirasë;

-Harta e rrugës;

-Vendimi nr.22, datë 07.07.2010 i Gjykatës së Apelit Shkodër, në të cilin është shqyrtuar çështja me objekt “Sigurimin e padisë dhe pezullimin e punimeve nga shoqëria “O” në ndërtimin e rrugës së nisur prej shoqërisë në vendin e quajtur Shtrazë 1 dhe 2, si dhe të punimeve operative shfrytëzuese të vendburimit minerar Shtrazë 1 dhe 2 që rakordojnë me parcelat nr.38 dhe 39 të fshatit Shopel”.

-Në përmbajtjen e vendimit, në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet çështja e mësipërme: ish Komuna Iballë ka bërë ankesë në Gjykatën e Rrethit Pukë, për sigurimin e padisë dhe pezullimin e punimeve nga shoqëria “O” në ndërtimin e rrugës së nisur prej shoqërisë në vendin e quajtur Shtrazë 1 dhe 2, si dhe të punimeve operative shfrytëzuese të vendburimit minerar Shtrazë 1 dhe 2 që rakordojnë me parcelat nr.38 dhe 39 të fshatit Shopel. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë me vendimin nr.43, datë 05.03.2010 ka vendosur pranimin e padisë së paraqitur nga ish Komuna Iballë”.

-Gjykata Administrative e Apelit Shkodër me vendimin nr.22, datë 07.07.2010, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Pukë duke rrëzuar kërkesë padinë e paditësit ish Komuna Iballë.

-Aneks kontratë qiraje datë 15.10.2012, për disa shtesa në kontratën e qirasë nr.3, datë 26.09.2011 të lidhur ndërmjet subjektit “O” dhe ish Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Pukë, duke ndryshuar tarifën e qirasë vjetore, pra vlerës 211,850 lekë do t’i shtohet edhe diferenca 90,391 lekë.

-Kontratë qiraje nr.1570/1 datë 26.08.2016 ndërmjet subjektit “O” dhe Bashkisë Fushë Arrëz, me afat 1 vit, objekt: 0.34 Ha sipërfaqe pjesë e ngastrave nr.38 dhe 39 dhe 1.245 km rrugë autopsyjore, me vlerë 211,850 lekë në vit.

-Kontratë qiraje nr.1153 prot., datë 12.04.2019 ndërmjet Bashkisë Fushë Arrëz dhe subjektit “O”, për dhënien me qira 0.643 km rrugë autopsyjore dhe 0.1500 ha shesh depozitimi në ekonominë pyjore Lumi i Berishës, me afat 10 vite, si dhe qira vjetore 82,075 lekë/820,750 lekë për 10 vite.

-Kërkesa nr.19 prot., datë 13.11.2020 e subjektit O drejtuar Bashkisë Fushë Arrëz, për mbylljen e kontratave të qirasë së datave nr.23.09.2009 dhe 26.04.2011, si dhe aneks kontratës së datës 13.10.2012, për arsye se nuk ushtrohet aktivitet minerar;

-Akt-Verifikimi datë 28.12.2020 i mbajtur nga grupi i punës së mësipërme në ngastrën pyjore nr.38 dhe 39, për të vlerësuar nëse subjekti po ushtron aktivitet në zonën e citur në kontratat e datave 23.09.2009; 26.09.2011 dhe aneks kontratës së datës 15.10.2012;

-Relacion datë 29.12.2020, përgatitur nga 3 inxhinier, konkretisht: D.LL, specialist i kadastrës pyjore & GIS; Z.A, specialist menaxhimi për pyjet; z.F.H, specialist pyjesh në Njësinë Administrative Iballë;

-Urdhër bllokimi i llogarive bankare nr.3764 prot., datë 27.09.2022, lëshuar nga Bashkia Fushë Arrëz;

-Vërtetim datë 04.10.2022 nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë, që pranë saj është regjistruar çështja me objekt “Kundërshtimi i aktit administrativ nr.1198/41 Prot., datë 22.05.2017 të Bashkisë Fushë Arrëz dhe faturës për arkëtim nr.283 datë 22.05.2017. Anullimin si akt absolutisht të pavlefshëm pjesërisht të aktit administrativ Raport Final nr.414/7 datë 21.07.2016 të KLSH. Çështja është regjistruar më datë nr.09.09.2019 me numër regjistri themeltar 13881.

-Nxjerrje llogarie nga banka Raffaisen për pagesa të kryera për qiranë e fondit pyjore/kullosor për vitet 2012, 2013, 2014, 2016, 2017, 2018, 2020, 2021, 2022;

**Sa më sipër me qëllim pasqyrimin e saktë dhe të plotë të veprimeve nga institucionet e përfshira në çështjen e mësipërme, ish Drejtoria e Shërbimit Pyjor Pukë dhe Bashkia Fushë Arrëz, u auditua dokumentacioni i administruar në Bashkinë Fushë Arrëz. Nga**

**auditimi rezultoi se dokumentacioni që administrohet vetëm për çështjen në fjalë (përfshirë dokumentacionin për veprime të tjera juridike ndërmjet Bashkisë Fushë Arrëz dhe subjektit O), pasqyrohet si më poshtë vijon:**

-Raporti përfundimtar i auditimit të kryer nga KLSH përcjellë me shkresën, pjesë e të cilit është trajtimi përkatës i bërë nga grupi i auditimit, fq nr.129-130, shprehimisht:

Leja nr.1312, datë 02.02.2009, në adresë të subjektit O për sipërfaqen e shfrytëzueshme prej 0.088 km<sup>2</sup>/8.8 Ha. Për këtë sipërfaqe zona Shtraz 1 dhe Shtraz 2 nga ish Komuna Iballë nuk ka të lidhur kontrata mbi përdorimin e sipërfaqes pyjore/kullosore për të bërë të mundur llogaritjen e detyrimit për qiranë në vlerën 11,616,000 lekë (8.8 Ha\*440,000 lekë/Ha/vit \* 3 vite (02.02.2009-02.02.2016), e ardhur e munguar me efekt negativ në buxhet. Për gjetjen e mësipërme (ku veç subjektit O, përfshihen edhe disa subjekte të tjera) është lënë rekomandimi nr.5.1 **“Masa Organizative”**, shprehimisht:

-Bashkia Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësitë Administrative Qafë Mali, Iballë dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Fushë Arrëz, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialist të fushës, për evidentimin dhe saktësimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme në pyje dhe kullota, duke lidhur kontrata ligjore para noterit publik, në përputhje me germën "f" të nenit 39 dhe nenet 40, 54, 56, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për noterinë", i ndryshuar, si dhe pikat 3, 4 dhe 7, të Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, të ndryshuar, duke përcaktuar dhe arkëtuar detyrimet për qiranë në vlerën 163,005,600 lekë, respektivisht:

-Shoqëria "B" për sipërfaqen 55 ha (zona Munell), me vlerë 48,400,000 lekë, sipërfaqen 298 ha (zona Lak Roshi), me vlerë 55,428,000 lekë, sipërfaqe 78 ha (zona Qaf Bari), me vlerë 9,672,000 lekë, sipërfaqe 88.4 ha (zona Tuç), me vlerë 10,961,600 lekë.

-Shoqëria "O" për sipërfaqen 8.8 Ha (zona Shtraz 1 dhe 2), me vlerë 11,616,000 lekë;

-Shoqëria "K" për sipërfaqen 28.6 Ha (zona Race), me vlerë 25,168,000 lekë;

-Shoqëria "E" për sipërfaqen 2 Ha (zona Iballë), me vlerë 1,760,000 lekë;

-Shkresa nr.1490 prot., datë 11.08.2016, ku Bashkia Fushë Arrëz i është drejtuar KLSH për zbatimin e rekomandimeve.

-Raporti mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.1113/139 prot., datë 31.01.2017 protokolluar në Bashkinë Fushë Arrëz me shkresën nr. 23 prot., datë 06.02.2017, sipas të cilit subjektit O i është drejtuar njoftimi nr.1651/1, datë 09.09.2016. Ndaj këtij njoftimi subjekti ka bërë ankim drejtuar Bashkisë Fushë Arrëz me shkresën nr.extra, datë 14.10.2016. Statusi i zbatimit: Rekomandimi është duke u zbatuar<sup>45</sup>.

-Bashkia Fushë Arrëz për zbatimin e rekomandimeve, rikërkuar nëpërmjet raportit të mësipërm, ka kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.333 datë 21.02.2017, për përcaktimin e personave përkatës për zbatimin e rekomandimeve.

-Në auditimin e rradhës kryer në periudhën Janar-Shkurt të vitit 2019, është audituar zbatimi i rekomandimeve të lëna, ku rezultoi se për **rekomandimin 5.1** të raportit të auditimit të vitit 2016, është pasqyruar situata si më poshtë:

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Fushë-Arrëz ka hapur proces gjyqësor në gjykatën e rrethit Pukë me Kërkesë - Padi me nr. 3187 datë 27.12.2017 kundër Shoqërisë "O" për sipërfaqen 8.8 ha (zona Shtraz 1 dhe Shtraz 2), me vlerë 11,616,000 lekë, por është pushuar nga kjo gjykata me vendimin nr. 21240-00003-52-2018(45) regjister themeltar datë 13.03.2018 pasi pala paditëse (bashkia) ka hequr dorë nga gjykimi, me justifikimin se nuk është bërë pagesa nga ana e bashkisë për munges fondesh në masën 1% e shumës.

**Rekomandimi nuk është zbatuar.**

Raporti i auditimit të mësipërm (ku është rikërkuar përsëri edhe zbatimi i rekomandimit nr.5.1) është dërguar në Bashkinë Fushë Arrëz me shkresën nr.199/6, datë 24.08.2019, protokolluar në Bashkinë Fushë Arrëz me nr. 2616 prot datë 27.08.2019, ndërsa Bashkia Fushë Arrëz për zbatim e rekomandimeve të KLSH-së (pjesë e të cilave edhe rekomandimi nr.5.1) ka kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 2616/1 prot datë 27.08.2019. Duhet plani i veprimit

<sup>45</sup> Sipas raportit të auditimit të KLSH.



-Në vijim përgjatë periudhës Mars-Prill të vitit 2020 është audituar zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2019, ku ka rezultuar se rekomandimi për çështjen në fjalë është në proces zbatimi.

-Nga planet e veprimit për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, rezulton se struktura e ngarkuar për zbatimin e rekomandimit është sektori i pyjeve, sektori juridik dhe sektori i taksave dhe tarifave vendore.

**Gjithashtu administrohet dokumentacion tjetër, si më poshtë vijon:**

-Kontratë qiraje datë 23.09.2009 ndërmjet subjektit O dhe ish Drejtorisë së Shërbimit Pyjor të rrethit Pukë, me afat 20 vjet, objekt: 5602 m<sup>2</sup>/0.56 Ha për hapjen e rrugës autopsyjore. Në kontratën e mësipërme nuk është e dukshme vlera e qirasë;

-Kontratë qiraje datë 26.09.2011 ndërmjet subjektit O dhe ish Drejtorisë së Shërbimit Pyjor të rrethit Pukë, me afat 9 vjet, objekt: 3400 m<sup>2</sup>/0.34 Ha për ushtrimin e aktivitetit për shfrytëzim minerali dhe 5602 m<sup>2</sup>/0.56 Ha për rrugën autopsyjore. Vlera e qirasë 168,300 lekë në vit.

-Aneks kontratë qiraje datë 15.10.2012, për disa shtesa në kontratën e qirasë nr.3, datë 26.09.2011 të lidhur ndërmjet subjektit "O" dhe ish Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Pukë, duke ndryshuar tarifën e qirasë vjetore, pra vlerës 211,850 lekë do t'i shtohet edhe diferenca 90,391 lekë.

-Faturë nr.83, datë 22.05.2017, lëshuar nga Bashkia Fushë Arrëz ndaj subjektit O për arkëtimin e vlerës 11,616,000 lekë.

-Urdhër zhdëmtimi nr.1198/41 prot., datë 22.05.2017, në ngarkim të subjektit O, që deri më datë 31.05.2017 të likujdojë detyrimin në vlerën 11,616,000 lekë.

-Urdhër nr.354, datë 02.12.2020, i Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz me objekt:

1.Ngritjen e komisionit për verifikimin nëse subjekti ushtron aktivitet minerarë në zonat e cituara sipas kontratës së qirasë datë 23.09.2009; 26.04.2011 dhe aneks-kontratës datë 15.10.2012, nga subjekti O.

2.Komisioni përbëhet nga: D.LL, M.A dhe F.H.

3.Komisioni duhet të përpilojë një relacion të detajuar për situatën nëse ushtrohet aktivitet minerar në zonat e cituara sipas kontratave në pikën 1 të këtij urdhëri.

-Akt-Verifikimi datë 28.12.2020 i mbajtur nga grupi i punës së mësipërme në ngastrën pyjore nr.38 dhe 39, për të vlerësuar nëse subjekti po ushtron aktivitet në zonën e cituar në kontratat e datave 23.09.2009; 26.09.2011 dhe aneks kontratës së datës 15.10.2012;

-Relacioni datë 29.12.2020, përgatitur nga 3 inxhinier, konkretisht: D.LL, specialist i kadastrës pyjore & GIS; Z.A, specialist menaxhimi për pyjet; z.F.H, specialist pyjesh në Njësinë Administrative Iballë;

-Kërkesë-padi nr.43 prot., datë 05.01.2018 e Bashkisë Fushë Arrëz në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, me objekt kërkimin e dëmshpërblimit në vlerë 11,616,000 lekë ndaj subjektit O;

-Kërkesën e Bashkisë Fushë Arrëz për pushimin e çështjes;

-Vendimin nr.28, datë 09.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë për pushimin e çështjes, si rrjedhojë e kërkesës për heqjen dorë nga padia e ngritur.

-Njoftimi nr.175/554/1463, datë 10.06.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, drejtuar Bashkisë Fushë-Arrëz, me objekt: Njoftimi me kërkesë padinë si dhe seancën përgatitore të datës 19.06.2019.

Palë paditëse: O Sh.P.K

**Të paditur: Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Bashkia Fushë Arrëz.**

Objekti: Kundërshtimi i aktit administrativ nr.1198/41 prot., datë 22.05.2017 të Bashkisë Fushë Arrëz dhe faturës për arkëtim nr.283, datë 22.05.2017. Anullimin si akt absolutisht i pavlefshëm pjesërisht i aktit administrativ, raporti përfundimtar, përcjellë me shkresën nr.414/7, datë 21.07.2016 të KLSH.

-Vendimi nr.364, datë 19.06.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ku është rrëzuar kërkesë-padia e subjektit O.

-Kërkesë ankimore e subjektit O drejtuar **Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë**, kundër vendimit nr.364, datë 19.06.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. **Palë të paditura: Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Bashkia Fushë Arrëz.**

Kërkesa ankimore është protokolluar pranë Bashkisë Fushë Arrëz me nr.2371 prot., datë 31.07.2019. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, më datë 09.09.2019 me numër regjistri themeltar 13881.

-Aktualisht çështja në është në gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

-Vendimi nr.1311, datë 11.10.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për refuzimin e kërkesës së paditësit, subjektit O Sh.P.K, me objekt:

1.Shfuqizimi tërësisht i aktit administrativ, Urdhër bllokimi të llogarive bankare për tatimpaguesin person juridik "O" shpk, si masë për garantimin e mbledhjes me forcë të detyrimit të papaguar.

2.Marrjen e masës së sigurimit të paditës, pezullimin e ekzekutimit të urdhërit të bllokimit të llogarive bankare të subjektit O dhe zhbllokimin e llogarive bankare.

-Gjithashtu në vendimin nr.1311, datë 11.10.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, pasqyrohet qëndrimi i gjyqtarit përkatës, shprehimisht:

"Në konkluzion të sa më sipër, Gjykata vlerëson se, nuk plotësohen kushtet dhe rrethanat ligjore të përcaktuara në nenet 28 e 29 të Ligjit nr.49/2012, për pranimin e kërkesës së palës paditëse për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Ndaj, Gjykata arrin në përfundimin se, kërkesa e palës paditëse, "O" shpk, për marrjen e masës së sigurimit të padisë, është e pabazuar në ligj e në prova dhe si e tillë duhet refuzuar. **Sa i përket pretendimeve të tjera, të parashtruara nga pala paditëse në kërkesë padi, ato i përkasin themelit të çështjes, për të cilat Gjykata do të disponojë me vendim përfundimtar, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të saj.**

**Sa më sipër nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nëpërmjet ankesës së subjektit O dhe dokumentacionit të administruar në Bashkinë Fushë Arrëz, arrihet në përfundimin se:**

**Titulli i Gjetjes:** Mbi shqyrtimin e ankesës së subjektit O.

**Situata:** Vlera e detyrimit është 11,616,000 lekë, e pa ndryshuar nga viti 2016 deri në vitin 2022.

-Vlera e detyrimit është njohur dhe kontabilizuar në pasqyrat financiare të institucionit.

-Për vlerën e evidentuar nga grupi i mëparshëm i auditimit, e cila i përket periudhës 2009-2016, pasqyruar në Kapitullin "Gjetje dhe rekomandime" të raportit përfundimtar të auditimit, gjetja nr.5 dhe rekomandimi nr.5.1, nuk mund të shprehemi për përlllogaritjen e saj, pasi për këtë auditim ka dal Vendimi i Kryetarit të KLSH-së, në të cilin janë miratuar gjetjet dhe rekomandimet e auditimit përkatës.

-Nga Bashkia Fushë Arrëz, **rekomandimi nr.5.1 është pranuar**, por nuk është vendosur në zbatim.

-Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz nuk ka ngritur një grup pune, i cili të evidentojë sipërfaqen e shfrytëzuar faktikisht nga subjekti në raport me sipërfaqen totale të lejes minerare nr.1312, datë 02.02.2009.

-Pra nëse nga 8.8 Ha sipërfaqe totale sipas lejes minerare nr.1312, datë 02.02.2009, sa sipërfaqe ka shfrytëzuar subjekti deri në vitin 2016 (pasi Bashkia Fushë Arrëz deri në vitin 2016 e njehë dhe pranon detyrimin që ka subjekti O ndaj saj);

-Zbritet sipërfaqja e cila është kontraktuar;

-Duke nxjerrë në këtë mënyrë sipërfaqen e shfrytëzuar nga subjekti dhe që nuk është tarifuar nga Bashkia Fushë-Arrëz<sup>46</sup>;

<sup>46</sup> Ligji Nr.10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 34 "Servituti minerar dhe ndryshimi për interes publik i pronësisë së sipërfaqes së zonës së lejuar të një lejeje minerare", 1. Zotëruesi i lejes minerare gëzon të drejtën e servitutit ligjor (të detyrueshëm) minerar mbi pronën në zonën e lejuar minerare, të përcaktuar nga leja. 2. Servituti minerar i jep zotëruesit të lejes minerare të drejtën të përdorë pronën shërbyese dhe të kryejë në të gjitha veprimet apo punimet mbështetëse, në përputhje me tipin e lejes minerare, si dhe detyron pronarin e pronës shërbyese ta lejojë zotëruesin

-Theksojmë se urdhri nr.354, datë 02.12.2020, i Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz, nuk shteron pasqyrimin e saktë dhe të plotë të subjektit mbi sipërfaqet e shfrytëzuara nga subjekti në bazë të kontratave të vitit 2009, 2011 dhe aneks kontratës së vitit 2012. Objekti i urdhrimit është verifikimi nëse subjekti aktualisht po shfrytëzon sipërfaqet sipas kontratave të mësipërme, por jo se çfarë sipërfaqe ka shfrytëzuar në të kaluarën, e cila do të krijonte mundësinë e një vlerësimi të saktë të detyrimeve që ka subjekti ndaj bashkisë.

-Gjithashtu në zbatim pikës 4 në nenin 13 të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, ku përcaktohet shprehimisht:

*“Tarifat për të gjitha veprimtaritë që zhvillohen në sektorin e pyjeve, mënyra dhe procedura e mbledhjes së tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Organi përgjegjës për vjeljen e të ardhurave në sektorin e pyjeve është struktura përgjegjëse për pyjet në bashki/zonat e mbrojtura, ndërsa procedura e mbledhjes së tyre apo ekzekutimit të detyrueshëm rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative”.*

Arrihet në konstatimin se nxjerrja e urdhërit për bllokimin e llogarive bankare të subjektit O, nuk ka bazën e duhur ligjore mbështetëse, pasi bllokimi i llogarive bankare është një masë shtrenguese, e cila merret në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, për subjektet debitore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, **ndërkohë** që të ardhurat nga fondi pyjor, arkëtohen nëpërmjet proceduës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative. Ky konstatim përforcohet edhe më tepër nga shkresa nr.3834 prot., datë 03.10.2022, ku “R. B.” Sh.A i drejtuar Bashkisë Fushë Arrëz, ku në mënyrë të përmbledhur shprehet se: “Nuk mund të bëjmë bllokimin e llogarive bankare të klientit “O”, pasi bllokimi i tyre nëpërmjet urdhër bllokimit të lëshuar nga Bashkia Fushë Arrëz bëhet vetëm për detyrimet tatimore. Sa më sipër bllokimi i llogarisë bankare do të bëhet vetëm nëpërmjet urdhërit të përmbartuesit gjyqësor”.

-Pra në këtë rast, Bashkia Fushë Arrëz, pas vlerësimit të sipërfaqes pyjore/kullosore dhe të ardhurave që duhej të arkëtohte, duhej të kishte hapur proces gjyqësor ndaj subjektit O, si dhe të kërkonte nëpërmjet gjykatës lëshimin e urdhrimit për vendosjen në ekzekutim të detyrimit, nëpërmjet shërbimit përmbartimor.

-Theksojmë se Bashkia Fushë Arrëz në vitin 2018 ka hapur proces gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, **por është tërhequr nga ky proces, për të cilin nuk administrohet dokumentacion mbi arsyet e tërheqjes së tij.**

-Gjithashtu çështja e mësipërme (vlera e kërkuar nga Bashkia Fushë Arrëz ndaj subjektit O) është objekt i procesit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, si rrjedhojë e kërkesë padisë së subjektit O **me palë të paditura Bashkinë Fushë Arrëz dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit.** Gjithashtu çështja është në proces shqyrtimi edhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Ndodhur në këto kushte nuk mund të shprehemi më tepër për çështjen e mësipërme.

-Në përfundim, veprimet që duhej të ndërmerreshin nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor për situatën e mësipërme:

- 1.Ngritja e grupit të punës për verifikimin e sipërfaqes;
- 2.Evidentimi i sipërfaqes së shfrytëzuar sipas kontratave të datës 23.09.2009; datë 26.09.2011; Aneks kontratë qiraje datë 15.10.2012, në prani të përfaqësuesit të subjektit;
- 3.Përlllogaritja e vlerës;
- 4.Njoftimi për likuidim vullnetar;
- 5.Në rast të mospërgjigjes, kërkesë padi në gjykatën përkatëse.

Si dhe në kushtet që ndodhet aktualisht Bashkia Fushë Arrëz me subjektin O, pra në proces gjyqësor, dokumentacioni i mësipërm shërben për plotësimin e dosjes gjyqësore.

-Këto veprime nuk janë ndërmarrë nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor.

-Sa më sipër mbajnë përgjegjësi Kryetari i Bashkisë z.F.T dhe Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor deri në 31.12.2021 z.Gj.Gj.

e lejes të përdorë pronën dhe të kryejë këto veprime e punime. 3. Ushtrimi i së drejtës së servitutit, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, bëhet në bazë të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, ku përcaktohet mënyra e ushtrimit të servitutit, dhe kundrejt pagesës së dëmit.

**Kriteri:** Pikat 1, 2 dhe 3 në ligjin nr.10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pika 4 në nenin 13 të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e arkëtimit të të ardhurave të munguara.

**Shkaku:** Mosmarrja e masave të duhura për zbatimin e rekomandimit të lënë në auditimin e mëparshëm të KLSH-së, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, të marrë masat e nevojshme duke ngritur një grup pune me specialist të fushës, të cilët të kryejnë verifikimin në terren dhe vlerësimin e sipërfaqes së shfrytëzuar sipas kontratave të datës 23.09.2009; datë 26.09.2011; Aneks kontratë qiraje datë 15.10.2012, përlllogaritjen e detyrimit, depozitimin e dokumentacionit të mësipërm pranë Gjykatës Administrative të Apelit, me qëllim plotësimin e dosjes gjyqësore, me prova konkrete materiale.

**2.8.2** Në zbatim të pikës 8 të Projekt Raportit të Auditimit “*Të ndryshme të dala gjatë auditimit*”, u auditua ankesa e shtetasit K.LL, administruar në KLSH me shkresën nr.2/228 prot., datë 03.06.2022.

**Dokumentacioni bashkëlidhur ankesës (listuar sipas datave të dokumenteve përkatës):**

- Vendimi nr.302, datë 26.04.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, në të cilin është shqyrtuar çështja me objekt “Shpalljen absolutisht të pavlefshëm aktin administrativ Urdhër nr.39/52 datë 29.09.2015 të Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz dhe rregullimin e pasojave të ardhura nga zbatimi i këtij akti absolutisht të pavlefshëm”.

-Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin nr.302, datë 26.04.2016, ka vendosur pranimin e padisë, shpalljen absolutisht të pavlefshëm të urdhërit nr.39/52 datë 29.09.2015 të Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz dhe rregullimin e pasojave duke vendosur rikthimin në vendin e punës dhe pagimin e pagave nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në momentin e marrjes në punë.

- Vendimi nr.4022, datë 09.11.2018 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në të cilin është shqyrtuar ankesa e Bashkisë Fushë Arrëz për rrëzimin e vendimit nr.302, datë 26.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

-Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr.4022, datë 09.11.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.302, datë 26.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

- Lajmërim për ekzekutim vullnetar nr.526 Regjistri, 323 Prot., datë 21.01.2019, lëshuar nga përmbartuesi gjyqësor “R.B.S” Sh.P.K ndaj Bashkisë Fushë Arrëz, ku kërkohet ekzekutimi vullnetar i vendimit nr.302, datë 26.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, konkretisht:

-Likujdimin e vlerës monetare në shumën 1,756,320 lekë, nga të cilat 1,488,000 lekë paga për shtetasin K.LL, 3,000 lekë shpenzime gjyqësore, 178,920 lekë tarifa e shërbimit të përmbartimit dhe 86,400 lekë tarifë shërbimi për rikthimin në vendin e punës.

- Vendim për ekzekutim të detyrueshëm nr.526 Regjistri, 460 Prot., datë 29.01.2019, lëshuar nga përmbartuesi gjyqësor “R.B.S” Sh.P.K ndaj Bashkisë Fushë Arrëz, ku është vendosur sekuestro konservative në llogarinë e Bashkisë Fushë Arrëz në Degën e Thesarit Pukë.

- Shkresa nr.1100 prot., datë 14.04.2022 nga Bashkia Fushë Arrëz drejtuar shtetasit K.LL, për dijeni Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe zyrës përmbartimore “R.B.S” Sh.P.K. Në këtë shkresë Bashkia Fushë Arrëz njofton shtetasin K.LL për tu paraqitur pranë zyrave të bashkisë deri më datë 20.04.2022 për të vijuar me rikthimin në punë në kategorinë ekzekutive.

- Shkresa nr.526 Regjistri, 905 Prot., datë 18.05.2022 nga përmbartuesi “R.B.S” Sh.P.K drejtuar Bashkisë Fushë Arrëz ku i kërkohet që komunikimet për llogari të shtetasit K.LL, t’i drejtohen vetëm zyrës përmbartimore, si dhe zbatimin e vendimit nr.302, datë 26.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

**Sa më sipër me qëllim pasqyrimin e saktë dhe të plotë të veprimeve nga Bashkia Fushë Arrëz, u auditua dokumentacioni i administruar në Bashkinë Fushë Arrëz. Nga auditimi**

**rezultoi se dokumentacioni që administrohet për çështjen në fjalë, pasqyrohet si më poshtë vijon:**

- Urdhër nr.39/52 datë 29.09.2015 i Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz për ndërprerje të marrëdhënieve të punës të z.K.Ll, sipas organikës së vjetër të miratuar me VKB nr.06, datë 10.03.2015.
- Akti nr.134/1 prot., datë 20.04.2015 lëshuar nga ish Komuna Qafë Mali, i deklarimit të statusit të punësimit drejtuar z. K.Ll me objekt “Nëpunës Civil i Konfirmuar” në pozicionin Përgjegjës për bujqësinë dhe Tatim-Taksat në Komunën Qafë Mali.
- Vendimi nr.3, datë 11.06.2016 i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili pasi ka shqyrtuar çështjen e shtetasit K.Ll, ka vendosur që njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore pranë Bashkisë Fushë Arrëz të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, për revokimin e aktit administrativ nr.39/52 datë 29.09.2015 të Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz për ndërprerje të marrëdhënieve të punës të z.K.Ll, sipas organikës së vjetër të miratuar me VKB nr.06, datë 10.03.2015; Kryerjen e procesit të ristrukturimit të institucionit sipas procedurës së përcaktuar në kuadrin rregullator, duke filluar me ngritjen e komisionit të ristrukturimit; Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore të kujdeset që në rastin e pamundësisë së sistemit të punonjësit që u është shkurtuar/ristrukturuar pozicioni i punës, të vendoset përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, duke u njohur të drejtën e shpërblimit financiar dhe mundësinë që brenda një periudhe 2 vjeçare të konkurrojë si nëpunës civilë.
- Vendimi nr.302, datë 26.04.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
- Vendimi nr.4022, datë 09.11.2018 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.
- Shkresë nr.4167 prot., datë 12.12.2018 e shtetasit K.Ll drejtuar Bashkisë Fushë Arrëz, ku kërkohet zbatimi i vendimeve të gjykatave.
- Rekurs i Bashkisë Fushë Arrëz drejtuar Gjykatës së Lartë Tiranë me shkresën nr.4187 prot., datë 13.12.2018, për kundërshtimin e vendimit nr.4022, datë 09.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.
- Lajmërim për ekzekutim vullnetar nr.526 Regjistri, 323 Prot., datë 21.01.2019, lëshuar nga përmbauesi gjyqësor “R.B.S” Sh.P.K ndaj Bashkisë Fushë Arrëz, ku kërkohet ekzekutimi vullnetar i vendimit nr.302, datë 26.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
- Vendim për ekzekutim të detyrueshëm nr.526 Regjistri, 460 Prot., datë 29.01.2019, lëshuar nga përmbauesi gjyqësor “R.B.S” Sh.P.K ndaj Bashkisë Fushë Arrëz, ku është vendosur sekuestro konservative në llogarinë e Bashkisë Fushë Arrëz në Degën e Thesarit Pukë.
- Kërkesa nr.526 Regjistri, 363 Prot., datë 23.01.2020 lëshuar nga përmbauesi gjyqësor “R.B.S” Sh.P.K ndaj Bashkisë Fushë Arrëz, me objekt “Kërkesë për likuidimin e menjëhershëm të detyrimit”.
- Urdhër për rivendosjen e sekuestros konservative nr.526 Regjistri, 373 Prot., datë 23.01.2020, lëshuar nga përmbauesi gjyqësor “R.B.S” Sh.P.K ndaj Bashkisë Fushë Arrëz, ku është vendosur sekuestro konservative në llogarinë ekonomike nr.602 të Bashkisë Fushë Arrëz në Degën e Thesarit Pukë, për shumën 1,756,320 lekë.
- Shkresa nr.526 Regjistri, 2161 Prot., datë 08.07.2021 lëshuar nga përmbauesi gjyqësor “R.B.S” Sh.P.K ndaj Bashkisë Fushë Arrëz, me objekt “Kërkesë për vëmendje”. Në këtë kërkesë pasqyrohet informacioni se Bashkia Fushë Arrëz ka detyrim pa likuiduar në vlerën 1,517,920 lekë.
- Shkresa nr.1621/1 prot., datë 19.07.2021 nga Bashkia Fushë Arrëz drejtuar zyrës përmbauesi “R.B.S” Sh.P.K. Në këtë shkresë Bashkia Fushë Arrëz kërkon që për pjesën e mbetur të vitit 2021, likuidimi të kryhet sipas grafikut muaji Korrik-Dhjetor-20,000 lekë në muaj.
- Shkresa nr.526 Regjistri, 3549 Prot., datë 16.12.2021 lëshuar nga përmbauesi gjyqësor “R.B.S” Sh.P.K ndaj Bashkisë Fushë Arrëz, me objekt “Paralajmërimi i fundit”. Në këtë shkresë kërkohet që Bashkia Fushë Arrëz të likujdojë detyrimin në vlerën 1,517,920 lekë brenda datës 25.12.2021.

- Shkresa nr.3248/1 prot., datë 28.12.2021 nga Bashkia Fushë Arrëz drejtuar zyrës përmbarimore “R.B.S” Sh.P.K. Në këtë shkresë Bashkia Fushë Arrëz njofton që do të fillojë likuidimin e detyrimit me fillimin e vitit 2022.
- Urdhër për rivendosjen e sekuestros konservative nr.526 Regjistri, 394 Prot., datë 17.03.2022, lëshuar nga përmbaruesi gjyqësor “R.B.S” Sh.P.K ndaj Bashkisë Fushë Arrëz, ku është vendosur sekuestro konservative në llogarinë ekonomike nr.602 të Bashkisë Fushë Arrëz në Degën e Thesarit Pukë, për shumën 1,517,920 lekë.
- Kërkesa nr.526 Regjistri, 497 Prot., datë 01.04.2022 lëshuar nga përmbaruesi gjyqësor “R.B.S” Sh.P.K ndaj Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Në këtë shkresë kërkohet nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër që të marrë masat ndaj Bashkisë Fushë Arrëz në zbatim të përcaktimeve të bëra në nenet 66 dhe 68 të Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, konkretisht:

### **Neni 66 Ekzekutimi i detyrueshëm**

1. Gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm, gjyqtari apo kryetari i trupit gjykues, që ka dhënë vendimin, me kërkesë të palëve ose të përmbaruesit gjyqësor, në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, urdhëron kryerjen e veprimeve të posaçme dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme, duke përcaktuar afatet dhe mënyrën e kryerjes së tyre.

### **Neni 68 Sanksione për mosekzekutimin e vendimit apo të urdhrat të gjykatës**

2. Në rast të moskryerjes me faj të detyrimeve, sipas vendimit apo urdhrave të gjykatës, pa shkaqe të përligjura, gjyqtari edhe kryesisht vendos gjobë ndaj titullarit të organit publik debitor. Masa e gjobës është e barabartë me 20 për qind të pagës minimale, në shkallë vendi, për çdo ditë vonesë në ekzekutim.

3. Në rastet e konstatimit të mosekzekutimit të vendimeve, pa shkaqe të përligjura, gjyqtari kërkon marrjen e masave disiplinore dhe, kur është rasti, paraqet edhe kallëzim penal ndaj personave përgjegjës.

- Shkresa nr.1100 prot., datë 14.04.2022 nga Bashkia Fushë Arrëz drejtuar shtetasit K.Ll, për dijeni Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe zyrës përmbarimore “R.B.S” Sh.P.K. Në këtë shkresë Bashkia Fushë Arrëz njofton shtetasin K.Ll për tu paraqitur pranë zyrave të bashkisë deri më datë 20.04.2022 për të vijuar me rikthimin në punë në kategorinë ekzekutive.
- Shkresa nr.526 Regjistri, 725 Prot., datë 27.04.2022 lëshuar nga përmbaruesi gjyqësor “R.B.S” Sh.P.K ndaj Bashkisë Fushë Arrëz, me objekt “Tërheqje vëmendje”. Në këtë shkresë kërkohet rikthimi në vendin e punës të shtetasit K.Ll dhe likuidimin e detyrimit të mbetur.
- Shkresa nr.526 Regjistri, 905 Prot., datë 18.05.2022 nga përmbaruesi “R.B.S” Sh.P.K drejtuar Bashkisë Fushë Arrëz ku i kërkohet që komunikimet për llogari të shtetasit K.Ll, t’i drejtohen vetëm zyrës përmbarimore, si dhe zbatimin e vendimit nr.302, datë 26.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
- Shkresa nr.1100 prot., datë 14.04.2022 nga Bashkia Fushë Arrëz drejtuar zyrës përmbarimore “R.B.S” Sh.P.K, për dijeni Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe shtetasin K.Ll. Në këtë shkresë Bashkia Fushë Arrëz shprehet se shtetasi K.Ll është njoftuar për tu paraqitur pranë bashkisë për tu rikthyer në punë, por nuk ka patur përgjigje nga shtetasi në fjalë.
- Gjithashtu administrohet edhe informacioni mbi likuidimin pjesor të detyrimit, pasqyruar si më poshtë vijon:

Detyrimi gjithësej	Likujduar			Mbetur
	U.Shpenzimit	Datë	Vlera	
1,756,320	364	22.11.2019	50,000	
121,600	212	5.8.2020	90,000	
	263	21.9.2020	60,000	
	349	3.12.2020	60,000	
	275	3.11.2021	50,000	
	365	6.1.2022	50,000	
	162	6.7.2022	60,000	

1,877,920		420,000	1,457,920
-----------	--	---------	-----------

**Sa më sipër nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nëpërmjet ankesës së shtetasit K.Ll dhe dokumentacionit të administruar në Bashkinë Fushë Arrëz, arrihet në përfundimin se:**

**Titulli i Gjetjes:** Mbi shqyrtimin e ankesës së shtetasit K.Ll.

**Situata:** Urdhri nr.39/52 datë 29.09.2015 i Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz për ndërprerje të marrëdhënieve të punës të z.K.Ll, është nxjerrë në kundërshtim me kuadrin rregullator të fushës dhe është shpallur i pavlefshëm.

- Pavlefshëmëria e urdhrin të mësipërm dhe nxjerrja e tij në kundërshtim me kuadrin rregullator të fushës është shpallur nëpërmjet: Vendimit nr.3, datë 11.06.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil; Vendimit nr.302, datë 26.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe Vendimit nr.4022, datë 09.11.2018 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

- Si rrjedhojë e nxjerrjes së urdhrin në kundërshtim me kuadrin rregullator dhe të pavlefshëm, Bashkia Fushë Arrëz ka krijuar detyrim ndaj palëve të treta shtetasin K.Ll dhe zyrës së përbarimit, gjithësej 1,877,920 lekë, duke rënduar buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz.

- Ndaj shtetasit K.Ll dhe zyrës përbarimore janë kryer likujdime pjesore në vlerën 420,000 lekë, *të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona.*

- Deri më datë 31.12.2021, Bashkia Fushë Arrëz nuk ka marrë masat për zbatimin e Vendimit nr.3, datë 11.06.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim rregullimin e ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit dhe pasojave që kanë ardhur prej tij, duke eliminuar në këtë mënyrë krijimin e detyrimeve financiare ndaj shtetasit K.Ll.

- Deri më datë 31.12.2021, Bashkia Fushë Arrëz nuk ka marrë masat për zbatimin e Vendimit nr.302, datë 26.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për rikthimin në pozicionin e punës me kushte dhe kategori të njëjtë të shtetasit K.Ll, duke eliminuar në këtë mënyrë krijimin e detyrimit në vlerën 1,877,920 lekë.

- Deri më datë 31.12.2021, Bashkia Fushë Arrëz nuk ka marrë masat për zbatimin e Vendimit nr.4022, datë 09.11.2018 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për rikthimin në pozicionin e punës me kushte dhe kategori të njëjtë të shtetasit K.Ll, duke eliminuar në këtë mënyrë krijimin e detyrimit në vlerën 1,877,920 lekë dhe bllokimin e llogarisë bankare të Bashkisë Fushë Arrëz.

- Deri më datë 31.12.2021, Bashkia Fushë Arrëz nuk ka marrë masat për zbatimin e shkresave të ardhura nga zyra e përbarimit “R.B.S” Sh.P.K (njoftim për likujdim vullnetar, vendim për ekzekutim të detyrueshëm, tërheqje vëmendje etj) për likujdim plotësisht të detyrimit ndaj shtetasit K.Ll<sup>47</sup> dhe rikthimin e tij në pozicionin e punës me kushte dhe kategori të njëjtë, mosveprime të cilat ka rritur vlerën e detyrimit me 121,600 lekë kamatëvonesa për shërbimin përbarimor, nga 1,756,320 lekë në fillim në 1,877,920 lekë.

- Sipas aktit nr.134/1 prot., datë 20.04.2015 lëshuar nga ish Komuna Qafë Mali, shtetasi K.Ll ka pozicionin Përgjegjës për bujqësinë dhe Tatim-Taksat, po kështu edhe nëpërmjet VKB nr. 10, datë 03.09.2015 (Pozicioni Inspektor – Shtesë Page Kategoria III-b<sup>48</sup>) ndërkohë që sipas shkresës nr. 1100 prot., datë 14.04.2022 shtetasi K.Ll është njoftuar për të vijuar me rikthimin në punë në kategorinë ekzekutive, pra jo në kategorinë e nivelit të ulët drejtues (Përgjegjës sektori/pozicion i barazvlefshëm me të), për më tepër në njoftimin e dërguar nga Bashkia Fushë Arrëz nuk specifikohet pozicioni për të cilin është njoftuar shtetasi K.Ll.

<sup>47</sup> Ndërkohë që në fund të vitit 2019 ka pasur disponibilitete në thesar, Konfirmuar nëpërmjet shkresës nr.234 prot., datë 23.06.2021 të Degës së Thesarit Pukë, drejtuar zyrës përbarimore “R. B. S.” Sh.P.K. E njëjta situatë paraqitet edhe për vitin 2020 dhe 2021, ku sipas llogarisë nr.520 (zbritur llogarinë nr.466) rezulton se Bashkia Fushë Arrëz ka pasur disponibilitete në thesar.

<sup>48</sup> VKM nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në nstitutionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, Kreu II-Kategoria III - Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues-Klasa Emërtimi i pozicionit:

1 Shef sektori i nivelit A.

2 Shef sektori i nivelit B

- Nuk administrohet lista e pritjes për punonjësit të cilët pas ristrukturimit/mbylljes së institucionit, pozicioni i punës nuk ekziston më/ka pësuar ndryshime në kriteret e punësimit. Lista e pritjes protokollohet dhe i përcillet Departamentit të Administratës Publike.
- Nuk administrohet baza e të dhënave gjyqësore, e cila përmban:
  - Numrin dhe datën e vendimit gjyqësor, palët, objektin e padisë;
  - Akti i largimit/lirimit të nëpunësit;
  - Fakte dhe rrethana të lindura në lidhje me pozicionin e punës pas daljes së vendimit gjyqësor;
  - Gjendjen juridike të pozicionit të punës, pas laragimit të nëpunësit, pra është bashkuar me pozicion tjetër, nuk ekziston më, ndryshim kriteresh etj.
- Nuk administrohet dokumentacion nga sektori i burimeve njerëzore (në rolin e njësisë përgjegjëse<sup>49</sup>) pranë Bashkisë Fushë Arrëz, për marrjen e masave të nevojshme në zbatim të nenit 66/1 në Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, si më poshtë vijon:
  - Vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë zbatohen menjëherë nga njësia përgjegjëse.
  - Nëse rikthimi i nëpunësve civilë në detyrë, sipas pikës 1, të këtij neni, është objektivisht i pamundur, atëherë ata regjistrohen në një listë pritjeje deri në sistemimin e tyre në një pozicion të rregullt në shërbimin civil. Lista administrohet nga njësia përgjegjëse.
  - Gjatë kohës së qëndrimit në listë, nëpunësit civilë paguhën sipas pozicionit të fundit që kanë pasur në shërbimin civil.
  - Njësia përgjegjëse është e detyruar që në momentin e krijimit të një vendi të lirë në shërbimin civil, të emërojë, fillimisht, me pëlqimin e tyre, nëpunësit civilë të regjistruar në listë, sipas kategorisë përkatëse dhe që plotësojnë kriteret e pozicionit të punës.
  - Këta nëpunës, me pëlqimin e tyre, mund të sistemohen edhe për plotësimin e vendeve të lira, të krijuara në mënyrë të përkohshme. Njësia përgjegjëse në këtë rast bën emërimin e përkohshëm të këtyre nëpunësve.

*Sa më sipër mbajnë përgjegjësi, z. F.T, Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz; zj. E.P, Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore për periudhën 01.02.2016-05.01.2018; zj. M.P, Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore për periudhën 05.01.2018-31.05.2018; zj. V.B, Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore për periudhën 31.05.2018-06.09.2019; z. S.Gj, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore për periudhën 06.09.2019 – në vazhdim.*

**Kriteri:** Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Nenet 4, 11, 41, 100 dhe 165 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 50 dhe nenin 66/1 në Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar; Pikën 1 në nenin 8 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Kreun II në VKM nr. 125, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”; Udhëzimin nr.1, datë 03.06.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”; Pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

**Ndikimi/Efekti:** Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe 420,000 lekë, shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Sektori i Financës të marrë masat e nevojshme për likuidimin e plotë të detyrimit ndaj shtetasit K.Ll.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimin e shtetasit K.Ll, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjes së mësipërme

<sup>49</sup> “Njësi përgjegjëse” është Departamenti i Administratës Publike (DAP) për institucionet e administratës shtetërore dhe njësia e burimeve njerëzore për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.



pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.885/8 prot., datë 11.01.2023, konkretisht nga Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore, për sa më poshtë:

**Pretendimi i Subjektit:**

Në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore, konstatuar si një nga personat përgjegjës për çështjen e ankesës së shtetasit K.Ll, parashtror si më poshtë:

Siç jeni njohur me dosjen e plotë që zyra e burimeve njerëzore administrojnë për çështjen dhe problematikën e shtetasit K.Ll, në zbatim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe akteve të tjera nënligjore, kemi marrë masën e duhur për rikuperimin e pasojës ligjore, ku përmes shkresës me nr.1100 prot, datë 14.04.2022 drejtuar shtetasit K.Ll dhe për dijeni Komisionerit të Shërbimit Civil, kemi njoftuar shtetasin në fjalë për t’u paraqitur pranë zyrave të bashkisë për të vijuar me rikthimin e tij në punë në kategorinë ekzekutive, ashtu siç ka qenë më parë. Për sa më sipër, sqaroj se:

Shtetasi K.Ll nuk është paraqitur pranë zyrës së burimeve njerëzore, duke refuzuar rikthimin në punë, gjë të cilën e kemi bërë të qartë përmes shkresës përkatëse, të cilën i’u kemi drejtuar sërish shtetasit K.Ll, si dhe për dijeni Komisionerit të Shërbimit Civil, në të cilën kemi informuar mosparaqitjen e tij pranë zyrave të bashkisë. Nisur nga kjo premisë dhe nga ky informacion, të cilin grupi auditues e ka administruar përmes verifikimit të dosjes konkrete, kërkoj rivlerësimin e konstatimit dhe marrjen në konsideratë të argumentimit të parashtruar.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

-Sa i përket observacionit të mësipërm, sqarojmë se me shkresën që kemi cituar në observacion, grupi i auditimit është njohur gjatë auditimit në terren, pranë Bashkisë Fushë Arrëz. Ngarkimi juaj me përgjegjësi është për mangësitë si më poshtë vijon:

-Nuk janë marrë masat për zbatimin e Vendimit nr.3, datë 11.06.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

-Nuk janë marrë masat për zbatimin e Vendimit nr.4022, datë 09.11.2018 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

-Sipas aktit nr.134/1 prot., datë 20.04.2015 lëshuar nga ish Komuna Qafë Mali, shtetasi K.Ll ka pozicionin Përgjegjës për bujqësinë dhe Tatim-Taksat, po kështu edhe nëpërmjet VKB nr. 10, datë 03.09.2015 (Pozicioni Inspektor – Shtesë Page Kategoria III-b<sup>50</sup>) ndërkohë që sipas shkresës nr. 1100 prot., datë 14.04.2022 shtetasi K.Ll është njoftuar për të vijuar me rikthimin në punë në kategorinë ekzekutive, pra jo në kategorinë e nivelit të ulët drejtues (Përgjegjës sektori/pozicioni i barazvlefshëm me të), për më tepër në njoftimin e dërguar nga Bashkia Fushë Arrëz nuk specifikohet pozicioni për të cilin është njoftuar shtetasi K.Ll.

Nuk administrohet lista e pritjes për punonjësit të cilët pas ristrukturimit/mbylljes së institucionit, pozicioni i punës nuk ekziston më/ka pësuar ndryshime në kriteret e punësimit. Lista e pritjes protokollohet dhe i përcillet Departamentit të Administratës Publike.

Nuk administrohet baza e të dhënave gjyqësore, e cila përmban:

-Numrin dhe datën e vendimit gjyqësor, palët, objektin e padisë;

-Akti i largimit/lirimit të nëpunësit;

-Fakte dhe rrethana të lindura në lidhje me pozicionin e punës pas daljes së vendimit gjyqësor;

-Gjëndjen juridike të pozicionit të punës, pas largimit të nëpunësit, pra është bashkuar me pozicion tjetër, nuk ekziston më, ndryshim kriteresh etj.

<sup>50</sup> VKM nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, Kreu II-Kategoria III - Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues-Klasa Emërtimi i pozicionit:

1 Shef sektori i nivelit A.

2 Shef sektori i nivelit B

-Nuk administrohet dokumentacion nga sektori i burimeve njerëzore (në rolin e njësisë përgjegjëse<sup>51</sup>) pranë Bashkisë Fushë Arrëz, për marrjen e masave të nevojshme në zbatim të nenit 66/1 në Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, si më poshtë vijon:

-Vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë zbatohen menjëherë nga njësia përgjegjëse.

-Nëse rikthimi i nëpunësve civilë në detyrë, sipas pikës 1, të këtij neni, është objektivisht i pamundur, atëherë ata regjistrohen në një listë pritjeje deri në sistemimin e tyre në një pozicion të rregullt në shërbimin civil. Lista administrohet nga njësia përgjegjëse.

-Gjatë kohës së qëndrimit në listë, nëpunësit civilë paguhën sipas pozicionit të fundit që kanë pasur në shërbimin civil.

-Njësia përgjegjëse është e detyruar që në momentin e krijimit të një vendi të lirë në shërbimin civil, të emërojë, fillimisht, me pëlqimin e tyre, nëpunësit civilë të regjistruar në listë, sipas kategorisë përkatëse dhe që plotësojnë kriteret e pozicionit të punës.

-Këta nëpunës, me pëlqimin e tyre, mund të sistemohen edhe për plotësimin e vendeve të lira, të krijuara në mënyrë të përkohshme. Njësia përgjegjëse në këtë rast bën emërimin e përkohshëm të këtyre nëpunësve.

#### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:**

**Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:**

##### **A.MASA ORGANIZATIVE**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.
- Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.
- Për vitin 2021 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit.
- Në Bashkinë Fushë Arrëz nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.
- Për vitin 2021 nuk dokumentohet ngritja dhe funksionimi i GMS.
- Nuk është krijuar rregjistri i riskut dhe strategjia e menaxhimit të riskut.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

**1.2.Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit Juridik në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit të Burimeve Njerëzore të kryejë ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.

**1.3.Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre, si dhe hartimin e hartës së proceseve të punës në Bashkinë Fushë Arrëz.

**Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023**

<sup>51</sup> “Njësi përgjegjëse” është Departamenti i Administratës Publike (DAP) për institucionet e administratës shtetërore dhe njësia e burimeve njerëzore për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Fushë Arrëz për gjatë vitit 2021, u konstatua se:

- Nuk është hartuar plani strategjik i auditimit të brendshëm për periudhën 2021-2023.
- Audituesit pranë këtij sektori nuk janë të pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm.
- Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njesisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.
- Në auditimet e kryera për vitin 2021, konstatohet se Sektori Auditit të Brendshëm, nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.
- Për vitin 2021, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete me risk të lartë që kryen Bashkia Fushë Arrëz, si Sektori i Financës, Sektori Juridik, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, prokurimet e realizuara nga Bashkia Fushë Arrëz. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bëra në shkronjën “ç” në nenin 6, nenin 13, shkronja “ç” në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”; Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1, faqe 18-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, Përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe Përgjegjësi i sektorit të auditit të brendshëm, të marrë masa për:

- Certifikimin e audituesve të brendshëm të punësuar pranë NJAB Fushë Arrëz;
- Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

**2.2.Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njesisë vendore në arritjen e objektivave institucional.

### **Përgjatë vitit 2023 dhe në vijimësi**

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Fushë Arrëz për arkëtim ndaj të tretëve, është pasqyruar më pak për vlerën 14,083,752 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, për vlerën:

- 13,686,443 lekë detyrimi i subjektit N.S.E, për kontratën e qirasë.
- 397,309 lekë kamatë-vonesa për kategorinë biznes.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “ë”, pika 3, neni 12 në ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c” në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1.Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në

llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022**

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më shumë për vlerën 919,930 lekë, si rrjedhojë e kontabilizimit në këtë llogari të disa makinerive, si 1 fadrom dhe 1 makinë teknologjike, të cilat janë makineri dhe jo mjete transporti, si dhe duhet të klasifikohen në llogarinë nr.214. Për këto makineri duhet të aplikohet normë tjetër amortizimi (5%) dhe jo (20%). Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik-instalime teknike, paisje, instrumente dhe vegla pune – llogaria 7-shifrore 2140240-Paisje dhe makineri për konstruksione (ndërtime); 2140260-Paisje pastrimi për rrugët; 2140320-Mjete dhe paisje të tjera teknike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1.Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022**

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar me 122,100,000 lekë, vlera e aksioneve në shoqërinë aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Fushë Arrëz Sh.A” me NIPT K19629304M. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Urdhrin e Ministrit të MFE nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”; Kreun 3.1, pika 31, shkronja “b” në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1.Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022**

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë për vlerën 6,016,237 lekë, për garanci të cilave i ka kaluar afati dhe duhet t’u kthehen subjekteve përkatëse<sup>52</sup>. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4” në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1.Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Financës në bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave i’u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

<sup>52</sup> Llogaria 466 për garancitë që i ka kaluar afati, pasqyrohet në Kapitullin “Aneksë” – “Aneksi nr.4” të raportit përfundimtar të auditimit.

## Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr. 202 “Studime dhe kërkime”, u konstatua se nuk është kryer amortizimi në vlerën 3,594,080 lekë sipas normës 15% për aktivet afatgjata jomateriale. Veç sa më sipër konstatohet se në këtë llogari janë të kontabilizuara projekte për investime për punë publike të përfunduara dhe sipas rastit të marra në dorëzim nëpërmjet akt-kolauditimit përfundimtar. Këto projekte duhet të ishin kontabilizuar rast pas rasti në objektin përkatës (llogaritë e klasës 2, ndërtesa, konstruksione, rrugë etj) si pjesë e kostos totale të tij. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2, Klasa 2 “Trajtimi kontabël për AAGJ jomateriale, shkronja “d” në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, si dhe pikën 36 “Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritë me metodën lineare me normë amortizimi 15%”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**7.1.Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”.

## Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr. 231 “Investime në proces”, e cila përfaqëson shpenzime për investime në proces, u konstatua se kjo llogari, është mbivlerësuar për vlerën 197,608,607 lekë, vlerë e cila përfaqëson shpenzime për investime të përfunduara, për të cilat është bërë kolaudimi/marrja në dorëzim (pra janë të shfrytëzueshme dhe në përdorim) por të pakapitalizuara në llogaritë e klasës 2 AAGJ. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun 2, klasa 2 në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**8.1.Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr.231 “Investime në proces” dhe llogarive nr. 213/212 sipas rastit, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë së aktivitet afatgjatë dhe në kredi të llogarisë së investimeve në proces.

## Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarive nr.210 “Toka, Troje, Terrene” nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, u konstatua se në këto llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet 2010-2016, pa ndryshuar në vijimësi, duke mos pasqyruar:

-Vlera e trullit nën objekt dhe të trullit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj, sipas inventarit të aktiveve afatgjata materiale, të pasqyruar në llogarinë nr.212 “Ndërtime e konstruksione”.

-Vlera e trullit të palestrës së shkollës 70-Vjetori i Pavarsisë, sipas lejes së ndërtimit, sheshi i ndërtimit me sipërfaqe  $458 \text{ m}^2 * 1,620^{53} \text{ lekë/m}^2 = 741,960 \text{ lekë}$ .

-Vlera e 394 pronave me sipërfaqe  $65,287,847 \text{ m}^2$  pyje e kullota, të cilat janë regjistruar në ish-ZVRPP Pukë, të evidentuara nga zyra e pyjeve e kullotave të bashkisë. Këto prona janë regjistruar në vitet 2012-2013 nga ish bashkia Fush Arrëz dhe ish Komuna Qaf Mali.

-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i llogarive të mësipërme.

-Për llogaritë e mësipërme në Bashkinë Fushë Arrëz nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitet, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitet, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia

<sup>53</sup> Përcaktuar në VKM nr.89, datë 03.0.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH”.

etj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kapitullin III, neni 9, pika 1.2 në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Pikat 26, 27, 30 dhe 74 në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Kapitullin III, pika 30 në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**9.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Sektorin e Financës të planifikojë në buxhet një fond të detajuar për kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve nga ekspertë vlerësues të licencuar.

**9.2.Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme, për:

- Kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene” nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”.

- Hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

### Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2021 për punë publike mallra dhe shërbime, u konstatua se në 16 raste, në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e kriterëve për kualifikim (si kërkesa për certifikatat e standardizimit, numrin e punonjësve, të makinerive, kategorive të licencave të zbatimit të punimeve etj), si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 46, pikat 1 dhe 3 në Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Nenin 2, pikën 2 në nenin 3, nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”; Pikën 5 në nenin 26, pikat 1, 3, 5 në nenin 27, pikën 2 në nenin 61 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 2, Shkronjën “b” të pikës 3 në nenin 15, pikën 4 në nenin 39, pikën 1 të nenit 40, shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43, pikën 1 të nenit 44 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**10.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e përcaktimit të kriterëve të kualifikimit në kundërshtim me kuadrin rregullator, si dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës.

**10.2.Rekomandimi:** Njësia e Prokurimit Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

-Njësia e Prokurimit në Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa që në vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në procedurat e prokurimit për blerjen e mallrave me natyrë lëndë djegëse për ngrohje dhe transport, të përcaktohet distanca e favorshme e magazinimit të lëndës djegëse, si dhe e stacionit të shitjes së karburantit, me qëllim plotësimin e nevojave të institucionit në kohë dhe me cilësi.

### Në procedurat e prokurimit për vitin 2023 dhe në vijimësi

**11.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2021, u konstatua se në 16 raste, OE janë shpallur fitues në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, si dhe nga KVO nuk është bërë anulimi i procedurës së prokurimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “ç” në pikën 1 në nenin 24, pika 1 në nenin 46 dhe pika 3 në nenin 53 në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Neni 98 në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; Pikën 2 të nenit 82, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr.285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

-Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**12.Gjetje nga auditimi:** Në auditimin për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, në 1 rast për lejen me objekt “Magazinë bujqësore në funksion të bujqësisë, me tarracë të gjelbëruar, 1 kat nëntokë”, personat përgjegjës që administrojnë procesin në sistemin “e-leje”, e kanë miratuar atë në mospërmbushje të dokumentacionit të rregullt sektorial për ndërtimin, pasi janë evidentuar mangësi që lidhen me bashkëveprimin e personave përgjegjës me institucionet përkatëse, të cilave gjatë procesit të miratimit të lejeve të ndërtimit, u dërgohet dosja teknike, për dhënie mendimi. Gjithashtu mungon VNM paraprake nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, mendimi i institucioneve sipas fushave përkatëse, veprime në kundërshtim me pikën 6 të nenit 10/1, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 122-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1.Rekomandimi:** Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, ku të respektohet legjislacioni sektorial në fuqi, duke kryer bashkëveprimin me të gjitha institucionet e ngarkuara për dhënia mendimi, përpara miratimit të lejes.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**13.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme, rezulton se në Bashkinë Fushë Arrëz nuk është krijuar Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit. Për periudhën objekt auditimi, nuk ka asnjë evidencë nga punonjës të bashkisë për veprimtari që mbulojnë fushën e inspektimit dhe kontrollit të territorit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 123-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**13.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**14.Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i ankesës së ardhur në KLSH me nr. 914, datë 06.10.2022 nga subjekti “O”, mbi procedurën e ndjekur nga Bashkia Fushë Arrëz në marrëdhënien kontraktore me subjektin “O” Sh.P.K, u konstatua se:

-Nga Bashkia Fushë Arrëz (Sektori i Financës) është bërë kontabilizimi i detyrimit për shumën 11,616 mijë lekë, por që nga vetë bashkia (sektorët përgjegjës), nuk është ndjekur asnjë procedurë ligjore në arkëtimin vlerës.

-Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz nuk është ngritur grup pune, ku të evidentojë sipërfaqen e shfrytëzuar faktikisht nga subjekti në raport me sipërfaqen totale sipas lejes minerare nr.1312, datë 02.02.2009, për të cilën duhej të ishin tarifuar detyrimet kontraktuale që subjekti i detyrohet bashkisë.

-Gjithashtu vetë bashkia nuk ka hapur proces gjyqësor ndaj subjektit me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikat 1, 2 dhe 3 në ligjin nr.10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pika 4 në nenin 13 të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 129-141, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**14.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, të marrë masat e nevojshme duke ngritur një grup pune me specialist të fushës, të cilët të kryejnë verifikimin në terren dhe vlerësimin e sipërfaqes së shfrytëzuar sipas kontratave të datës 23.09.2009; datë 26.09.2011; Aneks kontratë qiraje datë 15.10.2012, përlllogaritjen e detyrimit, depozitimin e dokumentacionit të mësipërm pranë Gjykatës Administrative të Apelit, me qëllim plotësimin e dosjes gjyqësore, me prova konkrete materiale.

### **Brenda 3 mujorit të parë të vitit 2023**

**15.Gjetje nga auditimi:** Realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 me të ardhurat e veta (pa transfertën e palushtëzuar) të Bashkisë Fushë Arrëz ka diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 325,874 mijë lekë, ndërsa realizimi 270,352 mijë lekë, ose në masën 83%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 26,467 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 14,558 mijë lekë, ose në masën 55 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Fushë Arrëz në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Gjithashtu edhe gjatë vitit 2021 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2021.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 46 në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**15.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë, Përgjegjësi i Sektorit të Financës, si dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korrigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**16.Gjetje nga auditimi:** Bashkia Fushë Arrëz në datën 01.01.2021 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 10,873 mijë lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2021 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti vlera 8,017 mijë lekë, nga e cila është likuiduar vlera 2,633 mijë lekë, ose 32.8% e vlerës së planifikuar.



Pra, në datën 31.12.2021 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2021), është ulur me 2,095 mijë lekë, ose në masën prej 19.2%. Rezulton se gjatë vitit 2021 Bashkia Fushë Arrëz ka parashikuar investime të reja nga të ardhurat e veta në vlerën 12,781,000 lekë dhe ka realizuar 10,239,840 lekë, si dhe nga transfertat e pakushtëzuar 13,686,000 lekë dhe ka realizuar 4,319,000 lekë. Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162; Nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**16.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Përgjegjësi i Sektorit të Financës të marrë masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

### Menjëherë dhe në vijimësi

**17.Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se nga 18 rekomandime të dhëna, 1 prej tyre është zbatuar ose 6%, 2 zbatuar pjesërisht ose 11%, 1 në proces zbatimi ose 6%, si dhe 13 pa zbatuar ose 72%. Në vlerë monetare, sa i përket rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, rezulton se:

-Janë dhënë 3 rekomandime për shpërblimin e dëmit të krijuar për 3 subjekte në vlerën 8,271 mijë lekë, të cilat nuk janë zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 124-128, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**17.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të marrë të gjithë masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, të cilat ende rezultojnë të pazbatuara.

### Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023

**18.Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e siguruar nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me leje minerare sipas regjistrimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se përgjatë periudhës 2020-2021, në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz, kanë ushtruar aktivitet në sektorin e kërkimit, zbulimit, prodhimit të minerareve, 10 subjekte në sipërfaqe pyjore/kullosore prej 11.475 km<sup>2</sup>, për të cilat NSHP Bashkia Fushë Arrëz nuk administron dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj)<sup>54</sup>. Veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin kullosor”, pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**18.1.Rekomandimi:** Drejtoria e shërbimit pyjor t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

<sup>54</sup> Pasqyruar në Kapitullin “Aneksë” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.

-Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

**Menjëherë**

### **B.1.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Fushë Arrëz për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën **200,000 lekë**, për 3 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa economicitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Gjithashtu konstatohet se në 3 raste për likuidimin e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullari i institucionit, por nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të proceseve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2021, u konstatua se Bashkia Fushë Arrëz ka prokuruar blerjen e mallit “lëndë djegëse dru zjarri” për ngrohje në institucionet publike. Grupi i auditimit gjatë auditimit të procedurës së mësipërme, duke pasur në konsideratë burimet natyrore (florën) të disponueshme në teritorrin administrativ të Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe sipërfaqet pyjore dhe kullimore, vlerësoi se Bashkia Fushë Arrëz ka mundësinë, që lëndën djegëse dru zjarri ta siguroj nëpërmjet prerjeve në fondin e saj pyjor dhe jo ta blejë, duke siguruar në këtë mënyrë kursimin e fondeve publike, në vlerën 3,139,712 lekë.

-Veç sa më sipër, u konstatua se kërkesat për karburant nga sektorë të ndryshëm në Bashkinë Fushë Arrëz, nuk argumentohen në mënyrë të plotë dhe të saktë. Gjithashtu për mjete të ndryshme nuk është përcaktuar norma e konsumit të karburantit, si p.sh., mjetet e sektorit të zjarrëfikses. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 23 në nenin 3 në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Pikën 2 në nenin 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të marrë masat e nevojshme, që të prokurorë shërbimin e prerjes së lëndës djegëse lloji “Dru zjarri” për ngrohje, dhe jo blerjen e tij, me qëllim eliminimin e përdorimit të fondeve publike pa eficiencë dhe economicitet.

**Në plotësimin e nevojave për vitin 2023 dhe në vijimësi**

-Gjithashtu në bashkëpunim me sektorin e financës, të marrë masa për ngritjen e komisionit, me qëllim përcaktimin e normës së konsumit të karburantit për mjetet e sektorit të zjarrëfikses, si dhe argumentimin e plotë dhe të saktë të sasisë për karburant nga sektorët përkatës.

### **Brenda muajit Janar të vitit 2023**

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i procedurës së ndjekur nga Bashkia Fushë Arrëz në marrëdhënien administrative me ish punonjës të z. K.Ll, iniciuar nga ankesa e shtetasit K.Ll, administruar në KLSH me shkresën nr.2/228 prot., datë 03.06.2022, u konstatua se:

-Urdhri nr.39/52 datë 29.09.2015 i Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz për ndërprerje të marrëdhënieve të punës të z. K.Ll, është nxjerrë në kundërshtim me kuadrin rregullator të fushës dhe është shpallur i pavlefshëm.

-Si rrjedhojë e nxjerrjes së urdhrit në kundërshtim me kuadrin rregullator dhe të pavlefshëm, Bashkia Fushë Arrëz ka krijuar detyrim ndaj palëve të treta shtetasin K.Ll dhe zyrës së përmbarimit, gjithësej 1,877,920 lekë, duke rënduar buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz.

-Ndaj shtetasit K.Ll dhe zyrës përmbarimore janë kryer likuidime pjesore në vlerën 420,000 lekë, *të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona.*

-Deri më datë 31.12.2021, Bashkia Fushë Arrëz nuk ka marrë masat për zbatimin e Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për rikthimin në pozicionin e punës me kushte dhe kategori të njëjtë të shtetasit K.Ll, duke eliminuar në këtë mënyrë krijimin e detyrimit në vlerën 1,877,920 lekë dhe bllokimin e llogarisë bankare të Bashkisë Fushë Arrëz. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenet 4, 11, 41, 100 dhe 165 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 50 dhe nenin 66/1 në Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar; Pikën 1 në nenin 8 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Kreun II në VKM nr. 125, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”; Udhëzimin nr.1, datë 03.06.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”; Pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 129-141, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Sektori i Financës të marrë masat e nevojshme për likuidimin e plotë të detyrimit ndaj shtetasit K.Ll, me qëllim eliminimin e detyrimeve të prapambetura të institucionet ndaj palëve të treta.

### **Brenda vitit 2023**

**3.2.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimin e shtetasit K.Ll, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjes së mësipërme pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

### **Në vijimësi**

## **B.2 MASA PËR ARKËTIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i debitorëve të Bashkisë Fushë Arrëz, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh në vlerën 18,441,055 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz dhe vlera 1,059,385 lekë është krijuar brenda vitit 2021.

Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Fushë Arrëz, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, është mjaftuar vetëm me njoftimin e subjekteve debitore dhe nuk ka kryer asnjë procedurë tjetër, për të vërtetuar nëse këto subjekte operojnë ose jo. Nuk është kërkuar kallëzim penal bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar. Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenit 45 dhe Kreun XI, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Fushë Arrëz, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën 18,441,055 lekë, si më poshtë vijon:

h- T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.

i- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).

j- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar.

k- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, si dhe të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilat nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

#### **Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se në Bashkinë Fushë Arrëz në fund të vitit ushtrimor 2021, ushtrojnë aktivitetin 4 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 3 subjekte nuk janë pajisur me autorizim 5 vjeçar, të cilët nuk kanë paguar detyrimet në vlerë 3,000,000 lekë, vlerë që konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz, ndërsa 1 subjekt është pajisur me autorizim 1 vjeçar, i cili ka paguar detyrimet në vlerë 200,000 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1, shkronja “b”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1.Rekomandimi:** Drejtoria e shërbimeve publike në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative në të gjitha shkallët e gjyqimit, për arkëtimin e tarifës prej 3,000,000 lekë ndaj 3 subjekteve, sipas listës së subjekteve në Kapitullin “Anekse-Aneksi nr.2” të raportit përfundimtar të auditimit.

#### **Brenda datës 30.03.2023**

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Fushë Arrëz me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe Sektori Juridik, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Fushë Arrëz, përlllogaritje e gabuar e tarifave, mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e qirave, etj), veprime dhe moveprime të cilat kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz në vlerën 53,839 mijë lekë.

-Gjithashtu në 1 rast, është konstatuar se është lidhur kontratë qiraje në tejkalim të kompetencës ligjore që përcakton kuadri rregullator i fushës, respektivisht “Amendimi i kontratë së qirasë nr.2718 prot, datë 07.11.2017 me qiramarrësin shoqëria "A 2014" Sh.P.K përfaqësuar nga administratori z. A.GJ, duke rritur sipërfaqen sipas nenit 4 të kontratës, në kundërshtim me procedurat ligjore. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Nenet 83, 154, 296, 663 dhe 678 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Neni 35 në Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Pika 11 në nenin 2 në Kreun I në Ligjin nr.8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010; Pikat 5 dhe 6 në Kreun I, shkronja “c” në pikën 15, pika 4 në Kreun II, si dhe shkronja “c” në pikën 1 në Kreun III në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të analizojë sitatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 53,839 mijë lekë, ndaj subjekteve si më poshtë vijon:

V.A – 300,000 lekë;

E & P – 1,228,716 lekë;

A 2014 – 15,479,198 lekë;

N.S.E – 24,401,188 lekë;

A – 4,017,138 lekë;

Q 1 – 2,361,810 lekë;

O – 6,051,394 lekë.

**3.2.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Sektori Juridik, në kushtet e konstatimit të mungesës së kompetencës lëndore për procesin e zhvillimit të procedurës dhe lidhjes së kontratës, të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për shpalljen absolutisht të pavlefshme të amendimit të kontratës së qirasë nr.2718 prot, datë 07.11.2017 me qiramarrësin shoqëria "A 2014" Sh.P.K.

**Menjëherë**

## V.ANEKSE

### **Aneksi nr.1 – Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin trajtuar nga faqja nr.16 deri në faqen nr.18 të raportit përfundimtar të auditimit.**

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

#### **I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:**

**Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.**

-Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

- Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

- Për vitin 2021 ka qenë në fuqi Rregullore e Brendshme miratuar me Vendimin nr. 1797/1, datë 26.07.2017 të Kryetarit të Bashkisë. Nuk ka urdhër të titullarit për njohjen dhe trajnimin e stafit me ndryshimet në rregullore. Nuk është miratuar Kodi i Etikës, por rregullat mbi etikën përshkruhen në rregulloren e brendshme, neni 13, Kreu III.

-Nga institucioni nuk ka program trajnimi të dedikuar për integritetin dhe sjelljen etike.

-Në Rregulloren e Brendshme është përcaktuar procedura e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, si dhe janë përcaktuar detyrat për njësinë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, procedura të mirëfillta për trajtimin e rasteve të tilla. Ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës.

-Aktualisht faqja e institucionit është jashtë funksionit, me qëllim verifikimin nëse është publikuar numri i telefonit, email-i personit përgjegjës për sinjalizimin.

-Nuk dokumentohet procedura e ndjekur për komunikimin dhe njohjen e stafit të Bashkisë Fushë Arrëz për ndryshimet ligjore të ndodhura në fusha të ndryshme.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Marrdhënieve me Publikun), duke i'u adresuar strukturave të Bashkisë sipas problemeve, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga Drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën.

- Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrdhëniet e punës me Kod Pune. Për vitin 2021 janë kryer vlerësimet e punonjësve.

**Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje”.**

- Për vitin 2021 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit, nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

- Për vitin 2021, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar çdo 4 - muaj, si dhe ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Ndërsa nga shoqëritë e përbashkëta, ku bashkia është aksionere dhe nga struktura në varësi të saj, Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt argumentimi të fondeve të alokuara.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit.
- Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

**Në lidhje me parimin 3** “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se rregullorja e brendshme nuk është përditësuar pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar struktura e Bashkisë Fushë Arrëz, ç’ka ndikon negativisht në linja të qarta raportimi, komunikimi dhe llogaridhënie.

-Në rregulloren e brendshme, por edhe me urdhër të titullarit, nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të bashkisë, konkretisht sektori i menaxhimit të kontratave me sektorin e taksave dhe tarifave vendore, me qëllim shkëmbimin e informacionit sa kontrata për punë publike janë lidhur, subjektet, si dhe nëse këta të fundit janë me seli kryesore në Bashkinë Fushë Arrëz apo duhet të pajisen me NIPT sekondar, duke vijuar me tarifimin e tyre nga sektori i taksave dhe tarifave. Kjo mangësi evidentohet edhe në mungesën e komunikimit ndërmjet sektorit të urbanistikës dhe sektorit të taksave dhe tarifave vendore, me qëllim shkëmbimin e informacionit për subjektet të cilat janë pajisur me leje për kryerjen e punimeve ndërtimore dhe që duhet të pajisen me NIPT sekondar, për të ushtruar aktivitetet në Bashkinë Fushë Arrëz.

-Lidhur me strukturën organizative të Bashkisë Fushë Arrëz, ndërmarrjes dhe institucioneve në varësi, përgjatë vitit 2021 nuk ka pasur ndryshime. Struktura e Bashkisë Fushë Arrëz për vitin 2021 është miratuar me VKB nr.48, datë 23.12.2020 dhe Urdhrit nr.371, datë 17.12.2020.

-Mungon raporti i vlerësimit nga njëësia e auditit të brendshëm për përputhjen e rregullores me strukturën organike.

- Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, por është bërë pjesë e dokumentit e PBA-ve, si dhe nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme.

Për çdo drejtori janë përcaktuar objektet, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist.

**Në lidhje me parimin 4** “Njëësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”.

- Në Bashkinë Fushë Arrëz nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme, por vetëm nga trajnimet e zhvilluara nga ASPA.

- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si përgjegjës i sektorit të financës.

**Në lidhje me parimin 5** “Njëësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.

-Në Rregulloren e Brendshme është parashikuar “Delegimi i kompetencave” në zbatim të ligjit 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative” si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokollin e institucionit rezulton se, nga NA për periudhën objekt auditimi ka patur raste të delegimit të detyrave me Urdhër nr.226 dhe 226/1 datë 15.07.2021.

- *Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).*

Në zbatim të nenit nr. 24 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar; ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për proçedurat standarte për përgatitjen e PBA të njëësive të Qeverisjes Vendore”, për buxhetin e vitit 2021 dhe përgatitjen e PBA 2021-2023 nuk dokumentohet ngritja dhe funksionimi i GMS. Në dosjen përkatëse administrohet Urdhri nr.69, datë 17.02.2021 “Për ngritjen e GMS dhe EMP në Bashkinë Fushë Arrëz”.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupi të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se:

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.
- Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

## **II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”.**

**Në lidhje me parimin 6:** Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

-Nga Bashkia Fushë Arrëz përcaktohen objektiva sasior. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar), sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr.68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

-Aktualisht faqja e institucionit është jashtë funksionit, me qëllim verifikimin nëse janë publikuar objektivat e performancës.

**Në lidhje me parimin 7:** “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

-Nuk janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut.

-Në Bashkinë Fushë Arrëz nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut.

-Në Bashkinë Fushë Arrëz nuk është krijuar regjistri i riskut.

-Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Mbetet problematike menaxhimi i riskut, pasi nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës dhe mbi bazën e proceseve të punës të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eliminimin e plotë të tij.

-Nuk dokumentohen takimet periodike (1 herë në dy muaj) të Koordinatorit të Riskut me drejtorat e drejtorive përkatëse të institucionit.

-Në Bashkinë Fushë Arrëz, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

**Në lidhje me parimin 8:** “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.

-Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

**Në lidhje me parimin 9:** “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

Bashkia Fushë Arrëz nuk ka një sistem të kontrollit të brendshëm.

## **III. Komponenti: “ Aktivitetet e Kontrollit”**

**Në lidhje me parimin 10:** “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, si procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet



nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës, hartimi dhe rregjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.

-Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimve/shërbimeve.

-Për çdo vit buxhetor hartohet rregjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj.

- Në rregulloren e brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur rregjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

- Në përgjithësi për procedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës si: Urdhri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi si dhe për asgjësimin e tyre. Ekzistojnë fletët e inventarit, relacioni i vlerësimit për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, procesverbale dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe procesverbalet për asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe kryer veprimet kontabël përkatës.

-Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Fushë Arrëz, si dhe veprimeve me arkën, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave (taksat e ndara) arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë kontabilizuar.

-Bashkia Fushë Arrëz në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

**Në lidhje me parimin 11:** “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

- Bashkia Fushë Arrëz nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

-Në rregulloren e brendshme nuk përcaktohen detyrat e specialistit të IT.

-Në Bashkinë Fushë Arrëz nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

-Në strukturën e Bashkisë Fushë Arrëz është vetëm 1 specialist IT, duke sjellë që i njëjti person të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI-së.

**Në lidhje me parimin 12:** “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

- Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, kjo evidentuar nga lista e projekteve në PBA 2021-2023, të cilët nuk i nënshtrohen një analize kosto-përfitim.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditareve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga përgjegjësi i sektorit. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e sektorit të financës.

- Nuk ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.08.2018 “Për hartimin e PF”, i ndryshuar). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

#### **IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”**

**Në lidhje me parimin 13:** “Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

-Sipas komunikimit me personat përkatës në Bashkinë Fushë Arrëz dhe verifikimit të grupit të auditimit, faqja e bashkisë është jashtë funksionit, pra nuk sigurohet transparenca e institucionit dhe e drejta për informim.

Për vitin 2021 nga Bashkia Fushë Arrëz (për vendimmarrje për dhënien e pasurive të paluajtshme me qira, buxhetin) nuk janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit. Nga sektori i financës u vendos në dispozicion linku<sup>55</sup>, por nuk evidentohet nëse janë zhvilluar konsultime, marrje mendimesh nga palët e interesit etj.

**Në lidhje me parimin 14:** Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor.

**Në lidhje me parimin 15:** Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit. Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale/email. Grupi auditues konstaton se, nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të email-it zyrtar të institucionit duke qenë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.

#### **V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”**

**Në lidhje me parimin 16:** “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

- Proçedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, administrohen raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

-Bashkia Fushë Arrëz lidhur me pyetësin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë për vitin 2021 ka raportuar në MFE.

-Ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

**Në lidhje me parimin 17:** “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

<sup>55</sup>[https://public.tableau.com/vieës/Planning\\_Dashboard\\_FusheArrez/Menu?:language=en&:display\\_count=y&publish=yes&:origin=viz\\_share\\_link](https://public.tableau.com/vieës/Planning_Dashboard_FusheArrez/Menu?:language=en&:display_count=y&publish=yes&:origin=viz_share_link).

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetsorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

## Aneksi nr.2 – Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit trajtuar nga faqja nr.23 deri në faqen nr.52 të raportit përfundimtar të auditimit.

Lista e investimeve të reja parashikuar në buxhetin vjetor të vitit 2021 nga të ardhurat e veta dhe granti.

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi i investimit	Nr dhe data e VKB	Burimi financimit	Vlera e miratuar në VKB	Vlera e realizuar e investimit (me TVSh)
1	Rikonstruksion mure mbajtëse Fushe Arrez U shpk UB 6403 kod 1550069	22, date 21.5.2021	Të ardhurat e veta	4,625,000	4,220,784
2	Hapje rruge Strame Aprripe guri S Al, kod projekti 1550070, Ub 6447.fature 2200 date 11.8.2021	22, date 21.5.2021	Të ardhurat e veta	2,400,000	2,399,682
3	Kolaudim Hapje rruge re auto 1550073	22, date 21.5.2021	Të ardhurat e veta	6,000	5,760
4	Super vizim Hapje rruge re auto	22, date 21.5.2021	Të ardhurat e veta	60,000	49,574
5	Hapje segmenti lidhes rruga auto Dardhe A shpk, kod projekti 1550083.	22, date 21.5.2021	Të ardhurat e veta	450,000	401,304
6	Sistemim asfaltim dhe ndriçim i rrugës auto lagja e vjetër në Qytetin Fushë Arrëz + supervizim dhe kolaudim (Shtese kontrate).	22, date 21.5.2021	Të ardhurat e veta	722,000	
7	Ndërtim I shpatullave te urave auto lagja Koprati(Iballe)+fshati Micoj	22, date 21.5.2021	Të ardhurat e veta	3,200,000	3,136,336
8	Kolaudim I ujësjiellësit Gere-Qendër Fshati Iballë	22, date 21.5.2021	Të ardhurat e veta	18,000	
9	kolaudim Shtese pedonale dhe Lulishte , kod projekti 1550045, Ub 6447 R 95 shpk fature nr. 6 date 21.8.2021	22, date 21.5.2021	Të ardhurat e veta	1,300,000	26,400
	<b>Total të ardhurat e veta</b>			<b>12,781,000</b>	<b>10,239,840</b>
			<b>Granti</b>		
1	Projekti Godina e Njesisë Blerim , N studio shpk ub 1550078	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	200,000	
2	Ndërtim i Godinës se Njesisë Administrative Blerim	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	5,650,000	
3	Shërbim supervizioni: Godina e Njesisë Administrative Blerim	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	80,000	827,280
4	Shërbim kolaudimi: Godina e Njesisë Administrative Blerim	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	10,000	937,000
5	Riparim I pjesshëm I pallatit 79 A shpk, kod projekti 1550087	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	840,000	398,330
6	Supervizim shkolla e mesme 70 vjetori I pavarësisë	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	937,000	41,474
7	Riparim qsh arstmiliska A shpk, kod projekti 1550082.	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	530,000	184,000
8	kolaudim Rikonstruksion mure mbajtëse Fushe Arrez M studio shpk kod 1550075	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	81,000	998,912
9	Mbikëqyrje Ndërtim I mureve mbajtëse te pallate 1550074	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	540,000	52,494
10	Rikonstruksione te pjesshme ne objekte shërbimi ne fshatra(mulli bloje) kod 1550088 A	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	1,000,000	87,126
11	Sistemim asfaltim dhe ndriçim i rrugës auto lagja e vjetër në Qytetin Fushë Arrëz + supervizim dhe kolaudim.	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	53,000	178,512
12	Supërvizimin e objektit “Sistemim Asfaltim Ndriçim i rrugës lidhëse pallati Demokracia”	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	105,000	235,872
13	Riparim I pjesshëm Ura Shpoz A shpk, kod projekti 1550090.fature 7 date 19.10.2021	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	180,000	150,000
14	Riparim I pjesshëm rruga auto Lumardh A shpk, kod projekti 1550091.fature 6 date 19.10.2021	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	250,000	
15	Riparim Ura pasarele Fshat Flet A shpk, kod projekti 1550089.	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	160,000	
16	Ndërtim bazamente te urave auto lagje Koprati,Fshati Iballë dhe Fshati Micoj + supervizim dhe kolaudim.	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	663,000	36,000
17	Vendosje te shtesave te urave auto lagja Koprati(Iballe)+fshati Micoj	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	2,320,000	
18	Shtesë në pedonale dhe Lulishte në Qytetin Fushë Arrëz, + supervizim dhe kolaudim.	22, date 21.5.2021	Transferata e pakushtëzuar	87,000	
	<b>Total nga granti</b>			<b>13,686,000</b>	<b>4,319,000</b>

Burimi: Drejtoria e financës

Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit për vitin 2021 sipas VKB përkatëse

Në 000 lekë

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2021				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2021			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr.50, datë 23.12.2022	Buxheti shtesë miratuar me VKB nr.22, datë 21.5.2021	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr.50, datë 23.12.2022	Buxheti shtesë miratuar me VKB nr.22, datë 21.5.2021	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	1	2	1+2		3	4	3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2021	29,427		29,427	Art. 600 Paga	97,442	13,823	111,265
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2021		22,395	22,395	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	15,690	2,588	18,278
<b>Total të ardhurat e veta</b>	<b>29,427</b>	<b>22,395</b>	<b>51,822</b>	Art.602 Shpenzime operative	13,472	15,893	29,365
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar		15,774	15,774	Art.604 Transferime korrente të brendshme	100		100
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike		20,602	20,602	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	96,785		96,785
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2021	79,240		79,240	Art. 230-231 Investime		14,559	14,559
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2021	79,171		79,171	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)			
<b>Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit</b>	<b>158,411</b>	<b>36,376</b>	<b>194,787</b>				
<b>TOTALI TE ARDHURAVE</b>	<b>187,838</b>	<b>58,771</b>	<b>246,609</b>	<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>	<b>223,489</b>	<b>46,863</b>	<b>270,352</b>

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2021 jepen në tabelat në vijim:

Kodi i detyrimit të prapamb.	Emerimi i detyrimit të prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2020	Vlera e paguar gjatë vitit 2021 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2021 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2021)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2021 (situata më 31.12.2021)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur pa më 31.12.2021
1	2	3	4	5=3-4	6	7=5+6
4864100	Detyrim per pagese furnizimi me tuba vaditje	1,156,787		1,156,787		1,156,787
4864100	Detyrime per heqje kioske ne menyre te palighshme	729,200		729,200		729,200
4864100	Detyrime per pagese shtese te verberit	2,433,423	2,433,423			
4864100	Detyrime per fatura telefonike	222,658		222,658		222,658
4864100	Detyrime per largim nga puna	374,202	70,000	304,202		304,202
4864100	Detyrime per largim nga puna	1,496,320	100,000	1,396,320		1,396,320
4864100	Detyrime per largim nga puna	671,552	30,000	641,552		641,552
4864100	Detyrime per largim nga puna	933,128		933,128		933,128
4864100	Detyrime per largim nga puna				342,360	342,360
4864100	Detyrime per largim nga puna				196,000	196,000
4864400	Rikonstruksion shkolla Iballe	194,055		194,055		194,055
4864400	Ndertim palestere dhe ambjente sportive	237,445		237,445		237,445
4864400	Rikonstruksion I Shkolles se mesme Fushe Arrez,	144,624		144,624		144,624
4864400	Investime ne Rikonstruksionin e ujesjellesit,	2,280,502		2,280,502		2,280,502
	<b>Totali</b>					
	Detyrim nga Minsistrie e linjes	2,856,626		2,856,626		2,856,626
	Detyrime ne total	<b>10,873,896</b>	<b>2,633,423</b>	<b>8,240,473</b>	<b>538,360</b>	<b>8,778,833</b>

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2021 për mallrat dhe shërbimet (Nga granti)

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2021	Shtesat gjate periudhës dhjetor 2021	Shlyerjet gjatë vitit 2021	Vlera e detyrimit me 31.12.2021
1	Fature energji elektrike	OSHEE		21, date 31.12.2021	341,136	341,136		341,136
2	Fature Uji	Ujesjelles sha		2, date 7.1.2022	109,296	109,296		109,296
3	Fature poste	Posta shqiptare		2105, date 5.1.2022	15,640	15,640		15,640
	<b>Totali i detyrimit</b>				<b>466,072</b>	<b>466,072</b>		<b>466,072</b>

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

Të paraqitet në mënyrë analitike lista e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likuidimet e kryera prej saj për dëmshpërblim page, për punonjësit e larguar nga puna.

Në lekë

Nr	Emri i kreditorit	Vendim Gjykatë nr. datë	Objekti i Vendimit	Vlera e detyrimit sipas Vendimit te Gjykatës	Gjendja e palikujduara	Vendime të ardhura gjatë vitit 2021		Detyrimi total	Likujduar	Gjendja e palikujduarar më 31.12.2021
						Nr dhe data e vendimit	Vlera e vendimit			
0	1	2	3	4	5	6	7	8=5+7	9	10=8-9
1	K.P	52-2017-471114, 30.10.17	Demshperblim page	584,202	374,202			374,202	70,000	304,202
2	K.LL	302 dt.26.4.2016	Demshperblim page	1,706,320	1,496,320			1,496,320	100,000	1,396,320
3	L.GJ	52-2017-447(99), 11.10.2017	Demshperblim page	671,552	671,552			671,552	30,000	641,552
4	M.T	52-2018-256(57), 26.8.2018	Demshperblim page	933,128	933,128			933,128		933,128
5	E.C		Demshperblim page			52-2021-47, date 22.2.2021	342,360	342,360		342,360
6	A.S		Demshperblim page			131, date 25.2.2021	196,000	196,000		196,000
	Totali i dëmshpërblim page			3,895,202			538,360	4,013,562	200,000	3,813,562

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

**Aneksi nr.3 – Mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave trajtuar nga faqja nr.23 deri në faqen nr.52 të raportit përfundimtar të auditimit.**

### Struktura e Sektorit të Tatim Taksave për vitin 2021

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Date fillimi	Ndryshimi gjatë 2021 nëse ka pasur
1	A.D	P. e Sektorit Tatim-Taks	18.12.2019	Larguar nga pozicioni date 18.05.2021
2	V.P	P. e Sektorit Tatim-Taks	25.05.2021	Defenitive
3	GJ.N	Specialist i Tatim-Taksav	08.04.2019	Larguar date 05.01.2022 (pension)
4	B.M	Inspektor Tatim-Taksa	09.11.2015	Defenitive
5	O.T	Specialist Tatim-Taksa	09.08.2021	Defenitive

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

### Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2021

në 000/lekë:

Nr.	Emërtimi	Realizimi		
		Plan	Fakt	%
1	Tatim mbi te ardhurat personale	-	2.069	-
2	Tatim I thjeshtuar mbi fitimin	-	37	-
3	Taksa Bujqesore	620	89	14
4	Takse Ndertese	6.813	2.589	38
5	Takse Trualli	412	466	113
6	Takse vjetore qarkullimi mjeteve te perdorura	1.300	1.990	153
7	Takse zenie te hapesires publike	210	148	70
8	Takse ndikimi ne infrastrukture	600	415	69
9	Takse ndriqimi	380	233	61
10	Tarife per shfrytezimin e lendes drusore	3.100	145	5
11	Tarife licence karburanti	-	200	-
12	Tarife leje ndertimi	-	480	-
13	Qira troje	6.500	2.448	38
14	Tarife leje transporti	400	366	92
15	Takes pastrimi	4.000	1.730	43
16	Te ardhurat nga kopshtet e femijeve	410	313	76
17	Te ardhura nga çerdhet	210	231	110
18	Te ardhura nga parkingu	206	9	4
19	Te ardhura nga sherbimi MNZ	-	4	-

Nr.	Emërtimi			
		Plan	Fakt	%
20	Gjoha te policise se ndertimit	-	200	-
21	Sponsorizime nga organizata jo qeveritare	972	873	90
22	Takse nga renta minerare	3.273	-	-
23	Takse fjetje ne hotel	21	-	-
24	Takse therje bagetish	-	-	-
<b>TOTALI I + II :</b>		<b>29.427</b>	<b>15.035</b>	<b>51</b>

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

Për subjektet të tregtimit të karburanteve, detyrimet, arkëtimet dhe vlera e tarifës së pa likuiduar, të cilat nuk janë pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë që nuk ka likuiduar tarifën e licencimit/autorizimit”

NR	Emërtimi i Subjektit	Data e fillimit të Aktivitetit	Afati i përdorimit të licencës		Periudha e shfrytëzimit të Aktivitetit	Pagesa sipas VKM nr.344, dt. 19.04.2017	Diferenca për pagesë
						Stac Shitje	
1	K OIL SHPK	4/16/2013	07.01.2021 -	06.01.2022	9 vjet	1,000,000	
2	L SHPK	11/15/2011	19.04.2017	18.04.2022	11 vjet	1,000,000	1,000,000
3	D SHPK	17/02/2009	19.04.2017	18.04.2022	13 vjet	1,000,000	1,000,000
4	V T OIL SHPK	1/23/2015	19.04.2017	18.04.2022	7 vjet	1,000,000	1,000,000
						<b>3,000,000</b>	

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

Në mënyrë të detajuar pasqyrohen në pasqyrën subjektet të cilat rezultojnë aktiv ndaj të cilëve nuk janë aplikuar taksa dhe tarifa vendore.

Nr	Nipti	Data e Fillimit	Statusi	Emri Rruges
1	K	5/1/2000	Aktiv	Lagjia Marinaj, prane Shkolles 9-vjecare Qafe-Mali
2	L	5/13/2010	Aktiv	IBALLE, PUKE
3	L	1/30/2012	Aktiv	Kamion Mercedes Benz, targe AA, Tuç, Qafe-Mali, Bashkia Fushe-Arrez
4	L	3/21/2012	Aktiv	Ne hyrje te qytetit Fushe-Arrez
5	L	3/23/2012	Aktiv	Lagjia Nushaj, Prane Fabrikes te Pasurimit te Bakrit
6	L	3/26/2012	Aktiv	Kamion Mercedes Benz, targe AA
7	L	4/4/2013	Aktiv	Kamion Mercedes Benz, targe AA
8	L	9/17/2013	Aktiv	Kamion Mercedes Benz, targe AA
9	L	6/5/2014	Aktiv	RRUGA:DEMOKRACIA,ISH ZDRUKHTARIA KATI 2,FUSHE ARREZ
10	L	2/24/2015	Aktiv	Lagje Marinaj prane shkolles 9-te vjecare, Qafe Mali, Puke, Zona kadastrale 3074, me numer pasurie 1102
11	L	10/28/2015	Aktiv	Lagja Skvine, Fshati Berishe e Vogel, Numer Pasurie 630, Zona Kadastrale 1162, Njesia Administrative Iballë
12	L	6/29/2016	Aktiv	FIERZE,PUKE
13	L	8/2/2017	Aktiv	NJESIA ADMINISTRATIVE BUGJON
14	L	1/3/2019	Aktiv	FSHATI DARDHE,BLERIM
15	L	4/23/2019	Aktiv	Bashkia Fushe-Arrez,Fshati Kryezi
16	M	3/19/2021	Aktiv	Rruga "Qender Qyteti", Pallati "Demokracia", Apartamenti Kati i III.

Burimi: Zyra e tatim taksave ripunuar nga grupi

## Regjistri i lejeve Minerare Aktive nëntor 2022

Emri i subjektit	Lloji i Mineralit	S=km2
E Shpk	Krom	0.02
B sh.a	Bakër	2.98
R.M SHPK (nenkontraktor B	Bakër	2.64
O. shpk	Krom	0.088
R.M SHPK (nenkontraktor B	Bakër	0.78
B Sh.a	Bakër	0.884
B Sh.a	Bakër	0.55
B Sh.a	Bakër	3.18
B Sh.a	Ndërtimor efuziv	0.067
K shpk	Krom	0.286

Burimi: Faqe zyrtare e AKBN

**Observacionet për administrimin e të ardhurave nga taksat, tarifatat dhe kontratat e qirave.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 858/8 prot datë 11.01.2023, si më poshtë:

**Pretendimi i Subjektit:**

Në lidhje me **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatat e tyre** ju informojmë se:

1.Në bazë të Rregullores së miratuar nga kryetari i Bashkisë “Për Organizimin, Funkcionimin, Detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Fushë-Arrëz” pikërisht neni 22 “Policia Bashkiake”, 22/4 “Detyrime të Përgjithshme” pika 22 përcakton saktë se Policia Bashkiake ka për detyrë të inspektojë dhe verifikojë pajisjen me liçence të tregtareve dhe personave që merren me veprimtari shitblerje të lendeve djegëse.

2.Nenit 29 “Tatim Taksat”, 29/2 “Specialisti i Tatim Taksave”, pika 31 e përcakton saktë se Specialisti i tatim taksave mban përgjegjësi për plotësimin korrekt të certifikatave e licencave të lëshuara.

Për sa i përket përlllogaritjes se vlerës së licencës për subjektin e tregtimit të karburantit K OIL SHPK, Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Fushë-Arrëz pas kërkesës së bërë nga Subjekti në fjalë ka bërë të mundur pajisjen me licencën përkatëse, ku theksojmë se përlllogaritja e vlerës që subjekti duhet të paguaj pranë Bashkisë Fushë-Arrëz për pajisjen me Licencë të tregtimit me pakicë bëhet nga sektori i Tatim Taksave.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Lidhur me observacionin e mësipërm, sqarojmë se, grupi i auditimit ka të njëjtin qëndrim me atë të mbajtur për observacionet e bëra për akt-konstatimin.

**Aneksi nr.4 – Mbi hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare trajtuar nga faqja nr.52 deri në faqen nr.65 të raportit përfundimtar të auditimit.**

**Llogaria analitike nr.486**

Objekti	Detyrimet në fund të vitit 2020	Shtuar	Pakësuar	Detyrimet në fund të vitit 2021
Vendim Gjykate për sherbime	1,156,787			1,156,787
Vendim Gjykate për sherbime	729,200			729,200
Vendim Gjykate për sherbime	222,658			222,658
Vendim Gjykate për paga nga largimet nga puna	2,433,423		2,433,423	-
Vendim Gjykate për paga nga largimet nga puna	374,202		70,000	304,202
Vendim Gjykate për paga nga largimet nga puna	1,496,320		100,000	1,396,320
Vendim Gjykate për paga nga largimet nga puna	671,552		30,000	641,552
Vendim Gjykate për paga nga largimet nga puna	933,128			933,128
Vendim Gjykate për paga nga largimet nga puna		342,360		342,360
Vendim Gjykate për paga nga largimet nga puna		196,000		196,000
Investime në rikonstruksionin e ujesjellesit	2,280,502			2,280,502
Rikonstruksion i shkollës Iballë	194,055			194,055
Ndërtim palestere dhe ambiente sportive	237,445			237,445
Rikonstruksion i shkollës së mesme	144,624			144,624
<b>TOTAL</b>	<b>10,873,896</b>	<b>538,360</b>	<b>2,633,423</b>	<b>8,778,833</b>

Në mënyrë analitike, garancitë të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes, si dhe objekti për të cilën është mbajtur kjo garanci ka përfunduar, paraqiten si më poshtë:

Nr	Emertimi	Vlera
1	Ndërtim I rrjetit të ujësjellësit Krrab-Fushë Arrëz	293,122
2	Ndërtim Shkolla 9 vjeçare Mzi	725,669
3	Rikonstruksion uëjsjellsi Buxhon	100
4	Pyllzime me drurë frutor	101,965
5	Rikonstruksion rruga Mzi	91,571
6	Ndërtim Shkolla 9 vjeçare Mzi	500,818
7	Ndërtim Shkolla 9 vjeçare Mzi	204,827
8	Rikonstruksion Ujësjellsi Kash Berishë vogël	53,510
9	Rikonstruksion Ujësjellsi Kash Berishë vogël	44,538
10	Rikonstruksion Ujësjellsi Kash Berishë vogël	4,597
11	Rikonstruksion Ujësjellsi Kash Berishë vogël	124,794
12	Rikonstruksion godina e komunës Blerim	12,357
13	Rikonstruksion rruga Dardhe	59,400
14	Ndërim ura tip beli Kryezi	240,000

15	Efiçenca e energjië në pallatin 5-katësh në bashkpronësi	273,064
16	Rikonstruksion sheshi dhe fasada pallatesh" UB 5810	10,888
17	Zgjerim dhe rrethim varreza Fashti Dardhe S al shpk,UB 6177	171,914
18	Vendosje kamera sigurie në ambiente publike dhe Institucione në varësi	121,934
19	Blerje Kamioni O shpk , UB6180	149,400
20	Sistemim asfaltim rruge lagje Fushaxhi UB 5996	301,640
21	Ndërtim I rrjetit të brendshëm të ujësjellësit dhe depove ekzistuese UB 5811	295,575
22	Rikonstruksioni ndricimit qytet S al UB6235	49,865
23	Sistemim asfaltim rruge lagje e vjeter P G UB6259	184,634
24	Ndërtim Shkolla Fierze V N is UB 6237	1,455,750
25	Shtese pedonale P G UB6256	345,567
26	Rikonstruksion Catia e pyjores D 1	37,496
27	Sistemim asfaltim dhe ndriçim i rrugës auto lagjia e vjetër	2,625
28	Ndërtim i shpatullave te urave auto lagjia Koprati(Iballe)+fshati Micoj	156,817
29	Shtesë në pedonale dhe Lulishte në Qytetin Fushë Arrëz	1,800

### Llogaria 231 në fund të vitit 2021

Nr	Emertimi	Celja	Kreditim	Debitim	Mbetja
1	Ndërtim Shkolla 9 vjeçare Mzi	28,626,277			28,626,277
2	Pyllzime me drurë frutor	407,654			407,654
3	Rikonstruksion rruga Mzi	3,871,437			3,871,437
4	Rikonstruksion Ujësjiellsi Kash Berishë vogël	4,548,788			4,548,788
5	Rikonstruksion rruga Dardhe	3,641,241			3,641,241
6	Efiçenca e energjië në pallatin 5-katësh në bashkpronësi	5,514,070			5,514,070
7	Rikonstruksion Gjinnazi Fushe Arrez	60,730,214		60,730,214	
8	Rikonstruksion shkolla iballe	18,811,394		18,811,394	
9	Zgjerim dhe rrethim varreza Fashti Dardhe	3,438,274.00			3,438,274.00
10	Kanele vaditese Njesia Fierze	1758324		1,758,324	
11	Vendosje kamera sigurie	2,438,688.00			2,438,688.00
12	Blerje Kamioni	2,988,000.00			2,988,000.00
13	Rikonstruksioni ndricimit	997,290.00			997,290.00
14	Sistemim asfaltim rruge lagje e vjeter	3,692,678.00			3,692,678.00
15	Ndërtim Shkolla Fierze	29,115,000.00			29,115,000.00
16	Ndërtim Ura koprati dhe micoj	3608520		3,608,520	
17	Shtese pedonale	6,911,340.00			6,911,340.00
18	Kanele vaditese Njesia Fierze	2233482		2,233,482	
19	Ndërtim palestere te shkolla mesme	42,149,202.00			42,149,202.00
20	Rikonstruksion I kanalit Iballe	29,749,673.00			29,749,673.00
21	Rikonstruksion Kanali Fushaxhi	3971486		3,971,486	
22	Rikonstruksion i çatisë së godinës së Ish Drejtorisë pyjore	749,911.00			749,911.00
23	Rikonstruksion mure mbajtese Fushe Arrez	9,235,356.00			9,235,356.00
24	Rikonstruksion Shkolla Fierze	3,226,068.00			3,226,068.00
25	Shkolla Iballe	2107780		2,107,780	
26	Rikonstruksion Shkolla mesme Fushe Arrez	6766853		6,766,853	
27	Supervizim + Kolaudim ne shkollat iballe,Fierze,Fushe Arrez	825,002.00			825,002.00
28	Supervizim+kolaudim per objektin Ndërtim I Palestres dhe ambienteve sportive Shkolla 70 vjetori I pavartesisë	478,693.00			478,693.00
29	Ndërtim palestere te shkolla mesme P.G UB6268	4,710,461.00			4710461
30	Riparim I pjesshem I pallatit 79 A shpk, kod projekti 1550087,fature 9 date 2.11.2021 .		827,280.00		827,280.00
31	supervizim shkolla e mesme 70 vjetori I pavarisise A studio 1550044,fature nr.21 date 3.8.2021		937,000	937,000	
32	Riparim qsh arstmiliska A shpk, kod projekti 1550082. fature 8 date 2.11.2021		398,330.00		398,330.00
33	Rikonstruksion mure mbajtese Fushe Arrez U shpk Fat. 53 dt. 09.11.2021 UB 6403 kod 1550069		4,220,784.00		4,220,784.00
34	kolaudim Rikonstruksion mure mbajtese Fushe Arrez M studio shpk Fat. 66 dt. 16.11.2021 kod 1550075		41,474.00		41,474.00
35	Mbikqyrje Ndërtim I mureve mbajtese te pallate 1550074		184,000.00		184,000.00
36	Rikonstruksione te pjesshme ne objekte sherbimi ne fshatra(mulli bloje) kod 1550088 A		998,912.00		998,912.00
37	Hapje rruge Strame Aprripe guri S AI, kod projekti 1550070, Ub 6447.fature 2200 date 11.8.2021		2,399,682.00		2,399,682.00
38	Kolaudim Hapje rruge re auto 1550073		5,760.00		5,760.00
39	Supervizim Hapje rruge re auto		49,574.00		49,574.00
40	Sistemim asfaltim dhe ndriçim i rrugës auto lagjia e vjetër në Qytetin Fushë Arrëz + supervizim dhe kolaudim P.G.		52,494.00		52,494.00
41	Hapje segmenti lidhes rruga auto Dardhe A shpk, kod projekti 1550083.fature 10 date 2.11.2021		401,304.00		401,304.00
42	Supërvizimin e objektit "Sistemim Asfaltim Ndriçim i rrugës lidhëse pallati Demokracia"		87,126.00		87,126.00
43	Riparim I pjesshem Ura Shpoz A shpk, kod projekti 1550090.fature 7 date 19.10.2021		178,512.00		178,512.00
44	Riparim I pjesshem rruga auto Lumardh A shpk, kod projekti 1550091.fature 6 date 19.10.2021		235,872.00		235,872.00
45	Riparim Ura pasarele Fshat Flet A shpk, kod projekti 1550089.fature 14 date 9.11.2021		150,000.00		150,000.00



46	Ndertim i shpatullave te urave auto lagjia Koprat(Iballe)+fshati Micoj N 2014		3,136,336.00		3,136,336.00
47	kolaudim Shtese pedonale dhe Lulishte , kod projekti 1550045, Ub 6447 R. 95 shpk fature nr. 6 date 21.8.2021		26,400.00		26,400.00
48	Shtesë në pedonale dhe Lulishte në Qytetin Fushë Arrëz, + supervizim dhe kolaudim.P.G		36,000.00		36,000.00
<b>TOTAL</b>			<b>287,303,156</b>	<b>14,366,840</b>	<b>100,925,053</b>
					<b>200,744,943</b>

**Aneksi nr.5 – Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm trajtuar nga faqja nr.113 deri në faqen nr.117 të raportit përfundimtar të auditimit.**

***Nga auditimi u konstatua se:***

1. Bashkia Fushë Arrëz nuk ka respektuar afatin prej 20-ditësh për dërgimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**Shkalla e zbatimit:** Ky detyrim ligjor nuk është është zbatuar.

2. Bashkia Fushë Arrëz me shkresën nr.4044 prot., datë 14.10.2022 ka dërguar në KLSH, raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, jashtë afatit prej 6-muajsh, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**Shkalla e zbatimit:** Ky detyrim ligjor nuk është zbatuar në afat.

**3. Analizimi dhe nxjerrja e përgjegjësive në Bashkinë Fushë Arrëz:**

Nga KLSH janë lënë 18 rekomandime gjithsej, nga këto:

9 masa organizative;

3 masa shpërblim dëmi;

5 masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Në numër rekomandimesh: 18 rekomandime të dhëna, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 18 rekomandime, 1 prej tyre është zbatuar ose 6%, 2 zbatuar pjesërisht ose 11%, 1 në proces zbatimi ose 6%, si dhe 13 pa zbatuar ose 72%.

-Në vlerë monetare, sa i përket rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

3 rekomandime për shpërblimin e dëmit të krijuar për 3 subjekte në vlerën 8,271 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht nga subjekti. Nga 3 rekomandime, nuk është zbatuar asnjë prej tyre.

-Janë lënë 5 masa disiplinore, të cilat nuk janë zbatuar.

Të dhënat e mësipërme janë pasqyruar në tabelën bashkëlidhur akt-verifikimit.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si vijon:

**A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa për planifikimin e saktë dhe në përputhje me mundësitë objektive të saj, si dhe për realizimin e të ardhurave vendore, finaciare dhe tjera, në zbatim të paketës fiskale të miratuar në KB të kerkesave ligjore dhe buxhetit të miratuar.

**Në vazhdimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, konkretisht të planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, hartuar nga përgjegjësja e sektorit zj. A. D., miratuar nga z.F.T, përsëri rezulton se nuk ka një planifikim realist të të ardhurave, si rasti i taksës së tokës bujqësore, taksës për pasurinë e paluajtshme ku realizimi i të ardhurave nga taksat e mësipërme në dy vitet e fundit (2019-2020) është gati sa ½ e planifikimit për vitin 2021. Kjo situatë kërkon

që planifikimi i të ardhurave nga këto taksa, por edhe për të tjera taksa dhe tarifa vendore, të bazohet mbi mundësitë reale që ka Bashkia Fushë Arrëz për t'i arkëtuar, duke marrë në konsideratë bazën e taksës (verifikimi në terren, dokumentacioni mbi pronësinë (sipërfaqe, AMTP të dhëna, që administrohet në Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Pukë), numrin e familjeve sipas gjëndjes civile, numrin e familjeve me ndihmë ekonomike, duke krijuar një regjistrer me informacion të plotë dhe të saktë, i cili shërben për maturimin e taksës së ndërtetës, truallit, tokës bujqësore etj.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 nuk është zbatuar.

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Fushë Arrëz të planifikojë në buxhetin e vitit 2022 fonde për likuidimin në radhë të parë të faturave të subjekteve të pa likuiduara në vlerën totale 3,410,092 lekë dhe më pas faturat e radhës të vitit ushtrimor.

**Në vazhdimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Lidhur me rekomandimin e mësipërm, sipas instrumentit të planifikimit financiar, rezulton se është planifikuar për tu likuiduar vlera e detyrimit të prapambetur.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 është zbatuar.

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Fushë Arrëz:

-Të analizojë përgjegjësitë administrative ndaj personave përgjegjës, të cilët kanë larguar në mënyrë të paligjshme 4 ish-punonjësit e bashkisë, sipas vendimeve të gjykatës, pasi kanë shkaktuar efekte negative në buxhet për vlerën 3,995,202 lekë shpenzime gjyqësore.

-Të analizohet dhe të nxirret përgjegjësia për shkaktimin e vlerës 1,003,440 lekë shpenzime përmbartimore, për sanksione nga vonesat në likuidimin e 4 vendimeve gjykatës.

**Në vazhdimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Lidhur me rekomandimin e mësipërm nuk administrohet dokumentacio që të vërtetojë zbatimin e tij.

**Zbatimi:** Rekomandimi 3.1 nuk është zbatuar.

**4.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës, Bashkia Fushë–Arrëz për vitet në vazhdim të implementojë mbajtjen e bilancit në një nga versionet e programeve kompjuterike Alfa 5 (financa 5), në përgjigje të standardeve bashëkohore.

**Në vazhdimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Lidhur me rekomandimin e mësipërm, nuk është planifikuar buxhet për kryerjen e investimit në blerjen e programit kompjuterik të mësipërm, si dhe nuk rezulton që Bashkia Fushë Arrëz të ketë përfituar grant në natyrë nga palë të treta.

**Zbatimi:** Rekomandimi 4.1 nuk është zbatuar.

**5.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës, Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa për sistemimin e llogarisë “debitor të ndryshëm” për vlerën 271,246,057 lekë, konkretisht:

-Të hartojë dhe miratojë program me afate të përcaktuara, për llogarinë “debitor të ndryshëm”, për 23 subjekte fizike e juridike dhe 97 persona për detyrime për taksa e tatime të pashlyera prapambetura si dhe rekomandime të KLSH.

-Të dërgojë nëpërmjet protokollit urdhrat e bllokimit në adresë të bankave të nivelit të dytë për subjektet debitorë.

**Në vazhdimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Lidhur me rekomandimin e mësipërm, nga verifikimi i llogarisë analitike ku pasqyrohen shtesat dhe pakësimet, rezulton se janë kontabilizuar debitorët e ndryshëm. Janë përcjellë pranë sektorit të taksave për ndjekjen e procesit të arkëtimit të tyre. Nga sektori i taksave janë dërguar njoftimet për likuidimin e detyrimeve, paralajmërim për bllokim të llogarive bankare, por pa konkluduar në bllokimin e llogarive bankare.

**Zbatimi:** Rekomandimi 5.1 është zbatuar pjesërisht.

**6.1. Rekomandimi:** Zyra juridike në bashkëpunim me zyrën e financës Bashkia Fushë –Arrëz të ndjekë të gjitha hapat ligjore për eliminimin dhe mos likuidimin e zërit “taksa e televizorit = 100 lekë/muaj” për 3 linjat e ndriçimit rrugor dhe 1 të tregut lirë, të pasqyruar në faturat e OSHEE, pasi kjo vlerë është përfituar nga OSHEE padrejtësisht.

**Në vazhdimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Lidhur me rekomandimin e mësipërm, sektori i financës i është drejtuar zyrës juridike me shkresën nr.723 prot., datë 10.03.2022. Gjithashtu OSHEE është njoftuar për likuidimin e vlerës së përfituar padrejtësisht në vlerën 9,600 lekë, por nuk i është përgjigjur kërkesës.

**Zbatimi:** Rekomandimi 6.1 është në proces zbatimi.

**7.1. Rekomandimi:** Zyra e shërbimeve, urbanistikës dhe financës Bashkia Fushë-Arrëz të plotësojnë dokumentacionin për meremetimin dhe rikonstrukcionin e veprave të infrastrukturës, për efekt të argumentimit tyre.

**Në vazhdimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Lidhur me rekomandimin e mësipërm nuk administrohet dokumentacion mbi plotësimin e dokumentacionit për 3 praktika “Mirëmbajtjen e rrugëve të Bashkisë Fushë-Arrëz”; Shërbim në 28,9 ha pyje Qafë Mali të Bashkisë Fushë-Arrëz; Ndërtimit bazamenteve të urave fshati Koprat dhe Micoj të fshatit Iballë”.

**Zbatimi:** Rekomandimi 7.1 nuk është zbatuar.

**8.1 Rekomandimi:** Nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartohet dhe miratohet plani strategjik dhe aktivitetet të detajuara për realizimin e objektivave të përcaktuara në strategji, dokumentacioni të përgatitet në përputhje me kuadrin ligjor, kryesisht duke ruajtur hapat sipas gjurmës së auditimit ekonomik e finciar të miratuar nga Titullari i Bashkisë Fushë Arrëz.

**Menjëherë**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Lidhur me rekomandimin e mësipërm nuk administrohet dokumentacion mbi zbatimin e tij.

**Zbatimi:** Rekomandimi 8.1 nuk është zbatuar.

**9.1. Rekomandimi:** Plani strategjik, planifikimi vjetor, si dhe gjithë dokumentacioni tjetër i nevojshëm në procesin auditues të NJAB, të përpilohen në përputhje me kërkesat e manualit të auditit të brendshëm si dhe të bëhet praktikë pune çelja e dosjeve të përhershme për çdo njësi të audituar duke i pasuruar ato me materiale nga auditimet e reja me qëllim që kjo ti shërbej auditimeve pasardhëse të njësisë. Nga NJAB pas përfundimit të auditimit të brendshëm të njësisë të bashkisë, të kryhet inventarizimi i dosjes koherente për çdo auditim, dhe të arkivohen në zyrë arkivin e Bashkisë Fushë Arrëz.

**Në vazhdimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Lidhur me rekomandimin e mësipërm rezulton se nga NJAB Fushë Arrëz për periudhën 2021-2023 nuk është përgatitur plani strategjik i auditimeve.

**Zbatimi:** Rekomandimi 9.1 është zbatuar pjesërisht.

## **C. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) - Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohej në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërbllimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin

dhe të kryejë regjistrimit e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim *shpërblimin e dëmit në vlerën 8,271,878 lekë ndaj subjekteve*, si më poshtë:

**1.1.Rekomandimi:** Nga Bashkia Fushë Arrëz të merren masa që të rishikohen volumet e punimeve civile, të shoqërohen me librezat masash të sakta, në mënyrë që pagesat të argumentohen mbi bazën e volumeve të sakta.

-Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlersojnë e të analizojnë zërat e punimeve të cilat rezultuan të paargumentuara në vlerën 1,185,166 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjësitetë ligjore e financiare, për arkëtimin e vlerës.

*Menjëherë*

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 nuk është zbatuar.

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Fushë Arrëz të merren masa që të rishikohen volumet e punimeve civile, të shoqërohen me profilet tërthore e gjatësore në librezat e masave, në mënyrë që pagesat të argumentohen mbi bazën e volumeve të sakta.

-Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlersojnë e të analizojnë zërat e punimeve të paargumentuara në vlerën 2,631,616 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjësitetë ligjore e financiare, për arkëtimin e vlerës.

*Menjëherë*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Lidhur me rekomandimin 2.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, nga titullari i Bashkisë Fushë Arrëz nuk janë marrë masa për vendosjen në zbatim të tij.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 nuk është zbatuar.

**3.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor Bashkia Fushë Arrëz, të formojë një grup pune me specialistë të fushës për të verifikuar dorëzimin real të projekteve dhe përputhshmërinë me aktet e mbajtura me BOE sipërmarrës për të evidentuar arsyet e mos përfundimit në afat të kontratës, përgjegjësitetë respektive dhe marrjen e masave për zbatimin e kontratës për penalitete në shumën 4,455,096 lekë ndaj sipërmarrësit të realizimit të projekteve.

*Menjëherë*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Lidhur me rekomandimin 3.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, nga titullari i Bashkisë Fushë Arrëz nuk janë marrë masa për vendosjen në zbatim të tij.

**Zbatimi:** Rekomandimi 3.1 nuk është zbatuar.

#### **D. MASA DISIPLINORE**

**a-Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”neni 58 gërma (c)”, ndaj punonjësve si më poshtë:**

-Zj. S.M, me detyrë Specialiste e Sektorit Juridik dhe Prokurimeve.

-Z. D.L, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.

-Z. T.P, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikim-Territorit.

**b-Vëretje me paralajmërim, neni 13.3 i kontratës individuale, ndaj punonjësve si më poshtë:**

-Z. L.N, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik.

-Z. N.M, me detyrë Administrator NjA Iball.

**c-Njoftimin e Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit për Shërbimin Civil.**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Lidhur me rekomandimin për dhënien e masave disiplinore, nuk administrohet dokumentacion mbi ngritjen e komisionit disiplinor, vendimmarrjen e tij, duke vijuar me përcjelljen e masave disiplinore pranë Departamentit të Administratës Publike.

**Zbatimi:** Rekomandimi **nuk është zbatuar.**

**Pasqyra e realizimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm**

Nr	E m ë r t i m i	Rekomandimet ne numër :					Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rekoman dim gjithsej	Nga rekomandimet janë:				Rekomanduar Gjithsej		Zbatuar arkëtuar		(në proces)		Pa zbatuar	
			Zbatu ar	Zbatuar pjesërisht	Proces zbatimi	Pa zbatuar	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek
1	Masa organizative	9	1	2	1	5								
2	Shpërblim demi	3	0	0	0	3	3	8,271					3	8,271
3	Masa disiplinore	5	0	0	0	5								
	<b>Totali</b>	<b>17</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>13</b>	<b>3</b>	<b>8,271</b>					<b>3</b>	<b>8,271</b>

Foto të kryera gjatë verifikimit në terren të punimeve shtesë në objektin “Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70-vjetori i pavarësisë, Bashkia Fushë Arrëz”.


*Rezervuari*



*Pozicioni i planifikuar për vendosjen e bredhave*



*Fidanat*



**Për sa më sipër paraqitet Raporti Përfundimtar i Auditimit.**

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**